



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
MINISTRI I SHTETIT
PËR DIASPORËN

PLANI I VEPRIMIT PER ZBATIMIN E STRATEGJISE KOMBETARE TE DIASPORES

BULETIN

Nr. 2 Qershor 2020

AGJENCIA
KOMBËTARE
E DIASPORËS



PËRMBAJTJA

HYRJE	3
QËLLIMI I BULETINIT	4
ZBATIMI I MASAVE 2018 - 2020	5

Hyrje

Diaspora shqiptare është një vlerë e shtuar e kombit. Ajo nuk është vetëm një burim, faktor dhe rezervuar të ardhurash financiare, por një kapital i madh njerëzor dhe social.

Duke u bazuar në kontributin, potencialet e Diasporës shqiptare dhe rëndësinë e angazhimit të saj në zhvillimin ekonomik, shoqëror e kulturor të vendit, politikëbërësit dhe institucionet shtetërore shqiptare vijojnë me hartimin dhe zbatimin e politikave shtetërore gjithëpërfshirëse për marrëdhëniet e shtetit shqiptar me Diasporën.

Strategjia Kombëtare e Diasporës (2018-2024) dhe Plani i Veprimit, miratuar me Vendimin Nr.259, datë 09.05.2018, të Këshillit të Ministrave, është një ndër dokumentet thelbësore mbi politikën e reja për Diasporën. Strategjia është një hap i rëndësishëm i reformës shtetërore për Diasporën dhe synon të ndërtojë një bashkëpunim gjithëpërfshirës me komunitetet e Diasporës. Objektivat e Strategjisë realizohen nëpërmjet zbatimit të 72 masave të Planit të Veprimit.

Agjencia Kombëtare e Diasporës ndjek zbatimin e masave të Planit të Veprimit nga institucionet përkatëse dhe informon çdo tre muaj publikun mbi ecurinë dhe procesin e zbatimit të masave, përmes publikimit të Buletinit.

Buletini nr. 2 (qershor 2020) është vazhdim i publikimeve të mëparshme dhe në të jepet një informacion i detajuar mbi ecurinë e zbatimit të masave të Planit të Veprimit, të Strategjisë Kombëtare të Diasporës nga institucionet shtetërore përgjegjëse për politikën e Diasporës. Publikimi i këtij dokumenti synon informimin e qytetarëve të interesuar brenda dhe jashtë vendit për ecurinë e politikave shtetërore për Diasporën. Gjithashtu, publikimi i Buletinit informon anëtarët e strukturave vendimmarrëse lidhur me politikën ekzistuese, sukseset e arritura dhe vështirësitë e hasura gjatë reformës shtetërore për Diasporën.

Buletini mbetet një dokument i hapur për çdo vërejtje dhe sugjerim. Institucionet, grupet e interesit, publiku, media dhe qytetarët janë të mirëpritur për propozimet e tyre, të cilat do të shërbejnë për fuqizimin e bashkëpunimit me Diasporën.

Agjencia Kombëtare e Diasporës
Tiranë
Qershor 2020

BULETINI Nr.2, QERSHOR 2020¹

QËLLIMI I PUBLIKIMIT TË BULETINIT “PËR ZBATIMIN E MASAVE TË PLANIT TË VEPRIMIT TË STRATEGJISË KOMBËTARE TË DIASPORËS 2018 - 2024” ËSHTË INFORMIMI I:

1. ANËTARËVE TË KOMITETIT SHTETËROR TË DIASPORËS MBI ECURINË E PLANIT TË VEPRIMIT TË STRATEGJISË KOMBËTARE TË DIASPORËS (2018-2024), MIRATUAR ME VENDIMIN NR.259/2018, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE.
2. ANËTARËVE TË NËNKOMISIONIT PËR DIASPORËN DHE MIGRACIONIN NË PËRBËRJE TË KOMISIONIT TË POLITIKËS SË JASHTME TË KUVENDIT TË SHQIPËRISË, NGRITUR ME VENDIMIN NR.98/2017, TË KUVENDIT TË SHQIPËRISË.
3. INSTITUCIONEVE PËRGJEGJËSE PËR ZBATIMIN E MASAVE TË PLANIT TË VEPRIMIT TË STRATEGJISË KOMBËTARE TË DIASPORËS.
4. PUBLIKUT TË INTERESUAR PËR ECURINË E REFORMËS NË FUSHËN E MARRËDHËNIEVE ME DIASPORËN SHQIPTARE.

¹ Buletini Nr. 2 (qershor 2020) përmban gjithashtu disa prej masave të Planit të Veprimit të vitit 2018 dhe 2019 të cilat janë në proces realizimi.

MASAT E PLANIT TE VEPRIMIT 2018-2020



|| Masa Nr. 1 ||

Bërja funksionale e institucioneve që legjislacioni i ri ngarkon për fushën e marrëdhënieve shtetërore me diasporën, siç janë Agjencia Kombëtare për Diasporën, Fondi për Zhvillimin e Diasporës dhe Qendra e Botimeve për Diasporën. Hartimi i një plani të detajuar për përthithjen e fondeve të nevojshme për financimin e politikave dhe të masave të parashikuara në Strategjinë Kombëtare. Ndarja e qartë e kompetencave midis strukturave që do të merren me trajtimin e diasporës. Krijimi i një njësie të specializuar për rishikimin e legjislacionit për diasporën për të ndërmarrë ndryshimet e nevojshme.

INDIKATORËT: Krijimi i Agjencisë Kombëtare për Diasporën, Fondit për Zhvillimin e Diasporës dhe Qendrës së Botimeve për Diasporën.

AFATI KOHOR: 6 muhori i parë 2018 (periodike)

INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:

- Zëvendëskryeministri
- Ministri i Shtetit për Diasporën
- Ministri i Financave dhe Ekonomisë

Buletini 2018:

- Krijuar Këshilli Drejtues i Agjencisë Kombëtare të Diasporës në zbatim të Ligjit Nr.115/2017 “Për Krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës” dhe Vendimit Nr.114/2018 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullave për emërimin, shkarkimin dhe shpërblimin e kryetarit dhe të anëtarëve të Këshillit Drejtues të Agjencisë Kombëtare të Diasporës”. Përmbyllja nga DAP i rekrutimeve për vendet e lira të punës. Aktualisht, Agjencia Kombëtare e Diasporës po punon për zbatimin e misionit të saj dhe Strategjisë Kombëtare të Diasporës.

- Krijuar Këshilli Drejtues i Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës me Vendimin Nr. 594/2018 të Këshillit të Ministrave “Për emërimin e kryetarit dhe të anëtarëve të Këshillit Drejtues të Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës”. Emëruar Drejtori Ekzekutiv i FSHZHD-së. Realizuar procedurat e rekrutimit për punonjësit e FSHZHD-së.

- Miratuar Vendimi Nr. 611/2018 i Këshillit të Ministrave “Për financimin e projektit “Diaspora për Zhvillim” dhe zbatimin e tij nga Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës”. Më datë 14 dhjetor 2018 u prezantua tek grupet e interesit, projekti “Diaspora për Zhvillim” i Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës.

² Gjatë 2018-ës dhe 2019-ës janë krijuar institucionet përkatëse të Diasporës të parashikuara në masën Nr. 1. Megjithatë, kjo masë është vendosur në proces për shkak të plotësimit të strukturës shtetërore përgjegjëse për diasporën me institucione të reja të domosdoshme për adresimin në mënyrë më gjithëpërfshirëse të diasporës shqiptare. Me krijimin e Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët krijohet një institucion i posaçëm kushtuar komunitetit Arbëresh.

~ Miratuar Vendimi Nr. 637/2018 i Këshillit të Ministrave “Për dhënien në përdorim, pa shpërblim, nga Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare tek Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës dhe Qendra e Botimeve për Diasporën, të vilave Nr.5, Nr. 6 dhe të palestrës të Bllokut të Vilave Gjermane, Tiranë”.

~ Miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë Ligji Nr. 99/2018 “Për Buxhetin e vitit 2019” ku janë parashikuar edhe fondet për institucionet e Diasporës.

Janar - Mars 2019:

~ Qendra e Botimeve për Diasporën ka nisur funksionimin në janar të 2019-ës.

~ Në përputhje me Vendimin Nr. 469/2018 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve për Diasporën”, janë emëruar me Urdhrin Nr. 3/2018, të Ministrit të Shtetit për Diasporën kryetari dhe anëtarët e Këshillit Koordinues të Botimeve për Diasporën.

~ Është emëruar Drejtori i Qendrës së Botimeve për Diasporën. Në proces miratimi i strukturës dhe emërimi i personelit.

~ Realizuar dhe miratuar Raporti vjetor i punës për vitin 2018 nga Agjencia Kombëtare e Diasporës dhe Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës.

~ Dërguar me shkresën Nr. 1827 Prot., datë 29 mars 2019, “Raporti vjetor i punës për vitin 2018 të Agjencisë Kombëtare të Diasporës”, Komisionit për Politikën e Jashtme dhe Nënkomisionit për Diasporën dhe Migracionin, në Kuvendin e Shqipërisë.

~ Dërguar me shkresën Nr. 1813 Prot., datë 29 mars 2019, “Raporti vjetor i punës për vitin 2018 të Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës”, Komisionit për Politikën e Jashtme dhe Nënkomisionit për Diasporën dhe Migracionin, në Kuvendin e Shqipërisë.

Prill - Qershor 2019:

~ Miratuar Urdhri Nr. 76, datë 15.04.2019 i Kryeministrit “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Qendrës së Botimeve për Diasporën”. U ngrit komisioni përgjegjës për rekrutimin e personelit të Qendrës së Botimeve për Diasporën, i cili e përfundoi procesin e rekrutimit duke e bërë funksional këtë institucion.

~ Miratuar Vendimi Nr. 371, datë 29.05.2019 i Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr.594, datë 09.10.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për emërimin e kryetarit dhe të anëtarëve të Këshillit Drejtues të Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës”, të ndryshuar”. Këshilli i Ministrave miratoi propozimin e Ministrit të Shtetit për Diasporën për ndryshimet dhe shtesat e anëtarëve të Këshillit Drejtues të Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës. Sipas vendimit, znj. Fjoralba Caka emërohet si përfaqësuese nga ministria përgjegjëse për drejtësinë; z. Kostandin Shkurti emërohet si përfaqësues nga ministria përgjegjëse për arsimin; znj. Kozeta Angjeliu emërohet si përfaqësuese nga ministria përgjegjëse për kulturën; dhe znj. Anila Hyka Smorgrav emërohet si përfaqësuese nga Këshilli Koordinues i Diasporës. Për herë të parë një anëtar i Diasporës shqiptare ka mundësinë për të kontribuar pranë një institucioni publik në Shqipëri.

~ Miratuar Vendimi Nr. 321, datë 15.05.2019 i Këshillit të Ministrave “Për financimin e

projektit “Diaspora shkencore si një faktor ndryshimi në procesin e integrimit evropian të Shqipërisë” dhe zbatimin e tij nga Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës”. Projekti ka si qëllim angazhimin e Diasporës shkencore shqiptare dhe profesionistëve të kualifikuar, në zbatim të Strategjisë Kombëtare, me qëllim gjenerimin e transformimeve ekonomike dhe sociale në Shqipëri.

~ Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës, në kuadër të projektit “Diaspora shkencore si një faktor ndryshimi në procesin e integrimit evropian të Shqipërisë”, ka realizuar procedurat e rekrutimit për punonjësit lidhur me vendet e shpallura për zbatimin e këtij projekti.

Korrik - Shtator 2019:

~ Miratuar Vendimi Nr. 514, Datë 19.7.2019 i Këshillit të Ministrave “Për financimin e projektit “Për Dhomën e Biznesit të Diasporës - krijimi dhe nxitja e investimeve të diasporës në Shqipëri”, dhe zbatimin e tij nga Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës”. Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës ka filluar procedurën e rekrutimit të punonjësve. Dhoma e Biznesit të Diasporës do të inaugurohet në nëntor 2019.

~ Miratuar Vendimi Nr. 601, Datë 04.09.2019 i Këshillit të Ministrave “Për krijimin e Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët”. Kjo qendër do të ketë si qëllim studimin e specializuar të historisë, letërsisë dhe kulturës së komunitetit arbëresh. Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët do të nisë funksionimin administrativ nga janari i vitit 2020.

Tetor - Dhjetor 2019:

~ Inagurimi i fillimit të funksionimit të Dhomës së Biznesit të Diasporës në datë 27 nëntor 2019. Ajo u regjistrua me Vendimin Nr. 6378, datë 12.11.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Dhoma e Biznesit të Diasporës shqiptare e nisi punën e saj me organizimin e sipërmarrësve shqiptarë në diasporë për të kontribuar në ndihmë të familjeveve shqiptare të prekura nga tërmeti i datës 26 nëntor 2019.

~ Në datë 18 dhjetor 2019 u realizua mbledhja e parë zyrtare e Këshillit Koordinues të Diasporës. Këshilli filloi veprimtarinë e tij si struktura e parë në shtetin shqiptar që përfaqëson dhe koordinon marrëdhëniet me diasporën. Në mbledhjen e parë të tij Këshillit Koordinues i Diasporës mori disa vendime:

- Vendimi Nr. 1, datë 18.12.2019 “Për zgjedhjen e kryetarit, nënkryetarit dhe sekretarit të Këshillit Koordinues të Diasporës”. Sipas këtij vendimi, struktura organizative përbëhet nga kryetari z. Mark Gjonaj; nënkryetare znj. Anila Hyka Smorgrav; dhe sekretare znj. Adriana Fishta Bejko.
- Vendimi Nr. 2, datë 18.12.2019 “Për miratimin e Rregullores së funksionimit të Këshillit Koordinues të Diasporës”.
- Vendimi Nr. 3, datë 18.12.2019 “Për ngritjen e grupit të punës për organizimin e Kuvendit të III-të të diasporës”. Sipas këtij vendimi, anëtarët e Këshillit u dakordësuan që “Samiti i Diasporës” të zëvendësohet me “Kuvendi i Diasporës”.

~ Miratuar buxheti për funksionimin e Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët, e cila do të fillojë veprimtarinë në janar 2020.

Janar - Mars 2020:

~ Në datën 18 shkurt 2020, Agjencia Kombëtare e Diasporës, Qendra e Botimeve për Diasporën dhe Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës raportuan në Nënkomisionin për Diasporën dhe Migracionin në Kuvend mbi veprimtarinë e institucioneve përkatëse të realizuar gjatë vitit 2019. Në këtë raportim, Ministri i Shtetit për Diasporën i kërkoi Nënkomisionit për Diasporën dhe Migracionin një seancë dëgjimore me përfaqësues nga Ministria e Brendshme, ALEAT dhe Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme mbi përditësimin e regjistrit të shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë vendit.

~ Filloi funksionimin Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët, me miratimin e Urdhrit Nr. 38, datë 18.02.2020 të Kryeministrit “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët”. Në përputhje me këtë urdhr, në proces realizimi i procedurave të rekrutimit për vendet e lira të punës.

~ Miratuar Urdhri Nr. 5, datë 26.02.2020 i Ministrit të Shtetit për Diasporën “Për miratimin e anëtarëve të Këshillit Koordinues të Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët”. Në përbërje të këtij Këshilli ka përfaqësues nga Akademia e Shkencave; Akademia e Studimeve Albanologjike; ministria përgjegjëse për politikën e jashtme; ministria përgjegjëse për kulturën, Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë; Universiteti i Tiranës; Agjencia Kombëtare e Diasporës dhe tre përfaqësues nga komuniteti Arbëresh, njëri prej të cilëve është nga komuna e Zarës, në Kroaci. Këshilli Koordinues i Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët mbajti mbledhjen e tij të parë më 5 mars 2020 ku miratoi rregulloren e funksionimit të këtij këshilli si dhe planin e aktiviteteve për vitin 2020 të Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët.

~ Kryesia e Dhomës së Biznesit të Diasporës zhvilloi mbledhjen e parë për vitin 2020 në datën 10 mars 2020. Në këtë mbledhje u miratua Rregullorja e Dhomës së Biznesit e cila bën plotësisht funksionale veprimin e saj. Në këtë mbledhje u prezantuan propozime konkrete rreth strategjisë për zhvillimin e Dhomës së Biznesit të Diasporës si dhe shërbimeve që ajo do të ofrojë në të ardhmen.

Prill - Qershor 2020:

~ Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët, institucioni më i ri shtetëror i miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.601, datë 04.09.2019 ka filluar funksionimin e plotë. Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët ka për mision studimin dhe mbrojtjen e trashëgimisë historike të komunitetit arbëresh, dhe për të promovuar arritjet kryesore të tyre.

ME VONESË

Masa Nr.2

Miratimi në Komitetin Shtetëror për Diasporën i programit vjetor për diasporën (aktivitetet që përfshijnë librin, arsimin, kulturën dhe biznesin) dhe në bashkëpunim me Kuvendin e Shqipërisë, vlerësimin e pjesëmarrjes e përfaqësimit në to. Përgatitja e informacioneve vlerësuese për Komitetin Shtetëror të Diasporës dhe Nënkomisionin e Kuvendit për Diasporën dhe Migracionin.

INDIKATORËT: Miratimi në Komitetin Shtetëror për Diasporën i programit vjetor për diasporën.

AFATI KOHOR: 6 mujori i dytë 2018 (periodike)

INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:

- Ministri i Shtetit për Diasporën
- Ministria e Kulturës
- Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit
- Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes

Buletini 2018:

~ Më datë 14 dhjetor 2018 u prezantua Projekti “Diaspora për Zhvillim” i Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës.

~ Miratuar Urdhri Nr.138/2018, i Kryeministrit, “Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për zbatimin e masave 2 dhe 45, të Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare të Diasporës”.

Janar - Mars 2019:

~ Publikuar dokumenti i Programit Vjetor të Aktiviteteve për Diasporën. Në vijim përgatitja e informacioneve vlerësuese për Programin Vjetor për Komitetin Shtetëror të Diasporës dhe Nënkomisionin Parlamentar për Diasporën dhe Migracionin me qëllim fillimin e punës për organizimin e Programit Vjetor të aktiviteteve të vitit 2020.

~ Miratuar Urdhri Nr.44/2019 i Kryeministrit “Për caktimin e koordinators shtetëror për organizimin e programit vjetor të aktiviteteve për diasporën”. Koordinatore Shtetërore është caktuar Znj. Ornela Çuçi, zëvendësministre e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit.

~ Ministri i Shtetit për Diasporën, me shkresën Nr. 1576 Prot., datë 19.03.2019, i ka përcjellë Kryeministrit konkluzionet për zbatimin e Urdhrit Nr. 138/2018 të Kryeministrit “Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për zbatimin e masave 2 dhe 45, të planit të veprimit të Strategjisë Kombëtare për Diasporën”.

~ Miratuar Urdhri Nr. 55/2019 i Kryeministrit “Për shfuqizimin e Urdhrave të Kryeministrit Nr.135/2018, Nr. 136/2018 dhe Nr. 138/2018”. Shfuqizimi ishte vlerësim i përbashkët i Grupit të Punës të krijuar me Urdhrin Nr.138/2018 të Kryeministrit për zbatimin e Masës 2 dhe 45 duke u nisur nga fakti se grupi e ka realizuar qëllimin e tij.

Prill - Qershor 2019:

~ Në 3 maj 2019 u zhvillua mbledhja e Komitetit Shtetëror për Diasporën, ku koordinatorët shtetërorë bënë një prezantim të shkurtër të politikave të institucioneve të tyre lidhur me fushën e përgjegjësisë të secilit koordinator për zbatimin e masave të Strategjisë Kombëtare të Diasporës. Koordinatorët që raportuan në mbledhje e Komitetit janë si më poshtë:

- Koordinatori Shtetëror për marrëveshjet shtetërore në fushën e sigurimeve për shtetasit shqiptarë jashtë vendit - zëvendësministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, z. Etjen Xhafaj;
- Koordinatori Shtetëror për organizimin e programit vjetor të aktiviteteve për diasporën shqiptare - zëvendësministre e Turizmit dhe Mjedisit, znj. Ornela Çuçi;
- Koordinatori Shtetëror për marrëveshjet shtetërore në fushën e njohjes së lejeve të drejtimit të automjeteve për shtetasit shqiptarë jashtë vendit - zëvendësministri i Infrastrukturës dhe Energjisë, z. Artan Shkreli;
- Koordinatori Shtetëror për programet/donatorët të cilët ofrojnë bursa studimi për jashtë vendit - zëvendësministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë, z. Redi Shtino; dhe
- Koordinatori Shtetëror për informimin e diasporës, drejtori i programimit dhe zhvillimit në Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), z. Fatjon Hallkaj.

- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, me shkresat Nr. 7508 Prot., datë 21.05.2019 dhe Nr. 8299 Prot., datë 05.06.2019 ka percjellë informacion pranë Agjencisë Kombëtare të Diasporës dhe Ministrisë të Shtetit për Diasporën mbi realizimin e kalendarit të aktiviteteve kulturore të disa përfaqësive diplomatike të Republikës së Shqipërisë.

Korrik - Shtator 2019:

- Në 17 shtator 2019 u zhvillua mbledhja e Komitetit Shtetëror për Diasporën, ku u raportua mbi veprimtarinë e strukturave shtetërore për Diasporën. Koordinatorët Shtetërorë raportuan mbi detyrat e përcaktuara në urdhrat e emërimit të tyre nga Kryeministri.

- Janë emëruar znj. Lorena Haxhiu, me Urdhrin nr.112, datë 30.8.2019 të Kryeministrit “Për caktimin e koordinatorit shtetëror për realizimin e programit “Jam shqiptar” të gjuhës dhe kulturës shqipe” dhe znj. Fjoralba Cakaj, me Urdhrin nr. 92, datë 17. 05. 2019 të Kryeministrit “Për ngritjen e grupit të punës dhe caktimin e personit përgjegjës për mbrojtjen e të drejtave të shqiptarëve që vuajnë heqjen e lirisë jashtë vendit, të drejtave të migrantëve nëpërmjet informimit mbi mundësitë e ndryshme për të apeluar ndaj shkeljeve të të drejtave të tyre, në strukturat e vendeve pritëse si dhe në ato ndërkombëtare”.

Tetor - Dhjetor 2019:

- Në datë 20 nëntor 2019 u zhvillua mbledhja e grupit të punës me Koordinatorin Shtetëror për Programin e Aktiviteteve për Diasporën Shqiptare, znj. Ornela Çuçi. Secili nga institucionet ka përgatitur programin e aktiviteteve me fokus diasporën dhe grupi i punës do të koordinojë të gjitha aktivitetet për t'i përmbledhur në një program të përbashkët. Programi Shtetëror i Aktiviteteve për Diasporën Shqiptare për vitin 2020 do të publikohet në muajin janar.

Janar - Mars 2020:

Koordinatorja Shtetërore për organizimin e programit vjetor të aktiviteteve për diasporën shqiptare, znj. Ornela Çuçi në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Diasporës po vijon me procesin e hartimit të programit të përbashkët të aktiviteteve për diasporën për vitin 2020. Informacioni përkatës po koordinohet me institucionet

qendrore si Ministria e Kulturës, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Agjencia Kombëtare e Turizmit dhe Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), si dhe institucionet vendore, konkretisht Këshillat e Qarqeve të Tiranës, Durrësit, Shkodrës, Fierit, Korçës, Beratit, Dibrës, Gjirokastrës, Elbasanit, Kukësit, Lezhës dhe Vlorës, si dhe Prefektët e këtyre qarqeve. Realizimi i kësaj mase është i vonuar.

Prill - Qershor 2020:

~ Për shkak të situatës të shpalljes së emergjencës kombëtare nga gjendja virusale "Covid-19", programi shtetëror i aktiviteteve për Diasporën për 2020 po rishikohet nga institucionet përgjegjëse.

NË PROCES

| Masa Nr.3 |

Ndjekja e procedurave të nevojshme, koordinatave për të diskutuar çdo vit në Komitetin Shtetëror të Diasporës dhe për të parashikuar në buxhetin vjetor (pasardhës) fondet e nevojshme për të zbatuar Strategjinë Kombëtare të Diasporës dhe planin e veprimit deri në vitin 2024.

INDIKATORËT: Procedurave të nevojshme koordinative për të diskutuar dhe për të parashikuar në buxhetin vjetor (pasardhës).

AFATI KOHOR: 6 mujori i dytë 2018 (periodike)

INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:

**Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
Ministria e Kulturës
Ministri i Shtetit për Diasporën**

Buletini 2018:

~ Vendosja e zbatimit të masave të Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare të Diasporës 2018 - 2024 në "kontratën e performancës" për vitin 2019, kontratë e cila lidhet ndërmjet Kryeministrit dhe anëtarëve të Këshillit të Ministrave.

~ Gjatë vitit 2018 në mbledhjet e Komitetit Shtetëror të Diasporës janë diskutuar çështjet si më poshtë: Strategjia Kombëtare e Diasporës, publikimi i Buletinit të Planit të Veprimit, si edhe buxheti i nevojshëm për zbatimin e masave të parashikuara në Planin e Veprimit të Strategjisë Kombëtare të Diasporës.

Janar - Mars 2019:

~ Në kuadër të projektit "Për Angazhimin e Diasporës Shqiptare për Zhvillimin Social dhe Ekonomik të Shqipërisë" në bashkëpunim me zyrën e IOM në Tiranë, financuar nga zyra e Kooperacionit Italian, ka filluar puna për rivlerësimin e Strategjisë Kombëtare të Diasporës 2018 - 2024 dhe të Planit të Veprimit. Ky projekt u diskutua në një sesion të veçantë në Samitin e Dytë të Diasporës.

- Rivlerësimi i Strategjisë Kombëtare të Diasporës 2018 - 2024 dhe Planit të Veprimit po kryhet me mbështetjen e ekspertizës ndërkombëtare në funksion të buxhetimit të detajuar të masave të Planit të Veprimit sipas institucioneve përgjegjëse. Për këtë qëllim, zyra e IOM në Tiranë ka organizuar dy takime të veçanta në datat 15 janar dhe 19 shkurt me koordinatorët e Agjencisë Kombëtare të Diasporës si edhe me Grupin e Koordinatorëve për zbatimin e Strategjisë Kombëtare³, ngritur me Urdhrin Nr. 98/2018, të Kryeministrit “Për përcaktimin e grupit të koordinatorëve për zbatimin e Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare për Diasporën 2018-2024”.

Prill - Qershor 2019:

- Në kuadër të projektit “Për Angazhimin e Diasporës Shqiptare për Zhvillimin Social dhe Ekonomik të Shqipërisë”, të financuar nga Kooperacioni Italian, nëpërmjet zyrës së IOM-it në Tiranë, ka përcjellë pranë Ministrit të Shtetit për Diasporën propozimet për përmirësimin e dokumentit të Strategjisë Kombëtare për Diasporën dhe Planit të Veprimit 2018 - 2024. Pjesë e propozimeve ishte edhe kostimi i masave të Planit të Veprimit. Ky dokument do të jetë i hapur për konsultime dhe sugjerime në procesin e rishikimit periodik të Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare për Diasporën 2018-2024.

Korrik - Shtator 2019:

- Në kuadër të diskutimeve të zhvilluara gjatë Samitit të Dytë të Diasporës lidhur me rishikimin e Strategjisë Kombëtare të Diasporës, ekspertët e Organizatës Ndërkombëtare për Migracion (IOM) kanë ndryshime në Strategjinë Kombëtare të Diasporës sidomos lidhur me kostimin e masave të Planit të Veprimit.

- Filloi procesi i diskutimit të Projektit të Strategjisë Kombëtare 2021-2025 e cila do të kalojë në disa faza:

- Faza e Parë do të jetë periudha për mbledhjen e opinioneve me shkrim nga individë dhe ekspertë të ndryshëm (nëntor 2019)
- Faza e Dytë do të jetë diskutimi në publik i projekt-dokumentit të Strategjisë Kombëtare të Diasporës (mars 2020)
- Faza e Tretë do të jetë përmbledhja dhe miratimi i Strategjisë Kombëtare (qershor 2020)

Projekti i dokumentit të ndryshuar të Strategjisë Kombëtare të Diasporës 2021 - 2025 është i hapur për konsultimin publik në faqen zyrtare të Ministrit të Shtetit për Diasporën www.diaspora.gov.al.

Tetor - Dhjetor 2019:

- Vazhdon procesi i rishikimit të Strategjisë Kombëtare të Diasporës dhe Planit të Veprimit 2021 -2025. Agjencia Kombëtare e Diasporës ndjek dhe mbledh opinionet e konsultimit publik në platformën elektronike www.konsultimipublik.gov.al edhe nëpërmjet emailit zyrtar info@akd.gov.al.

³ <https://diaspora.gov.al/diskutimi-mbi-angazhimin-e-diaspores-ne-zhvillimin-social-dhe-ekonomik-te-shqiperise/>

~ Në përputhje me parashikimet ligjore Agjencia Kombëtare e Diasporës, Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës dhe Qendra e Botimeve për Diasporën kanë depozituar parashikimet buxhetore pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Në datën 18 dhjetor 2019, Kuvendi i Shqipërisë miratoi ligjin “Për Buxhetin e vitit 2020” sipas parashikimeve buxhetore të bëra nga institucionet e sipërpërmendura.

Janar - Mars 2020:

~ Ministri i Shtetit për Diasporën dhe Agjencia Kombëtare e Diasporës vijojnë konsultimin publik për projekt Strategjinë Kombëtare të Diasporës, të rishikuar nga Organizata Kombëtare e Migracionit (IOM), me koordinatorët për zbatimin e Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare të Diasporës.

Prill - Qershor 2020:

~ Miratuar Urdhri Nr. 53, datë 09.04.2020 i Kryeministrit “Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për rishikimin e Strategjisë Kombëtare të Diasporës dhe të Planit të Veprimit”.

~ Në datë 26.05.2020 u zhvillua mbledhja e parë e grupit ndërinstitucional të punës për rishikimin e Strategjisë Kombëtare të Diasporës. Qëllimi i mbledhjes ishte hartimi i një programi pune lidhur me detyrat e grupit, mbi bazën e propozimeve e diskutimeve nga anëtarët e tij, për rishikimin e masave të Planit të Veprimit.

~ Në datë 19.06.2020 u zhvillua mbledhja e dytë e grupit ndërinstitucional të punës për rishikimin e Strategjisë Kombëtare të Diasporës. Gjatë takimit virtual, ministri Majko prezantoi draftin e Strategjisë dhe kërkoi sugjerimet e anëtarëve të grupit lidhur me rishikimin e masave të Planit të Veprimit. Strategjia e rishikuar do të paraqitet për miratim në Këshillin e Ministrave.

Realizuar (periodike)

| Masa Nr.4 |

Krijimi i grupit të punës për përgatitjen dhe organizimin e Samitit të Diasporës si ngjarja më e rëndësishme e komuniteteve shqiptare jashtë vendit. Organizimi periodik i Samitit të Diasporës Shqiptare, me qëllim shqyrtimin e politikave aktuale për mobilizimin e diasporës shqiptare, ku do të shqyrtohen çështjet si ruajtja e gjuhës dhe kulturës, fenomeni i ikjes së trurit dhe investimet në Shqipëri.

INDIKATORËT: Krijimi i Grupit të Punës për përgatitjen dhe organizimin e Samitit të dytë të Diasporës. Organizimi periodik i Samitit të Diasporës Shqiptare.

AFATI KOHOR: 6 mujori i parë 2018 (periodike)

INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:

- Ministri i Shtetit për Diasporën
- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë
- Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë

Buletini 2018:

~ Miratuar Urdhri Nr. 96/2018 “Për ngritjen e grupit të punës për organizimin e Samitit të Diasporës”. Në zbatim të këtij Urdhri u ngrit grupi i punës për organizimin e Samitit dhe u përcaktuan detyrat për çdo ministri dhe institucion përgjegjës.

Janar - Mars 2019:

~ Samiti i Dytë i Diasporës u organizua në datat 28 shkurt deri 2 mars 2019.

~ Sesioni kryesor i diskutimit të Samitit u organizua në 4 panele me tematikat e mëposhtme:

Paneli I: “Vota si e Drejtë! Politika e Re Shtetërore Për Diasporën”;

Paneli II: “Zhvillimi Ekonomik i Qëndrueshëm” Vendlindja dhe Diaspora;

Paneli III: “Identiteti Shqiptar. E ardhmja fillon nga Diaspora!”;

Paneli IV: “Ftesë nga Shtëpia Juaj”.

~ Në sesionin përmbyllës u paraqitën konkluzionet nga institucionet të cilat ishin pjesë e paneleve në Samitin e Dytë të Diasporës në funksion të përgatitjes së dokumentit “post-Samit”, i cili do të diskutohet në vazhdim me palët e interesuara. Hartimi i këtij dokumenti do të realizohet nën kujdesin e zyrës së IOM në Tiranë.

Prill - Qershor 2019:

~ Miratuar Vendimi Nr. 194, datë 05.04.2019 i Këshillit të Ministrave “Për kthim fondi në buxhetin e shtetit”. Sipas këtij vendimi, Drejtorja e Shërbimeve Qeveritare e cila menaxhoi fondet për Samitin e Dytë të Diasporës Shqiptare do të kthejë në buxhetin e shtetit, shumën prej 14 561 598 (katërmëdhjetë milionë e pesëqind e gjashtëdhjetë e një mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e tetë) lekë.

Korrik - Shtator 2019:

~ Për krijimin e rrjeteve të profesionistëve në komunitetet shqiptare në Diasporë, nga institucionet e reja shtetërore të Diasporës, do të organizohen aktivitete të përvitshme. Takimet e planifikuara për fillimin e 2020 dhe të miratuara në Komitetin Shtetëror të Diasporës janë:

- Samiti i Grave të Biznesit (18 janar 2020)
- Takimi i Mjekësisë në Diasporë (20 shkurt 2020)
- Takimi i Shkrimtarëve në Diasporë (22 shkurt 2020)
- Takimi i Mësuesve në Diasporë (14 mars 2020)
- Takimi i Juristëve në Diasporë (4 prill 2020)

Tetor - Dhjetor 2019:

~ U zhvillua mbledhja e parë zyrtare e Këshillit Koordinues të Diasporës në Ditën Kombëtare të Diasporës, në datë 18 dhjetor 2019. Gjatë takimit, anëtarët e Këshillit miratuan vendimet e mëposhtme:

- Vendimi Nr. 1, datë 18.12.2019 “Për zgjedhjen e kryetarit, nënkryetarit dhe sekretarit të Këshillit Koordinues të Diasporës”. Sipas këtij vendimi, struktura organizative përbëhet nga kryetari z. Mark Gjonaj; nënkryetare znj. Anila Hyka Smorgrav; dhe sekretare znj. Adriana Fishta Bejko.
- Vendimi Nr. 2, datë 18.12.2019 “Për miratimin e Rregullores së funksionimit të

Këshillit Koordinues të Diasporës”.

- Vendimi Nr. 3, datë 18.12.2019 “Për ngritjen e grupit të punës për organizimin e Kuvendit të III-të të diasporës”. Sipas këtij vendimi, anëtarët e Këshillit u dakordësuan që “Samiti i Diasporës” të zëvendësohet me “Kuvendi i Diasporës”.

- Në kuadër të krijimit të rrjeteve të profesionistëve në komunitetet shqiptare në Diasporë, Agjencia Kombëtare e Diasporës, Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës dhe Qendra e Botimeve për Diasporën do të organizojnë disa takime gjatë vitit 2020:

- Në proces përgatitja e Samitit të Grave të Biznesit (16-18 janar 2020) i cili do të organizohet nga Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe Dhomën e Biznesit të Diasporës. Në këtë aktivitet do të marrin pjesë gra sipërmarrëse të Diasporës, profesioniste të reja, studente, akademike dhe eksperte në fushën e biznesit, përfaqësuese të institucioneve shtetërore, si dhe të organizatave ndërkombëtare.

- Takimi i Mjekësisë në Diasporë (20 shkurt 2020) - Në kuadër të përgatitjeve për takimin, janë dërguar rreth 100 ftesa elektronike për pjesëmarrje tek anëtarët e Diasporës shqiptare dhe është në proces hartimi i programit për takimin.

- Takimi i Shkrimtarëve në Diasporë (22 shkurt 2020) do të organizohet nga Qendra e Botimeve për Diasporën në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës. Është hapur formulari i aplikimit online si dhe është përgatitur agjenda e takimit.

- Takimi i Mësuesve në Diasporë (14 mars 2020) do të organizohet nga Qendra e Botimeve për Diasporën në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Është krijuar dhe hapur formulari i aplikimit online për regjistrimin e mësuesve pjesëmarrës dhe është përgatitur agjenda e takimit.

- Takimi i Juristëve në Diasporë (4 prill 2020) - Agjencia Kombëtare e Diasporës me mbështetjen e Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë të Shtetit për Diasporën do të organizojë takimin e juristëve në Diasporë. Në proces përgatitja e programit të takimit.

Janar - Mars 2020:

- Këshilli i Koordinues të Diasporës ka vendosur që aktiviteti i Samitit të quhet “Kuvendi i Diasporës”. Ky aktivitet do të koordinohet nga ky Këshill në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse shtetërore.

Prill - Qershor 2020:

- Nuk ka informacion të ri për këtë periudhë. Kjo çështje do të ndiqet në bashkëpunim me Këshillin Koordinues të Diasporës.

Realizuar

Masa Nr.5

Krijimi i Këshillit Koordinues të Diasporës, si një strukturë koordinative për të punuar për forcimin organizativ të komuniteteve shqiptare me qëllim përfshirjen dhe partneritetin në zhvillimin e Shqipërisë.

INDIKATORËT: Krijimi i Këshillit Koordinativ të Diasporës si një strukturë koordinative.

AFATI KOHOR: 6 maji i dytë 2018

INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:

- **Ministri i Shtetit për Diasporën**
- **Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme**

Buletini 2018:

~ Në zbatim të Vendimit Nr. 340/2018, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për kushtet dhe mënyrën e zgjedhjes së përfaqësuesve të Këshillit Koordinues të Diasporës”, nëpërmjet Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ambasadorët e jashtëzakonshëm dhe fuqiplotë të Republikës së Shqipërisë, të akredituar jashtë vendit, i kanë paraqitur Ministrit të Shtetit për Diasporën propozimet për kandidatët për Këshillin Koordinues të Diasporës.

Janar - Mars 2019:

~ Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, me shkresën Nr. 2531 Prot., datë 19.02.2019, i ka përcjellë Ministrit të Shtetit për Diasporën kandidatët për Këshillin Koordinues të Diasporës të propozuar nga Ambasadorët e jashtëzakonshëm dhe fuqiplotë të Republikës së Shqipërisë, të akredituar jashtë vendit.

~ Publikuar kandidaturat e ardhura sipas procedurës në bazë të Vendimit Nr. 340/2018, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për kushtet dhe mënyrën e zgjedhjes së përfaqësuesve të Këshillit Koordinues të Diasporës”.

~ Në proces për miratimin e 15 anëtarëve të Këshillit Koordinues nga Këshilli i Ministrave.

Prill - Qershor 2019:

~ Miratuar Vendimi Nr. 195, datë 05.04.2019 i Këshillit të Ministrave "Për caktimin e anëtarëve të Këshillit Koordinues të Diasporës". Këshilli Koordinues i Diasporës përbëhet nga 15 anëtarë.

~ Miratuar Vendimi Nr. 320, datë 15. 05.2019 i Këshillit të Ministrave “Për statusin e anëtarëve të Këshillit Koordinues të Diasporës”. Sipas këtij vendimi, anëtarët e Këshillit Koordinues të Diasporës do të kenë mundësi të kërkojnë informacion për fushat përgjegjëse që mbulojnë, mund të propozojnë akte administrative pranë institucioneve shtetërore që lidhen me Diasporën shqiptare, si dhe mund të marrin pjesë në seancat dëgjimore të Komitetit Shtetëror të Diasporës ose komisionet e Kuvendit të Shqipërisë për çështjet që kanë të bëjnë me interesat e Diasporës shqiptare dhe me pajisjen me një adresë zyrtare.

~ Me shkresat Nr. 232; Nr. 233; Nr. 234; Nr. 235; Nr. 236; Nr. 237; Nr. 238; Nr. 239; Nr. 240; Nr. 241; Nr. 242; Nr. 243; Nr.244; Nr. 245; dhe Nr. 246 Prot, datë 20.05.2019, Agjencia Kombëtare e Diasporës i ka dërguar anëtarëve të Këshillit Koordinues të Diasporës projekt-Rregulloren e funksionimit të Këshillit Koordinues të Diasporës. Komentet dhe sugjerimet nga secili anëtar do të mblidhen në një draft përfundimtar, i cili do të realizohet brenda muajit Tetor.

- Miratuar Vendimi Nr. 371, datë 29.05.2019 i Këshillit të Ministrave "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr.594, datë 09.10.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për emërimin e kryetarit dhe të anëtarëve të Këshillit Drejtues të Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës", të ndryshuar. Këshilli i Ministrave ka miratuar propozimin e Ministrit të Shtetit për Diasporën për emërimin e znj. Anila Hyka Smorgrav, si anëtare e Këshillit Drejtues të Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës. Znj. Smorgrav do të jetë pjesë e këtij këshilli si përfaqësuese nga Këshilli Koordinues i Diasporës.

- Dërguar shkresa Nr. 267 Prot, datë 03.06.2019, "Kërkesë për pajisje me adresë zyrtare të anëtarëve të Këshillit Koordinues të Diasporës", nga Agjencia Kombëtare e Diasporës.

- Me shkresën Nr. 296/1 Prot, datë 10.06.2019, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit ka konfirmuar krijimin e adresave zyrtare për anëtarët e Këshillit Koordinues të Diasporës, të cilat tashmë janë të aksesueshme nga të gjithë anëtarët.

Korrik - Shtator 2019:

- Përgatitur dhe publikuar Revista Elektronike e Këshillit Koordinues të Diasporës. Ky dokument është një përmbledhje informuese e bazës ligjore dhe një prezantim i anëtarëve të Këshillit Koordinues të Diasporës.

- Në datat 12 - 13 tetor 2019 do të zhvillojë një takim paraprak me anëtarët e Këshillit Koordinues të Diasporës në Gjermani. Qëllimi i takimit është diskutimi mbi çështjet organizative dhe projekt rregulloren për funksionimin e Këshillit Koordinues të Diasporës. Mbledhja e parë zyrtare e Këshillit Koordinues të Diasporës do të mbahet në Tiranë më 18 dhjetor 2019.

Tetor - Dhjetor 2019:

- Në datat 12 - 13 tetor 2019, Ministri i Shtetit për Diasporën z. Pandeli Majko zhvilloi një takim përgatitor me anëtarët e Këshillit Koordinues të Diasporës në Dyseldorf, Gjermani, për mbledhjen zyrtare të datës 18 dhjetor 2019. Gjatë takimit u prezantua edhe "Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët" dhe aplikacionin "Diaspora shqiptare", i cili është një aplikacion informues jo vetëm për veprimtarinë e anëtarëve të Këshillit Koordinues të Diasporës, por edhe informacione të dobishme për komunitetin shqiptar në botë.

- Në datë 18 dhjetor 2019 u zhvillua mbledhja e parë zyrtare e Këshillit Koordinues të Diasporës. Takimin e përshëndeti Presidenti i Republikës së Shqipërisë, z. Ilir Meta dhe Kryeministri i Shqipërisë, z. Edi Rama, të cilët vlerësuan rolin e diasporës shqiptare dhe angazhimin e saj për zhvillimin vendit.

Gjatë takimit, anëtarët e Këshillit miratuan vendimet e mëposhtme:

Vendimi Nr. 1, datë 18.12.2019 "Për zgjedhjen e kryetarit, nënkryetarit dhe sekretarit të Këshillit Koordinues të Diasporës". Sipas këtij vendimi, struktura organizative përbëhet nga kryetari z. Mark Gjonaj; nënkryetare znj. Anila Hyka Smorgrav; dhe sekretare znj. Adriana Fishta Bejko.

Vendimi Nr. 2, datë 18.12.2019 "Për miratimin e Rregullores së funksionimit të Këshillit Koordinues të Diasporës".

Vendimi Nr. 3, datë 18.12.2019 "Për ngritjen e grupit të punës për organizimin e

Kuvendit të III-të të diasporës”. Sipas këtij vendimi, anëtarët e Këshillit u dakordësuan që “Samiti i Diasporës” të zëvendësohet me “Kuvendi i Diasporës”.

Anëtarët e Këshillit Koordinues zhvilluan takime të vecanata me personalitete të tjera shtetërore si Kryetarin e Kuvendit, z. Gramoz Ruci; Kryetarin e Partisë Demokratike, z. Lulzim Basha, Kryetarin e Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, z. Taulant Balla dhe Kryetarin e Bashkisë Tiranë, z. Erion Veliaj.

Janar - Mars 2020:

~ Agjencia Kombëtare e Diasporës publikoi Revistën Elektronike të mbledhjes së parë të Këshillit Koordinues të Diasporës. Kjo revistë është një botim i veçantë elektronik që përmbledh të gjitha vendimet e miratuara gjatë mbledhjes së parë, zhvilluar më 18 dhjetor 2019 në Tiranë. Pjesë e kësaj reviste është edhe Rregullorja e Funkcionimit të Këshillit.⁴

Prill - Qershor 2020:

~ Në kuadër të emergjencës së COVID-19, Këshilli Koordinues i Diasporës ka ruajtur komunikim të vazhdueshëm me strukturat shtetërore përgjegjëse.

~ Agjencia Kombëtare e Diasporës, me shkresën Nr.191 Prot. datë 28.05.2020, ka përcjellë pranë Komisionit të Posaçëm për Reformën Zgjedhore dhe Nënkomisionit për Diasporën dhe Migracionin në Kuvendin e Shqipërisë, një kërkesë për informacion të paraqitur nga kryetari i Këshillit Koordinues të Diasporës, z. Mark Gjonaj lidhur me garantimin e të drejtës së votës për shtetasit shqiptarë jashtë vendit.

~ Në datën 31 maj 2020, anëtarët e Këshillit Koordinues të Diasporës (KKD) zhvilluan mbledhjen e dytë zyrtare. Ajo u zhvillua "online". Në mbledhje morën pjesë ministri i Shtetit për Diasporën, z. Pandeli Majko, dhe Drejtorja Ekzekutive e Agjencisë Kombëtare të Diasporës, znj. Sonila Hysi. Në mbledhje u vlerësua se prej krijimit të Këshillit Koordinues të Diasporës, anëtarët e tij kanë bashkëpunuar dhe janë angazhuar për çështjet që kanë të bëjnë me përfaqësimin e interesave të shqiptarëve të larguar nga vendlindja dhe forcimin e marrëdhënieve të tyre me vendlindjen. Sipas rendit të ditës, diskutimi u hap nga Kryetari i KKD-së, z. Mark Gjonaj, për të vijuar më tej me një fjalë përshëndetëse nga ministri Majko, i cili theksoi rëndësinë e kësaj strukture përfaqësuese, me anëtarë nga Kanadaja në Australi. Ndër çështjet kryesore të diskutimit ishin miratimi i procesverbalit të mbledhjes së zhvilluar në 18 dhjetor, raportimi i grupeve të punës që mbulojnë çështjet e medias dhe komunikimit, edukimit dhe kulturës, ekonomisë dhe për organizimin e Kuvendit Mbarëkombëtar të Diasporës 2021. Në mbledhje u diskutua edhe ecuria e punës mbi garantimin e të Drejtës së Votës për Diasporën në procesin e ndryshimit të Kodit Zgjedhor. Në mbledhjen e Këshillit Koordinues të Diasporës u vendos për takimin e tretë zyrtar të Këshillit, i cili do të organizohet në datën 30 gusht 2020.

~ Agjencia Kombëtare e Diasporës, me shkresën Nr.191/1 Prot. datë 08.06.2020, ka përcjellë pranë Komisionit të Posaçëm për Reformën Zgjedhore një kërkesë për caktimin e znj. Brikena Muharremi, anëtare e Këshillit Koordinues të Diasporës, si

⁴ Revista Elektronike e mbledhjes së parë të Këshillit Koordinues të Diasporës është e disponueshme në link-un: <http://akd.gov.al/wp-content/uploads/2020/01/Revista-e-mbledhjes-s%C3%AB-K%C3%ABshillit-Koordinues-t%C3%AB-Diaspor%C3%ABs-2-1.pdf>

përfaqësuese e këtij Këshilli për çështjen e garantimit të të drejtës së votës për shtetasit shqiptarë jashtë vendit, pranë këtij komisioni.

~ Anëtarët e Këshillit Koordinues të Diasporës (KKD) zhvilluan një mbledhje online me Kryeministrin, z. Edi Rama, për të diskutuar mbi të drejtën e votës për shtetasit shqiptarë që jetojnë jashtë vendit. Në mbledhje morën pjesë edhe Ministri i Shtetit për Diasporën, z. Pandeli Majko; Ministri i Brendshëm, z. Sandër Lleshaj; bashkëkryetari i Komisionit Parlamentar për Reformën Zgjedhore dhe anëtar i Këshillit Politik, z. Damian Gjoknuri; Drejtoresha e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, znj. Mirlinda Karcanaj. Në këtë mbledhje, Kryeministri theksoi angazhimin e Qeverisë për të punuar për garantimin e votës për shtetasit shqiptarë që jetojnë jashtë vendit. Mbledhja vijoi me diskutimin e Kryetarit të KKD-së, z. Mark Gjonaj, dhe Ministrin të Shtetit për Diasporën, z. Pandeli Majko. Më pas, mbledhja vijoi me diskutimet e anëtarëve të KKD-së për angazhimin e palëve në procesin e garantimit të votës.

~ Anëtarët e Këshillit Koordinues të Diasporës (KKD) zhvilluan një mbledhje online me Kryetarin e Partisë Demokratike, z. Lulzim Basha, për të diskutuar mbi të drejtën e votës për shtetasit shqiptarë që jetojnë jashtë vendit. Kryetari i Këshillit Koordinues të Diasporës, z. Mark Gjonaj theksoi në fjalën e tij se tre janë pikat që Këshilli Koordinues të Diasporës kërkon të realizohen: sigurimi i votave të Diasporës për zgjedhjet e ardhshme parlamentare, listat e hapura si dhe garanci për pjesëmarrjen e përfaqësuesve të KKD-së dhe diasporës në procesin e implementimit (regjistrimit të listës së zgjedhësve) si dhe në procesin e numërimit.

NË PROCES

Masa Nr.6

Vlerësimi i nivelit organizativ të komuniteteve shqiptare në diasporë dhe përgatitja e një plani veprimi të veçantë për nxitjen e organizimit në nivel rajonal dhe shtetëror në vendet pritëse. Promovimi i idesë për mbajtjen e aktiviteteve që nxisin këtë nivel organizimi nëpërmjet informimit të komunitetit shqiptar dhe identifikimit të burimeve njerëzore.

INDIKATORËT: Vlerësimi i nivelit organizativ të komuniteteve shqiptare në diasporë. Promovimi i idesë.

AFATI KOHOR: 6 maji i dytë 2018 (periodike)

INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:

- Ministri i Shtetit për Diasporën
- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
- Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
- Ministria e Kulturës

Buletini 2018:

~ Në proces zbatimi i projektit “Për Angazhimin e Diasporës Shqiptare për Zhvillimin Social dhe Ekonomik të Shqipërisë” në bashkëpunim me zyrën e IOM në Tiranë, financuar nga zyra e Kooperacionit Italian.

~ Miratuar Vendimi Nr. 611/2018 i Këshillit të Ministrave “Për financimin e projektit “Diaspora për Zhvillim” dhe zbatimin e tij nga Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës”. Më datë 14 dhjetor 2018 u prezantua projekti “Diaspora për Zhvillim” i Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës.

~ Miratuar Vendimi Nr. 690/2018 të Këshillit të Ministrave, “Për prodhimin, transmetimin dhe financimin e emisioneve të posaçme televizive, arsimore dhe kulturore të dedikuara për Diasporën” i Këshillit të Ministrave.

~ Në proces marrëveshja dypalëshe në fushën e Diasporës me qeverinë e Irlandës. Në datat 29 tetor - 2 nëntor, Ministri i Shtetit për Diasporën bashkë me Drejtorin Ekzekutiv të Agjencisë Kombëtare për Diasporën zhvilluan një vizitë në Irlandë. Qëllimi i kësaj vizite ishte njohja e eksperiencave të programeve të Diasporës, duke përmendur platformën e njohur “Connect-Ireland” si dhe studimi i modelit që irlandezët kanë ndjekur në angazhimin e Diasporës së tyre në rritjen e investimeve në ekonominë vendase.

Janar - Mars 2019:

~ Miratuar Urdhri Nr. 180/2018, i Kryeministrit “Për përgatitjen e platformës së programeve të emisioneve të posaçme për mësimin e gjuhës shqipe, kulturën shqiptare dhe identitetin kombëtar, të dedikuara për Diasporën”. Në zbatim të këtij Urdhri, grupi i punës është duke përgatitur dy projekte “Fol Shqip” dhe “Krenohem me Ju”.

~ Në proces miratimi i marrëveshjeve dypalëshe në fushën e diasporës me Malin e Zi dhe Maqedoninë e Veriut.

~ Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës është në proces organizimi për zhvillimin e aktivitetit vjetor të Institutit të Alb-Shkencës, me temë “Sfidat për zhvillim të qëndrueshëm të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor në hapësirën mbarëshqiptare” më 27-29 shtator 2019, në Tiranë.

Prill - Qershor 2019:

~ Ministri i Shtetit për Diasporën zhvilloi një vizitë në komunitetin shqiptar në Ukrainë, në datat 5 dhe 6 maj 2019, me rastin e ditës së Shën Gjergjit. Në këtë ditë, komuniteti shqiptar nderon figurën e heroit tonë kombëtar Gjergj Kastriot Skënderbeu. Gjatë kësaj vizite u prezantua programi i Agjencisë Kombëtare për Diasporën, i cili konsiston në ruajtjen dhe përhapjen e gjuhës shqipe në komunitetin shqiptar në Ukrainë. Gjithashtu u dhuruan për fëmijët e komunitetit shqiptar abetare, libra në gjuhën shqipe si dhe kostume tradicionale në shenjë falenderimi për ruajtjen që i kanë bërë identitetit dhe kulturës shqiptare.

~ Nënshkruar Marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet Agjencisë Kombëtare të Diasporës dhe Teatrit Kombëtar të Operas, Baletit dhe Ansambllit Popullor “Për ruajtjen dhe promovimin e identitetit kulturor kombëtar në Diasporë”. Kjo marrëveshje parashikon organizimin e kurseve dhe trajnimeve për mësimin e valleve popullore, këngëve folklorike shqiptare nga Ansambli Shtetëror për Diasporën shqiptare. Në proces zbatimi i kësaj marrëveshjeje.

~ Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, me shkresën Nr. 8152 Prot., datë 03.06.2019 informon mbi vizitën që realizuan në Shqipëri disa nxënës shqiptarë nga Karakurti i Ukrainës, në datat 2-6 qershor 2019. Këta fëmijë u pritën edhe nga Ministri i Shtetit për Diasporën, si dhe u shoqëruan në Muzeun Historik Kombëtar. Kjo është hera e parë që një grup i organizuar fëmijësh realizojnë një ekskursion historik drejt vendit të të parëve të tyre.

Korrik - Shtator 2019:

~ Agjencia Kombëtare e Diasporës në bashkëpunim me Teatrin Kombëtar të Operas dhe Baletit po realizon për herë të parë programin e mësimin të këngëve dhe valleve shqiptare për komunitetet shqiptare në Ukrainë. Aktivitetet e organizuara vijojnë si më poshtë:

- 1 - 15 korrik 2019 grupi i parë i valltarëve zhvilloi klasat e mësimin të valleve për komunitetin shqiptar në Karakurt, Ukrainë.
- 10 - 13 shtator 2019 Agjencia Kombëtare e Diasporës zhvilloi vizitë pune në Zaporozhy, Ukrainë, ku u informua për projektet e realizuara dhe mënyrat e mbështetjes ndaj komunitetit shqiptar të Ukrainës. Ky program parashikon ofrimin e kurseve për mësimin e gjuhës shqipe dhe folklorit shqiptar. Kurset do të kryen nga mësues dhe koreografë profesionistë në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Agjencisë Kombëtare të Diasporës dhe Teatrit Kombëtar të Operas, Baletit dhe Ansambllit Popullor "Për ruajtjen dhe promovimin e identitetit kulturor kombëtar në Diasporë".
- 10 - 13 shtator 2019 në Ukrainë u firmos memorandum i bashkëpunimit me Institucionin edukativo-arsimor "Azimuth" në Priazov. Ky memorandum synon
- bashkëpunimin ndërinstitutional dhe edukimin e brezave të rinj për gjuhën, historinë dhe traditat shqiptare përmes organizimit të aktiviteteve të ndryshme në Ukrainë. Një ndër prioritetet është hapja e klasave për mësimin plotësues të gjuhës dhe kulturës shqipe për fëmijët e komunitetit shqiptar në këtë rajon. Gjithashtu memorandumit parashikon shkëmbimin arsimor të stafit pedagogjik me qëllim që mësuesit nga Ukraina të kryejnë studime të specializuara për gjuhën, literaturën dhe historinë shqiptare në Universitetin e Tiranës. Agjencia Kombëtare e Diasporës është angazhuar në monitorimin dhe zhvillimin e këtij bashkëpunimi.
- 31 tetor 2019 Agjencia Kombëtare e Diasporës, në bashkëpunim me Teatrin Kombëtar të Operas dhe Baletit të Republikës së Shqipërisë, do të organizojë një koncert në Odessa me pjesëmarrjen e valltarëve dhe instrumentistëve të Ansambllit Popullor dhe komunitetin shqiptar në Ukrainë.

~ Në datë 5 shtator 2019 Agjencia Kombëtare e Diasporës organizoi koncertin "Nëna Arbëri", me rastin e tre vjetorit të shenjtërimit të Nënë Terezës, në sheshin "Vittorio Emanuele", Piana degli Albanesi, Itali. Në këtë koncert performuan para publikut tre virtuozët e muzikës shqiptare, soprano Inva Mula, violinisti Olen Cezari, kompozitori Genc Tukiçi dhe artistë të tjerë italianë.

~ Në datat 27 - 28 shtator 2019 u zhvillua Takimi i XIV-të Ndërkombëtar "Kërkimi Shkencor në Hapësirën Mbarëshqiptare dhe Roli i Diasporës Shkencore", organizuar nga Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës në bashkëpunim me Institutin Albshkenca dhe

mbështetjen e GIZ në Shqipëri. Në këtë aktivitet, i cili kishte si synim angazhimin e diasporës shkencore shqiptare dhe profesionistëve të kualifikuar përmes shkëmbimit efektiv të njohurive, morën pjesë rreth 400 të ftuar ndër të cilët studiues të shquar të Diasporës shkencore shqiptare, anëtarë aktivë të Institutit Alb-Shkenca, studiues të rinj të angazhuar në studime pasuniversitare dhe teza doktorature; përfaqësues nga Akademia e Shkencave në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni, politikbërës, institute kërkimore, think tanks, organizata të Diasporës, profesionistë të kthyer etj. Rreth 100 ekspertë lokalë dhe profesionistë të Diasporës kontribuan në mënyrë aktive në panelet tematike dhe seksionet e konferencave shkencore të këtij takimi. Kontributet e tyre u materializuan në dy publikime: Libri me Referimet dhe Diskutimet në Panelet Tematike dhe Book of Proceedings (Përmbledhjet e punimeve shkencore).

- Në datat 17 - 20 korrik 2019 Agjencia Kombëtare e Diasporës zhvilloi një vizitë në komunitetin shqiptar në Mandrica, Bullgari ku u bisedua për projektet e përbashkëta që mund të realizohen lidhur me promovimin e turizmit dhe të vlerave kulturore të shqiptarëve në fshatin Mandricë, ku jeton komuniteti shqiptar prej vitit 1636.

- Agjencia Kombëtare e Diasporës do të organizojë në Otranto në datën 19 tetor 2019 një takim të përbashkët me arbëreshët në Itali ku do të diskutohen elementet kulturore, antropologjike, historike dhe folkloristike që bashkojnë veçoritë mes Italisë dhe Shqipërisë ndër shekuj. Ky aktivitet synon të sjellë në një dritë të veçantë kostumet tipike popullore e në veçanti “Fustanellën” dhe vallet e zonave ku banojnë arbëreshët. Në mbyllje të takimit të përbashkët, Agjencia Kombëtare e Diasporës, në bashkëpunim me Teatrin Kombëtar të Operas dhe Baletit dhe Ansamblin Popullor do të organizojë një koncert ku do të performojë trupa e Ansamblit Popullor të TOB.

- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, me shkresën Nr. 11 049 Prot., datë 29.07.2019 informon mbi takimin e zhvilluar ndërmjet ambasadorit të Republikës së Shqipërisë në Slloveni dhe ambasadorit të Republikës së Kosovës. Në periudhën shtator - tetor 2019 do të organizohet një aktivitet i përbashkët i dy ambasadave me përfaqësues të shoqatave shqiptare në Slloveni. Në këtë takim u prezantuan edhe dy projekte të tjera, si organizimi i një takimi sensibilizues për viktimat e dhunës gjatë luftës në Kosovë dhe organizimi i një veprimtarie diplomatike me trupin diplomatik dhe Ministrinë e Punëve të Jashtme të Sllovenisë, ku të promovohet biznesi shqiptar në fushën e hotelarisë dhe kulinarisë.

- Në datat 28-31 gusht 2019 përfaqësues nga Agjencia Kombëtare e Diasporës zhvilluan një takim pune në Kroaci me përfaqësuesit e shtetit kroat për Diasporën. Qëllimi i këtij takimi ishte diskutimi për bashkëpunim institucional për çështjet e Diasporës dhe mbështetjen e komunitetit shqiptar në Kroaci, në veçanti Arbëreshëve të Zarës, të cilët përbëjnë një pjesë të rëndësishme të trashëgimisë kulturore. Me Vendimin Nr. 3, datë 26.08.2019, Këshilli Drejtues i Agjencisë Kombëtare të Diasporës ka miratuar aktivitetet dhe buxhetin lidhur me mësimin e gjuhës shqipe, valleve dhe këngëve popullore, si dhe organizimin e një koncerti përmblyllës në Kroaci.

Tetor - Dhjetor 2019:

- Në datën 19 tetor 2019, Agjencia Kombëtare e Diasporës organizoi një takim të përbashkët me arbëreshët në Itali ku u diskutuan elementet kulturore, antropologjike, historike dhe folkloristike që bashkojnë veçoritë mes Italisë dhe Shqipërisë ndër shekuj. Ky aktivitet paraqiti kostumet tipike popullore e në veçanti “Fustanellën” dhe vallet e zonave ku banojnë arbëreshët. Në mbyllje të takimit të përbashkët Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansamblit Popullor organizoi një koncert me muzikë tradicionale dhe

arbëreshe.

~ Ministri i Shtetit për Diasporën, z. Pandeli Majko, zhvilloi një vizitë pune në Ukrainë në datat 28 tetor deri në 1 nëntor 2019. Ministri u takua me zëvendësministren për Integrimin në Evropë, znj. Oleksandra Klitina, ku u diskutua për marrëdhëniet e përbashkëta mes dy vendeve, veçanërisht për Marrëveshjen kuadër dypalëshe për lëvizjen e lirë për mallrat import - eksport ndërmjet dy vendeve.

Gjithashtu, ministri Majko takoi z. Bohdan Yaremenko, kryetari i Komitetit Parlamentar për Politikën e Jashtme, ku fokusi i bisedës ishin marrëdhëniet Shqipëri-Ukrainë dhe vëmendja ndaj komunitetit shqiptar në këtë vend. Në vijim, z. Majko zhvilloi një takim me zëvendësministren e Arsimit, znj. Mandzii Lubomira, lidhur me marrëdhëniet mes dy vendeve dhe studentëve me origjinë shqiptare që ndjekin studimet në Ukrainë.

Ndërkohë, me zëvendësministren e Kulturës në Ukrainë, znj. Svitlana Fomenko, ministri Majko bisedoi për një bashkëpunim ndërinstucional mes dy vendeve me qëllim hartimin e projekteve të përbashkëta kulturore në mbështetje të komunitetit shqiptar në zona të ndryshme të Ukrainës.

~ Në datë 31 tetor 2019, Agjencia Kombëtare e Diasporës, në bashkëpunim me Teatrin Kombëtar të Operas dhe Baletit të Republikës së Shqipërisë, organizoi një koncert në Odessa me pjesëmarrjen e valltarëve dhe instrumentistëve të Ansamblit Popullor dhe komunitetin shqiptar në Ukrainë.

~ Në datë 9 nëntor 2019, Ministri i Shtetit për Diasporën, z. Pandeli Majko, zhvilloi një vizitë pune në Belgjikë, ku u takua me kryetarin e Bashkisë së qytetit Namur, z. Maxime Prevot, me të cilin diskutoi rreth komunitetit shqiptar në Belgjikë, integritit të tij në shoqërinë belge dhe mundësinë e bashkëpunimeve në projekte të ndryshme për ruajtjen dhe vazhdimësinë e kulturës shqiptare në këtë komunitet.

Gjithashtu, gjatë vizitës në Belgjikë, Ministri i Shtetit për Diasporën mori pjesë në konferencën “Nënë Tereza mes nesh”, e organizuar në qytetin Namur nga shoqata shqiptare “Nënë Tereza” në bashkëpunim me organizatën studentore “Vlera” dhe me mbështetjen e Ambasadës së Republikës së Shqipërisë dhe Ambasadës së Kosovës në Bruksel.

~ Nënshkruar Marrëveshja ndërmjet Agjencisë Kombëtare të Diasporës dhe Teatrit “Migjeni”, Shkodër “Për bashkëpunimin në ruajtjen dhe promovimin e identitetit kulturor kombëtar në diasporë”. Në bazë të kësaj marrëveshjeje, në datë 14 nëntor 2019, u organizua një shfaqje teatrale nga trupa e Teatrit “Migjeni” për komunitetin shqiptar në Zarë, Kroaci.

~ Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, me shkresën Nr. 16663 Prot., datë 20.11.2019 informon mbi organizimin e aktivitetit “Krenari shqiptare” në Montreal, Kanada. Ky aktivitet synon evidentimin e shqiptarëve të suksesshëm në fusha të ndryshme, kryesisht në biznes, si dhe lehtësimin e njohjeve dhe bashkëpunimin ndërmjet tyre.

~ Me rastin e festave të nëntorit, nxënësit e gjimnazit “Petro Nini Luarasi”, me mbështetjen dhe organizimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës, vizituan fshatrat Mandricë dhe Arbanas në Bullgari. Gjatë kësaj vizite nxënësit u njohën me përpjekjet për ruajtjen e gjuhës shqipe, traditave, vlerave dhe identitetit kombëtar nga diaspora shqiptare në Bullgari.

~ Në datë 1 dhjetor 2019, Agjencia Kombëtare e Diasporës organizoi në Neë York një aktivitet në bashkëpunim me Teatrin e Operas, Baletit dhe Ansamblit Kombëtar dhe nën kujdesin e veçantë të Ministrit të Shtetit për Diasporën. Ky aktivitet filloi me një minutë heshtje nga artistët dhe pjesëmarrësit, të cilët në shenjë solidariteti ndaj situatës së vështirë që po kalonte Shqipëria pas tërmetit të datës 26 nëntor 2019 bënë thirrje për ndihmë ndaj familjeve të prekura nga tërmeti.

~ Agjencia Kombëtare e Diasporës në bashkëpunim me Ambasadën e Republikës së Shqipërisë në Hagë organizoi aktivitetin "Xhubleta" me rastin e festave të nëntorit. Në këtë aktivitet mori pjesë edhe Ministri i Shtetit për Diasporën z. Pandeli Majko, i cili në fjalën e tij, u shpreh për situatën që po kalonte vendi ynë për shkak të tërmetit, duke falenderuar për mbështetjen miqtë ndërkombëtarë dhe qeveritë e vendeve mike. Në këtë aktivitet morën pjesë edhe znj. Elisa Spiropali, ministre e Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin, e cila mbajti një fjalë përshëndetëse për të pranishmit, si dhe z. Ardian Lekaj, kryetari i Dhomës së Biznesit të Diasporës dhe anëtar i Këshillit Koordinues të Diasporës.

~ Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, me shkresën Nr. 17866 Prot., datë 16.12.2019, informon mbi përrurimin e parkut "Nënë Tereza" dhe vendosjen e shtatores së saj në qytetin Garfield, SHBA.

~ Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, me shkresën Nr. 18238 Prot., datë 20.12.2019, informon mbi ceremoninë e Pavarësisë së Shqipërisë të zhvilluar në Ontario të Kanadasë.

~ Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, me shkresën Nr. 18425 Prot., datë 24.12.2019, informon se në datë 17 tetor 2019 qeveria e Provincës Saskatchewan, Kanada, ka vendosur të shpallë muajin nëntor 2019 si "Muaji i Trashëgimisë Shqiptare".

~ Në datën 27 dhjetor 2019, Agjencia Kombëtare e Diasporës organizoi një koncert për komunitetin shqiptar në Zarë të Kroacisë, me artistët e mirënjohur shqiptarë, Inva Mula dhe Olen Cezari.

Janar - Mars 2020:

~ Në datë 27 janar 2020, në kuadër të "Ditëve të Shqipërisë", Agjencia Kombëtare e Diasporës organizoi një koncert në Selanik, Greqi, me pjesëmarrjen e artistëve të mirënjohur Inva Mula, Olen Cezari dhe Genc Tukiçi. Ky aktivitet u përshëndet nga Konsulli i Përgjithshëm i Republikës së Shqipërisë në Selanik. Të pranishëm në këtë koncert ishin shoqatat dhe organizatat shqiptare në rajonin e Selanikut si dhe mësues shqiptarë të cilët jetojnë në këtë qytet.

~ Në datë 31 janar 2020, Agjencia Kombëtare e Diasporës mori pjesë në një aktivitet të organizuar nga shoqata e rrjetit italo-shqiptar "ANIAS" në Romë, me temë "100 vjet parlamentarizëm shqiptar dhe nxitja e investimeve në Shqipëri". Në këtë aktivitet, Agjencia Kombëtare e Diasporës prezantoi politikat shtetërore për Diasporën, veprimtarinë e Agjencisë dhe ecurinë mbi zbatimin e masave të Strategjisë Kombëtare të Diasporës duke theksuar synimin e ngritjes së urave të qëndrueshme midis Diasporës shqiptare dhe vendit të origjinës si dhe angazhimin e saj në zhvillimin socio-ekonomik të vendit.

~ Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, me shkresën Nr. 2000 Prot., datë 05.02.2020 informon mbi aktivitetin e organizuar nga shoqata kulturore - artistike

“Lushnja”, Greqi me rastin e 100 vjetorit të Kongresit Kombëtar të Lushnjës.

Prill - Qershor 2020:

~ Për shkak të situatës së shpalljes së emergjencës kombëtare nga gjendja virusale "Covid-19", programi shtetëror i aktiviteteve për Diasporën për 2020 po rishikohet nga institucionet përgjegjëse.

~ Qendra e Botimeve për Diasporën, për shkak të situatës së krijuar në shkollat shqipe në Diasporë si pasojë e pandemisë globale, ka zhvilluar disa takime online me përfaqësues të shkollave shqipe, me qëllim marrjen e informacioneve dhe gjetjen e zgjidhjeve për problematikat e ngritura. QBD-ja ka organizuar gjithsej 7 takime online me përfaqësues të mësimdhënies së gjuhës shqipe nga shtete, si: Italia, Greqia, Gjermania, Zvicra, Anglia, SHBA-ja, Kanadaja, Spanja dhe Turqia. Në këto mbledhje u diskutua për problematikat e ndryshme lidhur me mësimin e gjuhës shqipe në kushtet e situatës së re të krijuar prej Covid-19, rëndësinë dhe mënyrën e përdorimit të Platformës digjitale për mësimin e gjuhës shqipe dhe pajisjen me tekste mësimore për vitin shkollor 2020-2021.

NË PROCES

| Masa Nr.7 |

Krijimi i një plani veprimi të përbashkët me shtetin e Kosovës për fushën e marrëdhënieve me diasporën në funksion dhe për pasurimin e marrëveshjeve ekzistuese që ekzistojnë midis dy vendeve në këtë drejtim. Përgatitja dhe realizimi i marrëveshjeve të nevojshme në fushën e diasporës me të gjitha vendet të cilat vlerësohen të rëndësishme dhe “prodhuese” të diasporës shqiptare në botë.

INDIKATORËT: Krijimi i një Plani-Veprimi të përbashkët me Shtetin e Kosovës.

AFATI KOHOR: 6 maji i dytë 2018

INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:

- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
- Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
- Ministri i Shtetit për Diasporën

Buletini 2018:

~ Nënshkruar Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës “Për bashkëpunimin në fushën e diasporës”, në Korçë, më 27 nëntor 2017.

~ Nënshkruar Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës “Për Qendrat Kulturore në Diasporë”, në Korçë, më 27 nëntor 2017. Në kuadër të kësaj marrëveshjeje i është përcjellë Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme shkresa Nr. 5032, datë 30.10.2018 “Kërkesë për buxhetin e vitit 2019”.

~ Nënshkruar Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës “Për bashkëpunimin, nxitjen e biznesit dhe informimin e diasporës” nënshkruar në Pejë më 26 nëntor 2018. Kjo marrëveshje ka si qëllim ngritjen e disa strukturave të veçanta si: Këshilli i Bashkëpunimit të Diasporës Shqiptare dhe Dhoma (Oda) e Biznesit të Diasporës në Tiranë dhe Prishtinë e cila do të shërbejë për të respektuar rregullat e funksionimit të të njëjtit rrjet biznesi në Diasporë.

~ Në funksion të Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Ministrisë së Diasporës së Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës “Për organizimin e përbashkët të mësimin të gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare” të datës 23.03.2015 janë ngritur 4 grupe pune të përbashkëta, si më poshtë:

1- Grupi i Kurrikulës pas disa takimesh ka finalizuar kurrikulën e përbashkët të nënshkruar edhe nga ministrat përgjegjës të arsimit të Shqipërisë dhe Kosovës në maj 2018. Mbi bazën e kësaj kurrikule po punohet për realizimin e teksteve të përbashkëta për mësimin në Diasporë.

2- Grupi i Standardeve ka hartuar draft-standardet për mësuesit e Diasporës, të cilat do të shërbejnë si model referimi për regjistrin e mësuesve të Diasporës.

3- Grupi i Legjislacionit është në përfundim të marrëveshjes së përbashkët për financimin e mësimin të gjuhës shqipe në Diasporë. Kjo marrëveshje është miratuar në parim nga qeveria e Shqipërisë dhe ajo e Kosovës.

4- Grupi i Promovimit ka përgatitur spotin “Mëso Shqip” për nxitjen e arsimimit në gjuhën shqipe në radhët e Diasporës dhe po marrin pjesë bashkërisht në emisionet televizive për këtë qëllim.

Janar - Mars 2019:

~ Në proces mbledhja e përbashkët e grupit të punës nga ministritë e arsimit të Shqipërisë dhe Kosovës për miratimin e teksteve të kurrikulës për mësimin në diasporë.

~ Miratuar Vendimi Nr. 104/2019 i Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve për krijimin e regjistrin shtetëror të mësuesve të gjuhës shqipe e të kulturës shqiptare dhe dhënien e certifikatës për nxënësit në diasporë”.

Prill - Qershor 2019:

~ Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë me shkresën Nr. 4410/1 Prot., datë 24.04.2019, propozon 3 anëtarë për komisionin e përbashkët për hartimin e teksteve të përbashkëta për Diasporën.

~ Më 22 maj 2019 u zhvillua mbledhja e parë e Komisionit të Përbashkët të Shqipërisë dhe Kosovës për miratimin e teksteve të përbashkëta mësimore për Diasporën. Në këtë mbledhje u vendos zgjedhja e z. Nuhi Gashi si kryetar i Komisionit të Përbashkët, si dhe hartimi i rregullores së këtij komisioni. Mbledhja e ardhshme për përcaktimin e planit të punës së Komisionit të Përbashkët u vendos të zhvillohej në Prishtinë, në datën 26 qershor 2019.

~ Në datat 26 dhe 27 qershor 2019, Komisioni i Përbashkët i Shqipërisë dhe Kosovës për Miratimin e Teksteve Mësimore për Diasporën zhvilloi mbledhjen e dytë në Prishtinë me qëllim planifikimin e punës për shpalljen e konkursit për hartimin dhe miratimin e

teksteve mësimore për Diasporën. Në përfundim të këtij takimi komisioni vendosi që brenda vitit 2019 të shpallë konkursin për nivelin e parë për tekstet mësimore të përbashkëta për Diasporën. Ndërkohë, Komisioni do të përgatisë dokumentacionin për shpalljen e konkursit duke filluar nga plotësimi i standarteve për tekstet për Diasporën. Komisioni hartoi dhe miratoi gjithashtu kalendarin e punës deri në miratimin përfundimtar të teksteve mësimore për Diasporën.

~ Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës organizuan programin e shkëmbimit “Si në Shtëpinë tënde” për 120 nxënës nga Shqipëria dhe Kosova. Ky program ka si qëllim integrimin e tyre në sistemin arsimor, qytetarisë dhe kulturës së vendit pritës, socializimit me komunitetin dhe forcimit të bashkëpunimit mes dy vendeve në fushën e arsimit dhe rinisë.

~ Dërguar shkresa Nr. 2180 Prot., datë 17.04.2019 Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë për mbledhjen e Grupit të Përbashkët të punës për çertifikimin e teksteve të kurrikulës së përbashkët Shqipëri-Kosovë.

~ Dërguar shkresa Nr. 2938 Prot., datë 29.05.2019 Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë ku kërkohet vlerësimi zyrtar për listën e teksteve mësimore për Diasporën për vitin shkollor 2019-2020.

~ Ministria e Kulturës, me shkresën Nr. 6314 Prot., datë 26.04.2019, ka përcjellë kalendarin e përbashkët kulturor Shqipëri-Kosovë për vitin 2019.

~ Në kuadër të aktivitetit “Për krijimin e rrjetit të profesionistëve në diasporë”, Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës realizoi një vizitë pune me qëllim shkëmbimin e përvojës me institucionet për Diasporën në Kosovë. Janë zhvilluar takime me Ministrinë e Diasporës dhe Investimeve Strategjike, Unionin e Bizneseve Shqiptaro-Gjermane, Kosovo Ideas, Asociacionin e Komunave të Kosovës dhe Innovation Center Kosovo dhe Organizatën Germin.

~ Në proces miratimi i marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës dhe Universitetit për Biznes dhe Teknologji (UBT) në Kosovë “Për bashkëpunim në fushën e kërkimit, mësimdhënies, zhvillimit teknologjik dhe inovacionit”.

~ Është nënshkruar Memorandum Mirëkuptimi midis Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës dhe Fondacionit Magna Grecia, Itali për bashkëpunim të ndërsjelltë në fushën e Diasporës, zhvillimin e projekteve të kërkimit dhe inovacionit për pjesëmarrje të përbashkët në Programet e Kornizës Evropiane.

Korrik - Shtator 2019:

~ Nënshkruar marrëveshja ndërmjet Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës dhe Universitetit për Biznes dhe Teknologji në Kosovë “Për bashkëpunim në fushën e kërkimit, mësimdhënies, zhvillimit teknologjik dhe inovacionit” në datën 22 korrik 2019 në Prishtinë. Sipas kësaj marrëveshje palët do të bashkëpunojnë për organizimin e aktiviteteve kërkimore, zhvillimore dhe inovative.

~ Më 22-23 korrik u zhvillua në Vlorë mbledhja e tretë e Komisionit të Përbashkët të Shqipërisë dhe Kosovës për miratimin e teksteve të përbashkëta. Në këtë mbledhje u diskutuan dhe u hartuan standardet për tekstet e përbashkëta për Diasporën.

~ Qendra e Botimeve për Diasporën ka publikuar dokumentin "Udhëzues për mësimdhënien në Diasporë 2019". Ky material është një dokument informues i ndryshimeve ligjore, akteve dhe shkresave me rëndësi në mbështetje të mësuesve dhe mësimdhënies në Diasporën shqiptare. Ai synon të paraqesë ecurinë e deritanishme të politikave shtetërore që ndikojnë drejtpërdrejt në përmirësimin e statusit të shkollave shqipe dhe të mësuesve në Diasporë. Ky udhëzues është edhe në vazhdim të bashkëpunimit midis Shqipërisë dhe Kosovës për miratimin e teksteve të përbashkëta për Diasporën nga Komisioni i Përbashkët ndërshtetëror, në zbatim të Marrëveshjes së Përbashkët mes institucioneve përgjegjëse të dy vendeve.

Tetor - Dhjetor 2019:

~ Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, me shkresën Nr. 17 386 Prot, datë 04.12.2019 informon mbi organizimin e "Ditëve të Kulturës Shqiptare" në Balerup, Danimarkë, nën kujdesin e Ambasadës së Republikës së Shqipërisë atje dhe Konsullatës së Republikës së Kosovës.

~ Vijon komunikimi për vazhdimësinë e punës së Komisionit të Përbashkët Shqipëri - Kosovë për hartimin e teksteve shkollore të përbashkëta, pezulluar prej situatës zgjedhore në Kosovë.

Janar - Mars 2020:

~ Për shkak të zgjedhjeve të parakohshme në Republikën e Kosovës dhe procesit të krijimit të qeverisë atje, ka pasur një shkëputje të përkohshme në komunikimin bilateral gjë e cila ka vazhduar në nivele të tjera të institucioneve përgjegjëse shtetërore për diasporën.

~ Qendra e Botimeve për Diasporën ka vijuar komunikimin për rinisjen e punës së Komisionit të Përbashkët Shqipëri - Kosovë, për përmbushjen e objektivave të përcaktuara nga marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë të Republikës së Shqipërisë, Ministrisë së Diasporës së Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës "Për organizimin e përbashkët të mësimit të gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në diasporë dhe në mërgatë" firmosur më 25 mars 2015.

Prill - Qershor 2020:

~ Qendra e Botimeve për Diasporën zhvilloi më 16 prill 2020 mbledhjen me Komisionin e Përbashkët Shqipëri-Kosovë për Miratimin e Teksteve Mësimore për Diasporën, i cili është ngritur në zbatim të marrëveshjes së miratuar midis dy shteteve "Për organizimin e përbashkët të mësimit të gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në Diasporë dhe mërgatë". Në këtë mbledhje u diskutua për problematikat e hasura deri tani në punën e këtij komisioni dhe për mënyrën e procedimit në të ardhmen. Për shkak të situatës së krijuar, takimi u zhvillua online.

~ Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët ka nënshkruar marrëveshje me disa institucione në shtetin e Kosovës. Këto marrëveshje synojnë nxitjen e bashkëpunimit midis këtyre institucioneve dhe Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët, për shkëmbimin e ekspertizës dhe studimeve dhe kërkimeve shkencore të përbashkëta për historinë dhe kulturën e komunitetit Arbëresh. Në këtë proces janë nënshkruar:

- Marrëveshja e Bashkëpunimit midis Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët (QSPA) dhe Bibliotekës Kombëtare të Kosovës “Pjetër Bogdani”. Në bazë të kësaj marrëveshjeje, pritet që të dyja institucionet të bashkëpunojnë për shkëmbimin e literaturës shkencore në funksion të hulumtimit të autorëve dhe të të dhënave mbi Arbëreshët. Gjithashtu, në qendër të marrëveshjes është edhe koordinimi në aspektin shkencor e profesional, në fushën e digjitalizimit të veprave mbi Arbëreshët, si dhe të veprimtarive të përbashkëta kulturoro-shkencore, mes të cilave shihet me përparësi promovimi i veprimtarive me karakter bibliografik, ekspozitave e botimeve.
- Memorandumi i bashkëpunimit mes Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët (QSPA) dhe Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës (ASHAK). Dokumenti i nënshkruar përfshin organizimin e veprimtarive në fushën kërkimore-shkencore, si dhe kryerjen e studimeve të përbashkëta mbi historinë dhe kulturën e komunitetit arbëresh. Memorandumi cilësohet të jetë një marrëveshje e zgjerimit dhe thellimit të marrëdhënieve në mes dy vendeve në fushën e kërkimit shkencor dhe sheh me përparësi koordinimin e punës dhe bashkëpunimin mes studiuesve të rinj të Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët me studiuesit me përvojë të Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës.
- Marrëveshja e bashkëpunimit midis Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët (QSPA) dhe Institutit Arkeologjik të Kosovës, i cili njihet si një ndër institucionet më të rëndësishme të Trashëgimisë Kulturore të Kosovës, dhe institucioni kryesor për shkencën e arkeologjisë në këtë vend.
- Marrëveshja e bashkëpunimit mes Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët (QSPA) dhe Institutit të Historisë “Ali Hadri”, Kosovë. Në qendër të kësaj marrëveshjeje është shkëmbimi i literaturës shkencore, si dhe hartimi i projekteve të përbashkëta akademike në realizimin e hulumtimeve shkencore dhe në organizimin e veprimtarive të ndryshme mbi Arbëreshët.
- Marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët (QSPA) dhe Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”. Kjo marrëveshje konsiston në bashkëpunimin e ndërsjelltë në fushën kërkimore-shkencore dhe marrjen pjesë në projekte të përbashkëta akademike, të cilat kanë në fokus botën arbëreshe.

~ Drejtoresha Ekzekutive e Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët (QSPA), Prof. Diana Kastrati ka zhvilluar një vizitë pune në Prishtinë, në funksion të prezantimit dhe bashkëpunimit me institucionet më të rëndësishme kulturoro-shkencore të Kosovës. Në këtë kuadër, Prof. Kastrati është takuar edhe me Ministren e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve znj. Vlora Dumoshi, e cila ka përshëndetur dhe vlerësuar institucionalizimin e studimeve mbi Arbëreshët. U vlerësua nxitja e bashkëpunimit mes Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët në Tiranë dhe Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve të Kosovës dhe për një kalendar të përbashkët aktivitesh.

~ Drejtoresha ekzekutive e Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët (QSPA), prof. Diana Kastrati, në kuadër të vizitës zyrtare në Prishtinë, ka zhvilluar një takim në mjediset e Institutit Albanologjik të Prishtinës (IAP), ku prof. Kastrati së bashku me studiuesen Vilma Proko janë takuar me Sekretarin Shkencor të IAP-së, prof. Lulëzim Lajçi dhe përgjegjësën e sektorit të gjuhësisë pranë këtij institucioni, prof.

Qemal Murati. Palët përfaqësuese të të dyja institucioneve kanë diskutuar në parim pikat dhe hapësirat e bashkëpunimit ndërinstitutional dhe konkretizimin e tyre edhe zyrtarisht në takimin e radhës. Po ashtu, në kuadër të bashkëpunimit të mëtejshëm me institucionet kërkimore-shkencore u zhvillua takim zyrtar edhe në Institutin e Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve. Studiuesit Qazim Namani, Emin Sallahu dhe përgjegjësja e bibliotekës, znj. Arbërie Demaçi bënë një prezantim të gjerë të botimeve të këtij Instituti, ku theksuan edhe fokusin kryesor të punës së tyre në rivlerësimin dhe mbrojtjen e monumenteve të kulturës kombëtare shqiptare.

NË PROCES

| Masa Nr.8 |

Vendosja e bashkëpunimit me institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare për zbatimin e programeve për këtë qëllim (për shembull me PNUD-in për të zbatuar TOKTEN në Shqipëri).

INDIKATORËT: Bashkëpunimi me institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare.

AFATI KOHOR: 6 mujori i parë 2019

INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:

- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
- Ministri i Shtetit për Diasporën

Janar - Mars 2019:

~ Dërguar shkresa me Nr. 540 datë 25.01.2019, Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme “Për zbatimin e masës Nr. 8 të Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare për Diasporën 2018-2024.”

Prill - qershor 2019:

~ Ministri i Shtetit për Diasporën zhvilloi takim me z. Joe Poëell, Zv. Drejtor i Përgjithshëm i organizatës amerikane “Partneriteti për Qeveri të Hapur” (OGP). Në këtë takim u diskutua për bashkëpunime konkrete midis qeverisë shqiptare, kësaj organizate dhe shoqërisë civile.

~ Ministri i Shtetit për Diasporën zhvilloi takim me z. Patricio Pagano, Drejtor Ekzekutiv i Bordit të Grupit të Bankës Botërore në Washington DC. Në këtë takim u diskutua mundësia e bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë të Shtetit për Diasporën dhe Zyrës së Bankës Botërore në Tiranë, përmes projekteve që synojnë kanalizimin e remitancave në një mënyrë të qëndrueshme për zhvillimin e vendit.

Korrik - Shtator 2019:

~ Agjencia Kombëtare e Diasporës ka aplikuar në Platformën "INTERREG ADRION 2019" në projektin me titull "Në rrënjët e mia: për të zhvilluar komunitete, për të rigjallëruar shoqëritë, për të luftuar varfërinë, për të mbajtur mjedisin, për të zotëruar të ardhmen." Në kuadër të këtij projekti, Agjencia Kombëtare e Diasporës vlerësohet të shërbejë si urë komunikimi dhe do të kontribuojë në shkëmbimin e informacionit me anëtarët e Diasporës në iniciativa sipërmarrëse.

~ Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës ka aplikuar për dy projekte të reja në kuadër të thirrjeve të lançuara nga organizatat ndërkombëtare:

- Building Bridges for Businesses në kuadër të projektit Interreg IPA Itali - Shqipëri - Mali i Zi në partneritet me AIDA, STIMMA Itali, Komuna Ulqin.
- CEI Cooperation Fund - Central European Initiative Cooperation Fund

(Projekti IPA është në proces vlerësimi. Projekti CEI është kualifikuar në fazën e parë të seleksionimit. Rezultatet e projekteve priten të jenë të disponueshme brenda dhjetorit 2019.)

Tetor - Dhjetor 2019:

~ Nënshkruar Memorandum Mirëkuptimi ndërmjet Ministrit të Shtetit për Diasporën dhe z. Jaagz Bajaj, përfaqësues i Fondacionit për Politikën Diplomatike dhe Kërkim Shkencor (DRPF) si dhe ekspert i UNESCO-s për Shqipërinë. Firmosja e këtij memorandumi ka një rëndësi të veçantë për forcimin e marrëdhënieve mes palëve në lidhje me realizimin e një arsimit sa më cilësor, promovimin dhe zhvillimin e kërkimit shkencor si dhe krijimin e një programi për arsimin në gjuhën shqipe që do t'u vijë në ndihmë komuniteteve shqiptare në Diasporë për të promovuar gjuhën dhe kulturën shqiptare.

~ Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës, në bashkëpunim me Ambasadën Zvicerane në Tiranë, do të realizojnë projektin "Gazeta e Diasporës". Institucionet janë në proces të hartimit të marrëveshjes financiare.

Janar - Mars 2020:

~ Për këtë masë nuk ka informacione të reja në këtë periudhë kohore.

Prill - Qershor 2020:

~ Miratuar Vendimi Nr. 419, datë 27. 05. 2020, i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e programit shtetëror për mbështetje në fuqizim dhe angazhim të diasporës shqiptare". Ky program do të realizohet përmes bashkëpunimit të Ministrit të Shtetit për Diasporën me institucionet qeveritare të niveleve të ndryshme me qëllim zhvillimin e instrumenteve për t'u angazhuar në mënyrë aktive me anëtarët dhe organizatat e Diasporës.

~ Gjatë muajit maj 2020, Agjencia Kombëtare e Diasporës ka aplikuar në projektet si më poshtë:

1. "Rezistenca marginale: modeli i ekonomisë qarkulluese për forcimin e profesioneve territoriale". Projekti zbatohet në bashkëpunim me rajonin e Puglias në Itali dhe bashkitë Vlorë dhe Himarë. Në muajin maj është dërguar letra e interesit për

pjesmarrjen në projekt dhe formulari i ekspertizës së AKD. Gjatë periudhës maj - qershor 2020 është realizuar pjesëmarrja në video-konferenca.

2. “Krijimi i hapësirave virtuale të të mësuarit për zhvillimin e rrjeteve të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve shkollore dhe universiteteve: Modelet, Udhëzuesit dhe Drejtimet e Politikave”. Projekti zbatohet në bashkëpunim me Universitetin e Basilicata në Itali. Në muajin maj është dërguar letra e shprehjes së interesit në cilësinë e partnerit në projekt. Projekti është në fazë vlerësimi.
3. “TILT - Qendra inovative ndërkombëtare për turizmin”. Projekti zbatohet në bashkëpunim me Universitetin e Basilicata në Itali. Në muajin maj është dërguar letra e shprehjes së interesit në cilësinë e partnerit në projekt. Projekti është në fazë vlerësimi.
4. Qendra inovative sociale dhe shëndetësore: platformë bashkëpunimi në telemedicinë”. Projekti zbatohet në bashkëpunim me Universitetin e Basilicata në Itali. Në muajin maj është dërguar letra e shprehjes së interesit në cilësinë e partnerit në projekt. Projekti është në fazë vlerësimi.

- Qendra e Botimeve për Diasporën ka aplikuar në projektet si vijon:

- Projekti për mbështetjen dhe përhapjen e mësimit të gjuhës shqipe në diasporën shqiptare, financuar nga UNESCO është në fazë vlerësimi.
- Projekt propozimin për t’u financuar nga Central European Initiative (CEI), për krijimin e një platforme digjitale për mësimdhënien në diasporë, “Learn Albanian language” (LAL).
- Projekti për krijimin e platformës së mësimit të gjuhës shqipe “Mëso Shqip” (portal + APP), pasi është miratuar nga Këshilli Koordinues i Botimeve për Diasporën është në proces për nisjen e procedurave. Për realizimin e këtij projekti QBD-ja ka kërkuar gjithashtu mbështetjen e ekspertëve të fushës, të financuar nga GIZ-i.

- Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës ka bashkëpunuar me institucionet e mëposhtme:

- Organizatën Ndërkombëtare për Migracionin (IOM) lidhur me projektin “Angazhimi i Diasporës Shqiptare në Zhvillim Social dhe Ekonomik”
- Ambasadën Zvicerane në Tiranë, si përfaqësuese e Departamentit Federal Zviceran për Punët e Jashtme për zbatimin e projektin “Gazeta e Diasporës Shqiptare”.
- GIZ në kuadër të projektit “Migracioni për Zhvillim” për angazhimin e ekspertëve të diasporës.
- Projekti “GreenBack” i Bankës Botërore, si pjesë e grupit këshillimor ndër-institucional të këtij Projekti, i cili synon kanalizimin në rrugë eficiente të remitançave në ekonominë e vendit.

| Masa Nr.9 |

Rivlerësimi i akteve ligjore ekzistuese në fushën e migracionit zgjerimin e sferës së mbrojtjes së komuniteteve shqiptare jashtë vendit në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe me qëllim përafrimin me Acquis Communautaire. Realizimi i procedurave për përfundimin e ratifikimit të instrumenteve ndërkombëtare (nëse nuk janë realizuar ende) si më poshtë:

- Konventa e Organizatës Ndërkombëtare të Punës Nr. 143 “Për punonjësit migrantë”.
- Ratifikimi i Konventës së Këshillit të Evropës “Mbi Statusin Ligjor të Punonjësve Migrantë”.
- Ratifikimi i Konventës së Kombeve të Bashkuara “Për mbrojtjen e të drejtave të të gjithë punonjësve migrantë dhe anëtarëve të familjeve të tyre”.

INDIKATORËT: Rivlerësimi i akteve ligjore ekzistuese në fushën e migracionit. Realizimi i procedurave për ratifikimit të instrumenteve ndërkombëtare

AFATI KOHOR: 6 mujori i dytë 2019

INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:

- Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme
- Ministria e Brendshme
- Ministri i Shtetit për Diasporën
- Ministria e Drejtësisë

Prill - qershor 2019:

~ Dërguar shkresa Nr. 3047 Prot. datë 6.06.2019 institucioneve përkatëse për zbatimin e masës.

Korrik - Shtator 2019:

~ Miratuar Vendimi Nr. 400, datë 19.06.2019, Këshilli i Ministrave ka miratuar Strategjinë Kombëtare për Qeverisjen e Migracionit dhe Planit të saj të Veprimit (2019 - 2022).

~ Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, me shkresën nr. 8390/1 Prot., datë 24.07.2019 informon se ky institucion vlerëson përputhshmërinë e akteve ligjore shqiptare me ato të *acquis communautaire* në momentin që tabelat e përputhshmërisë plotësohen nga institucioni përgjegjës, i cili identifikon *acquis-in* relevant në objekt të punës së tij.

~ Ministria e Brendshme, me shkresën nr. 4922/1 Prot., datë 30.07.2019 informon se aktet ligjore të parashikuara në këtë masë janë ratifikuar nga Republika e Shqipërisë. Gjithashtu, me qëllim ndërtimin e një politike migratore të fortë dhe koherente, janë përmirësuar aktet normative në këtë fushë.

Tetor - Dhjetor 2019:

~ Bazuar në Urdhrin Nr. 117, datë 11.09.2019 të Kryeministrit “Për ngritjen e grupit

ndërinstitucional të punës për hartimin e Profilit të Zgjeruar të Migracionit për periudhën 2015 -2018”, grupi i punës është në proces të përgatitjes së dokumentit të Profilit të Zgjeruar të Migracionit për periudhën 2015 - 2018. Ky dokument pasqyron të dhëna analitike mbi lëvizjet migratore në Shqipëri, ndikimin e migrimit në shoqërinë shqiptare, si dhe kuadrin politik, ligjor dhe institucional për menaxhimin e migracionit.

Janar - Mars 2020:

~ Në proces miratimi i Profilit të Zgjeruar të Migracionit për periudhën 2015 - 2018, si një dokument i Ministrisë së Brendshme që pasqyron të dhëna analitike mbi lëvizjet migratore në Shqipëri, ndikimin e migrimit në shoqërinë shqiptare, si dhe kuadrin politik, ligjor dhe institucional për menaxhimin e migracionit.

~ Në proces miratimi i Projektvendimit të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e programit shtetëror për mbështetje në fuqizim dhe angazhim të diasporës shqiptare". Ky program është përgatitur në zbatim dhe mbështetje të Strategjisë Kombëtare të Diasporës dhe synon angazhimin e diasporës shqiptare në vendlindje si një mënyrë e re veprimi në zhvillimin e qëndrueshëm social dhe ekonomik të Shqipërisë.

~ Është dërguar për mendim në institucionet përkatëse përmes platformës e-akte projektvendimi i cili synon ndryshimin e përbërjes së Këshillit Konsultativ të qeverisjes qendrore me vetëqeverisjen vendore duke shtuar në përbërjen e këshillit, në përputhje me ndryshimet ligjore në Ligjin Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, edhe përfaqësuesin e institucioneve përgjegjëse për diasporën.

Prill - Qershor 2020:

~ Miratuar Vendimi Nr. 419, datë 27.05.2020, i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e programit shtetëror për mbështetje në fuqizim dhe angazhim të diasporës shqiptare”. Ky program do të realizohet me institucionet shtetërore përgjegjëse për diasporën të niveleve të ndryshme me qëllim zhvillimin e instrumenteve për t’u angazhuar në mënyrë aktive komunitetet shqiptare në Diasporë.

NË PROCES

| Masa Nr.10 |

Vlerësimi i një pranie të re përfaqësimi diplomatik ose konsullor në vendet me një prezencë të qenësishme të komuniteteve shqiptare dhe të një rëndësie të veçantë për forcimin e mëtejshëm të marrëdhënieve diplomatike dhe ekonomike të vendit pritës me vendin e origjinës. Orientimi i planit të punës së trupës diplomatike dhe konsullore me një fokus të veçantë drejt marrëdhënieve me komunitete shqiptare jashtë vendit.

INDIKATORËT: Vlerësimi i një pranie të re përfaqësimi diplomatik ose konsullor

AFATI KOHOR: 6 mujori i dytë 2018

INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:

- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
- Ministri i Shtetit për Diasporën

Buletini 2018:

~ Dërguar shkresa Nr. 2796 Prot, më datë 11.6.2018, Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, “Për procedurat për emërimin e oficerëve koordinues pranë ambasadave në Itali dhe Greqi”. Ka vonesë në realizimin e këtyre emërimeve.

~ Dërguar shkresa Nr. 4008 prot, datë 3.9.2018, Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, “Për zbatimin e masës Nr.10 të Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare për Diasporën 2018 - 2024”.

~ Në proces një vlerësim i plotë nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme për këtë çështje. Nuk është realizuar akoma.

Janar - Mars 2019:

~ Vlerësimi i një pranie të re përfaqësimi diplomatik ose konsullor në vendet me një prezencë të qenësishme të komuniteteve shqiptare do të jetë pjesë e diskutimeve në Komitetin Shtetëror të Diasporës. Nuk ka ende komunikim zyrtar me Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme për këtë çështje.

Prill - Qershor 2019:

~ Në Kanberra të Australisë do të hapet një ambasadë e Shqipërisë. Hapja e ambasadës në Australi vjen edhe si kërkesë e komunitetit të Diasporës shqiptare në këtë vend. Kjo ambasadë vec të tjerash do të ketë funksion në ofrimin e shërbimeve konsullore për Diasporën shqiptare në Australi.

Tetor - Dhjetor 2019:

~ Miratuar Vendimi Nr. 780 datë 06.11.2019 i Këshillit të Ministrave “Për caktimin e oficerëve koordinues për çështjet e diasporës shqiptare në konsullatat shqiptare në Itali dhe Greqi”. Sipas këtij vendimi, pranë posteve konsullore të Republikës së Shqipërisë në Romë, Athinë, Milano dhe Selanik janë caktuar oficerët koordinues lidhur me çështjet e Diasporës shqiptare në fushën e kulturës, arsimit, financës dhe drejtësisë. Oficerët koordinues për Diasporën do të kenë mbështetje dhe bashkëpunim të vazhdueshëm me Agjencinë Kombëtare të Diasporës, Qendrën e Botimeve për Diasporën dhe Dhomën e Biznesit të Diasporës në adresimin e çështjeve të caktuara sipas fushës së veprimit.

Janar - Mars 2020:

~ Me vonesë zbatimi i Vendimit Nr. 780, datë 06.11.2019 të Këshillit të Ministrave “Për caktimin e oficerëve koordinues për çështjet e diasporës shqiptare në konsullatat shqiptare në Itali dhe Greqi” pasi Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme vlerëson pamundësi financiare në zbatimin e saj.

Prill - Qershor 2020:

~ Miratuar Vendimi Nr. 445, datë 03.06.2020 i Këshillit të Ministrave “Për një shtesë në Vendimin Nr.780, datë 06.11.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për caktimin e oficerëve koordinues për çështjet e diasporës shqiptare në konsullatat shqiptare në Itali dhe Greqi”. Sipas këtij vendimi, efektet financiare për zbatimin e tij, për vitin 2020, do të

mbulohen nga Agjencia Kombëtare e Diasporës.

NË PROCES

|| Masa Nr. 11 ||

Ndërgjegjësimi dhe orientimi i qytetarëve shqiptarë jashtë vendit për përdorimin e shërbimeve konsullore dhe diplomatike të cilat ofrohen nga përfaqësitë shqiptare, nëpërmjet platformës konsullore online. Dhënia e informacionit rreth organizatave jo qeveritare të akredituara nga shteti pritës, të cilat ofrojnë asistencë dhe mbrojtje ligjore për komunitetet e huaja.

INDIKATORËT: Orientimi i qytetarëve shqiptarë jashtë vendit për shërbimet nëpërmjet platformës konsullore online

AFATI KOHOR: 6 mujori i parë 2019 (periodike)

INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:

- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
- Ministri i Shtetit për Diasporën
- Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë

Janar - Mars 2019:

~ Miratuar Urdhri nr. 45/2019 i Kryeministrit "Për caktimin e koordinatorit shtetëror për informimin e diasporës". Koordinator Shtetëror është caktuar z. Fatjon Hallkaj, Drejtor i Drejtorisë së Programimit dhe Zhvillimit pranë AKSHI-t.

~ Dërguar shkresa me nr. 538 Prot., datë 25.01.2019, Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë "Për zbatimin e masës nr. 11 të Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare për Diasporën 2018-2024."

~ Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, me shkresën nr. 943/1 Prot., datë 04.03.2019, jep informacion për orientimin e qytetarëve shqiptarë jashtë vendit në faqen zyrtare të këtij institucioni.⁵

~ Realizuar një ndarje e veçantë "Diaspora" në të gjitha faqet e institucioneve përgjegjëse për zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Diasporën, nën drejtimin e Koordinatorit Shtetëror për informimin e diasporës. Në proces organizimi i tyre në kuadrin e një platforme të koordinuar nga AKSHI.

Prill - Qershor 2019:

~ Në proces lançimi i aplikacionit "Diaspora Shqiptare", i cili ofron informacion të plotë për gjithçka që ndodh me Diasporën shqiptare, përfshirë aktivitetet e komunitetit shqiptar në vendet pritëse. Aplikacioni "Diaspora Shqiptare" do të mund të shkarkohet

⁵ www.arsimi.gov.al

online dhe menaxhohet nga Agjencia Kombëtare e Diasporës.

~ Koordinatori shtetëror për informimin e Diasporës, caktuar me Urdhrin Nr. 45/2019 të Kryeministrit, ka raportuar në mbledhjen e Komitetit Shtetëror për Diasporën (3 maj) për krijimin e seksionit informativ "Diaspora". Ai informoi se deri tani është punuar për ngritjen e infrastrukturës dhe për hedhjen e disa prej të dhënave të ofruara nga pjesëmarrësit e Samitit të Dytë të Diasporës. Pjesë e detyrave në vijim është dhe krijimi i një databaze shtetërore për Diasporën që përmban të dhëna të ndryshme mbi anëtarët e Diasporës shqiptare si sipërmarrësit, mjekët, juristët, mësuesit, etj.

- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme ka realizuar platformën "Ambasada ime". Kjo platformë ofron informacion të plotë mbi strukturën e mbulimit diplomatik dhe konsullor të Shqipërisë në botë, si dhe mundëson komunikimin aktiv të njësive diplomatike e konsullore me shtetasit shqiptarë. "Ambasada Ime" ofron mundësinë e parashtrimit të pyetjeve, adresimit të ankesave dhe shpalosjes së ideve në përfaqësitë diplomatike të Shqipërisë.

Korrik - Shtator 2019:

~ Në datën 20 korrik 2019 u lançua aplikacioni "Diaspora Shqiptare", i cili synon të ofrojë informacion të plotë për gjithçka ndodh në Diasporë, të pasqyrojë aktivitetet e komunitetit shqiptar në çdo vend e mbi të gjitha të jetë pikë referimi për të gjithë shqiptarët kudo janë. Aplikacioni "Diaspora Shqiptare" është një platformë aktive informimi dhe shërbimesh për komunitetet e diasporës shqiptar në botë. Aplikacioni shkarkohet falas në Play Store dhe App Store.

~ Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme ka përditësuar platformën "Ambasada ime" me rubrikën "Raporto". Kjo rubrikë ka për qëllim trajtimin në mënyrë interaktive të ankesave, kërkesave për informacion të shtetasve shqiptarë kudo që ndodhen.

Tetor - Dhjetor 2019:

~ Aplikacioni "Diaspora Shqiptare" përditësohet në vazhdimësi duke ofruar një informacion të gjerë mbi aktivitetet e komunitetit shqiptar në çdo vend e mbi të gjitha shërben si pikë referimi për të gjithë shqiptarët kudo janë.

Janar - Mars 2020:

~ Është mbyllur procesi i ndërtimit dhe strukturimit të medias së parë online www.diasporashqiptare.al, si dhe aplikacionit për telefonat celularë.

~ Aplikacioni "Diaspora Shqiptare" përditësohet në vazhdimësi duke ofruar një informacion të gjerë mbi aktivitetet e komunitetit shqiptar në vendet pritëse.

~ Çdo javë publikohet "Newsletter e Diasporës", përmes së cilës Diaspora shqiptare informohet lidhur me veprimtarinë e institucioneve shtetërore të Diasporës dhe aktivitete të ndryshme brenda dhe jashtë vendit. Newsletter publikohet në faqet zyrtare të Ministrisë së Shtetit për Diasporën dhe Agjencisë Kombëtare të Diasporës në gjuhën shqipe dhe angleze.

~ Dhoma e Biznesit të Diasporës publikon çdo javë "Newsletter e Dhomës së Biznesit të Diasporës", në gjuhën shqipe dhe angleze, me qëllim informimin e komunitetit të

biznesit në Diasporë dhe Shqipëri mbi ekonominë, financat, sipërmarrjen, mundësitë për investime, ndryshimet ligjore, paketat fiskale dhe incentivuese, si dhe aktivitete të ndryshme brenda dhe jashtë vendit me fokus biznesin dhe investimet.

Prill - Qershor 2020:

~ Publikohet gazeta “Diaspora Shqiptare”, një projekt i financuar nga qeveria e Konfederatës së Zvicrës në bashkëpunim me Fondin Shqiptar të Zhvillimit të Diasporës. Ajo ka si mision informimin e komuniteteve shqiptare në diasporë dhe synon të jetë një hapësirë e lajmit për sfidat e migrimit, përvojën dhe arritjet e shqiptarëve larg vendlindjes.

~ Çdo javë publikohet “Newsletter e Diasporës”, përmes së cilës informohet lidhur me veprimtarinë e institucioneve shtetërore të Diasporës dhe aktivitete të ndryshme brenda dhe jashtë vendit. Newsletter publikohet në faqet zyrtare të Ministrit të Shtetit për Diasporën dhe Agjencisë Kombëtare të Diasporës në gjuhën shqipe dhe angleze.

~ Dhoma e Biznesit të Diasporës publikon çdo javë “Newsletter e Dhomës së Biznesit të Diasporës”, në gjuhën shqipe dhe angleze, me qëllim informimin e komunitetit të biznesit në Diasporë dhe Shqipëri mbi ekonominë, financat, sipërmarrjen, mundësitë për investime, ndryshimet ligjore, paketat fiskale dhe incentivuese, si dhe aktivitete të ndryshme brenda dhe jashtë vendit me fokus biznesin dhe investimet.

NË PROCES

| Masa Nr.12 |

Vlerësimi i përjasjes të strategjive të tjera kombëtare ekzistuese apo që do të miratohen me Strategjinë Kombëtare dhe Planin e Veprimit për Diasporën. Ky proces do të kryejë organizimin e politikave shtetërore ekzistuese apo që do të miratohen në të ardhmen në marrëdhënie me politikat për komunitet shqiptare jashtë vendit.

INDIKATORËT: Përjasja e strategjive të tjera kombëtare ekzistuese apo që do të miratohen.

AFATI KOHOR: 6 mujori i parë 2019 (periodike)

INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:

- Zëvendëskryeministri
- Ministri i Shtetit për Diasporën
- Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë
- Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes

Janar - Mars 2019:

~ Identifikimi i strategjive, të cilat janë në proces hartimi dhe zbatimi, të institucioneve shtetërore me qëllim përjasjen e tyre me Strategjinë Kombëtare të Diasporës dhe Planin e Veprimit.

- Dërguar shkresa nr. 943 Prot., datë 12.02.2019 drejtuar Zëvendëskryeministrit, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes lidhur me përqasjen e dokumenteve strategjike, në proces hartimi apo zbatimi, me Strategjinë Kombëtare të Diasporës.

- Ministria e Brendshme, me shkresën nr. 1258/1 Prot., datë 27.02.2019 informon se ajo drejton procesin për hartimin e Strategjisë Kombëtare për Qeverisjen e Migracionit dhe Planin e Veprimit (2019-2022). Në proces koordinimi për kohezionin e dokumentit me atë të Strategjisë Kombëtare të Diasporës 2018 - 2024.

- Ministri i Shtetit për Diasporën me shkresën nr. 1509/2, datë 01.04.2019, i ka paraqitur Ministrisë së Brendshme sugjerimet për Strategjinë Kombëtare për Qeverisjen e Migracionit dhe Planin e Veprimit 2019-2022.

Prill - Qershor 2019:

- Ministri i Shtetit për Diasporën, me shkresat nr.1509/2 Prot., datë 01.04.2019 dhe Nr. 4440 Prot. datë 21.05.2019 ka përcjellë propozimet lidhur me projekt Strategjinë Kombëtare për Qeverisjen e Migracionit dhe Planin e Veprimit (2019-2022), me qëllim përqasjen me Strategjinë Kombëtare të Diasporës dhe Planin e Veprimit (2018 - 2024).

- Me Vendimin nr. 400, datë 19.06.2019, Këshilli i Ministrave ka miratuar Strategjinë Kombëtare për Qeverisjen e Migracionit dhe Planin e Veprimit (2019 - 2022).

- Shkëmbim informacioni me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë në kuadër të rishikimit të Strategjisë së Biznesit dhe Investimeve me qëllim harmonizimin e saj me Strategjinë Kombëtare të Diasporës (2018-2024).

Korrik - Shtator 2019:

- Miratuar Urdhri Nr. 117, datë 11.09.2019, i Kryeministrit “Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për hartimin e profilit kombëtar të zgjeruar të migracionit për vitet 2015-2018”.

- Ministria e Brendshme me shkresën Nr. 7278/2, Prot., datë 24.09.2019, në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit Nr. 117, datë 11.09.2019, “Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për hartimin e profilit kombëtar të zgjeruar të migracionit për vitet 2015-2018”, i kërkon Ministrit të Shtetit për Diasporën caktimin e një anëtari në grupin e punës. Ministri i Shtetit për Diasporën, me shkresën Nr. 4812/1 Prot., datë 28.09.2019 ka caktuar znj. Elona Bano si përfaqësuese në grupin e punës.

Tetor - Dhjetor 2019:

- Bazuar në Urdhri Nr. 117, datë 11.09.2019 të Kryeministrit “Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për hartimin e Profilit të Zgjeruar të Migracionit për periudhën 2015 -2018”, grupi i punës është në proces të përgatitjes së dokumentit të Profilit të Zgjeruar të Migracionit për periudhën 2015 - 2018. Ky dokument pasqyron të dhëna analitike mbi lëvizjet migratore në Shqipëri, ndikimin e migrimit në shoqërinë shqiptare, si dhe kuadrin politik, ligjor dhe institucional për menaxhimin e migracionit.

- Ministria e Kulturës është në proces të rishikimit të Strategjisë Kombëtare për

Kulturën (2019-2025), ku Ministri i Shtetit për Diasporën, nëpërmjet sistemit e-akte, i ka përcjellë sugjerimet përkatëse.

Janar - Mars 2020:

~ Në proces miratimi i Profilit të Zgjeruar të Migracionit për periudhën 2015 - 2018, si një dokument i Ministrisë së Brendshme që pasqyron të dhëna analitike mbi lëvizjet migratore në Shqipëri, ndikimin e migrimit në shoqërinë shqiptare, si dhe kuadrin politik, ligjor dhe institucional për menaxhimin e migracionit.

~ Vijon procesi i diskutimit publik rreth Strategjisë Kombëtare të Diasporës dhe Planit të Veprimit. Ai do të jetë pjesë e diskutimeve që do të zhvillohen gjatë Takimit të Juristëve të Diasporës.

Prill - Qershor 2020:

~ Në datë 26.05.2020 u zhvillua mbledhja e parë e grupit ndërinstitucional të punës për rishikimin e Strategjisë Kombëtare të Diasporës. Qëllimi i mbledhjes ishte lidhur me detyrat e grupit, mbi bazën e propozimeve e diskutimeve nga anëtarët e tij, për rishikimin e masave të Strategjisë së Re dhe Planit të Veprimit, të cilat do të paraqiten për miratim brenda muajit qershor 2020.

~ Në datë 19.06.2020 u zhvillua mbledhja e dytë e grupit ndërinstitucional të punës për Strategjinë e Re Kombëtare të Diasporës. Gjatë takimit virtual, ministri Majko prezantoi draftin e Strategjisë dhe kërkoi sugjerimet e anëtarëve të grupit lidhur me rishikimin e masave të Planit të Veprimit. Strategjia e rishikuar do të paraqitet për miratim në muajin korrik 2020.

NË PROCES

| Masa Nr.13 |

Vlerësimi dhe zgjerimi i Regjistrimit Kombëtar të Gjendjes Civile me të dhëna për migrantët dhe rishikim periodik të bazës ligjore për regjistrimin e migrantëve. Përcaktimi i përgjegjësive dhe të dhënave që duhen mbledhur si edhe identifikimi dhe planifikimi i krijimit të rrjetit dhe infrastrukturës së duhur. Organizimi i aktiviteteve publike për shoqërinë civile, mbi qëllimin e sistemit të regjistrimit dhe votimit të shtetasve jashtë vendit.

INDIKATORËT: Zgjerimi i Regjistrimit Kombëtar të Gjendjes civile me të dhëna për migrantët. Përcaktimi i përgjegjësive dhe organizimi i aktiviteteve jashtë vendit.

AFATI KOHOR: 6 mujori i dytë 2018 (periodike)

INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:

- Zëvendëskryeministri
- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
- Ministria e Brendshme
- Ministri i Shtetit për Diasporën

Buletini 2018:

~ Miratuar Vendimi Nr. 405/2018, i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave mbi detyrimin për vetëdeklarim të adresës nga shtetasit shqiptarë që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe procedurave përkatëse që do të ndiqen për këtë qëllim”.

~ Zhvilluar në Kuvendin e Shqipërisë në datë 27.9.2018, mbledhja e dytë e grupit parlamentar “Miqtë e Fëmijëve”. “Miqtë e Fëmijëve” është një grup parlamentar shumëpartiak, i cili bashkëpunon me institucionet shtetërore dhe shoqërinë civile për trajtimin e çështjeve të fëmijëve dhe mbrojtjen e interesave të tyre. Në takim u diskutuan çështjet mbi regjistrimin e fëmijëve pa dokumente. Një problem i veçantë janë fëmijët që kanë lindur jashtë vendit të cilët mbajnë dy emra, dy mbiemra apo edhe fëmijët e braktisur që në lindje nga prindërit e tyre. Grupi së bashku me zyrën e UNCHR dhe ministritë përgjegjëse ndërmori iniciativë ligjvënëse për këtë çështje. Ligji Nr. 69/2018 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr.10129, datë 11.5.2009, “Për Gjendjen Civile”, të ndryshuar, parashikoi se për fëmijët e lindur jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë nga shtetas shqiptarë me banim të përhershëm në Shqipëri, regjistrimi i lindjes së fëmijës bëhet në shërbimin e gjendjes civile të atij vendi. Kur kjo është e pamundur, regjistrimi i lindjes mund të bëhet edhe në përfaqësitë diplomatike ose konsullore shqiptare në vendin e lindjes. Në proces aktet nënligjore të këtij ligji.

~ Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Civile ka krijuar portalin për regjistrimin e adresave të shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, bazuar në procesin e vetëdeklarimit. Për këtë qëllim, Ministria e Brendshme dhe Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme do të organizojnë trajnimet e specialistëve, pranë përfaqësive diplomatike dhe konsullore të Republikës së Shqipërisë.

Janar - Mars 2019:

~ Në proces komunikimi me Komisionin e Posaçëm për Reformën Zgjedhore për çështjen e regjistrimit të shtetasve jashtë vendit.

Prill - Qershor 2019:

~ Dërguar shkresa Nr. 1958 Prot., datë 05.04.2019, Zëvendëskryeministrit, Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme si dhe Ministrisë së Brendshme, përmes së cilës është kërkuar identifikimi i strukturës administrative dhe personave përgjegjës për ndjekjen e realizimit të masës nr. 13.

~ Shkëmbim informacioni me Ministrinë e Brendshme për regjistrimin e adresës së shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Civile për vitin 2019 ka planifikuar trajnimin e nëpunësve të përfaqësive diplomatike/konsullore, të cilët do të realizojnë procesin e konfirmimit të adresës jashtë shtetit të shtetasve dhe sipas rastit regjistrimin e kësaj adrese në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile.

Korrik - Shtator 2019:

~ Miratuar Urdhri Nr. 124, datë 18.09.2019 i Kryeministrit “Për ngritjen e grupit ndër-institucional të punës për hartimin e paketës ligjore për garantimin e të drejtës së votës për shtetasit shqiptarë jashtë territorit të Republikës të Shqipërisë”.

Tetor - Dhjetor 2019:

~ Dërguar shkresa Nr. 1958 Prot., datë 02.10.2019 Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme për ecurinë e regjistrimit të migrantëve.

~ Grupi ndërinstytucional i punës, ngritur me Urdhrin Nr. 124, datë 18.09.2019 të Kryeministrit “Për ngritjen e grupit ndërinstytucional të punës për hartimin e paketës ligjore për garantimin e të drejtës së votës për shtetasit shqiptarë jashtë territorit të Republikës të Shqipërisë”, në vijim të takimeve të zhvilluara ka përgatitur paketën me ndryshime ligjore për garantimin e të drejtës së votës për shtetasit shqiptarë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Ministri i Shtetit për Diasporën, me shkresën Nr. 6226 Prot., datë 17.12.2019 i ka përcjellë Kryeministrit propozimet për ndryshimin e Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë. Gjithashtu, Ministri i Shtetit për Diasporën, me shkresën Nr. 6223/1 Prot., datë 17.12.2019 i ka përcjellë këto propozime edhe Komisionit të Posaçëm për Reformën Zgjedhore pranë Kuvendit të Shqipërisë.

Janar - Mars 2020:

- Për këtë masë nuk ka të dhëna të reja për këtë periudhë kohore.

Prill - Qershor 2020:

~ Dërguar propozimi për krijimin e një task-force nën drejtimin e Ministrisë së Brendshme për të ndjekur procesin e regjistrimit të shtetasve shqiptarë jashtë vendit.

NË VONESË

| Masa Nr. 14 |

Ngritja e Qendrave Kulturore Shqiptare në vendet pritëse të diasporës në bashkëpunim me shtetin e Kosovës në shërbim të ruajtjes së identitetit kombëtar, për të promovuar imazhin e vendlindjes e të shqiptarëve jashtë vendit dhe për të ofruar shërbime e informacion për komunitetet e shqiptarëve në diasporë.

INDIKATORËT: Ngritja e Qendrave Kulturore Shqiptare në vendet pritëse në bashkëpunim me shtetin e Kosovës.

AFATI KOHOR: 6 mujori dytë 2019

INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:

- Ministri i Shtetit për Diasporën
- Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme
- Ministria e Financës dhe Ekonomisë
- Ministria e Kulturës
- Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë

Prill - Qershor 2019:

~ Dërguar shkresa Nr. 2923 Prot., datë 29.05.2019 Ministrisë për Evropën dhe Punët e

Jashtme mbi realizimin e detyrimeve buxhetore për ngritjen e Qendrave Kulturore për Diasporën.

Korrik - Shtator 2019:

~ Zbatimi i masës nr. 14 është në vonesë për mungesë të fondeve buxhetore nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme.

Tetor - Dhjetor 2019:

~ Zbatimi i masës Nr. 14 është në vonesë për mungesë të fondeve buxhetore nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme.

Janar - Mars 2020:

~ Zbatimi i masës Nr. 14 është në vonesë. Ka mungesë të fondeve buxhetore nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme.

Prill - Qershor 2020:

~ Zbatimi i masës Nr. 14 është në vonesë. Arsyeja është mungesa e fondeve buxhetore nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme.

Realizuar (periodike)⁶

| Masa Nr. 15 |

Mundësimi i informacioneve rreth diasporës shqiptare dhe zhvillimin e komuniteteve jashtë vendit. Realizimi i një raporti vjetor ku të pasqyrohen të dhënat dhe vlerësimi i shteteve ku duhet vepruar me përparësi nga politikatat për diasporën.

INDIKATORËT: Mundësimi i informacioneve dhe realizimi i një raporti vjetor rreth diasporës shqiptare.

AFATI KOHOR: 6 mujori i dytë 2018 (periodike)

INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:

- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
- Ministri i Shtetit për Diasporën
- Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
- Instituti i Statistikave INSTAT

Buletini 2018:

⁶ Në 2018, INSTAT ka publikuar raportin vjetor "Diaspora e Shqipërisë në Shifra", raport i cili do të botohet çdo vit.

~ Miratuar Urdhri nr.137/2018 i Kryeministrit “Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për zbatimin e masës 15 të Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare për Diasporën”.

~ Më datë 18.12.2018 u prezantua publikimi i parë vjetor “Diaspora e Shqipërisë në Shifra”, i cili ofron një vlerësim të Diasporës shqiptare dhe profilit të saj mbi karakteristikat bazë demografike dhe sociale.

Janar - mars 2019:

~ Në kuadër të përmbushjes së Masës 15 për vitin 2019, INSTAT ka filluar punën përgatitore për realizimin e Raportit Vjetor për vitin 2019. Në kuadër të zbatimit të kësaj mase, INSTAT do të përfshijë në raportin vjetor për vitin 2019 edhe masa të tjera të Planit të Veprimit si: 30, 32, 33, 40, 41, 59, 60 dhe 64, me qëllim evidentimin dhe llogaritjen e disa indikatorëve. Për këtë çështje INSTAT ka filluar komunikimin zyrtar me institucionet përgjegjëse.

Prill - Qershor 2019:

~ Dërguar shkresa nr. 199 Prot., datë 08.05.2019 Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Ministrit të Shtetit për Sipërmarrjen, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministrisë së Kulturës për dërgimin e informacionit të nevojshëm për INSTAT, me qëllim realizimin e raportit vjetor për vitin 2019.

~ Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, me shkresën nr. 6883 Prot., datë 10.05.2019 në zbatim të masave nr. 15 dhe nr. 30 të Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare të Diasporës i ka përcjellë INSTAT informacion në lidhje me organizimin dhe administrimin e një rrjeti për studiuesit e huaj e shqiptarë të specializuar në fushën e migracionit dhe të nëpunësve në administratë të specializuar në institucionet që merren me politikën e Diasporës dhe migracionit duke e plotësuar me emra dhe detaje.

Korrik - Shtator 2019:

~ Komunikim me INSTAT dhe Bankën e Shqipërisë për përgatitjen e raportit vjetor 2019 për çështjet që lidhen me interesat e diasporës (realizuar në vitin 2018).

Tetor - Dhjetor 2019:

~ Instituti i Statistikave (INSTAT) ka publikuar raportin vjetor “Diaspora e Shqipërisë në Shifra” për vitin 2019. Ky publikim ofron një vlerësim të Diasporës shqiptare dhe profilit të saj mbi karakteristikat bazë demografike dhe sociale.

~ Banka e Shqipërisë ka publikuar raportin vjetor “Diaspora dhe pagesat” për vitin 2019. Në këtë raport analizohet tregu i pagesave në Shqipëri dhe nevoja për reformim, kostot dhe kursimet e pagesave me vlerë të vogël në Shqipëri, si dhe statistika mbi remitancat.

Janar - Mars 2020:

~ Në kuadër të përgatitjes së Raportit Vjetor 2020, INSTAT po punon me mbledhjen e të dhënave për vitin 2020. Afati i dorëzimit të këtij Raporti është 18 Dhjetor 2020.

~ Në datë 20 janar 2020, Këshilli Drejtues i Agjencisë Kombëtare të Diasporës miratoi programin e aktiviteteve të Agjencisë për vitin 2020, ku si prioritet u vlerësua vazhdimi i programit kushtuar komuniteteve shqiptare në Ukrainë, Kroaci dhe Itali. Secili program përbëhet nga aktivitete të cilat synojnë ruajtjen dhe promovimin e kulturës shqiptare, si dhe ofrimin e ndihmës tek komunitetet shqiptare në diasporë për ruajtjen e gjuhës dhe trashëgimisë kombëtare.

Prill - Qershor 2020:

~ Instituti i Statistikave (INSTAT) po vijon punën për mbledhjen e të dhënave të nevojshme për përgatitjen e raportit vjetor “Diaspora e Shqipërisë në Shifra”, i cili publikohet në dhjetor 2020.

NË PROCES

| Masa Nr.16 |

Realizimi i trajnimeve të përgjithshme dhe të veçanta për fushën e migracionit dhe përfshirja e tyre në programet e universiteteve shqiptare. Organizimi i trajnimeve periodike në fushën e legjislacionit të brendshëm dhe atij ndërkombëtar për nëpunësit që mbulojnë çështje të migracionit. Identifikimi i nevojave dhe ekspertëve që kanë nevojë për trajnime ligjore. Hartimi i moduleve trajnuese në këtë fushë dhe përfshirjen e një moduli të tillë në trajnimet e nëpunësve të shërbimit civil.

INDIKATORËT: Trajnime të përgjithshme dhe të veçanta. Organizimi i trajnimeve periodike. Identifikimi i nevojave dhe ekspertëve. Hartimi i moduleve trajnuese.

AFATI KOHOR: 6 mujori i dytë i 2018 (periodike)

INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:

- Zëvendëskryeministri
- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
- Ministri i Shtetit për Diasporën
- Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
- Ministria e Drejtësisë

Buletini 2018:

~ Së bashku me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike (ASPA), me financim të qeverisë italiane dhe në zbatim nga zyra IOM në Tiranë, në kuadër të projektit “Angazhimi i Diasporës Shqiptare për Zhvillimin Social dhe Ekonomik të Shqipërisë” do të realizohen trajnime të stafit të Agjencisë Kombëtare për Diasporën, të cilat janë pjesë planit të nevojave për trajnim për vitin 2019. Në proces përgatitja e moduleve të trajnimit, sipas kuadrit ligjor shqiptar për sektorë të administratës shtetërore që do të konsiderohen të nevojshme. I është dërguar kërkesë zyrës së IOM në Tiranë për hartimin e manualeve/moduleve.

~ Më datë 05.12.2018 u zhvillua një takim me përfaqësuesit e institucioneve përgjegjëse për të diskutuar mbi hartimin e moduleve trajnuese. Në vijim të takimit, Ministria e Drejtësisë nëpërmjet ekspertëve ligjorë për migrimin nga Drejtoria e Përgjithshme e Kodifikimit dha kontributin e saj në krijimin e bazës ligjore mbi migracionin.

Janar - Mars 2019:

~ Zhvilluar vizitë studimore në Romë, në datat 4-8 shkurt 2019 nga një grup me përfaqësues të Ministrit të Shtetit për Diasporën, Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Agjencisë Kombëtare për Diasporën, Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës, Bankës së Shqipërisë dhe Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve. Qëllimi i vizitës ishte marrja dhe shkëmbimi i përvojës për rritjen e kapaciteteve të qeverisë, institucioneve e agjencive shqiptare për angazhimin e Diasporës në zhvillimin e vendit. Vizita u zhvillua në kuadër të Projektit të zyrës së IOM në Tiranë “Angazhimi i Diasporës Shqiptare në Zhvillimin Social dhe Ekonomik të Shqipërisë”.

~ Në kuadër të projektit “Për Angazhimin e Diasporës Shqiptare për Zhvillimin Social dhe Ekonomik të Shqipërisë” në bashkëpunim me zyrën e IOM në Tiranë, financuar nga zyra e Kooperacionit Italian, janë organizuar dy takime të veçanta në datat 15 janar dhe 19 shkurt me koordinatorët e Agjencisë Kombëtare për Diasporën si edhe me Grupin e Koordinatorëve për zbatimin e Strategjisë Kombëtare⁷, ngritur me Urdhrin Nr. 98/2018, të Kryeministrit “Për përcaktimin e grupit të koordinatorëve për zbatimin e Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare për Diasporën 2018-2024”.

Prill - Qershor 2019:

~ Dërguar shkresa nr. 1963 Prot., datë 05.04.2019 për Shkollën Shqiptare të Administratës Publike (ASPA) për realizimin e bashkëpunimit për trajnimin e koordinatorëve të institucioneve përgjegjëse për zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Diasporës.

~ Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA), me shkresën nr. 280/1, datë 16.04.2019, informon se ka të planifikuara për vitin 2019 zhvillimin e 4 trajnimeve në fushën e migracionit.

~ Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA), me shkresën nr. 319 Prot., datë 24.04.2019, ka përcjellë kalendarin e programeve të trajnimit të ASPA për periudhën prill-dhjetor 2019.

~ Dërguar Shkollës Shqiptare të Administratës Publike *target group* dhe temat mbi trajnimin në fushën e Diasporës dhe migracionit për nëpunësit e institucioneve përgjegjëse për zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Diasporës dhe Planit të Veprimit 2018 - 2024. Ka filluar trajnimi nga kjo Shkollë, i nëpunësve të Agjencisë Kombëtare të Diasporës.

Korrik - Shtator 2019:

~ Nënshkruar marrëveshja ndërmjet Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës dhe Universitetit për Biznes dhe Teknologji në Kosovë "Për bashkëpunim në fushën e

⁷ <https://diaspora.gov.al/diskutimi-mbi-angazhimin-e-diaspores-ne-zhvillimin-social-dhe-ekonomik-te-shqiperise/>

kërkimit, mësimdhënies, zhvillimit teknologjik dhe inovacionit" në datën 22 korrik 2019 në Prishtinë. Sipas kësaj marrëveshje palët do të bashkëpunojnë për organizimin e aktiviteteve kërkimore, zhvillimore dhe inovative. Gjithashtu, bashkëpunimi do të shtrihet më tej edhe në fushat e arsimit, kulturës dhe trajnimeve të avancuara.

Tetor - Dhjetor 2019:

- Në bashkëpunim me Organizatën Ndërkombëtare të Migracionit (IOM) dhe Shkollën Shqiptare të Administratës Publike do të zhvillohen trajnime për stafin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës në fushën e migracionit dhe diasporës. Aktualisht ekspertët e zgjedhur nga IOM janë në proces hartimi të kurrikulës. Me datën 20 nëntor 2019, ASPA ka shpallur pozicionin për trajnues dhe ekspert në hartim kurrikule për diasporën dhe migracionin.

- Në proces negocimi projektvendimi i Keshillit të Ministrave "Për ngritjen e strukturës së posaçme administrative për diasporën dhe migracionin në qeverisjen vendore". Ky projektvendim parashikon krijimin e zyrave të posaçme për diasporën dhe migracionin në institucionet e qeverisjes vendore, si dhe përgjegjësitë e detyrat e këtyre strukturave.

Janar - Mars 2020:

- Organizata Ndërkombëtare e Migracionit (IOM) në bashkëpunim me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike (ASPA) organizuan në 26 mars trajnimin me temë "Kurrikula e Trajnimit të Trajnerëve (ToT) mbi teknikat e mbledhjes së fondeve në aplikim projektsh." Dy konsulentët e IOM prezantuan kurrikulën e trajnimit të trajnerëve mbi teknikat e aplikimit dhe mbledhjes së fondeve nga donatorë të ndryshëm. Trajnerët që përvetësuan këtë modul do të trajnojnë stafin e institucioneve përgjegjëse për diasporën si dhe koordinatorët për zbatimin e Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare të Diasporës pranë ministrive të linjës.

Prill - Qershor 2020:

- Në datat 8-10 prill 2020, Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (IOM) dhe Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA) zhvilluan një trajnim online për ngritjen e fondeve me përfaqësuesit e Agjencisë Kombëtare të Diasporës, Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës, Dhomës së Biznesit të Diasporës, Qendrës së Botimeve për Diasporën dhe Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët.

NË PROCES

| Masa Nr.17 |

Nxitja e bashkëpunimit shtetëror me institucionet e vendeve pritëse të cilat janë me profile dhe trajtojnë çështje të migrantëve, të drejtave të grave dhe të drejtave të fëmijëve. Krijimi i komisioneve dypalëshe konsultative të nivelit të lartë me shtetet pritëse për mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve shqiptare të diasporës dhe funksionimi i tyre në mënyrë periodike për këtë qëllim. Informimi publik për ecurinë dhe zhvillimin e kësaj veprimtarie për publikun e interesuar.

INDIKATORËT: Bashkëpunim shtetëror me institucionet e vendeve pritëse. Krijimi i komisioneve dypalëshe konsultative. Informimi publik për ecurinë.

AFATI KOHOR: 6 mujori i parë 2019 (periodike)

INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:

- **Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme**
- **Ministri i Shtetit për Diasporën**
- **Ministria e Drejtësisë**

Janar - mars 2019:

~ Dërguar shkresa nr. 1545 Prot., datë 15.03.2019, pranë Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Ministrisë së Drejtësisë për identifikimin e strukturës administrative dhe personave përgjegjës të cilët do të ndjekin realizimin e masës dhe bërjen funksionale të komisioneve dypalëshe konsultative për mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve shqiptare në Diasporë.

Prill - Qershor 2019:

~ Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës dhe Qendra e Botimeve për Diasporën morën pjesë në Festivalin e Shumëgjuhësisë që u zhvillua në Selanik, Greqi më datë 17 - 20 maj 2019. Kjo pjesëmarrje pati edhe synim njohjen me rrjetin e grave, punën e bërë, si dhe çështje të tjera me qëllim mbështetjen e iniciativave të tyre në Greqi, forcimin e lidhjeve me vendin e origjinës dhe angazhimin e këtij rrjeti në projektet e ndryshme dedikuar Diasporës shqiptare.

Korrik - Shtator 2019:

~ Në datat 31 korrik - 3 gusht 2019 Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e Republikës së Kosovës dhe Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë e Republikës së Shqipërisë organizuan Seminarin XV të mësimin plotësues të gjuhës shqipe. Në këtë aktivitet Qendra e Botimeve për Diasporën prezantoi para mësuesve misionin dhe hapat e ndërmarrë për hartimin e teksteve të reja të përbashkëta për mësimdhënien në Diasporë. Qendra e Botimeve për Diasporën shpërndau për mësuesit "Udhëzuesin për mësimdhënien në Diasporë" botuar nga QBD-ja, si dhe materiale të tjera informuese.

~ Më datë 19-30 gusht, Qendra e Botimeve për Diasporën mori pjesë në Seminarin XXXVIII Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, e organizuar nga Fakulteti i Filologjisë së Universitetit të Prishtinës, në të cilin morën pjesë rreth 100 studentë vendas dhe të huaj, si dhe 40 ligjërues nga vende të ndryshme të botës. Aty u diskutua dhe vendosën kontaktet mes QBD-së dhe studiuesve të gjuhës dhe kulturës shqiptare në diasporë.

~ Më datë 15 shtator, Qendra e Botimeve për Diasporën mori pjesë në panairin "Diaspora 2019" në Uster të Zvicrës. Qendra e Botimeve për Diasporën bëri publike edhe nismën e për organizimin e një Takimi Mbarëkombëtar të Shkrimtarëve të Diasporës më 22 shkurt 2020 si dhe mbi Takimin Mbarëkombëtar të Mësuesve që do të organizohet në 14-15 mars 2020 në Tiranë.

Tetor - Dhjetor 2019:

~ Ministri i Shtetit për Diasporën, z. Pandeli Majko, zhvilloi një vizitë pune në Ukrainë në datat 28 tetor deri në 1 nëntor 2019. Ministri u takua me Ministrin e Infrastrukturës

në Ukrainë, z. Vladislav Kriklii, ku u diskutua mbi rishikimin e Marrëveshjes Ukrainë-Shqipëri për lehtësimin e kalimit të mallrave me transport rrugor mes dy vendeve.

Janar - Mars 2020:

~ Ministria e Drejtësisë, përmes komunikimit elektronik me email, informon se në bashkëpunim me Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, ka krijuar databazën me të dhënat e shtetasve shqiptarë që vuajnë dënimin me heqje lirie jashtë vendit. Me qëllim ndjekjen e rasteve për të cilat kërkohet bashkëpunim me institucione të tjera, Ministria e Drejtësisë po rakordon me Kryqin e Kuq Shqiptar dhe Komitetin Shqiptar të Helsinkit në Greqi dhe vende të tjera fqinje.

Prill - Qershor 2020:

~ Ministria e Drejtësisë, përmes komunikimit me email, informon se është në proces të përgatitjes së një dokumenti-katalog përmbledhës "Karta e të Drejtave", me parimet e zbatueshme dhe të drejtat e personave të dënuar jashtë Shqipërisë, bazuar në standardet ndërkombëtare, i cili do të jetë i aksesueshëm në faqet zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme.

NË PROCES

| Masa Nr.18 |

Përgatitja dhe shpërndarja e informacionit (broshurave, fletëpalosje, faqe interneti etj.) që ju drejtohet komuniteteve shqiptare në diasporë, ku të jepet informacion në lidhje me statusin dhe të drejtat e tyre si edhe për shërbimet që ju ofrohen nga përfaqësitë diplomatike dhe konsullore si edhe nga shoqatat e migrantëve me mbështetjen e organizatave ndërkombëtare.

INDIKATORËT: Shpërndarja e informacionit në lidhje me statusin të drejtat si edhe shërbimet që ju ofrohen.

AFATI KOHOR: 6 mujori i parë 2019 (periodike)

INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:

- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
- Ministria e Brendshme
- Ministri i Shtetit për Diasporën
- Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
- Instituti i Statistikave INSTAT
- Ministria e Drejtësisë

Janar - Mars 2019:

~ Koordinator Shtetëror për Informimin e Diasporës, në zbatim të Urdhrit nr. 45/2019 të Kryeministrit "Për caktimin e Koordinatorit Shtetëror për Informimin e Diasporës", ka filluar koordinimin e punës për publikimin e informacionit në faqet zyrtare të institucioneve përgjegjëse.

~ Janë krijuar faqet zyrtare të Agjencisë Kombëtare të Diasporës, Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës dhe Qendrës së Botimeve për Diasporën, si platforma komunikimi

dhe informimi. Pjesë e këtyre faqeve është dhe rubrika E-Albania, e cila ofron shërbime dhe informacione për komunitetet shqiptare jashtë vendit.

Prill - Qershor 2019:

~ Në proces lançimi i aplikacionit “Diaspora Shqiptare”, i cili ofron informacion të plotë për gjithçka që ndodh me Diasporën shqiptare, përfshirë aktivitetet e komunitetit shqiptar në vendet pritëse. Aplikacioni “Diaspora Shqiptare” do të mund të shkarkohet online dhe menaxhohet nga Agjencia Kombëtare e Diasporës.

~ Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme realizoi platformën "Ambasada ime". Kjo platformë ofron informacion të plotë mbi strukturën e mbulimit diplomatik dhe konsullor të Shqipërisë në botë, si dhe mundëson komunikimin aktiv të njëjve diplomatike e konsullore me shtetasit shqiptarë. “Ambasada Ime” ofron mundësinë e parashtrimit të pyetjeve, adresimit të ankesave dhe kërkesave pranë përfaqësive diplomatike të Shqipërisë.

~ Koordinator i Shtetëror për informimin e Diasporës, caktuar me Urdhrin nr. 45/2019 të Kryeministrit, ka raportuar në mbledhjen e Komitetit Shtetëror për Diasporën (3 Maj 2019) për krijimin e seksionit informativ “Diaspora”. Ai informoi se deri tani është punuar për ngritjen e infrastrukturës dhe për hedhjen e disa prej të dhënave të ofruara nga pjesëmarrësit e Samitit të Dytë të Diasporës. Pjesë e detyrave në vijim është dhe krijimi i një databaze shtetërore për Diasporën që përmban të dhëna të ndryshme mbi anëtarët e Diasporës shqiptare si sipërmarrësit, mjekët, juristët, mësuesit, etj.

~ Qendra e Botimeve për Diasporën është në proces të përgatitjes së një dokumenti me informacione të plota për mësimdhënien në Diasporë, në ndihmesë të mësuesve, të cilët e ushtrojnë këtë profesion në shërbim të komuniteteve shqiptare jashtë vendit.

Korrik - Shtator 2019:

~ Në datën 20 korrik 2019 u lançua aplikacioni “Diaspora Shqiptare”, i cili synon të ofrojë informacion dhe shërbime për komunitetet shqiptare në diasporë. Aplikacioni “Diaspora Shqiptare” do të jetë një platformë aktive lidhur me realitetin shqiptar. Aplikacioni shkarkohet falas në Play Store dhe App Store.

~ Qendra e Botimeve për Diasporën ka publikuar dokumentin "Udhëzues për mësimdhënien në Diasporë 2019". Ky material është një dokument informues i ndryshimeve ligjore, akteve dhe shkresave me rëndësi në mbështetje të mësuesve dhe mësimdhënies në Diasporën shqiptare. Ai synon të paraqesë ecurinë e deritanishme të politikave shtetërore që ndikojnë drejtpërdrejt në përmirësimin e statusit të shkollave shqipe dhe të mësuesve në Diasporë. Ky udhëzues është një tregues i bashkëpunimit midis Shqipërisë dhe Kosovës për miratimin e teksteve të përbashkëta për Diasporën nga Komisioni i Përbashkët ndërshtetëror, në zbatim të Marrëveshjes së Përbashkët mes institucioneve përgjegjëse të dy vendeve.

~ Agjencia Kombëtare e Diasporës në bashkëpunim me Ministrin e Shtetit për Diasporën ka përgatitur dhe publikuar Revistën Elektronike të Këshillit Koordinues të Diasporës. Ky dokument është një përmbledhje informuese e bazës ligjore dhe anëtarëve të Këshillit Koordinues të Diasporës.

~ Agjencia Kombëtare e Diasporës ka publikuar Revistën Elektronike të Komitetit Shtetëror për Diasporën. Ky dokument është një përmbledhje e bazës ligjore dhe

jetëshkrimeve të koordinatorëve shtetërorë.

~ Në kuadër të konferencës së Diasporës shkencore, zhvilluar në Tiranë më 27-28 shtator, Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës i ka materializuar dhe promovuar kontributet e panelistëve dhe kumtuesve në dy publikime: Libri me Referimet dhe Diskutimet në Panelet Tematike dhe Book of Proceedings (Përmbledhjet e punimeve shkencore) si dhe ka shpërndarë fletëpalosjet dhe broshurat prezantuese të projekteve të reja të Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës: Diaspora shkencore shqiptare dhe Dhoma e Biznesit të Diasporës.

Tetor - Dhjetor 2019:

~ Agjencia Kombëtare e Diasporës ka botuar librin “Politika Shtetërore për Diasporën 2019”. Ky botim i posaçëm përmban të gjitha aktet e miratuara gjatë vitit 2019 për diasporën.

~ Aplikacioni “Diaspora Shqiptare” përditësohet në vazhdimësi duke ofruar një informacion të gjerë mbi aktivitetet e komunitetit shqiptar në çdo vend e mbi të gjitha shërben si pikë referimi për të gjithë shqiptarët kudo janë.

~ Çdo javë publikohet “Newsletter e Diasporës”, përmes së cilës, Diaspora shqiptare informohet lidhur me veprimtarinë e institucioneve shtetërore të Diasporës dhe aktivitete të ndryshme brenda dhe jashtë vendit.

~ Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës ka botuar Periodikun e Dytë, si një përmbledhje studimore për Diasporën shqiptare. Ky botim përmban studime kryesore të vitit 2019 për Diasporën dhe Migrimin si dhe analiza dhe raporte të institucioneve kombëtare dhe ndërkombëtare.

Janar - Mars 2020:

~ Me qëllim informimin e komunitetit të biznesit në diasporë, Dhoma e Biznesit të Diasporës pulikon çdo javë “Newsletter e Dhomës së Biznesit të Diasporës”, në gjuhën shqipe dhe angleze, me informacione mbi ekonominë, financat, sipërmarrjen, mundësitë për investime, ndryshimet ligjore, paketat fiskale dhe incentivuese, si dhe aktivitete të ndryshme brenda dhe jashtë vendit me fokus biznesin dhe investimet.

~ Çdo javë publikohet “Newsletter e Diasporës”, përmes së cilës, Diaspora shqiptare informohet lidhur me veprimtarinë e institucioneve shtetërore të Diasporës dhe aktivitete të ndryshme brenda dhe jashtë vendit.

~ Agjencia Kombëtare e Diasporës ka publikuar fletëpalosjen me informacion rreth veprimtarisë dhe aktiviteteve të realizuara gjatë vitit 2019. Kjo fletëpalosje u shpërnda edhe në Takimin e Mjekësisë në Diasporë, organizuar në datë 20 shkurt 2020, në Tiranë.

Prill - Qershor 2020:

~ Publikohet gazeta “Diaspora Shqiptare”, një projekt i financuar nga qeveria e Konfederatës së Zvicrës në bashkëpunim me Fondin Shqiptar të Zhvillimit të Diasporës. Gazeta “Diaspora Shqiptare” çdo javë u dërgon me e-mail anëtarëve të komuniteteve shqiptare në botë përmbledhjen e lajmeve dhe ngjarjeve kryesore të Diasporës të paqyruara gjatë javës në gazetë.

~ Çdo javë publikohet “Newsletter e Diasporës”, përmes së cilës, Diaspora shqiptare informohet lidhur me veprimtarinë e institucioneve shtetërore të Diasporës dhe aktivitete të ndryshme brenda dhe jashtë vendit.

NË PROCES

| Masa Nr. 19 |

Hartimi i manualeve praktike që lidhen me çështjet e migracionit dhe vënia e tyre në dispozicion të zyrtarëve që merren me zbatimin në praktikë të legjislacionit për migracionin. Identifikimi i akteve ligjore/nënligjore që zbatohen në praktikë nga çdo institucion i cili mbulon çështje të caktuara të diasporës dhe migracionit. Trajnimi dhe certifikimi i trupit diplomatik të Shqipërisë lidhur me legjislacionin migrator dhe në mënyrë të veçantë me të drejtat e komuniteteve shqiptare në diasporë.

INDIKATORËT: Hartimi i manualeve praktike. Identifikimi i akteve ligjore/nënligjore. Trajnimi dhe certifikimi i trupit diplomatik të Shqipërisë.

AFATI KOHOR: 6 maji i dytë i 2018 (periodike)

INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:

- Zëvendëskryeministri
- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
- Ministria e Brendshme
- Ministri i Shtetit për Diasporën
- Ministria e Drejtësisë

Buletini 2018:

~ Në bashkëpunim me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike (ASPA), me financim të qeverisë italiane dhe në zbatim nga zyra e IOM në Tiranë, në kuadër të projektit “Angazhimi i Diasporës Shqiptare për Zhvillimin Social dhe Ekonomik të Shqipërisë” do të realizohen trajnime të stafit të Agjencisë Kombëtare për Diasporën, të cilat janë përfshirë në planin 2019 të nevojave për trajnim. Në proces përgatitja e moduleve të trajnimit, sipas kuadrit ligjor shqiptar për sektorë të administratës shtetërore që do të konsiderohen të nevojshme. I është dërguar kërkesë zyrës së IOM në Tiranë, për hartimin e manualeve/moduleve.

Janar - Mars 2019:

~ Realizuar një botim i posaçëm me legjislacionin dhe aktet nënligjore “Politika Shtetërore për Diasporën 2018”. Ky botim do të realizohet çdo vit me qëllim informimin e administratës përgjegjëse dhe publikut të interesuar.

- Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës ka publikuar Periodikun e parë “Diaspora Shqiptare”, një përmbledhje studimore për Diasporën shqiptare. Ky botim i posaçëm do të realizohet çdo 6 muaj.

Prill - Qershor 2019:

~ Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës është në proces për përgatitjen e Periodikut të dytë “Diaspora Shqiptare”, një përmbledhje studimore për Diasporën shqiptare, e cila botohet dy herë në vit.

~ Qendra e Botimeve për Diasporën është në proces të përgatitjes së një dokumenti me informacione të plota për mësimdhënien në Diasporë, në ndihmesë të mësuesve, të cilët e ushtrojnë këtë profesion në shërbim të komuniteteve shqiptare jashtë vendit.

~ Dërguar shkresa nr. 1963 Prot., datë 05.04.2019 për Shkollën Shqiptare të Administratës Publike (ASPA) ku i kërkohet bashkëpunim për realizimin e trajnimeve për koordinatorët e institucioneve përgjegjëse për zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Diasporës.

~ Dërguar Shkollës Shqiptare të Administratës Publike *target group* dhe temat mbi trajnimin në fushën e Diasporës dhe migracionit për nëpunësit e institucioneve përgjegjëse për zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Diasporës dhe Planit të Veprimit 2018 - 2024.

~ Shkëmbim informacioni me Ministrinë e Brendshme për regjistrimin e adresës së shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile për këtë vit ka planifikuar trajnimin e nëpunësve të përfaqësive diplomatike/konsullore, të cilët do të realizojnë procesin e konfirmimit të adresës jashtë shtetit të shtetasve dhe sipas rastit regjistrimin e kësaj adrese në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile.

~ Më 5 prill 2019, Ministri i Shtetit për Diasporën, z. Pandeli Majko zhvilloi një takim informues me diplomatët e rinj, pjesë e Akademisë Diplomatike pranë Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme. Gjatë këtij takimi ata u njohën me strukturat e ministrit të Shtetit për Diasporën, funksionin e tyre dhe politikat shtetërore të hartuara dhe të zbatuara deri më sot.

Korrik - Shtator 2019:

~ Qendra e Botimeve për Diasporën ka publikuar dokumentin "Udhëzues për mësimdhënien në Diasporë 2019". Ky material është një dokument informues i ndryshimeve ligjore, akteve dhe shkresave me rëndësi në mbështetje të mësuesve dhe mësimdhënies në Diasporën shqiptare. Ky udhëzues është një tregues i bashkëpunimit midis Shqipërisë dhe Kosovës për miratimin e teksteve të përbashkëta për Diasporën nga Komisioni i Përbashkët ndërshtetëror, në zbatim të Marrëveshjes së Përbashkët mes institucioneve përgjegjëse të dy vendeve.

~ Në kuadër të konferencës së diasporës shkencore, zhvilluar në Tiranë më 27-28 shtator, Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës i ka materializuar dhe promovuar kontributet e panelistëve dhe kumtuesve në dy publikime: Libri me Referimet dhe Diskutimet në Panelet Tematike dhe Book of Proceedings (Përmbledhjet e punimeve shkencore). Ai ka shpërndarë fletëpalosjet dhe broshurat me prezantimin e projekteve të reja të Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës: Diaspora shkencore shqiptare dhe Dhoma e Biznesit të Diasporës. Këto publikime do të shërbejnë si rekomandime dhe propozime për t'u marrë parasysh në zbatimin në praktikë të legjislacionit për migracionin dhe një pjesë e tyre do të shërbejë për botimin e Periodikut të dytë “Diaspora Shqiptare”.

~ Agjencia Kombëtare e Diasporës është në proces të përgatitjes të botimit të posaçëm me legjislacionin dhe aktet nënligjore “Politika Shtetërore për Diasporën 2019”. Ky botim do të realizohet në dhjetor 2019 dhe do të pasojë vëllimin e publikuar në dhjetor 2018.

Tetor - Dhjetor 2019:

~ Agjencia Kombëtare e Diasporës ka botuar librin “Politika Shtetërore për Diasporën 2019”. Ky botim i posaçëm përmban të gjitha aktet e miratuara gjatë vitit 2019 për diasporën.

~ Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës ka botuar Periodikun e Dytë, si një përmbledhje studimore për Diasporën shqiptare. Ky botim përmban studime kryesore të vitit 2019 për Diasporën dhe Migrimin si dhe analiza dhe raporte të institucioneve kombëtare dhe ndërkombëtare.

~ Në bashkëpunim me Organizatën Ndërkombëtare të Migracionit (IOM) dhe Shkollën Shqiptare të Administratës Publike do të zhvillohen trajnime për stafin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës në fushën e migracionit dhe diasporës.

Janar - Mars 2020:

~ Avokati i Popullit në bashkëpunim me Organizatën Ndërkombëtare të Migracionit (IOM) ka publikuar një Manual me konventat dhe ligjet e ratifikuara për të drejtat e shtetasve shqiptarë që vuajnë heqjen e lirisë jashtë vendit. Ky manual gjendet i publikuar në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë, në rubrikën “Diaspora” për t’u ardhur në ndihmë shtetasve shqiptarë që vuajnë heqjen e lirisë jashtë vendit.

Prill - Qershor 2020:

~ Nuk ka informacion për këtë periudhë 3 mujore.

ME VONESË

Masa Nr.20

Vendosja e kontakteve të rregullta me Grupin Evropian të Autoriteteve Rajonale dhe Lokale në fushën e Imigracionit (ERLAI) me qendër në Bruksel, për të vlerësuar mundësitë e mbështetjes së politikës të mbrojtjes së komuniteteve të shqiptarëve në diasporë në vendet pritëse të BE-së.

INDIKATORËT: Kontakte të rregullta me Grupin Evropian të Autoriteteve Rajonale dhe Lokale në fushën e Imigracionit.

AFATI KOHOR: 6 muji i dytë i 2018

INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:

- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
- Ministri i Shtetit për Diasporën - Agjencia Kombëtare për Diasporën
- Ministria e Drejtësisë

Buletini 2018:

~ Dërguar shkresa nr. 4010, datë 3.9.2018, Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Ministrisë së Drejtësisë, “Për zbatimin e masës Nr.20 të Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare për Diasporën 2018 - 2024”.

~ Agjencia Kombëtare e Diasporës është informuar nga Ministria e Brendshme mbi objektivin kryesor të programit aktual të ERLAI, mbi avancimin e elementeve të lidhura me migrimin e Agjendës 2030, për Zhvillimin e Qëndrueshëm duke promovuar koherencën e politikave për migracionin në nivel global dhe lokal.

~ Ministria e Drejtësisë sugjeron që në zbatim të Vendimit nr. 502/2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Brendshme”, Ministria e Brendshme duhet të vlerësojë nevojat e anëtarësimit të Shqipërisë në këtë rrjet ndërkombëtar. Në proces ndjekja e sugjerimit.

Prill - Qershor 2019:

~ Dërguar shkresa nr. 1964 Prot., datë 05.04.2019, Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Drejtësisë për identifikimin e strukturave shtetërore të cilat kanë marrëdhënie bashkëpunimi me ERLAI dhe zhvillimin e bashkëpunimit me këtë organizatë.

Korrik - Shtator 2019:

~ Lidhur me zbatimin e masës nr. 20 nuk ka informacion të ri.

Tetor - Dhjetor 2019:

~ Ministria e Drejtësisë, përmes komunikimit me email, ka kërkuar nga Ministria e Brendshme informacion lidhur me programin ERLAI dhe/ose projekte të tjera që zbaton Ministria e Brendshme për garantimin e mbrojtjes së të drejtave të emigrantëve.

Janar - Mars 2020:

~ Nuk ka informacion të ri në zbatimin e kësaj mase.

Prill - Qershor 2020:

~ Nuk ka informacion të ri në zbatimin e kësaj mase.

NË PROCES

| Masa Nr.21 |

Nxitja dhe intensifikimi i kontakteve të ngushta ndërmjet organizimeve shqiptare në diasporë dhe shoqatave vendase për mbrojtjen e migrantëve. Identifikimi i organizatave në vendet pritëse për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të migrantëve në këto vende. Ndërgjegjësim nëpërmjet informacioneve në internet, tryezave dhe takimeve për mbrojtjen sociale dhe shëndetësore në vendet pritëse dhe të origjinës.

INDIKATORËT: Kontakte të ngushta ndërmjet organizimeve shqiptare në diasporë dhe shoqatave vendase, ndërgjegjësim për mbrojtjen sociale dhe shëndetësore.

AFATI KOHOR: 6 mujori i dytë 2018 (periodike)

INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:

- **Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme**
- **Ministri i Shtetit për Diasporën - Agjencia Kombëtare për Diasporën**
- **Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale**
- **Ministria e Drejtësisë**

Buletini 2018:

~ Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës është duke zbatuar projektin “Diaspora për Zhvillim”, miratuar me Vendimin Nr. 611/2018 të Këshillit të Ministrave, i cili parashikon edhe realizimin e kontakteve ndërmjet organizimeve shqiptare në Diasporë dhe shoqatave vendase për mbrojtjen e migrantëve.

~ Në diskutim vlerësimi i krijimit i një ëeb-site/portali për informimin dhe trajtimin e rasteve më të shpeshta të shkeljeve të të drejtave të njeriut si një mundësi për garantimin e të drejtave të tyre në kohë reale.

Janar - Mars 2019:

~ Agjencia Kombëtare e Diasporës ka krijuar regjistrin me shoqatat shqiptare në Diasporë, sipas fushës së veprimtarisë së tyre. Në proces plotësimi në vazhdim i tij.

Prill - Qershor 2019:

~ Në proces organizimi në muajin shtator, nën koordinimin e Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës, të Takimit të XIV-të Vjetor Ndërkombëtar të Institutit ALB-SHKENCA me temë plenare: “Kërkimi shkencor në hapësirën mbarëshqiptare dhe roli i Diasporës shkencore”. Në këtë takim do të marrin pjesë studiues nga rajoni dhe Diaspora që janë pjesë e strukturave akademike shqiptare, kërkues shkencorë të pavarur si dhe shkencëtarë të huaj me qëllim dhënien e kontributit dhe rekomandimeve për përmirësimin e sektorëve zhvillimorë në Shqipëri.

- Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës dhe Qendra e Botimeve për Diasporën morën pjesë në Festivalin e Shumëgjuhësisë që u zhvillua në Selanik, Greqi. Kjo pjesëmarrje pati edhe synim njohjen me rrjetin e grave, punën e bërë, si dhe çështje të tjera me qëllim mbështetjen e iniciativave të tyre në Greqi, forcimin e lidhjeve me vendin e origjinës dhe angazhimin e këtij rrjeti në projektet e ndryshme dedikuar Diasporës shqiptare.

~ Ministri i Shtetit për Diasporën, z. Pandeli Majko mori pjesë në simpoziumin shkencor “Si e kapërcyem pragun e shpresës”, aktivitet i organizuar me rastin e 30 vjetorit të shoqatës kulturore të shqiptarëve “Migjeni” në Lubjanë, Slloveni. “Migjeni” është shoqata e parë shqiptare në ish-Jugosllavi, e cila ka ngulmuar në kërkesat e saj për njohjen e të drejtave të shqiptarëve. Në këtë përvjetor të rëndësishëm, Ministri i Shtetit për Diasporën i dorëzoi shoqatës “Migjeni” titullin “Naim Frashëri”, për “Veprimtarinë dhe angazhimin në mbrojtjen e çështjes kombëtare shqiptare”, titull ky akorduar nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë. Gjithashtu, gjatë ceremonisë i'u

akordua titulli "Naim Frashëri" (pas vdekjes) edhe ish kryetarit të kësaj shoqate, z. Gjon Simonit.

Korrik - Shtator 2019:

~ Në datat 31 korrik- 3 gusht 2019 Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e Republikës së Kosovës dhe Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë e Republikës së Shqipërisë organizuan Seminarin XV të mësimit plotësues të gjuhës shqipe. Në këtë aktivitet Qendra e Botimeve për Diasporën prezantoi para mësuesve misionin dhe vizionin e saj, hapat e ndërmarrë për hartimin e teksteve të reja të përbashkëta për mësimdhënien në Diasporë, si dhe projektet e tjera për ruajtjen dhe përhapjen e gjuhës dhe kulturës shqiptare jashtë vendit. Qendra e Botimeve për Diasporën shpërndau për mësuesit "Udhëzuesin për mësimdhënien në Diasporë" botuar nga QBD-ja, si dhe materiale të tjera informuese.

~ Më datë 19-30 gusht, Qendra e Botimeve për Diasporën mori pjesë në Seminarin XXXVIII Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, të organizuar nga Fakulteti i Filologjisë së Universitetit të Prishtinës, në të cilin morën pjesë rreth 100 studentë vendas dhe të huaj, si dhe 40 ligjërues. Aty u diskutua dhe u vendosën kontaktet mes QBD-së dhe studiuesve të gjuhës dhe kulturës shqiptare në Diasporë.

~ Më datë 15 shtator, Qendra e Botimeve për Diasporën u prezantua në panairin "Diaspora 2019" në Uster të Zvicrës. Aty QBD-ja bëri publike edhe nismën e Ministrit të Shtetit për Diasporën për organizimin e një Takimi Mbarëkombëtar të Shkrimtarëve të Diasporës më 22 shkurt 2020. Të pranishmit u njoftuan edhe për Takimin Mbarëkombëtar të Mësuesve që do të organizohet në 14-15 mars 2020 në Tiranë. Ky aktivitet u realizua nën organizimin e shoqatës "Bashkimi", me praninë e përfaqësuesve të institucioneve shtetërore të Shqipërisë, Kosovës dhe Zvicrës, të shtëpive botuese vendase dhe shqiptare, si dhe të shkrimtarëve dhe mësuesve në Diasporë.

~ Në datat 27 - 28 shtator 2019 u zhvillua Takimi i XIV-të Ndërkombëtar "Kërkimi Shkencor në Hapësirën Mbarëshqiptare dhe Roli i Diasporës Shkencore", organizuar nga Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës në bashkëpunim me Institutin Albshkenca dhe mbështetjen e GIZ në Shqipëri. Në këtë aktivitet, i cili kishte si synim angazhimin e diasporës shkencore shqiptare dhe profesionistëve të kualifikuar përmes shkëmbimit efektiv të njohurive, morën pjesë rreth 400 të ftuar ndër të cilët studiues të shquar të Diasporës shkencore shqiptare, anëtarë aktivë të Institutit Alb-Shkenca, studiues të rinj të angazhuar në studime pasuniversitare dhe teza doktorature; përfaqësues nga Akademia e Shkencave në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni, politikbërës, institute kërkimore, *think tanks*, organizata të Diasporës, profesionistë të kthyer etj. Rreth 100 ekspertë lokalë dhe profesionistë të Diasporës kontribuan në mënyrë aktive në panelet tematike dhe seksionet e konferencave shkencore të këtij takimi. Kontributet e tyre u materializuan në dy publikime: Libri me Referimet dhe Diskutimet në Panelet Tematike dhe Book of Proceedings (Përmbledhjet e punimeve shkencore).

~ Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës me mbështetjen e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Ministrit të Shtetit për Diasporën do të organizojë Samitin e Grave të Biznesit në 18 janar 2020.

~ Agjencia Kombëtare e Diasporës, me mbështetjen e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministrit të Shtetit për Diasporën, do të organizojë Takimin e

Mjekësisë në Diasporë në 22 shkurt 2020.

~ Qendra e Botimeve për Diasporën, me mbështetjen e Ministrisë së Kulturës dhe Ministrit të Shtetit për Diasporën, do të organizojë Takimin Mbarëkombëtar të Shkrimtarëve nga Diaspora “LETRA NGA DIASPORA” në 22 shkurt 2020. Ky takim do të ndihmojë në njohjen dhe promovimin e shkrimtarëve të Diasporës me lexuesit dhe botuesit shqiptarë dhe synon prezantimin e letërsisë së Diasporës, duke e kthyer në një traditë vjetore të letërsisë së migracionit shqiptar.

~ Qendra e Botimeve për Diasporën, me mbështetjen e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Ministrit të Shtetit për Diasporën, do të organizojë Takimin e Mësuesve të Diasporës në 14 mars 2020. Në qendër të vëmendjes së tij do të jetë mësimdhënia e gjuhës dhe kulturës shqiptare brenda dhe jashtë vendit, krijimi i kontakteve, diskutimet mbi literaturën shtesë për procesin e mësimdhënies në Diasporë.

~ Agjencia Kombëtare e Diasporës, do të organizojë Takimin e Juristëve në Diasporë në 4 prill 2020. Agjencia Kombëtare e Diasporës ka dërguar shkresën nr. 419 Prot., datë 11.09.2019 drejtuar Ministrisë së Drejtësisë dhe shkresën nr. 426 Prot., datë 13.09.2019 drejtuar Dhomës Kombëtare të Avokatisë duke kërkuar mbështetjen e institucioneve për identifikimin e pjesëmarrësve.

Tetor - Dhjetor 2019:

~ Për krijimin e rrjeteve të profesionistëve në komunitetet shqiptare në Diasporë, Agjencia Kombëtare e Diasporës, Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës dhe Qendra e Botimeve për Diasporën do të organizojnë disa takime gjatë vitit 2020:

- Në proces përgatitja e Samitit të Grave të Biznesit (16-18 janar 2020) i cili do të organizohet nga Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe Dhomën e Biznesit të Diasporës. Në këtë aktivitet do të marrin pjesë gra sipërmarrëse të Diasporës, profesioniste të reja, studente, akademike dhe eksperte në fushën e biznesit, përfaqësuese të institucioneve shtetërore, si dhe të organizatave ndërkombëtare.

- Takimi i Mjekësisë në Diasporë (20 shkurt 2020) - Në kuadër të përgatitjeve për takimin, janë dërguar rreth 100 ftesa elektronike për pjesëmarrje tek anëtarët e Diasporës shqiptare dhe është në proces hartimi i programit për takimin.

- Takimi i Shkrimtarëve në Diasporë (22 shkurt 2020) në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës. Është hapur formulari i aplikimit online, janë përzgjedhur autorët pjesëmarrës, si dhe është përgatitur agjenda e takimit.

- Takimi i Mësuesve në Diasporë (14 mars 2020) në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Është hapur formulari i aplikimit online për regjistrimin e mësuesve pjesëmarrës dhe është përgatitur agjenda e takimit.

- Takimi i Juristëve në Diasporë (4 prill 2020) - Agjencia Kombëtare e Diasporës me mbështetjen e Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrit të Shtetit për Diasporën do të organizojë takimin e juristëve në diasporë. Në proces përgatitja e programit të takimit.

~ Në kuadër të aktiviteteve të projektit “Diaspora për Zhvillim”, përfaqësues nga Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës morën pjesë në takimin e rrjetit të profesionistëve

dhe grave shqiptare të Diasporës, organizuar nga Shoqata Internacionale “Woman Alb World”, në datat 1-3 nëntor 2019, në Gjenevë, Zvicër. Qëllimi i këtij aktiviteti ishte prezantimi i strategjisë së Shoqatës “Women Alb World”, krijimi i rrjetit të grave shqiptare në Diasporë.

~ Në kuadër të projektit “Diaspora për Zhvillim”, është në proces finalizimi zhvillimi i platformave “Rrjeti i Profesionistëve” dhe “Dhoma e Biznesit - Si të Bësh Biznes në Shqipëri”, platforma në të cilën është parashikuar regjistrimi dhe ndërveprimi i profesionistëve dhe bizneseve në Diasporë. Këto platforma do të shërbejnë për mbledhjen e të dhënave dhe krijimin e bazës së tyre si dhe hartëzimit. Platforma e profesionistëve, e cila parashikon ndarjen e të dhënave sipas kategorive, nënkategorive, si edhe pozicionit gjeografik do t’u japë mundësinë e regjistrimit në mënyrë autonome profesionistëve, duke krijuar kështu një bazë të dhënash dinamike e gjithmonë në rritje.

~ Në kuadër të mbrojtjes së të drejtave të njeriut, për vitin 2020, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka përfshirë në axhendën e aktiviteteve të saj kombëtare dhe ndërkombëtare, ndërgjegjësimin për mbrojtjen sociale dhe shëndetësore edhe në diasporë.

Janar - Mars 2020:

~ Në datat 16 - 18 janar 2020 Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë organizoi Samitin e Grave në Biznes. Në këtë Samit morën pjesë profesioniste të reja, studente, gra akademike dhe eksperte në fushën e biznesit, përfaqësues të institucioneve shtetërore si dhe të organizatave ndërkombëtare, veçanërisht ato që në programet në zbatim, zhvillojnë objektiva lidhur me gratë dhe zhvillimin e tyre në fushën e biznesit dhe sipërmarrjes.

~ Në datë 20 shkurt 2020, Agjencia Kombëtare e Diasporës në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Fondin Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës, organizoi Takimin e Mjekësisë në Diasporë. Ky takim u zhvillua në formën e dy paneleve kryesore: “Politikat dhe programet e punësimit në sektorin e shëndetësisë” dhe “Inovacionet në shëndetësinë shqiptare & raste suksesi”, ku profesionistët e suksesshëm të diasporës në fushën e mjekësisë patën mundësi të diskutojnë dhe të shkëmbejnë eksperiencat e tyre. Në këtë aktivitet u identifikuan edhe shoqatat e mjekëve shqiptarë dhe organizimet e tyre jashtë vendit.

~ Në datë 22 shkurt 2020, Qendra e Botimeve për Diasporën, në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës organizoi Takimin e Shkrimtarëve në Diasporë. Ky takim mbledhi autorë, përkthyes, studiues dhe emra të njohur të letrave shqipe, brenda dhe jashtë vendit në një diskutim mbi për letërsinë, gjuhën dhe vlerat atdhetare.

~ Në datën 14 mars 2020, Qendra e Botimeve për Diasporën, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe nën kujdesin e Ministrit të Shtetit për Diasporën, do të organizonte Takimin e Mësuesve në Diasporë. Takimi synon shkëmbimin e përvojave dhe dijeve në fushën e arsimit dhe mësimdhënies në Diasporë. Për shkak të situatës së krijuar nga pandemia e COVID-19, takimi shtyhet për një kohë të papërcaktuar.

~ Krijuar Portali “Dhoma e Biznesit të Diasporës - Si të fillosh një biznes në Shqipëri”, publikuar në domain-in www.adbc.al, i cili do të shërbejë si mekanizëm kryesor në krijimin dhe forcimin e rrjetit të bizneseve të Diasporës me ato vendase përmes:

krijimit të rrjeteve funksionale të bizneseve të Diasporës; dhënies së informacionit mbi legjislacionin, institucionet, njoftime, grante, dokumenta të ndryshme që ndihmojnë në krijimin apo transferimin e biznesit në Shqipëri; etj.

~ Në proces plotësimi i platformës “Rrjeti i Profesionistëve të Diasporës”, www.adpn.al, si një mjet i cili i shërben rritjes së kapaciteteve dhe rrjetëzimit të kapitalit shoqëror në Diasporë, si një vlerë e shtuar për zhvillimin ekonomik të vendit. Çdo shqiptar në Diasporë mund të krijojë profilin personal në platformë dhe ka mundësinë të kërkojë profesionistë të tjerë në botë, të ndarë në kategori sipas fushës së veprimtarisë dhe vendndodhjes. “Rrjeti i Profesionistëve të Diasporës” do të ofrojë gjithashtu dhe informacion rreth procedurave të njohjes së titujve akademikë në Shqipëri, profesioneve të lira, si edhe aktiviteteve që angazhojnë profesionistë të fushave të ndryshme.

Prill - Qershor 2020:

~ Agjencia Kombëtare e Diasporës, në datë 4 prill 2020, do të organizonte Takimin e Juristëve në Diasporë, si një aktivitet me qëllim vendosjen e kontakteve ndërmjet rrjeteve të profesionistëve në Diasporë dhe në Shqipëri. Ky takim u shty për shkak të pandemisë COVID-19.

~ Qendra e Botimeve për Diasporën, për shkak të situatës së krijuar në shkollat shqipe në Diasporë si pasojë e pandemisë globale, ka zhvilluar disa takime online me përfaqësues të shkollave shqipe, me qëllim marrjen e informacioneve dhe gjetjen e zgjidhjeve për problematikat e ngritura. QBD-ja ka organizuar gjithsej 7 takime online me përfaqësues të mësimdhënies së gjuhës shqipe nga shtete, si: Italia, Greqia, Gjermania, Zvicra, Anglia, SHBA-ja, Kanadaja, Spanja dhe Turqia. Në këto mbledhje u diskutua për problematikat e ndryshme lidhur me mësimin e gjuhës shqipe në kushtet e situatës së re të krijuar prej Covid-19, rëndësinë dhe mënyrën e përdorimit të Platformës digjitale për mësimin e gjuhës shqipe dhe pajisjen me tekste mësimore për vitin shkollor 2020-2021.

| Masa Nr.22 |

NË PROCES

Rivlerësimi periodik i politikës së shërbimeve, procedurave dhe tarifave të tyre. Në bazë të informacioneve të marra nga përfaqësitë hartimi nga ministria përgjegjëse për diasporën të një raporti vjetor për gjendjen konkrete të emigrantëve shqiptarë, me propozime masash respektive për përmirësimin e asistencës për ta.

INDIKATORËT: Rivlerësimi periodik i politikës së shërbimeve; Hartimi nga ministria përgjegjëse për diasporën të një raporti vjetor.

AFATI KOHOR: 6 mujori i parë 2019 (periodike)

INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:

- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
- Ministri i Shtetit për Diasporën
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë
- Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë

- **Ministria e Drejtësisë**

Janar - Mars 2019:

- Për këtë qëllim janë miratuar urdhrat e mëposhtëm:

- Urdhri nr. 43/2019 i Kryeministrit “Për caktimin e Koordinatorit Shtetëror në fushën e sigurimeve për shtetasit shqiptarë jashtë vendit”;
- Urdhri nr. 44/2019 i Kryeministrit “Për caktimin e Koordinatorit Shtetëror për organizimin e programit vjetor të aktiviteteve për diasporën shqiptare”;
- Urdhri nr. 45/2019 i Kryeministrit “Për caktimin e Koordinatorit Shtetëror për informimin e diasporës shqiptare”;
- Urdhri nr. 47/2019 i Kryeministrit “Për caktimin e Koordinatorit Shtetëror për programet/donatorët të cilët ofrojnë bursa studimi jashtë vendit”;

- Në proces miratimi i Urdhrit nga Kryeministri “Për caktimin e Koordinatorit Shtetëror për mbrojtjen e të drejtave të shqiptarëve që vuajnë heqjen e lirisë jashtë vendit ose ndodhen në strukturat e vendeve pritëse.

- Në proces miratimi i Urdhrit nga Kryeministri “Për caktimin e Koordinatorit Shtetëror për marrëveshjet shtetërore për njohjen e ndërsjellë të lejeve të drejtimit për shtetasit shqiptarë jashtë vendit”.

- Referuar urdhrave dhe projekt urdhrave të cituar më sipër, Koordinatorët Shtetërorë do të raportojnë periodikisht në mbledhjet e Komitetit Shtetëror të Diasporës.

- Ministri i Shtetit për Diasporën, me shkresën nr. 1152, datë 22.02.2019, i është drejtuar Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë “Për krijimin e një sektori të posaçëm për bursat”.

- Ministri i Shtetit për Diasporën, me shkresën nr. 983, datë 15.02.2019, i është drejtuar Ministrisë së Drejtësisë “Për krijimin e një sektori të posaçëm për mbrojtjen e të drejtave të personave që vuajnë dënimin me heqje lirie jashtë vendit”.

- Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës ka publikuar periodikun e parë “Diaspora Shqiptare”, një përmbledhje studimore për Diasporën shqiptare. Ky publikim përmban raporte, analiza, studime të realizuara për migracionin shqiptar, gjendjen dhe kapacitetet e tij, nga institucione si Banka e Shqipërisë, Instituti i Statistikave, Banka Botërore, si dhe punime shkencore nga akademikë dhe kërkues shkencorë.

Prill - Qershor 2019:

- Miratuar Urdhri nr.78/2019 i Kryeministrit “Për caktimin e Koordinatorit Shtetëror në fushën e njohjes së lejeve të drejtimit të automjeteve për shtetasit shqiptarë jashtë vendit”.

- Miratuar Urdhri nr.92/2019 i Kryeministrit “Për ngritjen e grupit të punës dhe caktimin e personit përgjegjës për mbrojtjen e të drejtave të shqiptarëve që vuajnë heqjen e lirisë jashtë vendit, të drejtave të migrantëve nëpërmjet informimit mbi mundësitë e ndryshme për të apeluar ndaj shkeljeve të të drejtave të tyre, në strukturat e vendeve

pritëse si dhe ato ndërkombëtare”.

~ Dërguar shkresa nr. 2239 Prot., datë 19.04.2019 Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Ministrisë së Drejtësisë për zbatimin e masës nr. 22.

~ Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, me shkresën nr. 6631 Prot., datë 06.05.2019 informon mbi shërbimet konsullore që ofron online për qytetarët shqiptarë jashtë vendit. Aty shpjegohet se tarifrat për shërbimet konsullore përcaktohen bazuar në Ligjin nr. 9975/2008 "Për taksat kombëtare" dhe Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ministrit të Punëve të Jashtme nr. 37/2014 "Për përcaktimin e tarifës për shërbimet konsullore të Ministrisë së Punëve të Jashtme apo ambasadave tona jashtë vendit".

~ Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme ka realizuar platformën "Ambasada ime". Kjo platformë ofron informacion të plotë mbi strukturën e mbulimit diplomatik dhe konsullor të Shqipërisë në botë, si dhe mundëson komunikimin aktiv të njëjësive diplomatike e konsullore me shtetasit shqiptarë. "Ambasada Ime" ofron mundësinë e parashtrimit të pyetjeve, adresimit të ankesave dhe shpalesjes së ideve në përfaqësitë diplomatike të Shqipërisë.

~ Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, me shkresën nr. 4483/1, datë 15.05.2019 informon se me informacionin e përcjellë nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme ka krijuar një databazë lidhur me shoqatat, kurset, shkollat dhe mësuesit e gjuhës shqipe në Diasporë. Gjatë periudhës 31 korrik - 3 gusht 2019 do të zhvillohet Seminari i XV i mësimit plotësues të gjuhës shqipe, ku ndër të tjera do të mblidhet informacion i detajuar mbi gjendjen aktuale të mësimit plotësues të gjuhës shqipe dhe nevojat për ndërhyrje dhe përmirësime.

~ Ministri i Shtetit për Diasporën, me shkresën nr. 3455 Prot., datë 28.06.2019, i ka kërkuar Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë hapjen e një sektori të posaçëm për Diasporën në këtë institucion.

Korrik - Shtator 2019:

~ Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë me shkresën nr.2278/1 Prot., datë 24.07.2019 informon se krijimi i një sektori të posaçëm për diasporën pranë këtij institucioni nuk është i mundur pasi procedurat për bursat studimore jashtë Shqipërisë për studentë shqiptarë, sipas marrëveshjeve dypalëshe, ndiqen nga Drejtoria e Integritimit, Koordinimit, Marrëveshjeve dhe Asistencës (DIKMA).

~ Në datat 31 korrik-3 gusht 2019 Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e Republikës së Kosovës dhe Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë e Republikës së Shqipërisë organizuan Seminarin e XV të mësimit plotësues të gjuhës shqipe. Në këtë aktivitet mori pjesë edhe drejtoresha ekzekutive e Qendrës së Botimeve për Diasporën znj. Mimoza Hysa, e cila prezantoi para mësuesve misionin dhe vizionin e Qendrës së Botimeve për Diasporën, hapat e ndërmarrë për hartimin e teksteve të reja të përbashkëta për mësimdhënien në Diasporë, si dhe projektet e tjera për ruajtjen dhe përhapjen e gjuhës dhe kulturës shqiptare jashtë vendit. Qendra e Botimeve për Diasporën shpërndau për mësuesit "Udhëzuesin për mësimdhënien në Diasporë" botuar nga QBD-ja, si dhe materiale të tjera informuese.

~ Në mbledhjen e Komitetit Shtetëror për Diasporën në datën 17 shtator, Koordinatori Shtetëror për marrëveshjet shtetërore në fushën e njohjes së lejeve të drejtimit të

automjeteve për shtetasit shqiptarë jashtë vendit, z. Artan Shkreli informoi se:

- Greqia dhe Turqia janë ende në proces të njohjes së lejedrejtimit.
- Marrëveshja me Greqinë për njohje dhe konvertim nuk ka hyrë ende në fuqi sepse pala greke nuk ka përfunduar procedurat e saj.
- Marrëveshja me Emiratet e Bashkuara Arabe për njohje dhe konvertim është në proces amendimi me qëllim ri-negocimi.
- Marrëveshja me Arabinë Saudite për njohje të ndërsjelltë është në proces negocimi.

- Patentat shqiptare të lëshuara nga data 24 janar 2017 e deri më sot do të njihen edhe në shtetin Italian. Njohja dhe konvertimi i patentave shqiptare në Itali është rezultat i një pune të organizuar me institucionet italiane, një bashkëpunim ky i arritur në kuadër të marrëveshjes së përbashkët mes qeverive të të dyja vendeve.

- Në mbledhjen e Komitetit Shtetëror për Diasporën në datën 17 shtator, Personi Përgjegjës për mbrojtjen e të drejtave të shqiptarëve që vuajnë heqjen e lirisë jashtë vendit, të drejtave të migrantëve nëpërmjet informimit mbi mundësitë e ndryshme për të apeluar ndaj shkeljeve të të drejtave të tyre, në strukturat e vendeve pritëse si dhe në ato ndërkombëtare, znj. Fjoralba Caka (zëvendësministre e drejtësisë) informoi se Ministria e Drejtësisë po vijon me hedhjen e rekordeve penale të shtetasve shqiptarë të dënuar jashtë Shqipërisë. Të dhënat sillen në mënyrë periodike dhe vullnetarisht në bazë të Nenit 22 të Konventës për Ndihmën e Ndërsjellë Juridike.

- Fondit të Zhvillimit të Diasporës është në përgatitje të botimit të “Periodiku” Nr. 2 për vitin 2019. Ky botim është një ftesë për ta ngritur diskutimin e studiuesve për migracionin shqiptar në nivel të një cilësie gjithëpërfshirëse dhe reflektuese. Ai do të përmbledhë po ashtu dokumentat më të rëndësishme të raporteve shtetërore dhe të shoqërisë civile për diasporën shqiptare. Ky botim parashikohet të realizohet në dhjetor 2019-ës.

- Agjencia Kombëtare e Diasporës është në proces të përgatitjes së një botimi të posaçëm me legjislacionin dhe aktet nënligjore “Politika Shtetërore për Diasporën 2019”. Ky botim do të realizohet në dhjetor 2019.

Tetor - Dhjetor 2019:

- Miratuar Akti Normativ Nr. 10, datë 18.12.2019 “Për disa shtesa në ligjin Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar. Sipas këtij Akti Normativ, do të përjashtohen nga pagimi i tatimit mbi të ardhurat edhe të ardhurat nga pensionet dhe shpërblimet e tjera të ngjashme të shtetasve të huaj me origjinë shqiptare apo të atyre nga vendet e Bashkimit Evropian, me leje qëndrimi në Republikën e Shqipërisë, si dhe të shtetasve të huaj që kanë marrë shtetësinë shqiptare e janë rezidentë në Republikën e Shqipërisë dhe që i përfitojnë këto të ardhura sipas legjislacionit të vendit ku përfitojnë pensionin apo shpërblimet e tjera të ngjashme.

Janar - Mars 2020:

- Miratuar Ligji Nr. 1/2020 “Për miratimin e Aktit Normativ, me fuqinë e ligjit Nr. 10, datë 18.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për disa shtesa në ligjin Nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat””, të ndryshuar. Me këtë ligj do të

përfshihen nga pagimi i tatimit mbi të ardhurat nga pensionet dhe shpërblimet e tjera të ngjashme të shtetasve të huaj me origjinë shqiptare apo të atyre nga vendet e Bashkimit Evropian, me leje qëndrimi në Republikën e Shqipërisë, si dhe të shtetasve të huaj që kanë marrë shtetësinë shqiptare e janë rezidentë në Republikën e Shqipërisë dhe që i përfitojnë këto të ardhura sipas legjislacionit të vendit ku përfitojnë pensionin apo shpërblimet e tjera të ngjashme.

Prill - Qershor 2020:

- Nuk ka informacion të ri për realizimin e kësaj mase.

NË PROCES

| Masa Nr.23 |

Negocimi për të nënshkruar marrëveshjet dypalëshe për mbrojtjen sociale të migrantëve me vendet pritëse, me qëllim që ata të transferojnë sigurimet shoqërore edhe në Shqipëri. Rishikimi i praktikave të mbledhjes së kontributit vullnetar për sigurimet shoqërore dhe nëse duhet nënshkrimi i marrëveshjeve ndërmjet Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe bankave. (Rivlerësimi i një plani veprimi të veçantë për çështjen e pensioneve të migrantëve shqiptarë).

INDIKATORËT: Negocimi për marrëveshjet dypalëshe me vendet pritëse. Rishikimi i praktikave të mbledhjes së kontributit vullnetar për sigurimet shoqërore.

AFATI KOHOR: 6 mujori i dytë 2018 (periodike)

INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:

- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
- Ministri i Shtetit për Diasporën
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
- Ministria e Drejtësisë

Buletini 2018:

- Dërguar shkresa nr.4011, datë 3.9.2018 Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për zbatimin e masës nr.23, të Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare për Diasporën 2018 - 2024”.

- Marrëveshje të parashikuara nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e kësaj mase: Implementimi i marrëveshjes për mbrojtjen shoqërore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Austrisë (në proces) Implementimi i marrëveshjes ndërmjet Republikës së Kosovës për vërtetimin e periudhave të sigurimit për realizimin e të drejtës për pension (në proces).

- Nënshkrimi i marrëveshjes për mbrojtjen shoqërore me Kanadanë (në proces);
- Nënshkrimi i marrëveshjes me Konfederatën Zvicerane (në proces);
- Hapja e negociatave për marrëveshje dypalëshe me Malin e Zi (në proces).

- Ministria e Drejtësisë ka përgatitur një material ku është identifikuar legjislacioni

kombëtar dhe ndërkombëtar bazë mbi lidhjen e marrëveshjeve, si dhe disa fusha ku mund të përqendrohen këto marrëveshje.

Janar - Mars 2019:

~ Miratuar Urdhri nr. 43/2019 "Për caktimin e Koordinatorit Shtetëror për marrëveshjet shtetërore në fushën e sigurimeve për shtetasit shqiptarë jashtë vendit". Në këtë detyrë është caktuar zëvendësministri për Evropën dhe Punët e Jashtme z. Etjen Xhafaj.

Prill - Qershor 2019:

~ Nënshkruar Marrëveshja ndërmjet Shqipërisë dhe Kanadasë "Për mbrojtjen shoqërore mes Shqipërisë dhe Kanadasë si edhe rregullores administrative". Qëllimi i kësaj marrëveshje është shmangia e mbulimit të dyfishtë për të njëjtën periudhë dhe bashkimi i periudhave të sigurimit të realizuara në dy vendet. Nga nënshkrimi i kësaj marrëveshjeje do të përfitojnë rreth 60 mijë shtetas shqiptarë që jetojnë dhe punojnë në Kanada.

~ Koordinatori Shtetëror për marrëveshjet shtetërore në fushën e sigurimeve për shtetasit shqiptarë jashtë vendit, caktuar me Urdhrin nr. 43/2019, ka raportuar në mbledhjen e Komitetit Shtetëror për Diasporën (3 maj) lidhur me marrëveshjet për njohjen reciproke të kontributeve të sigurimeve shoqërore. Marrëveshjet dypalëshe që priten të hyjnë në fuqi janë me Rumaninë, Republikën e Kosovës dhe Konfederatën Zvicerane. Koordinatori Shtetëror, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore janë duke nisur negociatat për dakordësimin për tekstet e marrëveshjeve me Malin e Zi, Italinë dhe Bullgarinë.

~ Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, me shkresën nr. 8334 Prot., datë 05.06.2019, i kërkon Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë caktimin e anëtarëve të grupit teknik të punës për të filluar bisedimet për inicimin dhe negocimin e marrëveshjeve shtetërore për mbrojtjen sociale të migrantëve në vendet pritëse.

~ Ministria e Financave dhe Ekonomisë, me shkresën nr. 10691/1 Prot., datë 21.06.2019 ka përcaktuar anëtarët e grupit teknik të punës për inicimin dhe negocimin e marrëveshjeve shtetërore për mbrojtjen sociale me Italinë dhe Malin e Zi.

~ Ministria e Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr.10 691/1 Prot., datë 21.06.2019 drejtuar Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme ka përcaktuar anëtarët e grupit teknik të punës për inicimin dhe negocimin e marrëveshjeve shtetërore për mbrojtjen sociale të migrantëve në vendet pritëse.

Korrik - Shtator 2019:

~ Ministria e Financave dhe Ekonomisë, nëpërmjet komunikimit me email, informon mbi inicimin dhe negocimin e marrëveshjeve për mbrojtjen shoqërore:

- Marrëveshje me Malin e Zi - Po studiohet nga strukturat përgjegjëse projekt marrëveshja dhe legjislacioni i Malit të Zi në fushën e mbrojtjes shoqërore dhe së shpejti do të konkludohet.
- Marrëveshje me Bullgarinë - Ndërmjet palëve është rënë dakord që të nisin negociatat në Sofie, Bullgari në datat 5-8 nëntor 2019 për hartimin e një

marrëveshje të re që do të zëvendësojë marrëveshjen e vjetër me Bullgarinë.

- Marrëveshje me Italinë - Pala Shqiptare ka përgatitur projekt marrëveshjen, e cila u është dërguar zyrtarisht autoriteteve Italiane, si dhe një studim i hollësishëm për pensionet, ku janë përfshirë qytetarët shqiptarë dhe italianë që punojnë në dy vendet si dhe koston financiare të procesit.

~ Në mbledhjen e Komitetit Shtetëror për Diasporën në datën 17 shtator 2019, koordinatori shtetëror për marrëveshjet shtetërore në fushën e sigurimeve për shtetasit shqiptarë jashtë vendit, z. Etjen Xhafaj informoi mbi marrëveshjet dypalëshe që priten të hyjnë në fuqi janë:

- Rumania, e ratifikuar nga Parlamenti Shqiptar me Ligjin nr.42/2016, datë 14.04.2016, dhe jemi në pritje të caktimit të datës për firmosjen e marrëveshjes administrative për zbatimin e marrëveshjes.
- Republika e Kosovës - për vërtetimin e periudhave të sigurimit për realizimin e të drejtës për pension ratifikuar nga Parlamenti me Ligjin nr. 20/2018, datë 12.04.2018.
- Kanada, miratuar në parim me Vendimin nr.336, datë 22.04.2015, të Këshillit të Ministrave është nënshkruar dhe ka hyrë në fuqi.
- Konfederata Zvicerane - kanë filluar procedurat teknike për nënshkrim. Pritet të ratifikohet në parlament në sesionin aktual.

Koordinatori shtetëror, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore janë duke nisur negociatat për dakordësimin për tekstet e marrëveshjeve me Malin e Zi, Bullgarinë dhe Italinë.

Tetor - Dhjetor 2019:

~ Miratuar Akti Normativ Nr. 10, datë 18.12.2019 “Për disa shtesa në ligjin Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar. Sipas këtij Akti Normativ, do të përjashtohen nga pagimi i tatimit mbi të ardhurat edhe të ardhurat nga pensionet dhe shpërblimet e tjera të ngjashme të shtetasve të huaj me origjinë shqiptare apo të atyre nga vendet e Bashkimit Evropian, me leje qëndrimi në Republikën e Shqipërisë, si dhe të shtetasve të huaj që kanë marrë shtetësinë shqiptare e janë rezidentë në Republikën e Shqipërisë dhe që i përfitojnë këto të ardhura sipas legjislacionit të vendit ku përfitojnë pensionin apo shpërblimet e tjera të ngjashme.

~ Ministria e Financave dhe Ekonomisë, nëpërmjet komunikimit me email, informon mbi statusin e inicimit dhe negociimit të marrëveshjeve dypalëshe për mbrojtjen shoqërore:

Janë ratifikuar dhe kanë hyrë në fuqi marrëveshjet dypalëshe për mbrojtjen shoqërore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe shteteve të mëposhtme:

- Republikën e Turqisë, në fuqi nga 01.02.2005;
- Republikën e Maqedonisë, në fuqi nga 01.06.2016;
- Dukatin e Madh të Luksemburgut, në fuqi nga 01.07.2016;
- Hungarinë, në fuqi nga 01.07.2016;
- Republikën Çeke, në fuqi nga 01.02.2017;
- Republikën Federale të Gjermanisë, në fuqi nga 01.12.2017;
- Republikën e Austrisë, në fuqi nga 01.12.2018.

Pritet të hyjnë në fuqi marrëveshjet dypalëshe me:

- Rumaninë, ratifikuar nga Parlamenti Shqiptar me Ligjin Nr.42/2016, datë 14.04.2016;
- Republikën e Kosovës, “Për vërtetimin e periudhave të sigurimit për realizimin e të drejtës për pension“, ratifikuar nga Parlamenti me Ligjin 20/2018, datë 12.04.2018.
- Kanadanë - ratifikuar nga Parlamenti me Ligjin Nr 58, datë 12.09.2019.

Janë në procedim teknik për nënshkrim, marrëveshjet dypalëshe me:

- Konfederatën Zvicerane, miratuar në parim me VKM nr. 553, datë 31.07.2019.

Në kuadër të zgjerimit të skemave të mbrojtjes shoqërore me vende të tjera, nëpërmjet Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme është bërë prezent interesi dhe angazhimi i qeverisë Shqiptare për të filluar bashkëpunimin me vendet të tjera anëtare të BE me të cilët nuk ka marrëveshje. Janë përgjigjur pozitivisht Mali i Zi dhe Bullgaria.

- Bullgaria, në datat 5-8 Nëntor 2019 është zhvilluar raundi i parë negociatave në Sofie, Bullgari ku është diskutuar drafti i marrëveshjes për mbrojtjen shoqërore që do të zëvendësojë marrëveshjen e vjetër me Bullgarinë (në fuqi me dekretin nr.1578, datë 20.11.1952);
- Mali i Zi, pala Malazeze ka shprehur interesin për hapjen e bisedimeve për dakordësimin e një marrëveshje dypalëshe të dërguar nga pala Malazeze;

Janar - Mars 2020:

~ Me propozim të Ministrit të Shtetit për Diasporën është miratuar Ligji Nr. 1/2020 “Për miratimin e Aktit Normativ, me fuqinë e ligjit Nr. 10, datë 18.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për disa shtesa në ligjin Nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat””, të ndryshuar. Me këtë ligj do të përjashtohen nga pagimi i tatimit mbi të ardhurat nga pensionet dhe shpërblimet e tjera të ngjashme të shtetasve të huaj me origjinë shqiptare apo të atyre nga vendet e Bashkimit Evropian, me leje qëndrimi në Republikën e Shqipërisë, si dhe të shtetasve të huaj që kanë marrë shtetësinë shqiptare e janë rezidentë në Republikën e Shqipërisë dhe që i përfitojnë këto të ardhura sipas legjislacionit të vendit ku përfitojnë pensionin apo shpërblimet e tjera të ngjashme.

Prill - Qershor 2020:

~ Ministria e Financave dhe Ekonomisë, përmes komunikimit elektronik, informon se janë në proces negocimi i marrëveshjes dypalëshe për mbrojtjen sociale me shtetin e Bullgarisë (rishikimi i marrëveshjes ekzistuese), si dhe hapja e bisedimeve me Malin e Zi, për negocimin e draft-marrëveshjes të propozuar nga pala malazeze. Nisur nga situata e emergjencës virusale, gjatë 3-mujorit të dytë 2020 nuk ka patur zhvillim të mëtejshëm.

Krijimi i regjistrit për shtetasit shqiptarë që vuajnë heqjen e lirisë në burgje jashtë vendit dhe organizimi i një takimi vjetor organizuar në bashkëpunim me zyrën e Avokatit të Popullit dhe organizatën e Kryqit të Kuq Shqiptar për këtë çështje. Vlerësimi i informacionit periodik dhe konkluzioneve për Komitetin Shtetëror të Diasporës.

INDIKATORËT: Krijimi i regjistrit për shtetasit shqiptarë që vuajnë heqjen e lirisë në burgje jashtë. Vlerësimi i informacionit periodik.

AFATI KOHOR: 6 mujori i dytë 2019 (periodike)

INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:

- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
- Ministri i Shtetit për Diasporën
- Ministria e Drejtësisë

Prill - qershor 2019:

~ Miratuar Urdhri nr. 92, datë 17.05.2019 i Kryeministrit "Për ngritjen e grupit të punës dhe caktimin e personit përgjegjës për mbrojtjen e të drejtave të shqiptarëve që vuajnë heqjen e lirisë jashtë vendit, të drejtave të migrantëve nëpërmjet informimit mbi mundësitë e ndryshme për të apeluar ndaj shkeljeve të të drejtave të tyre, në strukturat e vendeve pritëse si dhe në ato ndërkombëtare".

Korrik - Shtator 2019:

~ Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, me shkresën nr. 9845 Prot., datë 04.07.2019, drejtuar Qendrës së Botimeve për Diasporën ka kërkuar pajisjen me libra artistikë në gjuhën shqipe të institucioneve penitenciare në Zvicër dhe Greqi me qëllim vënien në dispozicion të këtyre librave shtetasve shqiptarë që vuajnë dënimin me heqje lirie në këto vende.

~ Dërguar shkresa nr. 397 Prot., datë 26.08.2019 drejtuar Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Ministrit të Shtetit për Diasporën për caktimin e përfaqësuesve të grupit ndërshtetëror të punës sipas Urdhrit nr. 92/2019 të Kryeministrit "Për ngritjen e grupit të punës dhe caktimin e personit përgjegjës për mbrojtjen e të drejtave të shqiptarëve që vuajnë heqjen e lirisë jashtë vendit, të drejtave të migrantëve nëpërmjet informimit mbi mundësitë e ndryshme për të apeluar ndaj shkeljeve të të drejtave të tyre, në strukturat e vendeve pritëse si dhe në ato ndërkombëtare".

Tetor - Dhjetor 2019:

~ Avokati i Popullit, me shkresën Nr. 442 Prot., datë 14.10.2019 drejtuar Ministrit të Shtetit për Diasporën, Ministrit të Brendshëm, Ministrit në detyrë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Ministres së Drejtësisë për organizimin e një takimi për të koordinuar mbi kontributin konkret të secilit prej këtyre institucioneve në drejtim të mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe të shtetasve shqiptarë të privuar nga liria jashtë vendit.

~ Në datë 21 tetor 2019 u zhvillua takimi i grupit ndërshtetëror të punës për

mbrojtjen e të drejtave të shqiptarëve që vuajnë heqjen e lirisë jashtë vendit, të drejtave të migrantëve nëpërmjet informimit mbi mundësitë e ndryshme për të apeluar ndaj shkeljeve të të drejtave të tyre, në strukturat e vendeve pritëse si dhe në ato ndërkombëtare, i cili drejtohet nga znj. Fjoralba Caka, zëvendësministre në Ministrinë e Drejtësisë. Në këtë takim grupi i punës u dakordësua për hartimin e broshurave informuese mbi të drejtat e migrantëve dhe për shtetasit shqiptarë që vuajnë dënimin me heqje lirie jashtë vendit.

~ Ministria e Drejtësisë është në komunikim me Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme mbi angazhimin e ambasadorëve në mbledhjen e të dhënave të personave të burgosur jashtë Shqipërisë.

Janar - Mars 2020:

~ Në zbatim të Urdhrit Nr. 92/2019 të Kryeministrit “Për ngritjen e grupit të punës dhe caktimin e personit përgjegjës për mbrojtjen e të drejtave të shqiptarëve që vuajnë heqjen e lirisë jashtë vendit, të drejtave të migrantëve nëpërmjet informimit mbi mundësitë e ndryshme për të apeluar ndaj shkeljeve të të drejtave të tyre, në strukturat e vendeve pritëse si dhe në ato ndërkombëtare”, Koordinatorja Shtetërore, znj. Fjoralba Caka, informon se:

- Ministria e Drejtësisë, në bashkëpunim me Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, ka krijuar databazën me të dhënat e shtetasve shqiptarë që vuajnë dënimin me heqje lirie jashtë vendit.
- Me qëllim ndjekjen e rasteve për të cilat kërkohet bashkëpunim me institucione të tjera, Ministria e Drejtësisë po rakordon me Kryqin e Kuq Shqiptar dhe Komitetin Shqiptar të Helsinkit në Greqi dhe vende të tjera fqinje.
- Ministria e Drejtësisë po përgatit një dokument-katalog përmbledhës me parimet e zbatueshme dhe të drejtat e personave të dënuar jashtë Shqipërisë, bazuar në standardet ndërkombëtare, i cili do të jetë i aksesueshëm në website-et e Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme. Drafti po rishikohet dhe do të marrë formën finale brenda muajit qershor.

~ Avokati i Popullit në bashkëpunim me Organizatën Ndërkombëtare të Migracionit (IOM) ka publikuar një Manual me konventat dhe ligjet e ratifikuara për të drejtat e të burgosurve jashtë vendit. Ky manual gjendet i publikuar në faqen zyrtare të internetit të Ministrisë së Drejtësisë, në rubrikën “Diaspora”.

Prill - Qershor 2020:

~ Ministria e Drejtësisë, përmes komunikimit me email, informon se është në proces të përgatitjes së një dokumenti-katalog përmbledhës “Karta e të Drejtave”, me parimet e zbatueshme dhe të drejtat e personave të dënuar jashtë Shqipërisë, bazuar në standardet ndërkombëtare, i cili do të jetë i aksesueshëm në faqet zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme.

NË PROCES

|| Masa Nr.25 ||

Rishikimi i kuadrit të marrëveshjeve ekzistuese për migracionin me vendet pritëse të

komuniteteve shqiptare në diasporë. Negocimi i kuadrit të marrëveshjeve të punësimit me shtetet pritëse me qëllim përfshirjen në këto marrëveshje të formimit profesional, ose për to të diskutohet në veçanti. Rivlerësimi në bashkëpunim me vendet e BE e projekte të veçanta për të lehtësuar zbatimin e marrëveshjeve të punësimit duke përfutur edhe nga legjislacioni provizor dhe i veçantë i vendeve pritëse, që kanë mungesë të fuqisë punëtore.

INDIKATORËT: Rishikimi i kuadrit të marrëveshjeve ekzistuese për migracionin; Negocimi i kuadrit të marrëveshjeve të punësimit; Bashkëpunim me vendet e BE-së për projekte të veçanta.

AFATI KOHOR: 6 muhori i parë 2019 (periodike)

INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:

- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
- Ministri i Shtetit për Diasporën
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Janar - Mars 2019:

~ Miratuar Urdhri nr. 43/2019 i Kryeministrit "Për caktimin e Koordinatorit Shtetëror për marrëveshjet shtetërore në fushën e sigurimeve për shtetasit shqiptarë jashtë vendit". Në këtë detyrë është caktuar zëvendësministri për Evropën dhe Punët e Jashtme z. Etjen Xhafaj.

-Dërguar nga Ministria e Brendshme lista e marrëveshjeve të miratuara dhe ato në proces në fushën e migracionit. Këto marrëveshje do të rishikohen me qëllim përfshirjen e formimit profesional në to.

~ Dërguar shkresa nr. 1544 datë 15.03.2019 Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për rivlerësimin e marrëveshjeve ekzistuese dhe projekteve për migracionin shqiptar, me fokus të veçantë punësimin dhe formimin profesional për komunitetet shqiptare në vendet pritëse.

Prill - Qershor 2019:

~ Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka përcaktuar si strukturë përgjegjëse për zbatimin e masës nr. 25, Drejtorinë e Politikave të Punësimit dhe Aftësimin Profesional.

~ Ministria e Financave dhe Ekonomisë, me shkresën nr. 4541/1 Prot., datë 03.04.2019, informon se Shërbimi Kombëtar i Punësimit do të zhvillojë një takim me homologët në Gjermani, në muajin prill, me qëllim negocimin e një marrëveshje dypalëshe punësimi për migrim sezonal. Aty vlerësohet zbatimi i projektit me GIZ "Këshillimi për migracionin në Shqipëri" dhe nxitja e bashkëpunimit me vendet e BE-së për projekte të veçanta për të lehtësuar zbatimin e marrëveshjeve të punësimit.

~ Shkëmbim informacioni me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë mbi pjesëmarrjen e Shërbimit Kombëtar të Punësimit në Konferencën e zhvilluar në Agjencinë Federale të Punësimit Gjermane në 9 dhe 10 prill 2019. Gjatë kësaj konference u diskutua mundësia e hartimit të një marrëveshje dypalëshe në fushën e punësimit sezonal në sektorin e bujqësisë. Pala gjermane paraqiti një draft marrëveshje për të cilën Shërbimi Kombëtar

i Punësimit ka paraqitur sugjerimet dhe komentet përkatëse.

Korrik - Shtator 2019:

- Në mbledhjen e Komitetit Shtetëror për Diasporën në datën 17 shtator 2019, koordinatori shtetëror për marrëveshjet shtetërore në fushën e sigurimeve për shtetasit shqiptarë jashtë vendit, z. Etjen Xhafaj informoi mbi marrëveshjet dypalëshe në fushën e sigurimeve shoqërore si dhe rreth ecurisë së negociimit të marrëveshjeve të reja.

Tetor - Dhjetor 2019:

~ Lidhur me zbatimin e masës Nr. 25 nuk ka informacion të ri.

Janar - Mars 2020:

- Në proces miratimi i Profilit të Zgjeruar të Migracionit për periudhën 2015 - 2018, si një dokument i Ministrisë së Brendshme që pasqyron të dhëna analitike mbi lëvizjet migratore në Shqipëri, ndikimin e migrimit në shoqërinë shqiptare, si dhe kuadrin politik, ligjor dhe institucional për menaxhimin e migracionit.

- Ratifikuar marrëveshja për njohjen e ndërsjelltë të patentave midis Shqipërisë dhe Greqisë. Sipas kësaj marrëveshjeje, të gjithë shtetasit shqiptarë që udhëtojnë drejt vendit fqinj mund të drejtojnë automjetin e tyre pa pasur nevojë të pajisen me leje drejtimi ndërkombëtare. Gjithashtu parashikohet që shtetasit shqiptarë me qëndrim në Greqi mund t'i konvertojnë patentat e tyre shqiptare pa pasur nevojë për kryerjen e testeve teorike dhe praktike.

Prill - Qershor 2020:

~ Ministria e Financave dhe Ekonomisë, përmes komunikimit elektronik, informon se ka vijuar zbatimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe GIZ, për projektin "Këshillimi për migrim". Projekti synon të lehtësojë zbatimin e marrëveshjeve të punësimit. Marrëveshja e iniciuar nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit për punësimin stinor në Gjermani, nisur nga situata e emergjencës virusale, gjatë 3-mujorit të dytë 2020 nuk ka patur zhvillim të mëtejshëm.

NË PROCES

| Masa Nr.26 |

Vlerësimi dhe nxitja e migrimit qarkullues ndërmjet Shqipërisë dhe vendeve pritëse të komuniteteve shqiptare në diasporë me anë të masave favorizuese apo negociimi i marrëveshjeve bilaterale (duke i dhënë përparësi Greqisë dhe Italisë). Realizimi një zyre kontakti dhe koordinimi për vlerësimin dhe monitorimin e gjendjes së tregjeve të huaja të punës dhe me pas ky informacion t'i kalohet institucioneve përgjegjëse.

INDIKATORËT: Masat favorizuese apo negociimi i marrëveshjeve bilaterale; Realizimi një zyre kontakti dhe koordinimi për tregjet e huaja të punës.

AFATI KOHOR: 6 maji i dytë 2019 (periodike)

INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:

- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
- Ministri i Shtetit për Diasporën
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Prill - Qershor 2019:

~ Dërguar shkresa nr. 3046 Prot., datë 6.06.2019 institucioneve përkatëse për zbatimin e masës.

~ Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, me shkresën nr. 8394/1 Prot., datë 25.06.2019 drejtuar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë kërkon bashkëpunim në zbatimin e masës 26.

Korrik - Shtator 2019:

~ Ministria e Financave dhe Ekonomisë, me shkresën Nr.10 836/1 prot., Datë 30.07.2019 sugjeron ngritjen e një grupi ndërinstytucional pune me Ministrinë e Brendshme, Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, INSTAT dhe asistencën e IOM për shkak se zbatimi i kësaj mase lidhet me fushat e veprimtarisë së këtyre institucioneve.

~ Në mbledhjen e Komitetit Shtetëror për Diasporën në datën 17 shtator 2019, koordinatori shtetëror për marrëveshjet shtetërore në fushën e sigurimeve për shtetasit shqiptarë jashtë vendit, z. Etjen Xhafaj informoi mbi marrëveshjet dypalëshe në fushën e sigurimeve shoqërore.

~ Koordinatori shtetëror, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore janë duke nisur negociatat për dakordësimin për tekstet e marrëveshjeve me Malin e Zi, Bullgarinë dhe Italinë.

Tetor - Dhjetor 2019:

~ Bazuar në Urdhrin Nr. 117, datë 11.09.2019 të Kryeministrit “Për ngritjen e grupit ndërinstytucional të punës për hartimin e Profilit të Zgjeruar të Migracionit për periudhën 2015 -2018”, Grupi i Punës me pjesëmarrje dhe nga përfaqësues të Ministrisë së Shtetit për Diasporën është në proces të përgatitjes së dokumentit të Profilit të Zgjeruar të Migracionit për periudhën 2015 - 2018. Ky dokument pasqyron të dhëna analitike mbi lëvizjet migratore në Shqipëri, ndikimin e migrimit në shoqërinë shqiptare, si dhe kuadrin politik, ligjor dhe institucional për menaxhimin e migracionit.

Janar - Mars 2020:

~ Për këtë masë nuk ka informacione të reja për këtë periudhë.

Prill - Qershor 2020:

~ Nuk ka informacion të ri për këtë masë.

Organizimi i një programi të veçantë vjetor për promovimin e prodhimeve bujqësore dhe ushqimore shqiptare duke organizuar aktivitete periodike në funksion të rrjeteve të organizuara të prodhuesve shqiptarë dhe rrjetit të bizneseve shqiptare në diasporë që tregtojnë prodhime të natyrave të tilla.

INDIKATORËT: Program vjetor për promovimin e prodhimeve bujqësore dhe ushqimore shqiptare.

AFATI KOHOR: 6 mujori i parë 2019 (periodike)

INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:

- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
- Ministri i Shtetit për Diasporën
- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit

Janar - Mars 2019:

~ Dërguar shkresa me nr. 542 Prot., datë 25.01.2019, Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit “Për zbatimin e masës nr. 27 të Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare për Diasporën 2018- 2024”.

~ Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme me shkresën nr. 3896 Prot., datë 19.03.2019, ka dërguar listën me mbi 600 restorante në Diasporë me pronarë shqiptarë apo që menaxhohen nga shqiptarë, evidentuar nga përfaqësitë diplomatike për të qenë në dispozicion të eksportuesve dhe shoqatave të agrobiznesit në Shqipëri.

~ Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, me shkresën nr. 943/3 Prot., datë 19.03.2019, shpreh interesin për të bashkëpunuar për krijimin e një databaze për shqiptarët e Diasporës në fushën e biznesit.

~ Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka në proces miratimin e kalendarit të aktiviteteve për promovimin e prodhimeve bujqësore dhe ushqimore shqiptare.

Prill - Qershor 2019:

~ Shkëmbim informacioni me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për listën e bizneseve shqiptare që operojnë në Diasporë, e cila i shërben për hartimin e një programi të veçantë për promovimin e prodhimeve bujqësore dhe ushqimore shqiptare.

Korrik - Shtator 2019:

~ Në mbledhjen e Komitetit Shtetëror për Diasporën në datën 17 shtator, Koordinatori Shtetëror për organizimin e programit vjetor të aktiviteteve për Diasporën shqiptare, znj. Ornela Çuçi informoi se gjatë periudhës janar - shtator 2019 janë realizuar në total 66 aktivitete të parashikuara në kalendarin e vitit 2019.

Tetor - Dhjetor 2019:

~ Kabineti i Ministrit të Shtetit për Diasporën zhvilloi një takim me z. Astrit Panxha, drejtor i Klubit të Prodhuesve të Kosovës. Fokusi kryesor gjatë diskutimit ishte mundësia e organizimit të një festivali kulinar-gastronomik dhe kulturor në Berlin, Gjermani. Festivali synon promovimin e kulturës dhe kulinarisë shqiptare në vendet pritëse.

~ Në datat 21-23 nëntor 2019, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural mori pjesë në konferencën dhe panairin "Shqipëria destinacioni tjetër për Turizëm, Bujqësi, Tregti dhe Investim" për promovimin e produkteve "Made in Albania" në Varshavë, Poloni. Ky panair shërbeu si një platformë e rëndësishme e promovimit të bashkëpunimit të ndërsjelltë midis Shqipërisë dhe Polonisë.

~ Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural është në proces përditësimi të një databaze me restorante në Diasporë me pronarë shqiptarë apo që menaxhohen nga shqiptarë, e cila do iu shërbejë eksportuesve dhe shoqatave të agrobiznesit në Shqipëri.

Janar - Mars 2020:

~ Për këtë masë nuk ka informacione të reja për këtë periudhë.

Prill - Qershor 2020:

~ Për shkak të situatës së shpalljes së emergjencës kombëtare nga gjendja virusale "Covid-19", programi shtetëror i aktiviteteve për Diasporën për 2020 po rishikohet nga institucionet përgjegjëse.

NË PROCES

| Masa Nr.28 |

Përgatitja e Certifikatës së Diasporës, e cila mund të aplikohet online dhe krahas regjistrimit të të interesuarit e pajis atë me një dokument të printueshëm ("Jam Shqiptar") i cili mund të vendoset në ambiente të hapura për të pohuar identitetin kombëtar shqiptar.

INDIKATORËT: Përgatitja e Certifikatës së Diasporës.

AFATI KOHOR: 6 mujori i parë 2020

INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:

- Ministri i Shtetit për Diasporën
- Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme

Janar - Mars 2020:

~ Agjencia Kombëtare e Diasporës në bashkëpunim me Koordinatorin shtetërorë znj. Lorena Haxhiu, zëvendësministre e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, caktuar me Urdhrin Nr. 112, datë 30.08.2019 të Kryeministrit "Për caktimin e koordinatorit shtetëror për realizimin e programit "Jam shqiptar" të gjuhës dhe kulturës shqipe" ka përgatitur draft programin në bazë të memorandumit të nënshkruar për këtë qëllim ndërmjet

institucioneve përgjegjëse.

~ Përgatitur modeli i Certifikatës së Diasporës, e cila mund të vendoset në ambiente të hapura për të pohuar identitetin kombëtar shqiptar. Në proces koordinimi me Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe përgatitja e aplikimit online.

Prill - Qershor 2020:

~ Organizimi i Shkollës Verore 2020 do të shtyhet për shkak të emergjencës virusale COVID-19.

NË PROCES

| Masa Nr.29 |

Ndihmë për institucionet e mikrokreditimit për zbatimin e politikave që synojnë kanalizimin e dërgesave të emigrantëve nëpërmjet marrëveshjeve me institucionet financiare në vendet pritëse. Inkurajimi i shoqatave të migrantëve për nxitjen e zhvillimit lokal nëpërmjet mbledhjes vullnetare të donacioneve nga anëtarët për të financuar projekte të ndryshme në qytetin apo fshatin e tyre.

INDIKATORËT: Ndihmë për institucionet e mikrokreditimit; Mbledhja vullnetare e donacioneve nga anëtarët e shoqatave të migrantëve.

AFATI KOHOR: 6 mujori i parë 2019 (periodike çdo vit)

INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:

- **Ministria e Financave dhe Ekonomisë**
- **Ministri i Shtetit për Diasporën**
- **Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes**

Janar - Mars 2019:

~ Ndërmarrë iniciativa nga Ministri i Shtetit për Diasporën për ndryshimin e Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”. Ky ndryshim është miratuar me Vendimin nr. 691/2018, të Këshillit të Ministrave dhe është në proces miratimi në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë. Kjo iniciativë është ndërmarrë për krijimin e strukturës së posaçme për Diasporën dhe migracionin, për administrimin e shërbimeve në nivel vendor, si pjesë administrative e njësisë vendore, në çdo bashki të vendit.

~ Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës ka në proces çeljen e llogarisë bankare “Diaspora për Diasporën” për krijimin/depozitimin e fondeve nga donacione të anëtarëve të diasporës, për shpenzime me karakter social-kulturor, shkencor dhe shëndetësor që do t'i shërbejnë komuniteteve shqiptare në vendet pritëse.

~ Dërguar shkresa nr. 1543 Prot., datë 15.03.2019 Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Bankës së Shqipërisë dhe Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes për identifikimin e strukturës administrative përgjegjëse për zbatimin e masës nr. 29.

Prill - Qershor 2019:

~ Në programin e Kuvendit është përfshirë projekt-ligji për disa ndryshime në Ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”. Propozimet për ndryshimin e këtij ligji janë miratuar me Vendimin nr. 691/2018, të Këshillit të Ministrave. Këto ndryshime konsistojnë në krijimin e një strukture të posaçme për Diasporën dhe migracionin për administrimin e shërbimeve në nivel vendor, në çdo bashki.

~ Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka përcaktuar si strukturë përgjegjëse për zbatimin e masës nr. 29 Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit Ekonomik dhe Punësimit.

~ Shkëmbim informacioni për personat përgjegjës për ndjekjen e zbatimit të masës nr. 29, të përcaktuar nga zëvendësministri i Financave dhe Ekonomisë dhe me shkresën nr. 4542/1 Prot., datë 24.04.2019.

~ Ministria e Financave dhe Ekonomisë informon se është në proces të hartimit të një projektligji “Për Shërbimet e Pagesave në Republikën e Shqipërisë”, i cili vlerësohet të kontribuojë në zgjerimin e gamës së aktiviteteve të MTO-ve (*Money Transfer Operators*) që janë dhe kanali kryesor formal i përdorur nga emigrantët duke i lejuar hapjen e llogarive të pagesave dhe emëtimin e instrumenteve elektronikë. Ky projektligj do të zgjerojë prezencën e shërbimeve të ofruara nga bankat në të gjithë territorin e vendit nëpërmjet prezantimit dhe rregullimit të modelit të “Bankave të cilat ofrojnë shërbime pagesash nëpërmjet agjentëve”.

Korrik - Shtator 2019:

~ Miratuar Ligji nr.38/2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”. Në bazë të këtij ligji në çdo bashki do të krijohet një strukturë e posaçme për diasporën dhe migracionin, për administrimin e shërbimeve në nivel vendor.

~ Në proces aktet nënligjore për Ligjin nr.38/2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

Tetor - Dhjetor 2019:

~ Në datën 14 dhjetor 2019, kryetarja e Këshillit Drejtues të Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës si dhe përfaqësues të Drejtorisë së Projekteve dhe Mbështetjes së Sipërmarrjes të FSHZHD-së zhvilluan një takim pune me përfaqësues të Fondacionit Italian Magnia Grecia. Të dy institucionet kanë nënshkruar në prill 2019, një marrëveshje bashkëpunimi në fushën e kërkimit, studimeve dhe projekteve.

Gjatë takimit u zhvillua prezantimi i platformës MyOurJob, si një sistem inovativ për orientimin e studentëve të rinj në zgjedhjen e profesioneve. Kjo platformë është implementuar dhe ka rezultuar një model i suksesshëm në disa prej vendeve të Evropës. Në rastin specifik të Diasporës Shqiptare Myourjob mund të përbëjë lidhjen e domosdoshme midis nevojave të kompanive shqiptare, por edhe atyre që do të investojnë në Shqipëri, për sa i përket aftësive profesionale, dhe specializimeve të marra me kalimin e kohës nga studentët e rinj të Diasporës, duke sjellë kështu në vendin e tyre të origjinës “know how” dhe “kapitalin njerëzor” të kualifikuar dhe të duhur. Gjithashtu, gjatë takimit u prezantuan edhe disa projektpropozime të tjera me

fokus financat dhe mikrokredinë.

Janar - Mars 2020:

- Asambleja e Përgjithshme e Dhomës së Biznesit të Diasporës vendosi se deri në nëntor 2020, kuotat e anëtarësimit pranë Dhomës do të jenë në vlerën 0 (zero), si rezultat i mbështetjes dhe asistencës financiare nga Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës, nëpërmjet projektit “Për Dhomën e Biznesit të Diasporës - Nxitja dhe krijimi i investimeve të huaja në Shqipëri” me qëllim krijimin e një besimi institucional tek të gjithë bizneset potenciale në Shqipëri dhe Diasporë.

Prill - Qershor 2020:

- Miratuar Ligji Nr. 55/2020 “Për shërbimet e pagesave”. Ky ligj krijon themelet e ndërlidhjeve midis tregut shqiptar dhe atij evropian të pagesave, si dhe zgjeron prezencën e shërbimeve të ofruara nga bankat në të gjithë territorin e vendit nëpërmjet prezantimit dhe rregullimit të modelit të “Bankave të cilat ofrojnë shërbime pagesash nëpërmjet agjentëve”.

NË PROCES

Masa Nr.30

Organizimi dhe administrimi i një rrjeti për studiuesit e huaj e shqiptarë të specializuar në fushën e migracionit dhe të nëpunësve në administratë të specializuar në institucionet të cilat merren me politikat e Diasporës dhe Migracionit. (Plotësimi i rrjetit edhe me emrat dhe detajet e studiuesve dhe nëpunësve shtetërorë nga agjencitë administrative që do të merren me politikat për diasporën).

INDIKATORËT: Organizimi dhe administrimi i një rrjeti për studiuesit e huaj e shqiptarë të specializuar në fushën e migracionit.

AFATI KOHOR: 6 mujori i parë 2019 (periodike)

INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:

- Ministri i Shtetit për Diasporën
- Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme

Janar - Mars 2019:

- Dërguar shkresa me nr. 539 Prot., datë 25.01.2019, Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, “Për zbatimin e masës nr. 30 të Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare për Diasporën 2018-2024.”

- Fondi Shqiptar i Zhvillimit për Diasporën është në proces organizimi për zhvillimin e aktivitetit vjetor të Institutit të Alb-Shkencës, me temë “Sfidat për zhvillim të qëndrueshëm të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor në hapësirën mbarëshqiptare” më 27-29 shtator 2019, në Tiranë.

~ Në kuadër të përmbushjes së masës 15 për vitin 2019, INSTAT ka filluar punën përgatitore për realizimin e Raportit Vjetor për vitin 2019. Në kuadër të zbatimit të kësaj mase, INSTAT do të përfshijë në raportin vjetor për vitin 2019 edhe masa të tjera të Planit të Veprimit si: 30, 32, 33, 40, 41, 59, 60 dhe 64, me qëllim evidentimin dhe llogaritjen e disa indikatorëve. Për këtë çështje INSTAT ka filluar komunikimin zyrtar me institucionet përgjegjëse.

~ Akademia e Shkencave ka dërguar informacion mbi botime të studiuësve shqiptarë në diasporë, të cilët janë anëtarë të Akademisë së Shkencave.

~ Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme ka përcjellë një listë me studiuës shqiptarë për çështjet e migracionit, të cilët veprojnë në diasporë. Agjencia Kombëtare për Diasporën, është duke realizuar regjistrin e studiuësve shqiptarë për çështjet e migracionit.

Prill - Qershor 2019:

~ Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës është në proces të organizimit të aktivitetit vjetor në bashkëpunim me Institutin e Alb-Shkencës, me temë “Kërkimi shkencor në hapësirën mbarëshqiptare dhe roli i Diasporës shkencore”. Aktiviteti do të zhvillohet më 27-28 shtator 2019 në Tiranë.

~ Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, me shkresën nr. 5076 Prot. datë 05.04.2019, ka dërguar informacion dhe një listë me studiuës shqiptarë dhe të huaj për çështjet e migracionit, të cilët veprojnë në Diasporë.

~ Agjencia Kombëtare e Diasporës ka krijuar një regjistër elektronik (format *excel*) të studiuësve shqiptarë e të huaj në çështjet e migracionit dhe është në përditësim të vazhdueshëm të tij.

~ Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, me shkresën nr. 5187 Prot., datë 09.04.2019 ka përcjellë një listë me ekspertë nga administrata polake.

~ Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, me shkresën nr. 6883 Prot., datë 10.05.2019 në zbatim të masave nr. 15 dhe nr. 30 të Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare të Diasporës i ka përcjellë INSTAT-it informacion në lidhje me organizimin dhe administrimin e një rrjeti për studiuësit e huaj e shqiptarë të specializuar në fushën e migracionit dhe të nëpunësve në administratë të specializuar në institucionet që merren me politikën e Diasporës dhe migracionit duke e plotësuar me emra dhe detaje.

Korrik - Shtator 2019:

~ Në datat 27 - 28 shtator 2019 u zhvillua Takimi i XIV-të Ndërkombëtar “Kërkimi Shkencor në Hapësirën Mbarëshqiptare dhe Roli i Diasporës Shkencore”, organizuar nga Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës në bashkëpunim me Institutin Albshkenca dhe mbështetjen e GIZ në Shqipëri. Në këtë aktivitet, i cili kishte si synim angazhimin e diasporës shkencore shqiptare dhe profesionistëve të kualifikuar përmes shkëmbimit efektiv të njohurive, morën pjesë rreth 400 të ftuar ndër të cilët studiuës të shquar të Diasporës shkencore shqiptare, anëtarë aktivë të Institutit Alb-Shkenca, studiuës të rinj të angazhuar në studime pasuniversitare dhe teza doktorature; përfaqësues nga Akademia e Shkencave në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni, politikbërës, institute

kërkimore, think tanks, organizata të Diasporës, profesionistë të kthyer etj. Rreth 100 ekspertë lokalë dhe profesionistë të Diasporës kontribuan në mënyrë aktive në panelet tematike dhe seksionet e konferencave shkencore të këtij takimi. Kontributet e tyre u materializuan në dy publikime: Libri me Referimet dhe Diskutimet në Panelet Tematike dhe Book of Proceedings (Përmbledhjet e punimeve shkencore).

~ Nënshkruar Marrëveshja e Bashkëpunimit ndërmjet Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës dhe Institutit "Alb-shkenca" "Për bashkëpunimin në fushën e kërkim-zhvillimit dhe të bashkëveprimit me diasporën shkencore shqiptare". Kjo marrëveshje përfshin bashkëpunimin në fushën e kërkimit shkencor, organizimin e konferencave shkencore, botimeve dhe studimeve në funksion të interesit dhe përfitimit të përbashkët. Aktivitetet bashkëpunuese në kuadër të kryerjes së kërkimit shkencor përfshijnë bashkëpunimin për zhvillimin dhe promovimin e aktiviteteve me interes të përbashkët nëpërmjet rrjeteve ndërkombëtare, botimin dhe publikimin e studimeve mbi historinë e Diasporës shqiptare dhe trashëgiminë kulturore, si dhe promovimin e publikimin e studimeve apo botimeve në formatin e-book.

Tetor - Dhjetor 2019:

~ Në datën 9 dhjetor 2019 u zhvillua konferenca "Itali dhe Shqipëri, një portë e hapur në Ballkan". Ky aktivitet u organizua nga Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës, Dhoma e Biznesit të Diasporës Shqiptare në bashkëpunim me Universitetin e-Campus, Ambasadën Italiane në Shqipëri dhe me mbështetjen e veçantë të Ministrit të Shtetit për Diasporën. Në konferencë u trajtua çështja e arsimit, si një "urë" e qëndrueshme bashkëpunimi mes Italisë dhe Shqipërisë, e cila synon që studentët të marrin njohuritë e duhura për të përballuar kërkesat e larta të integritimit mes dy vendeve tona, por edhe më tej në Evropë. Në këtë aktivitet u lançua edhe projekti "Diaspora Shkencore si një faktor ndryshimi në procesin e Integritimit European."

~ Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës ka përgatitur projektin "Diaspora e-student", i cili synon krijimin e një platforme të dedikuar për studentët shqiptarë në Diasporë. Kjo platformë synon të jetë një plotësim ndaj platformës së profesionistëve në projektin "Diaspora për Zhvillim", e cila do të shërbejë si një mjet komunikimi, informimi dhe ndërlidhjeje me tregun e punës.

~ Përfaqësues nga Agjencia Kombëtare e Diasporës, Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës dhe Qendra e Botimeve për Diasporën morën pjesë në një trajnim "Diaspora për Zhvillimin Lokal" (*Diaspora for local development*) në Serbi, organizuar nga Western Balkans Migration Network dhe organizata Germin. Trajnimi synonte trajtimin e modeleve të suksesshme në angazhimin e Diasporës në zhvillimin e vendit të origjinës.

Janar - Mars 2020:

~ Në funksion të zhvillimit të Platformës së Profesionistëve, Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës ka përgatitur projekt-propozimin "Diaspora E-student", i cili synon krijimin e një platforme të dedikuar për studentët shqiptarë në Diasporë. Kjo platformë në të ardhmen synon të jetë një plotësim ndaj platformës së profesionistëve në projektin "Diaspora për Zhvillim", e cila do të shërbejë si një mjet komunikimi, informimi dhe ndërlidhjeje me tregun e punës.

~ Në proces plotësimi i platformës "Rrjeti i Profesionistëve të Diasporës", www.adpn.al, si një mjet i cili i shërben rritjes së kapaciteteve dhe rrjetëzimit të kapitalit shoqëror

në Diasporë, si një vlerë e shtuar për zhvillimin ekonomik të vendit. Çdo person i interesuar jashtë vendit mund të krijojë profilin personal në platformë dhe ka mundësinë të kërkojë profesionistë të tjerë në botë, të ndarë në kategori sipas fushës së veprimtarisë dhe vendndodhjes. “Rrjeti i Profesionistëve të Diasporës” do të ofrojë gjithashtu dhe informacion rreth procedurave të njohjes së titujve akademikë në Shqipëri, profesioneve të lira, si edhe aktiviteteve që angazhojnë profesionistë të fushave të ndryshme.

Prill - Qershor 2020:

~ Nënshkruar memorandumi i bashkëpunimit ndërmjet Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët dhe Akademisë së Shkencave. Ky memorandum synon nxitjen e bashkëpunimit midis dy institucioneve për shkëmbimin e ekspertizës dhe studimeve e kërkimeve shkencore të përbashkëta për historinë dhe kulturën e komunitetit arbëresh.

~ Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës ka zhvilluar platformën “Rrjeti i Profesionistëve”, i cili është duke u përditësuar me informacionin përkatës. Krijimi i rrjetit të profesionistëve në Diasporë shërben si një platformë që synon të mbështesë e të nxisë zhvillimin e Shqipërisë, duke ofruar një urë lidhëse për Diasporën, me qëllim mbledhjen dhe shkëmbimin e informacioneve, në drejtim të përfshirjes së ekspertizës së anëtarëve të këtyre komuniteteve në zhvillimin e vendit si dhe në drejtim të gjenerimit të ideve dhe nismave me përfitim të përbashkët për anëtarët e këtyre komuniteteve dhe zhvillimin ekonomik, social e kulturor të vendit.

~ Nënshkruhet memorandumi i bashkëpunimit mes Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët (QSPA) dhe Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës (ASHAK). Dokumenti i nënshkruar përfshin organizimin e veprimtarive në fushën kërkimore-shkencore, si dhe kryerjen e studimeve të përbashkëta mbi historinë dhe kulturën e komunitetit arbëresh. Memorandumi cilësohet të jetë një marrëveshje e zgjerimit dhe thellimit të marrëdhënieve në mes dy vendeve në fushën e kërkimit shkencor dhe sheh me përparësi koordinimin e punës dhe bashkëpunimin mes studiuesve të rinj të Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët me studiuesit me përvojë të Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës.

~ Nënshkruar memorandumi i bashkëpunimit midis Akademisë së Studimeve Albanologjike (ASA), Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët (QSPA) dhe Ministrisë së Shtetit për Diasporën. Ky memorandum bashkëpunimi ka si qëllim krijimin e infrastrukturës së nevojshme për kërkimin shkencor, si dhe rrjetëzimin e kontakteve dhe literaturës së nevojshme për studimin e thelluar të historisë, kulturës dhe letërsisë arbëreshe. Memorandumi mes tri institucioneve, synon koordinimin e studimeve për kulturën e komunitetit arbëresh, bashkëpunimin ndër-institucional që parashikon realizimin e studimeve të përbashkëta, organizimin e aktiviteteve studimore, si dhe krijimin e grupeve të punës për aplikimin në projekte të përbashkëta.

REALIZUAR

| Masa Nr.31 |

Promovimi i rasteve të personaliteteve të suksesshme të diasporës dhe në Shqipëri dhe dhënia e titullit “Ambasador i Kombit”. Krijimi i rrjetit të Ambasadorëve të Kombit

(formulimi i akteve juridike të nevojshme për këtë çështje).

INDIKATORËT: Promovimi i personaliteteve. Krijimi i rrjetit të Ambasadorëve.

AFATI KOHOR: 6 muhori i parë i 2019 (periodike)

INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:

- Ministri i Shtetit për Diasporën
- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme

Janar - Mars 2019:

- Miratuar Vendimi nr. 339/2018 i Këshillit të Ministrave "Për kriteret dhe mënyrën e ndarjes së çmimit "Ambasador i Kombit".
- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme ka përcjellë propozimet përfundimtare për çmimin "Ambasador i Kombit" dhe nëpërmjet Ministrit të Shtetit për Diasporën i janë përcjellë Kryeministrit.
- Miratuar Urdhri nr. 50/2019 i Kryeministrit "Për dhënien e çmimit "Ambasador i Kombit".
- Me rastin e organizimit të Samitit të Dytë të Diasporës Shqiptare, më datë 2 mars në një ceremoni të veçantë, janë shpërndarë çmimet e para "Ambasador i Kombit" për përfaqësues të suksesshëm të komuniteteve shqiptare të Diasporës.
- Është në proces krijimi i rrjetit të Ambasadorëve të Kombit nga Agjencia Kombëtare e Diasporës.

Prill - Qershor 2019:

- Dërguar shkresa nr. 230 Prot., datë 20.05.2019 Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme për plotësimin e dokumenteve dhe të dhënave të kontaktit për Ambasadorët e Kombit.
- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, me shkresën nr. 7530/1 Prot., datë 25.06.2019 ka përcjellë informacionin e kërkuar lidhur me të dhënat e kontaktit për Ambasadorët e Kombit.
- Agjencia Kombëtare e Diasporës, ka realizuar krijimin e rrjetit të Ambasadorëve të Kombit, i cili do të jetë i aksesueshëm në ëbsite-t e Diasporës.

Korrik - Shtator 2019:

- Agjencia Kombëtare e Diasporës ka përgatitur një material informues lidhur me Rrjetin e Ambasadorëve të Kombit për Këshillin Koordinues të Diasporës.

Tetor - Dhjetor 2019:

- Kjo masë është realizuar.

Janar - Mars 2020:

~ Në proces propozimi i Ministrit të Shtetit për Diasporën dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për projektvendimin “Për krijimin e çmimit “Rushen Golemi” në mjekësinë shqiptare”, i cili është dërguar për mendim në institucionet përkatëse përmes platformës e-akte.

~ Në proces propozimi i Ministrit të Shtetit për Diasporën dhe Ministrisë së Kulturës projektvendimi “Për krijimin e çmimit “Martin Camaj” në letërsinë shqiptare”, i cili është dërguar për mendim në institucionet përkatëse përmes platformës e-akte

Prill - Qershor 2020:

~ Nuk ka informacion të ri për këtë masë.

NË PROCES

| Masa Nr.32 |

Krijimi i Regjistrimit të Diasporës së Kualifikuar dhe zbatimi i programeve kombëtare dhe të përbashkëta me institucione ndërkombëtare me qëllim që të tërhiqen anëtarët e kualifikuar të diasporës për t'i shërbyer ekonomisë së Shqipërisë. Vlerësimi i programeve që nxisin investitorët që të punësojnë staf të kualifikuar nga diaspora jashtë vendit. Mbi bazën e këtyre programeve, koordinimi dhe krijimi i mundësive për studentët shqiptarë që të mirëprehen dhe të ndihmohen nga anëtarë të diasporës shqiptare për të lehtësuar studimet e tyre në universitete të huaja nëpërmjet një rrjeti të ngritur për këtë qëllim në diasporë.

INDIKATORËT: Regjistri i Diasporës së Kualifikuar; Programet kombëtare; Vlerësimi i programeve; Koordinimi dhe krijimi i mundësive për studentët shqiptarë.

AFATI KOHOR: 6 mujori i parë i 2020 (periodike çdo vit)

INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:

- Ministri i Shtetit për Diasporën
- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë
- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
- Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
- Agjencia Kombëtare e Diasporës

Janar - Mars 2020:

~ Agjencia Kombëtare e Diasporës ka krijuar databazë të dhënash të mjekëve në diasporë, të juristëve dhe profesionistëve në fushën e së drejtës, si dhe studiuesve në fushën e migracionit dhe diasporës.

~ Me propozim të Ministrit të Shtetit për Diasporën dhe Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë është hartuar projektvendimi “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të studentëve të cilët studiojnë jashtë vendit dhe shtetasve të huaj me origjinë shqiptare të cilët përfitojnë bursa nga Shqipëria” në mënyrë që të identifikohen edhe programet

që ofrojnë bursa studimi jashtë vendit. Qëllimi i këtij projektvendimi është krijimi, për herë të parë, i një baze të dhënash shtetërore të studentëve të cilët kryejnë studimet e larta jashtë vendit, studentëve shqiptarë të cilët kanë përfituar bursat e studimit të cilat i ofrohen Shqipërisë nga shtete, organizata ndërkombëtare dhe jofitimprurëse në bazë të marrëveshjeve të nënshkruara apo dokumente të tjera ku Qeveria e Republikës së Shqipërisë është palë, si dhe të studentëve të huaj me origjinë shqiptare të cilët janë përfitues të programeve të financuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.

~ Qendra e Botimeve për Diasporën përditëson në vazhdimësi hartën dixhitale të shkollave shqipe në Diasporë, si dhe të dhënat për mësuesit e gjuhës shqipe në Diasporë.

~ Qendra e Botimeve për Diasporën përditëson në vazhdimësi të dhënat për shkrimtarët dhe personalitetet e letrave në Diasporë.

~ Me shkresën Nr. 795/1, datë 10.02.2020 Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë ka përcjellë Listën e mësuesve të gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në Diasporë.

~ Në funksion të zhvillimit të platformës së Profesionistëve, Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës ka përgatitur projekt propozimin “Diaspora E-student”, i cili synon krijimin e një platforme të dedikuar për studentët shqiptarë në Diasporë. Kjo platformë do të shërbejë për studentët në diasporë si një mjet komunikimi, informimi dhe ndërlidhjeje me tregun e punës në shtetin pritës dhe në vendin e origjinës.

~ Në proces plotësimi i platformës “Rrjeti i Profesionistëve të Diasporës”, www.adpn.al, si një mjet i cili i shërben rritjes së kapaciteteve dhe rrjetëzimit të kapitalit shoqëror në Diasporë, si një vlerë e shtuar për zhvillimin ekonomik të vendit. Çdo shqiptar në Diasporë mund të krijojë profilin personal në platformë dhe ka mundësinë të kërkojë profesionistë të tjerë në botë, të ndarë në kategori sipas fushës së veprimtarisë dhe vendndodhjes. “Rrjeti i Profesionistëve të Diasporës” do të ofrojë gjithashtu dhe informacion rreth procedurave të njohjes së titujve akademikë në Shqipëri, profesioneve të lira, si edhe aktivitetve që angazhojnë profesionistë të fushave të ndryshme.

Prill - Qershor 2020:

~ Agjencia Kombëtare e Diasporës ka krijuar databazë të profesionistëve shqiptarë në fushën e drejtësisë që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në Diasporë.

~ Me propozim të Ministrit të Shtetit për Diasporën është hartuar projektvendimi “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të studentëve të cilët studiojnë jashtë vendit dhe shtetasve të huaj me origjinë shqiptare të cilët përfitojnë bursa nga Shqipëria” në mënyrë që të identifikohen edhe programet që ofrojnë bursa studimi jashtë vendit. Qëllimi i këtij projektvendimi është krijimi për herë të parë i një baze të dhënash shtetërore të studentëve të cilët kryejnë studimet e larta jashtë vendit, si dhe adresimi i problematikave me të cilat ata përballen duke ju ardhur në ndihmë në shtetet ku studiojnë.

~ Qendra e Botimeve për Diasporën ka përgatitur hartën digjitale të shkollave shqipe në Diasporë dhe vijon me përditësimin e të dhënave për shkollat, kurset, mësuesit dhe nxënësit e gjuhës shqipe në Diasporë.

- Qendra e Botimeve për Diasporën ka hartuar bazën e të dhënave të shkrimtarëve dhe personaliteteve të letrave në Diasporë dhe vijon me përditësimin e të dhënave.

- Në proces është krijimi i Rrjetit të Profesionistëve në Diasporë nga Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës, i cili synon të mbështesë e të nxisë zhvillimin e Shqipërisë, duke ofruar një urë lidhëse për Diasporën, me qëllim mbledhjen dhe shkëmbimin e informacionit, në drejtim të përfshirjes së ekspertizës së anëtarëve të këtyre komuniteteve në zhvillimin e vendit si dhe në drejtim të gjenerimit të ideve dhe nismave me përfitim të përbashkët për anëtarët e këtyre komuniteteve dhe zhvillimin ekonomik, social e kulturor të vendit.

REALIZUAR

Masa Nr.33

Krijimi i Dhomës së Biznesit të Diasporës në bashkëpunim me rrjetin e bizneseve në diasporë. Krijimi i Regjistrimit të Bizneseve të Diasporës si bazë për krijimin e Dhomës së Biznesit të Diasporës si organizuese dhe ndihmuese në marrëdhëniet e biznesit me administratën shtetërore.

INDIKATORËT: Krijimi i Dhomës së Biznesit të Diasporës; Krijimi i Regjistrimit të Bizneseve të Diasporës.

AFATI KOHOR: 6 mujori i parë i 2019

INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:

- Ministri i Shtetit për Diasporën
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë
- Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes

Janar - Mars 2019:

- Ministri i Shtetit për Diasporën, z. Pandeli Majko gjatë vizitës së zhvilluar në datat 13-16 shkurt 2019 në Itali është takuar me përfaqësues të Konfederatës Kombëtare të Zejtarisë. Gjatë këtij takimi u diskutuan detajet konkrete për krijimin e Dhomës së Tregtisë për Diasporën Shqiptare në Itali, e cila në bashkëpunim me Fondin Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës do të jetë një pikë mbështetëse për biznesin e vogël dhe të mesëm të krijuar nga shqiptarët në Itali. Në vijim është në proces negociimi marrëveshja ndërmjet Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës me Dhomën e Biznesit në Itali, CNA.

- Memorandumi i Mirëkuptimit ndërmjet Fondit Shqiptar të Zhvillimit për Diasporën të Republikës së Shqipërisë dhe Unionit të Dhomave të Biznesit në Greqi është dërguar për mendim tek Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme.

- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, përmes shkresës nr. 1697, datë 05.02.2019, informon mbi takimin e zhvilluar me disa sipërmarrës shqiptarë që ushtrojnë aktivitetin e tyre në Atikë, Kretë dhe Santorini. Takimi u zhvillua në Athinë, Greqi. Pjesëmarrja e sipërmarrësve shqiptarë është një mundësi për të promovuar eksperiencën e tyre dhe për të realizuar në praktikë çfarë kërkohet dhe propozohet.

~ Në kuadër të përmbushjes së masës 15 për vitin 2019, INSTAT ka filluar punën përgatitore për realizimin e Raportit Vjetor për vitin 2019. Në kuadër të zbatimit të kësaj mase, INSTAT do të përfshijë në raportin vjetor për vitin 2019 edhe masa të tjera të Planit të Veprimit si: 30, 32, 33, 40, 41, 59, 60 dhe 64, me qëllim evidentimin dhe llogaritjen e disa indikatorëve. Për këtë çështje INSTAT ka filluar komunikimin zyrtar me institucionet përgjegjëse.

Prill - Qershor 2019:

~ Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës asiston në procesin e krijimit të Dhomës së Biznesit të Diasporës. Për këtë qëllim, janë kryer takime me përfaqësues të zyrës së Delegacionit European dhe GIZ për bashkëpunim dhe koordinim të projektit të propozuar nga Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës për Dhomën e Biznesit të Diasporës në Shqipëri, dhe portofolit të projekteve që këto institucione janë duke zbatuar, në kuadër të programeve për Diasporën.

~ Drejtuesit e Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës zhvilluan takime me përfaqësues të Unionit të Bizneseve Shqiptaro-Gjermane, më datë 26 prill 2019 në Prishtinë. Aty u diskutua mbi krijimin e Dhomës së Biznesit të Diasporës në Kosovë dhe Shqipëri, si dhe mbi mundësitë e bashkëpunimit në këtë kuadër.

~ Në proces miratimi i Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës dhe Unionit të Dhomave të Biznesit në Greqi.

~ Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës mori pjesë në Konferencën Ekonomike të Diasporës Shqiptare, organizuar në 24 dhe 25 maj 2019 në Prishtinë. Konferenca kishte për qëllim lidhjen e bizneseve të Diasporës nga Evropa me bizneset vendase dhe identifikimin e mundësive për investime dhe eksporte për produktet dhe shërbimet nga Kosova.

~ Realizuar aplikimi për thirrjen Interreg IPA CBC Itali - Shqipëri - Mali i Zi me projektin BBB - Building Bridges for Businesses, në partneritet me AIDA dhe STIIMA CNR.

Korrik - Shtator 2019:

~ Fondi Shqiptar për zhvillimin e Diasporës mori pjesë në Forumin “Invest in Prizren”, organizuar nga Komuna e Prizrenit në partneritet me Organizatën Germin në datat 5-7 korrik 2019, i cili pati për qëllim prezantimin e mundësive për investime në Prizren dhe lidhjen e tregut mes bizneseve nga diaspora dhe atyre vendase. Rrjetëzimi me bizneset e Diasporës është një hap i rëndësishëm për ngritjen e Dhomës së Biznesit në Shqipëri.

~ Miratuar Vendimi nr. 514, datë 19.7.2019 i Këshillit të Ministrave “Për financimin e projektit “Për Dhomën e Biznesit të Diasporës - krijimi dhe nxitja e investimeve të diasporës në Shqipëri”, dhe zbatimin e tij nga Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës”. Në kuadër të këtij projekti Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës ka filluar procedurën e rekrutimit të punonjësve. Dhoma e Biznesit të Diasporës do të inaugurohet në nëntor 2019.

~ Në fund të vitit 2019 parashikohet të nënshkruhet Memorandumi i Mirëkuptimit ndërmjet Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës dhe Bashkimit të Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë së Greqisë. Nëpërmjet këtij Memorandumi, palët do të bien dakord të krijojnë Dhomën e Biznesit të Diasporës Shqiptare në Greqi, e cila nxit dhe lehtëson sipërmarrjen e diasporës shqiptare në Greqi.

Tetor - Dhjetor 2019:

- Inagurimi i fillimit të funksionimit të Dhomës së Biznesit të Diasporës në datë 27 nëntor 2019. Ajo u regjistrua me Vendimin Nr. 6378, datë 12.11.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Dhoma e Biznesit të Diasporës shqiptare e nisi punën e saj me organizimin e sipërmarrësve shqiptarë në diasporë për të kontribuar në ndihmë të familjeve shqiptare të prekura nga tërmeti i datës 26 nëntor 2019.

- Në 25 tetor, Ministri i Shtetit për Diasporën zhvilloi një takim me përfaqësues të Dhomës së Tregisë së Athinës, ku u diskutua mbi rritjen e anëtarësimit të sipërmarrjeve shqiptare, bashkëpunimin me Dhomën e Biznesit të Diasporës si edhe organizimin e një takimi vjetor për mbështetjen e bizneseve shqiptare në Diasporë.

- Në datat 9 - 10 nëntor 2019, përfaqësuesit e fondit shqiptar për Zhvillimin e Diasporës morën pjesë në zhvillimin e punimeve të Kongresit të II-të Ekonomik të “Unionit të Bizneseve Shqiptaro-Gjermane” në Frankfurt, Gjermani. Në këtë aktivitet ISHIN PJESMARRES nga biznese të industrive të ndryshme, përfaqësues të fushave të ekonomisë dhe dhomave të bizneseve, përfaqësues politikë, institucione diplomatike dhe organizata joqeveritare ndërkombëtare nga Gjermania dhe trevat shqiptare. Diskutimet ishin të fokusuar kryesisht rreth mënyrave të bashkëpunimit midis bizneseve shqiptare në Diasporë dhe atyre në trevat shqiptare por edhe rreth bizneseve të huaja.

- Miratuar Vendimi Nr. 746, datë 20.11.2019 i Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime në Vendimin Nr. 294, datë 08.04.2015 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e Këshillit të Investimeve”, të ndryshuar. Sipas këtij vendimi, Dhoma e Biznesit të Diasporës dhe Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës bëhen anëtarë me status të përhershëm në Këshillin e Investimeve.

- Në datë 4 dhjetor 2019, Ministri i Shtetit për Diasporën, z. Pandeli Majko, mori pjesë në Forumin e Biznesit “Shqipëria, porta e Ballkanit” në Holandë. Në këtë takim, ministri Majko u përqendrua tek situata e biznesit në Shqipëri dhe e vendeve perëndimore, të cilat kanë shërbyer si model për vendin tonë. Gjithashtu, ministri prezantoi edhe Dhomën e Biznesit të Diasporës, institucionin e ri që do të ofrojë mbështetje për investime në vendin tonë. Pjesë e takimit ishte dhe z. Ardian Lekaj, anëtar i Këshillit Koordinues të Diasporës dhe kryetar i Dhomës së Biznesit të Diasporës.

- Në kuadër të projektit “Diaspora për Zhvillim”, është në proces ndërtimi i platformave “Rrjeti i Profesionistëve” dhe “Dhoma e Biznesit - Si të Bësh Biznes në Shqipëri”. Në këto platforma do të bëhet edhe regjistrimi i rrjetit të profesionistëve dhe bizneseve në Diasporë.

- Në kuadër të projektit “Diaspora për Zhvillim”, është në proces finalizimi zhvillimi i platformave “Rrjeti i Profesionistëve” dhe “Dhoma e Biznesit - Si të Bësh Biznes në Shqipëri”, platforma në të cilën është parashikuar regjistrimi dhe ndërveprimi i profesionistëve dhe bizneseve në Diasporë. Këto platforma do të shërbejnë për mbledhjen e të dhënave dhe krijimin e bazës së tyre si dhe hartëzimit. Platforma e profesionistëve, e cila parashikon ndarjen e të dhënave sipas kategorive, nënkategorive, si edhe pozicionit gjeografik do t’u japë mundësinë e regjistrimit në mënyrë autonome profesionistëve, duke krijuar kështu një bazë të dhënash dinamike e gjithmonë në rritje.

Janar - Mars 2020:

~ Krijuar Portali “Dhoma e Biznesit të Diasporës - Si të fillosh një biznes në Shqipëri”, publikuar në faqen e internetit www.adbc.al, i cili do të shërbejë si mekanizëm kryesor në krijimin dhe forcimin e rrjetit të bizneseve të Diasporës me ato vendase përmes:

- Krijimit të rrjeteve funksionale të bizneseve të Diasporës;
- Dhënies së informacionit mbi legjislacionin, institucionet, njoftime, grante, dokumenta të ndryshme që ndihmojnë në krijimin apo transferimin e biznesit në Shqipëri, etj;
- Ofrimit të asistencës për bizneset e Diasporës në identifikimin e sektorëve me interes brenda vendit dhe iniciativat sipërmarrëse;
- Ndikimit në rritjen e interesimit të investitorëve nga Diaspora;

~ Dhoma e Biznesit të Diasporës publikon çdo javë “Newsletter e Dhomës së Biznesit të Diasporës”, në gjuhën shqipe dhe angleze, me qëllim informimin e komunitetit të biznesit në Diasporë dhe Shqipëri mbi ekonominë, financat, sipërmarrjen, mundësitë për investime, ndryshimet ligjore, paketat fiskale dhe incentivuese, si dhe aktivitete të ndryshme brenda dhe jashtë vendit me fokus biznesin dhe investimet. Newsletter e Dhomës së Biznesit shpërndahet elektronikisht në një databasë prej rreth 1000 kontaktesh, përbërë nga biznese, shoqata biznesi në Diasporë, Dhoma Tregtie në Shqipëri e Diasporë, zyra ekonomike të Ambasadave të huaja në Shqipëri, etj.

~ Në datë 27 janar 2020 Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës dhe Dhoma e Biznesit të Diasporës morën pjesë në mbledhjen e parë për këtë vit të Këshillit të Investimeve. Gjatë kësaj mbledhje, u theksua rëndësia e ndërveprimit bashki - biznes për rritjen e transparencës dhe zhvillimin ekonomik të vendit.

~ Dhoma e Biznesit të Diasporës dhe Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës morën pjesë për herë të parë në mbledhjen e Steering Committee për projektin “EU for Innovation”, bashkëpunim midis Zyrës së Delegacionit të Bashkimit Europian në Shqipëri, Organizatës gjermane GIZ dhe asaj suedeze SIDA, si dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Në takim u diskutua rreth zhvillimit të projektit në rrethe të ndryshme të vendit, rreth target grupeve specifike si komuniteti i Diasporës si dhe rreth hapjes së thirrjeve të projektit në muajin mars 2020.

- Në datë 22 shkurt 2020, Dhoma e Biznesit të Diasporës mori pjesë në takimin e zhvilluar nga Lidhja e Bizneseve greko-shqiptar të Greqisë së veriut. Ky takim kishte si qëllim promovimin e iniciativave të përbashkëta mes Shqipërisë dhe Greqisë, për të konsoliduar zhvillimin e marrëdhënieve të bizneseve dhe sipërmarrjeve shqiptare në Greqi dhe ato greke në Shqipëri.

~ Më 28 shkurt 2020 Dhoma e Biznesit të Diasporës, në bashkëpunim me Ambasadën e Republikës së Shqipërisë në Holandë, Ambasadën e Italisë në Holandë dhe Fondacionin Holandezo-Shqiptar (SNAV) organizuan një koncert bamirësie me artistë të Diasporës shqiptare në Hollandë dhe artistë të huaj. Të ardhurat e këtij koncerti solidariteti do të shkojnë për restaurimin e muzeut “Shtëpia me gjethe”, fitues i çmimit Muzeu i Evropës, i cili u dëmtua nga tërmeti i 26 nëntorit.

- Dhoma e Biznesit të Diasporës mori pjesë në konferencën Ballkanike për Dialogun në Biznes, zhvilluar në 5 mars 2020 në Hagë, ku Kryetari i Dhomës, z. Ardian Lekaj, prezantoi para kompanive holandeze të interesuara për investime në Shqipëri mundësitë dhe potencialet që ofron vendin ynë. Gjithashtu, ndër çështjet kryesore të diskutimit ishin zhvillimet më të fundit ekonomike në vendet e Ballkanit Perëndimor, si dhe modeli “Si të bësh biznes” në këto vende.

- Në datë 3 shkurt 2020 nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Dhomës së Biznesit të Diasporës me Agjencinë Shqiptare për Zhvillimin e Investimeve (AIDA) dhe Agjencinë e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA) me qëllim përmirësimin e klimës së biznesit në Shqipëri dhe të shërbimeve ndaj sipërmarrësve të Diasporës shqiptare, si dhe nxitjen e kapitalit investues të Diasporës në vendin e origjinës. Dy agjencitë ofrojnë mbështetje dhe konsulencë për shërbimet e reja pranë Dhomës së Biznesit të Diasporës.

- Dhoma e Biznesit të Diasporës në bashkëpunim me Organizatën Ndërkombëtare për Migracionin (IOM) do të realizojë projektin “Connect Albania” me qëllim ngritjen e strukturave të posaçme për të asistuar dhe mbështetur investitorët. Projekti parashikon krijimin e një njësie brenda Dhomës së Biznesit të Diasporës, të përbërë nga një grup profesionistësh që do të marrin informacionin e plotë në lidhje me procedurat e investimeve në Shqipëri, fushat prioritare të investimeve dhe do të lehtësojnë dhe koordinojnë të gjitha hapat dhe procedurat e investimeve të kërkuara.

- Në datë 10 mars 2020, Kryesia e Dhomës së Biznesit të Diasporës zhvilloi mbledhjen e parë për vitin 2020, ku u miratua rregullorja e Dhomës së Biznesit, u analizuan dhe prezantuan disa ide konkrete rreth strategjisë për zhvillimin e Dhomës së Biznesit të Diasporës si dhe shërbimeve që ajo do të ofrojë në të ardhmen, si dhe u miratua vendimi se deri në Nëntor 2020, kuotat e anëtarësimit pranë Dhomës do të jenë në vlerën 0 (zero), me qëllim tërheqjen e bizneseve të diasporës për anëtarësim.

Prill - Qershor 2020:

- Dhoma e Biznesit të Diasporës ka koordinuar veprimtarinë me Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme për organizimin e takimeve me ambasadat shqiptare për të pasuruar regjistrin e bizneseve të Diasporës.

- Në proces krijimi i Rrjetit të Profesionistëve në Diasporë nga Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës, i cili synon të mbështesë e të nxisë zhvillimin e Shqipërisë, duke ofruar një urë lidhëse për Diasporën, me qëllim mbledhjen dhe shkëmbimin e informacionit, në drejtim të përfshirjes së ekspertizës së anëtarëve të këtyre komuniteteve në zhvillimin e vendit.

- Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës (FSHZHD) është në proces negocimi me palët përkatëse për:

- Memorandum Mirëkuptimi midis FSHZHD-së dhe Unionit të Dhomave të Biznesit në Greqi për bashkëpunim në fushën e sipërmarrjes dhe tregtisë;
- Marrëveshje Bashkëpunimi midis FSHZHD-së dhe Konfederatës Kombëtare të Zejtarisë dhe Sipërmarrjes së Vogël dhe të Mesme në Itali, për krijimin e Dhomës së Tregtisë për Diasporën Shqiptare në Itali.

- Dhoma e Biznesit të Diasporës publikon çdo javë “Newsletter e Dhomës së Biznesit të

Diasporës”, në gjuhën shqipe dhe angleze, me qëllim informimin e komunitetit të biznesit në Diasporë dhe Shqipëri mbi ekonominë, financat, sipërmarrjen, mundësitë për investime, ndryshimet ligjore, paketat fiskale dhe incentivuese, si dhe aktivitete të ndryshme brenda dhe jashtë vendit me fokus biznesin dhe investimet.

NË PROCES

|| Masa Nr.34 ||

Zhvillimi i aktiviteteve vjetore në fushën e prodhimeve vendase në koordinim me bizneset blerëse në diasporë (krijimi i hartës së restoranteve dhe bizneseve të ushqimit në diasporë) për të ndërlidhur bizneset shitëse dhe blerëse brenda dhe jashtë vendit.

INDIKATORËT: Zhvillimi i aktiviteteve vjetore; Krijimi i hartës së restoranteve dhe bizneseve.

AFATI KOHOR: 6 mujori i parë i 2019 (Periodike çdo vit)

INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:

- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
- Ministri i Shtetit për Diasporën
- Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes

Janar - Mars 2019:

~ Dërguar shkresa me nr. 541 Prot., datë 25.01.2019, Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes dhe Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, “Për zbatimin e masës nr. 34 të Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare për Diasporën 2018-2024”.

~ Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, me shkresën nr.541/3 Prot., datë 19.03.2019 informon se në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë janë në proces për ndërtimin e një baze të dhënash për të gjitha llojet e biznesit në Shqipëri.

~ Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme me shkresën nr. 3896 Prot., datë 19.03.2019, ka dërguar listën me 600 restorante në Diasporë me pronarë shqiptarë apo që menaxhohen nga shqiptarët, evidentuar nga përfaqësitë diplomatike për të qenë në dispozicion të eksportuesve dhe shoqatave të agrobiznesit në Shqipëri.

~ Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka krijuar Hartën e Restoranteve në Diasporë si dhe ka publikuar *network*-un e këtyre bizneseve në *ëbsite*-in: tipik.al.

~ Në proces puna për të krijuar një aktivitet vjetor për qëllimin e kësaj mase.

Prill - Qershor 2019:

~ Shkëmbim informacioni (me *email*) me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për listën e bizneseve shqiptare që operojnë në Diasporë, e cila do të shërbejë si bazë për hartimin e një programi të veçantë për promovimin e prodhimeve bujqësore dhe

ushqimore shqiptare.

~ Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës është në proces diskutimi për një projekt të veçantë me donatorët për zbatimin e masës nr. 34, në funksion të ndërlidhjes së tregjeve lokale brenda vendit me ato në Diasporë lidhur me tregtimin dhe promovimin e produkteve bujqësore.

Korrik - Shtator 2019:

~ Për zbatimin e masës nr. 34 nuk ka informacion të ri për periudhën korrik-shtator.

Tetor - Dhjetor 2019:

~ Kabineti i Ministrit të Shtetit për Diasporën zhvilloi një takim me z. Astrit Panxha, drejtor i Klubit të Prodhuesve të Kosovës. Fokusi kryesor gjatë diskutimit ishte mundësia e organizimit të një festivali kulinar-gastronomik dhe kulturor në Berlin, Gjermani. Festivali synon promovimin e kulturës dhe kulinarisë shqiptare në vendet pritëse.

~ Në datat 21-23 nëntor 2019, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural mori pjesë në konferencën dhe panairin "Shqipëria destinacioni tjetër për Turizëm, Bujqësi, Tregti dhe Investim" për promovimin e produkteve "Made in Albania" në Varshavë, Poloni. Ky panair shërbeu si një platformë e rëndësishme e promovimit të bashkëpunimit të ndërsjelltë midis Shqipërisë dhe Polonisë.

~ Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural është në proces përditësimi të një databaze me restorante në Diasporë me pronarë shqiptarë apo që menaxhohen nga shqiptarë, e cila do iu shërbejë eksportuesve dhe shoqatave të agrobiznesit në Shqipëri.

Janar - Mars 2020:

~ Në proces hartimi i programit të përbashkët të aktiviteteve për diasporën për vitin 2020. Informacioni me qëllim zhvillimin e fushës së prodhimeve vendase po merret nga Këshillat e Qarqeve të Tiranës, Durrësit, Shkodrës, Fierit, Korçës, Beratit, Dibrës, Gjirokastrës, Elbasanit, Kukësit, Lezhës dhe Vlorës, si dhe Prefektët e këtyre qarqeve.

~ Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka publikuar një listë të restoranteve dhe bizneseve të ushqimit, të menaxhuara apo drejtuara nga shqiptarë në Diasporë. Kjo listë është publikuar në website-in zyrtar të ministrisë, tek rubrika Diaspora.

Prill - Qershor 2020:

~ Dhoma e Biznesit të Diasporës po punon për përgatitjen e një "databaze" të bizneseve shqiptare në diasporë.

NË PROCES

| Masa Nr.35 |

Rivlerësimi i festave kombëtare, fetare nëpërmjet një planifikimi të kujdesshëm aktiviteteve, në bashkëpunim me sektorin privat, organizatat jofitimprurëse, federatat sportive dhe promovimi nga institucionet përgjegjëse të Turizmit në tregje të rëndësishme, duke rritur ndjeshëm flukset turistike

INDIKATORËT: Planifikim aktivitetesh dhe promovim për rritjen e flukseve turistike.

AFATI KOHOR: 6 mujori i dytë 2019

INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:

- Ministri i Shtetit për Diasporën
- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
- Ministria e Kulturës
- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit

Prill - Qershor 2019:

~ Dërguar shkresa nr. 3045 prot., datë 6.06.2019 institucioneve përkatëse për zbatimin e masës.

~ Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, me shkresën nr. 9368 Prot., datë 25.06.2019 informon se nëpërmjet përfaqësive diplomatike shënon kur është e mundur festimin e festave kombëtare, ndërsa festat fetare nuk janë pjesë e këtyre festimeve.

Korrik - Shtator 2019:

~ Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, me shkresën nr. 5404/1 Prot., datë 18.07.2019 ka përcjellë festat lokale të organizuara gjatë muajit maj 2019 dhe informon se kalendari i festave lokale i është vënë në dispozicion agjencive turistike dhe *tour* operatorëve turistik për promovimin e produkteve vendase.

~ Në mbledhjen e Komitetit Shtetëror për Diasporën në datën 17 shtator, koordinatori shtetëror për organizimin e programit vjetor të aktiviteteve për Diasporën shqiptare, znj. Ornela Çuçi informoi se gjatë periudhës janar - shtator 2019 janë realizuar në total 66 aktivitete të parashikuara në kalendarin e vitit 2019.

Tetor - Dhjetor 2019:

~ Në proces përgatitor projekti i Shkollës Verore 2020. Ai do të realizohet në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit dhe Ministrinë e Kulturës. Shkolla verore 2020 do të realizohet në bazë të Programit për fëmijët e diasporës “Jam shqiptar”. Për këtë Program është vendosur me Urdhrin Nr. 112/2019 të Kryeministrit Koordinatorja Shtetërore znj. Lorena Haxhiu, zëvendësministre në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Programi “Jam shqiptar” ka për qëllim nxitjen e organizimit të veprimtarive kulturore dhe gjuhësore për formimin kulturor të fëmijëve pjesëmarrës nga diaspora. Ai synon ruajtjen e identitetit kombëtar, kulturor dhe gjuhësor shqiptar në kushtet e distancës nga vendi i origjinës.

Janar - Mars 2020:

~ Është realizuar itinerari dhe programi i Shkollës Verore 2020, në bashkëpunim me zëvendësministren e arsimit, znj. Lorena Haxhiu, Koordinatore Shtetërore për realizimin e programit “Jam Shqiptar” të gjuhës dhe kulturës shqipe.

~ Agjencia Kombëtare e Diasporës, në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencinë Kombëtare të Turizimit dhe Agjencinë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve, po përgatisin programin e përbashkët të aktiviteteve për diasporën për vitin 2020 duke siguruar planifikimin e kujdesshëm dhe koordinimin institucional.

Prill - Qershor 2020:

~ Për shkak të emergjencës virusale Covid-19, programi shtetëror i aktiviteteve për Diasporën për 2020 po rishikohet nga institucionet përgjegjëse.

NË PROCES

Masa Nr.36

Vlerësim vjetor për remitancat dhe politikat nxitëse bankare për diasporën shqiptare. Përpunimi dhe zbatimi i një politike koherente dhe të plotë për administrimin e dërgesave të diasporës. Rivlerësim për marrjen e masave për të rritur flukset e dërgesave të migrantëve duke motivuar migrantët që sjellin kursimet e tyre në Shqipëri (si p.sh: me anë të normave të favorshme të këmbimit, si dhe mundësia për t'i mbajtur ato në valutë të huaj).

INDIKATORËT: Vlerësim vjetor për remitancat; Politika koherente dhe të plota për dërgesat; Rivlerësim për të rritur flukset e dërgesave.

AFATI KOHOR: 6 mujori i parë 2019 (periodike çdo vit)

INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:

- Ministria e Financave dhe Ekonomisë
- Ministri i Shtetit për Diasporën
- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
- Banka e Shqipërisë

Janar - Mars 2019:

~ Dërguar shkresa me nr. 467 Prot., datë 23.01.2019, Bankës së Shqipërisë për përcaktimin e përfaqësuesve në Grupin e Koordinatorëve për zbatimin e Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare të Diasporës.

~ Dërguar shkresa nr. 1543 Prot., datë 15.03.2019 Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Bankës së Shqipërisë dhe Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes për identifikimin e strukturës administrative përgjegjëse për zbatimin e masës.

~ Në datën 1 mars 2019, u zhvillua takimi i parë i Grupit Këshillimor të Greenback, Banka Botërore në Tiranë. Në përpjekje për t'i orientuar remitancat drejt një përfshirje financiare sa më të gjerë në Shqipëri, Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës u bë pjesë e Grupit Këshillimor në kuadër të projektit Greenback. Programi shtrihet edhe në vende të tjera në rajon dhe synon rritjen e sigurisë dhe efikasitetit të pagesave me vlerë të vogël, me një fokus të veçantë në remitancat ndërkombëtare.

Prill - Qershor 2019:

~ Ministri i Shtetit për Diasporën zhvilloi në Washington një takim me z. Patrizio Pagano, Drejtor Ekzekutiv i Bordit të Grupit të Bankës Botërore, ku u diskutua mundësia e thellimit të mbështetjes me projekte të Diasporës shqiptare, si një bashkëpunim midis Ministrisë të Shtetit për Diasporën dhe Zyrës së Bankës Botërore në Tiranë në kuadrin e Strategjisë së Bankës Botërore për vendin. Synimi i këtij projekti është kanalizimi i remitancave në një mënyrë të qëndrueshme për zhvillimin e vendit. U diskutua edhe mundësia e organizimit të një takimi vjetor rajonal për remitancat.

~ Ministri i Shtetit për Diasporën, z. Pandeli Majko zhvilloi në Washington një takim me Shefin e Misionit të FMN për Shqipërinë, z. Jan Kees Martijn. Me interes gjatë kësaj bisede ishte fusha e arsimit dhe lehtësimi i procedurave për rikthimin e Diasporës shqiptare në atdhe.

~ Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka përcaktuar si strukturë përgjegjëse Drejtorinë e Analizave Makroekonomike dhe Statistikave/Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit Ekonomik dhe Punësimit.

~ Shkëmbim informacioni për personat përgjegjës në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe Bankën e Shqipërisë për ndjekjen e zbatimit të masës nr. 36, ku kërkohet informacion mbi ecurinë e zbatimit të masës.

~ Shkëmbim informacioni (me *email*) me Bankën e Shqipërisë, për ecurinë e projektligjit “Për shërbimet e pagesave”, në zbatim të direktivës së Bashkimit Evropian për “Shërbimet e pagesave në tregun e brendshëm”. Banka informoi se u miratua Rregullorja 26/2019, datë 28.03.2019 “Për Licencimin, rregullimin dhe mbikëqyrjen e operatorëve të sistemeve për shlyerjen e titujve”. Krijimi i një entiteti të tillë plotëson të gjithë hallkat e infrastrukturës së nevojshme për funksionimin e bursës në Shqipëri dhe emëtimit të titujve të kompanive private nëpërmjet procedurave transparente dhe të besueshme (të cilat garantojnë nëpërmjet emëtimit të titujve në ofertë publike). Banka e Shqipërisë vlerëson se funksionimi i bursës mund të konsiderohet si një kanal alternativ për thithjen e fondeve dhe investimeve nga Diaspora duke marrë në konsideratë normat e favorshme të kthimit të cilat do të ketë tregu jonë krahasuar me vendet ku Diaspora jeton dhe punon.

~ Banka e Shqipërisë ka përgatitur një fletëpalosje me të dhëna mbi remitancat në Shqipëri. Gjithashtu, Banka është në proces për përgatitjen e një raporti vjetor lidhur me remitancat e vitit 2019.

Korrik - Shtator 2019:

~ Banka e Shqipërisë, me shkresën nr. 5182 Prot., datë 01.08.2019 drejtuar Ministrisë së Financave informon mbi veprimtarinë e saj lidhur me zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Diasporës:

- Shpalljen dhe analizimin e fluksit të dërgesave nga emigrantët në çdo deklaratë periodike të Bilancit të Pagesave;
- Në kuadër të zbatimit të masës nr. 36, Banka e Shqipërisë po punon për botimin e Revistës “Remitancat: Një mbështetje për zhvillim”;
- Miratimi dhe publikimi, nëpërmjet Komitetit Kombëtar të Sistemit të Pagesave, i raportit të hartuar me mbështetjen e Bankës Botërore “Një pasqyrë e tregut të

- remitancave në Shqipëri”;
- Publikimi i fletëpalosjes informuese në lidhje me remitancat, statistika mbi tregun vendas dhe kostot për dërgimin e tyre në Shqipëri;
 - Ka ndërmarrë një anketë përfaqësuese lidhur me financimin e familjeve shqiptare, nga ku do të ketë rezultate edhe mbi remitancat në buxhetin e familjeve shqiptare.

~ Banka e Shqipërisë është duke përgatitur raportin vjetor mbi remitancat, i cili do të publikohet në dhjetor 2019.

Tetor - Dhjetor 2019:

~ Banka e Shqipërisë ka publikuar raportin vjetor “Diaspora dhe pagesat” për vitin 2019. Në këtë raport analizohet tregu i pagesave në Shqipëri dhe nevoja për reformim, kostot dhe kursimet e pagesave me vlerë të vogël në Shqipëri, si dhe statistika mbi remitancat.

~ Në proces miratimi i projektligjit “Për shërbimet e pagesave” i hartuar nga Banka e Shqipërisë. Ky projektligj vlerësohet se nëpërmjet modernizimit të tregut vendas të pagesave me vlerë të vogël dhe nxitjes së konkurrencës, dhe si rrjedhojë rritjen e efikasitetit dhe sigurisë së tregut, do të ketë ndikim pozitiv në dërgimin e remitancave nëpërmjet kanaleve formale.

Janar - Mars 2020:

~ Banka e Shqipërisë është në proces të përgatitjes së raportit “Remitancat, një mbështetje për zhvillim”, i cili do të publikohet në dhjetor 2020. Gjithashtu, Banka e Shqipërisë ka në proces përgatitjen e raportit 3-mujor të Bilancit të Pagesave, i cili do të botohet në fund të muajit mars të këtij viti. Në bilancin e pagesave raportohet edhe për fluksin 3-mujor të remitancave.

Prill - Qershor 2020:

~ Miratuar Ligji Nr. 55/2020 “Për shërbimet e pagesave”. Ky ligj krijon themelet e ndërlidhjeve midis tregut shqiptar dhe atij evropian të pagesave, si dhe zgjeron prezencën e shërbimeve të ofruara nga bankat në të gjithë territorin e vendit nëpërmjet prezantimit dhe rregullimit të modelit të “Bankave të cilat ofrojnë shërbime pagesash nëpërmjet agjentëve”.

NË PROCES

| Masa Nr.37 |

Rivlerësimi në marrjen e masave për kalimin e dërgesave të migrantëve nga rrugët informale të transferimit në ato formale, dhe më pak të kushtueshme. Vendosija e një dialogu periodik me përfaqësuesit e sistemit bankar të vendit për këtë çështje. Nxitja e shoqërive private për të tërhequr dërgesat e emigrantëve nëpërmjet produkteve financiare (si p.sh: letra me vlerë).

INDIKATORËT: Masa për kalimin formal të dërgesave; Dialog me përfaqësuesit e sistemit bankar; Tërheqja e dërgesave nëpërmjet produkteve financiare.

AFATI KOHOR: 6 mujori i parë 2019 (periodike çdo vit)

INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:

- **Ministria e Financave dhe Ekonomisë**
- **Ministri i Shtetit për Diasporën**
- **Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme**
- **Banka e Shqipërisë**

Janar - mars 2019:

~ Dërguar shkresa me nr. 467 Prot, datë 23.01.2019, Bankës së Shqipërisë për përcaktimin e përfaqësuesve në Grupin e Koordinatorëve për zbatimin e Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare të Diasporës.

Prill - Qershor 2019:

~ Dërguar shkresa nr. 2240 Prot., datë 19.04.2019, Zëvendëskryeministrit, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Bankës së Shqipërisë për identifikimin e strukturës administrative dhe personave përgjegjës për zbatimin e kësaj mase.

~ Shkëmbim informacioni (me *email*) për personat përgjegjës në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe Bankën e Shqipërisë për ndjekjen e zbatimit të masës nr. 37.

~ Banka e Shqipërisë informon (me *email*) se vijon të vlerësojë fluksin e dërgesave duke e shpallur dhe analizuar në çdo deklaratë periodike të Bilancit të Pagesave, si dhe për vitin 2019 ka ndërmarrë një anketë përfaqësuese (10,000 familje) lidhur me financimin e familjeve shqiptare, nga ku do të ketë rezultate edhe mbi remitancat në buxhetin e familjeve shqiptare. Banka informon se anketa është aktualisht në terren.

~ Ministria e Financave dhe Ekonomisë informon se përgjatë kësaj periudhe është angazhuar në miratimin e projektligjit “Për shërbimet e pagesave”, i cili zbaton direktivën e Bashkimit Evropian për “Shërbimet e pagesave në tregun e brendshëm”. Gjithashtu, ajo vlerëson se projektligji “Për Llogarinë e pagesave” në periudhën afatmesëm (bazuar në Planin e Veprimit të Strategjisë brenda vitit 2020) do të zbatohet Direktivën e Bashkimit Evropian “Për llogarinë e pagesave” dhe vlerësohet se do të kontribuojë në prezantimin e “llogarisë bazike” e cila nuk ka kosto/ose mbartë kosto minimale për konsumatorët të cilët nuk zotërojnë llogari. Gjithashtu, direktiva nxit transparencën duke krijuar një regjistër publik për të gjithë komisionet e aplikuara nga institucionet dhe në një mënyrë lehtësisht të krahasueshme. Ky zhvillim vlerësohet të kontribuojë më tej në nismën aktuale të ndërmarrë nga Banka e Shqipërisë në këtë drejtim.

~ Banka e Shqipërisë ka përgatitur një fletëpalosje me të dhëna mbi remitancat në Shqipëri. Gjithashtu, Banka është në proces për përgatitjen e një raporti vjetor lidhur me remitancat e vitit 2019.

Korrik - Shtator 2019:

~ Banka e Shqipërisë, me shkresën nr. 5182 Prot., datë 01.08.2019 drejtuar Ministrisë së Financave informon mbi veprimtarinë e saj lidhur me zbatimin e Strategjisë Kombëtare

të Diasporës:

- Ka vijuar punën për miratimin e projektligjit “Për shërbimet e pagesave”, i cili transponon direktivën e Bashkimit Evropian “Shërbimet e Pagesave në tregun e brendshëm”.
- Miratimi i rregullores 26/2019, datë 28.03.2019 “Për licencimin, rregullimin dhe mbikëqyrjen e operatorëve të sistemeve për shlyerjen e titujve”. Miratimi dhe zbatimi i kësaj rregulloreje plotëson kuadrin e nevojshëm rregullativ për funksionimin e bursës në Shqipëri. Funksionimi i bursës mund të konsiderohet si një kanal alternativ për thithjen e fondeve dhe investimeve nga diaspora.
- Vendosja e një dialogu periodik me përfaqësuesit e sistemit bankar të vendit.

~ Banka e Shqipërisë është duke përgatitur raportin vjetor mbi remitancat, i cili do të publikohet në dhjetor 2019.

Tetor - Dhjetor 2019:

~ Banka e Shqipërisë ka publikuar raportin vjetor “Diaspora dhe pagesat” për vitin 2019. Në këtë raport analizohet tregu i pagesave në Shqipëri dhe nevoja për reformim, kostot dhe kursimet e pagesave me vlerë të vogël në Shqipëri, si dhe statistika mbi remitancat.

~ Në proces miratimi i projektligjit “Për shërbimet e pagesave” i hartuar nga Banka e Shqipërisë, i cili nëpërmjet modernizimit të tregut vendas të pagesave me vlerë të vogël dhe nxitjes së konkurrencës, dhe si rrjedhojë rritjen e efikasitetit dhe sigurisë së tregut, do të ketë ndikim pozitiv në dërgimin e remitancave nëpërmjet kanaleve formale.

Janar - mars 2020:

~ Në kuadër të projektit Green Back 2.0 si dhe të studimeve të Bankës së Shqipërisë janë përpunuar të dhëna lidhur me të ardhurat nga remitancat, koston e transaksioneve në cash, humbjet dhe përfitimet në ekonomi nga formalizimi /mosformalizimi i dërgesave.

~ Ministri i Shtetit për Diasporën, z. Pandeli Majko, mori pjesë në konferencën dyditore “The Central and Eastern European Forum 2020”, e cila u zhvillua në Vjenë të Austrisë. Fokusi i konferencës ishte perspektiva ekonomike e shteteve të Evropës Qendrore dhe Lindore në vitin 2020. Në panelin “Albanians going international”, ministri Majko nënvizoi rolin e remitancave si burim i të ardhurave për vendet në zhvillim, përfshirë edhe Shqipërinë. Ato janë burim i rëndësishëm i zhvillimit të vendit, dhe për këtë arsye, sektori privat dhe publik në Shqipëri është përqendruar në krijimin e një bashkëpunimi të ngushtë me anëtarët e Diasporës.

Prill - Qershor 2020:

~ Miratuar Ligji Nr. 55/2020 “Për shërbimet e pagesave”. Ky ligj krijon themelet e ndërlidhjeve midis tregut shqiptar dhe atij evropian të pagesave, si dhe zgjeron prezencën e shërbimeve të ofruara nga bankat në të gjithë territorin e vendit nëpërmjet prezantimit dhe rregullimit të modelit të “Bankave të cilat ofrojnë shërbime pagesash nëpërmjet agjentëve”.

Krijimi i zyrave të posaçme administrative në institucionet përgjegjëse të ekonomisë për trajtimin e diasporës shqiptare sidomos në zbatimin e politikave të dërgesave të migrantëve dhe lehtësimin e tërheqjes së investimeve nga diaspora.

INDIKATORËT: Krijimi i zyrave administrative.

AFATI KOHOR: 6 muhori i parë 2019

INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:

- Zëvendëskryeministri
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë
- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
- Ministri i Shtetit për Diasporën
- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
- Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes

Janar - Mars 2019:

- Ndërmarrë iniciativa nga Ministri i Shtetit për Diasporën për ndryshimin e Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”. Ky ndryshim është miratuar me Vendimin nr. 691/2018, të Këshillit të Ministrave dhe është në proces miratimi në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë. Kjo iniciativë është ndërmarrë për krijimin e strukturës së posaçme për Diasporën dhe migracionin për administrimin e shërbimeve në nivel vendor si pjesë administrative e njësisë vendore, në çdo bashki të vendit.

- Më datë 6 shkurt u zhvillua takim me përfaqësues nga IFC (Grupi i Bankës Botërore) dhe Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) lidhur me tërheqjen e bizneseve zvicerane për të investuar në Shqipëri. Në maj 2019 do të zhvillohet në Zvicër Agriculture Outreach Campaign 2019, organizuar nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve në bashkëpunim me institucione të larta shtetërore, për nxitjen e investimeve të huaja në sektorin e bujqësisë me qëllim zhvillimin e këtij sektori.

- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) dhe IFC (Grupi i Bankës Botërore) po bashkëpunojnë për hartimin e prezantimit Agriculture Outreach Campaign 2019. Gjatë muajit maj 2019, përfaqësuesit e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural do të marrin pjesë në Agriculture Outreach Campaign 2019, në Zvicër.

Prill - Qershor 2019:

- Në programin e Kuvendit është përfshirë projektligji për disa ndryshime në Ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”. Propozimet për ndryshimin e këtij ligji janë miratuar me Vendimin nr. 691/2018, të Këshillit të Ministrave. Këto ndryshime konsistojnë në krijimin e një strukture të posaçme për Diasporën dhe migracionin për administrimin e shërbimeve në nivel vendor, në çdo bashki.

- Dërguar shkresa nr. 2240 Prot., datë 19.04.2019, Zëvendëskryeministrit, Ministrisë së

Financave dhe Ekonomisë, Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Bankës së Shqipërisë për identifikimin e strukturës administrative dhe personave përgjegjës për zbatimin e kësaj mase.

~ Ministri i Shtetit për Diasporën, me shkresën nr. 2504/1 Prot., datë 10.05.2019 ka përcjellë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë propozimet për projektligjin “Për investimet”.

Korrik - Shtator 2019:

~ Miratuar Vendimi nr. 514, datë 19.7.2019 i Këshillit të Ministrave “Për financimin e projektit “Për Dhomën e Biznesit të Diasporës - krijimi dhe nxitja e investimeve të diasporës në Shqipëri”, dhe zbatimin e tij nga Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës”. Në kuadër të këtij projekti Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës ka filluar procedurën e rekrutimit të punonjësve. Dhoma e Biznesit të Diasporës do të inaugurohet në nëntor 2019.

~ Miratuar Ligji nr.38/2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”. Në bazë të këtij ligji në çdo bashki do të krijohet një strukturë e posaçme për diasporën dhe migracionin, për administrimin e shërbimeve në nivel vendor.

Tetor - Dhjetor 2019:

~ Me hyrjen në fuqi të ndryshimit në Ligjin Nr 139/2018 “Për vetëqeverisjen vendore” është në proces koordinimi i punës së përbashkët me Ministrinë e Brendshme dhe Shoqatat e Bashkive. Struktura administrative për diasporën dhe migracionin do të hapen në çdo bashki. Trajnimi i punonjësve të tyre do të kryhet në bashkëpunim me zyrën në Tiranë të Organizatës Ndërkombëtare të Migracionit (IOM).

~ Ka filluar veprimtarinë Dhoma e Biznesit të Diasporës, e cila synon mbështetjen e investitorëve të Diasporës që dëshirojnë të krijojnë apo të zgjerojnë bizneset e tyre në atdhe. Dhoma e Biznesit të Diasporës shërben si një mjet efikas për nxitjen e investimeve në Shqipëri.

~ Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) me shkresën Nr. 391/10 Prot., datë 06.12.2019 kërkon caktimin e personave të kontaktit nga Ministri i Shtetit për Diasporën në zbatim të Urdhrit Nr. 97, datë 16.07.2018 të Kryeministrit “Për bashkërendimin ndërinstitucional të procesit të promovimit të potencialeve të vendit, informimin/këshillimin/asistimin e investitorëve”.

Janar - Mars 2020:

~ Në proces nënshkrimi i memorandumit “Për bashkërendimin e punës për ngritjen e strukturës administrative për diasporën dhe migracionin në qeverisjen vendore” ndërmjet Ministrisë së Brendshme, Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministrit të Shtetit për Diasporën, Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë dhe Shoqatës për Autonomi Vendore. Qëllimi i këtij memorandumi është angazhimi në krijimin e strukturës administrative pranë bashkive, për diasporën dhe migracionin, sipas parashikimeve të Ligjit Nr. 38/2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

~ Në proces miratimi i projektvendimit “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 910, datë 21.12.2016 të Këshillit të Ministrave “Për çështjet, objekt konsultimi dhe strukturën, procedurën, formën dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Këshillit Konsultativ të qeverisjes qendrore me vetëqeverisjen vendore”. Ky ndryshim ka për qëllim shtimin në Këshillin konsultativ të qeverisjes qendrore me vetëqeverisjen vendore të drejtorit ekzekutiv të Agjencisë Kombëtare të Diasporës, në përputhje me parashikimet e nenit 29/1 të Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, për monitorimin e funksioneve të bashkive në fushën e diasporës dhe përfaqësuesit të Ministrit të Shtetit për Sipërmarrjen me qëllim mbrojtjen e konsumatorit dhe zhvillimin ekonomik vendor.

Prill - Qershor 2020:

~ Nënshkruar Memorandum Bashkëpunimi ndërmjet Ministrit të Shtetit për Diasporën, Ministrisë së Brendshme, Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Shoqatës për Autonominë Vendore “Për bashkërendimin e punës me qëllim ngritjen e strukturës administrative pranë bashkive, për diasporën dhe migracionin në qeverisjen vendore”.

~ Miratuar Vendimi Nr. 456, datë 10.06.2020 i Këshillit të Ministrave “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin Nr. 910, datë 21.12.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për çështjet, objekt konsultimi, dhe strukturën, procedurën, formën, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Këshillit Konsultativ të qeverisjes qendrore me vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar. Sipas këtij vendimi, pjesë përbërëse e Këshillit Konsultativ të qeverisjes qendrore me vetëqeverisjen vendore do të jenë edhe përfaqësues nga instucionet përgjegjëse për Diasporën.

~ Publikuar Revista Elektronike e Strukturës Administrative për Diasporën dhe Migracionin në Qeverisjen Vendore, pjesë e së cilës janë Memorandumi i Bashkëpunimit për bashkërendimin e punës për ngritjen e strukturës administrative për Diasporën dhe migracionin në qeverisjen vendore dhe harta administrative territoriale e qarqeve të Shqipërisë.

NË PROCES

Masa Nr.39

Rivlerësim për përmirësimin dhe zgjerimin e shërbimeve bankare në vendet pritëse të diasporës si dhe për të afërmit e tyre në Shqipëri (kryesisht në zonat rurale). Nxitja e bankave në vendet pritëse që me ndihmën e shoqatave të migrantëve shqiptarë, të përcaktojnë shërbime "ad-hoc" për emigrantët (Brenda shkallës së mundësisë dhe negocimit).

INDIKATORËT: Rivlerësim për përmirësimin dhe zgjerimin e shërbimeve bankare; Përcaktimi i shërbimeve “ad hoc” për emigrantët.

AFATI KOHOR: 6 mujori i dytë 2018 (periodike çdo vit)

INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:

- Ministria e Financave dhe Ekonomisë
- Ministri i Shtetit për Diasporën
- Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes

Buletini 2018:

~ Banka e Shqipërisë, në qershor 2018, ka publikuar për herë të parë raportin vjetor zyrtar “Remitancat: Një mbështetje për zhvillim.” Ky raport do të publikohet çdo vit.

~ Ministri i Shtetit për Diasporën zhvilloi më 15 nëntor 2018 një takim koordinues me përfaqësues të Bankës Botërore për bashkëveprimin në kuadër të lançimit të projektit “Greenback”. Projekti është në vazhdim dhe synon edukimin financiar të migrantëve dhe familjeve të tyre dhe promovimin e ndryshimeve në trajtimin e remitancave bazuar në nevojat reale të përfituesve finalë të transfertave ndërkombëtare. Projektit i është propozuar hartimi i një strategjie të përbashkët komunikimi dhe shpërndarje sa më të mirë të informacionit.

~ Miratuar Memorandumi i Mirëkuptimit ndërmjet Ministrit të Shtetit për Diasporën, Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me qëllim nxitjen e bashkëpunimit të efektshëm midis palëve për çështje që kanë të bëjnë me kontributin e dërgesave në para nga migrantët shqiptarë në diasporë për zhvillimin e ekonomisë. Më datë 14 dhjetor 2018 u zhvillua takimi i dytë i nivelit të lartë midis Bankës së Shqipërisë, Ministrit të Shtetit për Diasporën, bankave tregtare dhe subjekteve financiare të angazhuara në fushën e transfertave monetare që operojnë në vendin tonë.

~ Nënshkruar Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës “Për bashkëpunimin, nxitjen e biznesit dhe informimin e diasporës”, në Pejë më datë 26 nëntor 2018.

~ Masat kryesore që Banka e Shqipërisë ka identifikuar për përdorimin gjerësisht të kanaleve formale të dërgesave dhe rritjen e përfshirjes financiare të popullsisë janë: hartimi i projektligjit “Për Shërbimet e Pagesave në Republikën e Shqipërisë” dhe hartimi i projektligjit “Për Llogarinë e Pagesave”.

~ Ministria e Financave dhe Ekonomisë është në proces vlerësimi me Shoqatën e Bankave për lehtësimin e procedurave dhe mundësinë e krijimit të shërbimeve *ad-hoc* për migrantët.

Janar - Mars 2019:

~ Në datën 1 mars 2019 u zhvillua takimi i parë i Grupit Këshillimor të Greenback, Banka Botërore në Tiranë. Në përpjekje për t’i orientuar remitancat drejt një përfshirje financiare sa më të gjerë në Shqipëri, Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës u bë pjesë e Grupit Këshillimor në kuadër të projektit Greenback. Programi shtrihet edhe në vende të tjera në rajon dhe synon rritjen e sigurisë dhe efikasitetit të pagesave me vlerë të vogël, me një fokus të veçantë në remitancat ndërkombëtare.

Prill - Qershor 2019:

~ Banka e Shqipërisë informon (me *email*) se përgjatë kësaj periudhe është angazhuar në miratimin e projektligjit “Për shërbimet e pagesave”, i cili zbaton direktivën e Bashkimit Evropian për “Shërbimet e pagesave në tregun e brendshëm”. Gjithashtu u

miratua Rregullorja 26/2019, datë 28.03.2019 “Për Licencimin, rregullimin dhe mbikëqyrjen e operatorëve të sistemeve për shlyerjen e titujve”. Krijimi i një entiteti të tillë plotëson të gjithë hallkat e infrastrukturës së nevojshme për funksionimin e bursës në Shqipëri dhe emëtimit të titujve të kompanive private nëpërmjet procedurave sa më transparente dhe të besueshëm (të cilat garantojnë nëpërmjet emëtimit të titujve në ofertë publike). Banka e Shqipërisë vlerëson se funksionimi i bursës mund të konsiderohet si një kanal alternativ për thithjen e fondeve dhe investimeve nga Diaspora duke marrë në konsideratë normat e favorshme të kthimit të cilat do të ketë tregu jonë krahasuar me vendet ku Diaspora shqiptare jeton dhe punon.

Korrik - Shtator 2019:

~ Banka e Shqipërisë, me shkresën Nr. 5182 Prot., datë 01.08.2019 drejtuar Ministrisë së Financave informon mbi veprimtarinë e saj lidhur me zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Diasporës:

- Ka vijuar punën për miratimin e projektligjit “Për shërbimet e pagesave”, i cili transponon direktivën e Bashkimit Evropian “Shërbimet e Pagesave në tregun e brendshëm”.
- Miratimi i rregullores 26/2019, datë 28.03.2019 “Për licencimin, rregullimin dhe mbikëqyrjen e operatorëve të sistemeve për shlyerjen e titujve”. Miratimi dhe zbatimi i kësaj rregulloreje plotëson kuadrin e nevojshëm rregullativ për funksionimin e bursës në Shqipëri. Funksionimi i bursës mund të konsiderohet si një kanal alternativ për thithjen e fondeve dhe investimeve nga diaspora.
- Vendosija e një dialogu periodik me përfaqësuesit e sistemit bankar të vendit.

~ Banka e Shqipërisë është duke përgatitur raportin vjetor mbi remitancat, i cili do të publikohet në dhjetor 2019.

Tetor - Dhjetor 2019:

~ Në proces miratimi i projektligjit “Për shërbimet e pagesave” i hartuar nga Banka e Shqipërisë. Ky projektligj vlerësohet se nëpërmjet modernizimit të tregut vendas të pagesave me vlerë të vogël dhe nxitjes së konkurrencës, dhe si rrjedhojë rritjen e efikasitetit dhe sigurisë së tregut, do të ketë ndikim pozitiv në dërgimin e remitancave nëpërmjet kanaleve formale.

Janar - Mars 2020:

~ Në proces diskutimi në Komisionet Parlamentare projektligji “Për shërbimet e pagesave” i hartuar nga Banka e Shqipërisë. Ky projektligj vlerësohet se nëpërmjet modernizimit të tregut vendas të pagesave me vlerë të vogël dhe nxitjes së konkurrencës, dhe si rrjedhojë rritjen e efikasitetit dhe sigurisë së tregut, do të ketë ndikim pozitiv në dërgimin e remitancave nëpërmjet kanaleve formale.

Prill - Qershor 2020:

~ Miratuar Ligji Nr. 55/2020 “Për shërbimet e pagesave”. Ky ligj krijon themelet e ndërlidhjeve midis tregut shqiptar dhe atij evropian të pagesave, si dhe zgjeron prezencën e shërbimeve të ofruara nga bankat në të gjithë territorin e vendit nëpërmjet prezantimit dhe rregullimit të modelit të “Bankave të cilat ofrojnë shërbime pagesash nëpërmjet agjentëve”.

| Masa Nr.40 |

Evidentimi i shoqatave kulturore, sportive, arsimore, sociale, shkencore që veprojnë në vendet pritëse si dhe i individëve të talentuar dhe të suksesshëm që veprojnë në diasporë. Krijimi i një regjistri të veçantë për këtë qëllim.

INDIKATORËT: Evidentimi i shoqatave. Krijimi i një regjistri

AFATI KOHOR: 6 mujori i dytë 2018 (periodike)

INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:

- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
- Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
- Ministria e Kulturës
- Ministri i Shtetit për Diasporën
- Akademia e Shkencave

Buletini 2018:

~ Akademia e Shkencave ka realizuar krijimin e Rrjetit të Akademisë së të Rinjve, ku përfshihen edhe të rinjtë e talentuar të Diasporës në shkenca të ndryshme. Gjithashtu Asambleja e Akademisë së Shkencave ka filluar përfshirjen në radhët e saj akademikë të cilët janë pjesë e Diasporës dhe që janë shkencëtarë të njohur në fushat e tyre të ekspertizës.

~ Ministria e Kulturës ka krijuar një listë të artistëve, të cilët veprojnë dhe zhvillojnë aktivitetin e tyre jashtë vendit. Lista e shoqatave kulturore është duke u përditësuar.

~ Me shkresën nr.5344 Prot., datë 15.11.2018, Ministria e Kulturës kërkon informacion nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme për shoqatat kulturore në Diasporë dhe të personaliteteve të shquara të Diasporës.

Janar - Mars 2019:

~ Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë po bashkëpunon me Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme për ndërtimin e një regjistri të mësuesve në Diasporë duke iu referuar Ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Mbi bazën e këtij regjistri dhe në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe e Teknologjisë së Republikës së Kosovës, do të organizohet seminari vjetor në datat 31 korrik - 3 gusht 2019, në Kosovë.

~ Miratuar Vendimi nr. 104/2019 i Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve për krijimin e regjistrit shtetëror të mësuesve të gjuhës shqipe e të kulturës shqiptare dhe dhënien e certifikatës për nxënësit në diasporë”.

~ Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës është në proces organizimi për zhvillimin e aktivitetit vjetor të Institutit të Alb-Shkencës, me temë “Sfidat për zhvillim të qëndrueshëm të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor në hapësirën mbarëshqiptare”

më 27-29 shtator 2019, në Tiranë.

~ Në kuadër të përmbushjes së masës 15 për vitin 2019, INSTAT ka filluar punën përgatitore për realizimin e Raportit Vjetor për vitin 2019. Në kuadër të zbatimit të kësaj mase, INSTAT do të përfshijë në raportin vjetor për vitin 2019 edhe masa të tjera të Planit të Veprimit si: 30, 32, 33, 40, 41, 59, 60 dhe 64, me qëllim evidentimin dhe llogaritjen e disa indikatorëve. Për këtë çështje INSTAT ka filluar komunikimin zyrtar me institucionet përgjegjëse.

~ Përcjellë nga Ministria e Kulturës lista e artistëve shqiptarë, të cilët veprojnë dhe zhvillojnë aktivitetin e tyre jashtë vendit. Gjithashtu janë përcjellë edhe dy lista të cilat përmbajnë shoqatat kulturore shqiptare dhe emra të personaliteteve shqiptare të propozuar nga ambasadat.

~ Agjencia Kombëtare e Diasporës ka krijuar regjistrin me shoqatat shqiptare në Diasporë sipas fushës së veprimtarisë së tyre, i cili do përditësohet në vazhdimësi.

Prill - Qershor 2019:

~ Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës është në proces organizimi të aktivitetit vjetor me Institutin Alb-Shkenca, me temë “Kërkimi shkencor në hapësirën mbarëshqiptare dhe roli i Diasporës shkencore”. Ky aktivitet do të zhvillohet në 27-28 shtator 2019 në Tiranë.

- Agjencia Kombëtare e Diasporës është në proces të krijimit të një databaze me shoqatat shqiptare në diasporë sipas fushës së veprimtarisë së tyre.

~ Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës dhe Qendra e Botimeve për Diasporën morën pjesë në Festivalin e Shumëgjuhësisë që u zhvillua në Selanik, Greqi në 17 - 20 maj 2019. Kjo pjesëmarrje pati edhe synim njohjen me rrjetin e grave, punën e bërë, si dhe çështje të tjera me qëllim mbështetjen e iniciativave të tyre në Greqi, forcimin e lidhjeve me vendin e origjinës dhe angazhimin e këtij rrjeti në projektet e ndryshme dedikuar Diasporës shqiptare.

~ Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë e Shqipërisë dhe Ministria e Arsimit, Shkencës dhe e Teknologjisë e Kosovës do të organizojnë Seminarin e XV kombëtar për mësimin plotësues në gjuhën shqipe në Diasporë “Prizreni 2019” në periudhën 31 korrik - 3 gusht 2019 në Prizren.

~ Ministri i Shtetit për Diasporën, me shkresën nr. 3455 Prot., datë 28.06.2019 ka kërkuar Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë hapjen e një sektori të posaçëm për Diasporën në këtë institucion.

Korrik - Shtator 2019:

~ Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, me shkresën nr. 9209 Prot., datë 20.06.2019 informon mbi takimin e zhvilluar me përfaqësuesin e shoqatës "Mandrica", Ivalyo Petrov, Bullgari.

~ Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë me shkresën nr.2278/1 Prot., datë 24.07.2019 informon se krijimi i një sektori të posaçëm për diasporën pranë këtij institucioni nuk është i mundur pasi procedurat për bursat studimore jashtë Shqipërisë për studentë shqiptarë, sipas marrëveshjeve dypalëshe, ndiqen nga Drejtoria e Integritimit,

Koordinimit, Marrëveshjeve dhe Asistencës (DIKMA).

~ Në datat 31 korrik- 3 gusht 2019 Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e Republikës së Kosovës dhe Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë e Republikës së Shqipërisë organizuan Seminarin e XV të mësimit plotësues të gjuhës shqipe. Në këtë aktivitet mori pjesë edhe drejtoresha ekzekutive e Qendrës së Botimeve për Diasporën znj. Mimoza Hysa, e cila prezantoi para mësuesve misionin dhe vizionin e Qendrës së Botimeve për Diasporën, hapat e ndërmarrë për hartimin e teksteve të reja të përbashkëta për mësimdhënien në Diasporë, si dhe projektet e tjera për ruajtjen dhe përhapjen e gjuhës dhe kulturës shqiptare jashtë vendit. Qendra e Botimeve për Diasporën shpërndau për mësuesit “Udhëzuesin për mësimdhënien në Diasporë” botuar nga QBD-ja, si dhe materiale të tjera informuese, përfshirë 300 kopjet e librit “De Rada”.

~ Në datat 27 - 28 shtator 2019 u zhvillua Takimi i XIV-të Ndërkombëtar “Kërkimi Shkencor në Hapësirën Mbarëshqiptare dhe Roli i Diasporës Shkencore”, organizuar nga Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës në bashkëpunim me Institutin Albshkenca dhe mbështetjen e GIZ në Shqipëri. Në këtë aktivitet, i cili kishte si synim angazhimin e diasporës shkencore shqiptare dhe profesionistëve të kualifikuar përmes shkëmbimit efektiv të njohurive, morën pjesë rreth 400 të ftuar ndër të cilët studiues të shquar të Diasporës shkencore shqiptare, anëtarë aktivë të Institutit Alb-Shkenca, studiues të rinj të angazhuar në studime pasuniversitare dhe teza doktorature; përfaqësues nga Akademia e Shkencave në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni, politikbërës, institute kërkimore, think tanks, organizata të Diasporës, profesionistë të kthyer etj. Rreth 100 ekspertë lokalë dhe profesionistë të Diasporës kontribuan në mënyrë aktive në panelet tematike dhe seksionet e konferencave shkencore të këtij takimi. Kontributet e tyre u materializuan në dy publikime: Libri me Referimet dhe Diskutimet në Panelet Tematike dhe Book of Proceedings (Përmbledhjet e punimeve shkencore).

Tetor - Dhjetor 2019:

~ Krijuar Regjistri Elektronik i shoqatave në diasporë, i cili përditësohet nën përgjegjësinë e Agjencisë Kombëtare të Diasporës.

~ Krijuar harta digjitale me 250 shkolla shqipe në Diasporë, si dhe rregjistri elektronik me 320 mësues të gjuhës shqipe në diasporë, i cili përditësohet në përgjegjësinë e QBD-së.

~ Krijuar baza e të dhënave me 80 shkrimtarë, përkthyes dhe njerëz të letrave që jetojnë dhe zhvillojnë veprimtarinë e tyre në Diasporë. Të dhënat përditësohen në përgjegjësinë e QBD-së dhe paraqiten në faqen në internet të kësaj qendre.

~ Në kuadër të aktiviteteve të projektit “Diaspora për Zhvillim”, përfaqësues nga Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës morën pjesë në takimin e rrjetit të profesionistëve dhe grave shqiptare të Diasporës, organizuar nga Shoqata Internacionale “Woman Alb World”, në datat 1-3 nëntor 2019, në Gjenevë, Zvicër.

Janar - Mars 2020:

~ Agjencia Kombëtare e Diasporës plotëson periodikisht Regjistrin e Shoqatave në Diasporë.

~ Me propozim të Ministrit të Shtetit për Diasporën dhe Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe

Rinisë është hartuar projektvendimi “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të studentëve të cilët studiojnë jashtë vendit dhe shtetasve të huaj me origjinë shqiptare të cilët përfitojnë bursa nga Shqipëria” në mënyrë që të identifikohen edhe programet që ofrojnë bursa studimi jashtë vendit. Qëllimi i këtij projektvendimi është krijimi, për herë të parë, i një baze të dhënash shtetërore të studentëve të cilët kryejnë studimet e larta jashtë vendit, studentëve shqiptarë të cilët kanë përfituar bursat e studimit të cilat i ofrohen Shqipërisë nga shtete, organizata ndërkombëtare dhe jofitimprurëse në bazë të marrëveshjeve të nënshkruara apo dokumente të tjera ku Qeveria e Republikës së Shqipërisë është palë, si dhe të studentëve të huaj me origjinë shqiptare të cilët janë përfitues të programeve të financuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.

~ Në datë 20 shkurt 2020, Agjencia Kombëtare e Diasporës, në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Fondin Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës, organizoi Takimin e Mjekësisë në Diasporë, ku profesionistët e suksesshëm të diasporës në fushën e mjekësisë patën mundësi të diskutojnë dhe të shkëmbejnë eksperiencat e tyre. Ky aktivitet mundësoi krijimin e një database të profesionistëve shqiptarë në fushën e mjekësisë në diasporë.

~ Në datë 22 shkurt 2020, Qendra e Botimeve për Diasporën, në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës organizoi Takimin e Shkrimtarëve në Diasporë. Ky takim, me synim krijimin e rrjeteve të profesionistëve në komunitetet shqiptare në Diasporë, mbledhi autorë, përkthyes, studiues dhe emra të njohur të letrave shqipe, brenda dhe jashtë vendit në një diskutim mbi letërsinë, gjuhën dhe vlerat atdhetare. Ky aktivitet mundësoi krijimin e një database të profesionistëve shqiptarë në fushën e letërsisë në diasporë.

~ Agjencia Kombëtare e Diasporës, me shkresën Nr. 110 Prot., datë 02.03.2020 ka kërkuar informacion të përditësuar nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme mbi shoqatat shqiptare që kryejnë veprimtarinë në diasporë, si dhe individët e spikatur në fushën e mjekësisë, biznesit dhe kulturës, me qëllim zgjerimin e regjistrave që Agjencia disponon.

Prill - Qershor 2020:

~ Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, përmes komunikimit elektronik, ka përcjellë një listë të përditësuar të shoqatave shqiptare në Diasporë.

~ Qendra e Botimeve për Diasporën ka përgatitur hartën digjitale të shkollave shqipe në Diasporë dhe vijon me përditësimin e të dhënave për shkollat, kurset, mësuesit dhe nxënësit e gjuhës shqipe në Diasporë.

~ Qendra e Botimeve për Diasporën ka hartuar bazën e të dhënave të shkrimtarëve dhe personaliteteve të letrave në Diasporë dhe vijon me përditësimin e të dhënave.

NË PROCES

|| Masa Nr.41 ||

Nxitja e organizimeve të Rrjetit të Grave në Diasporë dhe ndërtimi i politikave të veçanta në këtë drejtim. Organizimi në Shqipëri ose jashtë saj i Samitit të Grave të Diasporës. Krijimi i një rrjeti bashkëpunimi të qëndrueshëm me organizatat dhe me institucionet që mbulojnë këtë çështje në vendet pritëse dhe me shoqërinë civile në

Shqipëri për këtë qëllim.

INDIKATORËT: Organizime të Rrjetit të Grave në Diasporë; Organizimi i Samitit të Grave të Diasporës; Krijimi i një rrjeti bashkëpunimi me organizatat, institucionet dhe shoqërinë civile.

AFATI KOHOR: 6 muhori dytë 2019 (periodike)

INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:

- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
- Ministri i Shtetit për Diasporën
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Prill - Qershor 2019:

~ Dërguar shkresa nr. 3048 prot., datë 6.06.2019 institucioneve përkatëse për zbatimin e masës.

~ Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, me shkresën nr. 9348 Prot., datë 24.06.2019 drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, kërkon përcjelljen e informacionit mbi politikat dhe masat që MSHMS ka marrë në zbatimin e kësaj mase.

Korrik - Shtator 2019:

~ Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, me shkresën nr. 3141/2 Prot., datë 29.07.2019 ka përcaktuar strukturat përgjegjëse në zbatimin e masës.

~ Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës me mbështetjen e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Ministrit të Shtetit për Diasporën do të organizojë Samitin e Grave të Biznesit në 18 janar 2020.

Tetor - Dhjetor 2019:

~ Në proces përgatitja e Samitit të Grave të Biznesit (16-18 janar 2020) në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe Dhomën e Biznesit të Diasporës. Në këtë aktivitet do të marrin pjesë gra sipërmarrëse të Diasporës, profesioniste të reja, studente, akademike dhe eksperte në fushën e biznesit, përfaqësuese të institucioneve shtetërore, si dhe të organizatave ndërkombëtare.

~ Në kuadër të aktiviteteve të projektit “Diaspora për Zhvillim”, përfaqësues nga Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës morën pjesë në takimin e rrjetit të profesionistëve dhe grave shqiptare të Diasporës, organizuar nga Shoqata Internacionale “Woman Alb world”, në datat 1-3 nëntor 2019, në Gjenevë, Zvicër.

Janar - Mars 2020:

~ Në datat 16 - 18 janar 2020, Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, nën kujdesin e veçantë të Ministrit të Shtetit për Diasporën, organizoi Samitin e Grave të Biznesit. Në këtë Samit morën pjesë profesioniste të reja, studente, gra akademike dhe eksperte në fushën e biznesit, përfaqësues të institucioneve shtetërore si dhe të organizatave ndërkombëtare, veçanërisht ato që në programet në zbatim, zhvillojnë objektiva lidhur me gratë dhe

zhvillimin e tyre në fushën e biznesit dhe sipërmarrjes. Gjatë punimeve të Samitit u ndanë përvojat e suksesit dhe projektet nga anëtarë të Diasporës shqiptare dhe përfaqësues të biznesit vendas, si dhe u prezantuan platformat elektronike, “Rrjeti i Profesionistëve” dhe “Si të bësh biznes në Shqipëri” të Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës.

Prill - Qershor 2020:

~ Nuk ka informacion të ri në zbatimin e kësaj mase.

NË PROCES

| Masa Nr.42 |

Organizimi dhe mbështetja e rrjeteve (edhe ndërkombëtare) të grupeve dhe shoqatave të veçanta të Diasporës shqiptare në bazë të interesave, profesioneve të përbashkëta, apo vendndodhjes gjeografike. Krijimi i lehtësirave si p.sh: botimi në gazeta, apo në faqe interneti e informacioneve që mundësojnë krijimin e grupeve profesionale dhe të interesave të përbashkëta. Ndërmjetësimi për vendosjen e kontakteve midis grupeve “homologe” në vende të ndryshme për të krijuar rrjete funksionale të kësaj natyre.

INDIKATORËT: Organizimi dhe mbështetja e grupeve dhe shoqatave të diasporës; Krijimi i lehtësirave; Vendosja e kontakteve midis grupeve “homologe”.

AFATI KOHOR: 6 muhori i parë 2019

INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:

- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
- Ministri i Shtetit për Diasporën

Janar - Mars 2019:

~ Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës është në proces organizimi për zhvillimin e aktivitetit vjetor të Institutit të Alb-Shkencës, me temë “Sfidat për zhvillim të qëndrueshëm të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor në hapësirën mbarëshqiptare” në 27-29 shtator 2019, në Tiranë.

~ Ministri i Shtetit për Diasporën zhvilloi takim me rrjetin e avokatëve dhe me përfaqësinë e studentëve shqiptarë në Romë në datat 14-17 shkurt 2019. Në takimin e kryer në ambientet e Institutit Enciklopedik Italian “Treccani” u diskutua mbi situatën e profesionistëve shqiptarë në Itali dhe rrjetëzimin e tyre në funksion të mbrojtjes së interesave të komunitetit shqiptar në Itali.

~ Më 16 shkurt në Berlin u zyrtarizua themelimi i “Shoqatës së Mjekëve Shqiptarë në Gjermani”. Me një pjesëmarrje të madhe të mjekëve shqiptarë të ardhur nga e gjithë Gjermania, kryetare e kësaj shoqate për katër vitet e ardhshme u zgjodh PD Dr. Marsela Ceno.

~ Është në proces nënshkrimi i një marrëveshjeje me Institutin Enciklopedik Italian Treccani për bashkëpunim në fushën e Diasporës: projekte në fushën arsimore dhe

kulturore si dhe kërkime e studime shkencore në fushën e emigracionit.

~ Organizata “Jeta” me seli në Athinë, Greqi organizoi me datë 16 mars 2019 Konferencën e III-të të Gruas me temë: “Roli i Gruas në Diasporë, kthimi në Atdhe, sfidat dhe perspektivat”. Pjesë e konferencës ishin dhe përfaqësues nga Agjencia Kombëtare e Diasporës dhe Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës.

Prill - Qershor 2019:

~ Miratuar Vendimi nr. 321, datë 15.05.2019 i Këshillit të Ministrave “Për financimin e projektit “Diaspora shkencore si një faktor ndryshimi në procesin e integritimit evropian të Shqipërisë” dhe zbatimin e tij nga Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës”. Ky projekt lindi si rezultat i Samitit të Dytë të Diasporës dhe ka si qëllim angazhimin e Diasporës shkencore shqiptare dhe profesionistëve të kualifikuar, përmes zbatimit të strategjive kombëtare, me qëllim gjenerimin e transformimeve ekonomike dhe sociale në Shqipëri.

~ Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës është në proces organizimi të aktivitetit vjetor me Institutin Alb-Shkenca, me temë “Kërkimi shkencor në hapësirën mbarëshqiptare dhe roli i diasporës shkencore” në 27-28 shtator 2019 në Tiranë.

~ Në proces lançimi i aplikacionit “Diaspora Shqiptare”, i cili ofron informacion të plotë për gjithçka që ndodh me Diasporën shqiptare, përfshirë aktivitetet e komunitetit shqiptar në vendet pritëse. Aplikacioni “Diaspora Shqiptare” mund të shkarkohet online dhe menaxhohet nga Agjencia Kombëtare e Diasporës.

~ Në kuadër të aktivitetit “Për krijimin e rrjetit të profesionistëve në Diasporë”, Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës realizoi një vizitë pune për njohje dhe shkëmbim përvoja me institucionet për Diasporën në Kosovë. Objektivi i vizitës ishte takimi me aktorët kyç në Kosovë (institucione shtetërore dhe organizata jofitimprurëse) për të përfituar nga eksperiencia dypalëshe në identifikimin e praktikave më të mira për arritjen e objektivave të projektit dhe nxitjen e angazhimit të Diasporës në përgjithësi. Takimet u zhvilluan me Ministrinë e Diasporës dhe Investimeve Strategjike, Germin, Unionin e Bizneseve Shqiptaro-Gjermane, Kosovo Ideas, Asociacioni i Komunave të Kosovës, Innovation Center Kosovo.

~ Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës dhe Qendra e Botimeve për Diasporën morën pjesë në Festivalin e Shumëgjuhësisë që u zhvillua në Selanik, Greqi në datat 17 - 20 maj 2019. Kjo pjesëmarrje pati edhe synim njohjen me rrjetin e grave, punën e bërë, si dhe çështje të tjera me qëllim mbështetjen e iniciativave të tyre në Greqi, forcimin e lidhjeve me vendin e origjinës dhe angazhimin e këtij rrjeti në projektet e ndryshme dedikuar Diasporës shqiptare.

~ Në kuadër të aktivitetit “Për krijimin e rrjetit të profesionistëve në Diasporë”, dhe aktivitetit “Si të fillosh biznes” Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës u bë pjesë e “Konferencës Ekonomike të Diasporës Shqiptare” ku morën pjesë rreth 400 sipërmarrës shqiptarë. Qëllimi i kësaj konference ishte njohja me bizneset shqiptare në Diasporë dhe krijimi i bashkëpunimeve me bizneset vendase për mundësi investimi në Shqipëri dhe Kosovë. Konferenca, ndër të tjera, përmbante takime B2B, panele ekonomike, vizita në komuna dhe në ndërmarrje të suksesshme në Kosovë.

~ Pjesëmarrje në takimin e organizuar nga “Open Gov Hub” dhe “Open Government Partnership” në Washington, me temë diskutimi qeverisjen transparente. U paraqitën

reformat konkrete që janë aplikuar në politikat shtetërore shqiptare për Diasporën. Gjithashtu u njohën të pranishmit me të gjitha format e publikimit dhe nivelin e transparencës të institucioneve në varësi të tij: Buletini tre mujor i cili paraqet ecurinë e zbatimit të Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare të Diasporës, “Periodiku” i Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës, raportet vjetore të Agjencisë Kombëtare të Diasporës dhe Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës si dhe publikimin informativ të përjavshëm “Neësletter e Diasporës”. Gjatë këtij takimi, OGH - Open Gov Hub prezantoi nismën e saj në Shqipëri, hapjen e zyrës rajonale në Tiranë. Gjatë këtij takimi u fol edhe për iniciativën për të krijuar Dhomën Tregtare në Pennsylvania, Albanian Chamber in PA, me asistimin edhe të Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës.

Korrik - Shtator 2019:

~ Në datën 20 korrik 2019 u lançua aplikacioni “Diaspora Shqiptare”, i cili synon të ofrojë informacion të plotë për gjithçka ndodh në Diasporë, të pasqyrojë aktivitetet e komuniteteve shqiptare. Aplikacioni “Diaspora Shqiptare” do të jetë një platformë aktive për veprimtarinë e Këshillit Koordinues të Diasporës, i cili përbëhet nga 15 përfaqësues të komunitetit shqiptar në botë. Aplikacioni shkarkohet falas në Play Store dhe App Store.

~ Nënshkruar Marrëveshja e Bashkëpunimit ndërmjet Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës dhe Institutit “Alb-shkenca” “Për bashkëpunimin në fushën e kërkim-zhvillimit dhe të bashkëveprimit me diasporën shkencore shqiptare”. Kjo marrëveshje përfshin bashkëpunimin në fushën e kërkimit shkencor, organizimin e konferencave shkencore, botimeve dhe studimeve në funksion të interesit dhe përfitimit të përbashkët. Aktivitetet bashkëpunuese në kuadër të kryerjes së kërkimit shkencor përfshijnë bashkëpunimin për zhvillimin dhe promovimin e aktiviteteve me interes të përbashkët nëpërmjet rrjeteve ndërkombëtare, botimin dhe publikimin e studimeve mbi historinë e Diasporës shqiptare dhe trashëgiminë kulturore, si dhe promovimin e publikimin e studimeve apo botimeve në formatin e-book.

~ Në datat 27 - 28 shtator 2019 u zhvillua Takimi i XIV-të Ndërkombëtar “Kërkimi Shkencor në Hapësirën Mbarëshqiptare dhe Roli i Diasporës Shkencore”, organizuar nga Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës në bashkëpunim me Institutin Albshkenca dhe mbështetjen e GIZ në Shqipëri. Në këtë aktivitet, i cili kishte si synim angazhimin e diasporës shkencore shqiptare dhe profesionistëve të kualifikuar përmes shkëmbimit efektiv të njohurive, morën pjesë rreth 400 të ftuar ndër të cilët studiues të shquar të Diasporës shkencore shqiptare, anëtarë aktivë të Institutit Alb-Shkenca, studiues të rinj të angazhuar në studime pasuniversitare dhe teza doktore; përfaqësues nga Akademia e Shkencave në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni, politikbërës, institute kërkimore, *think tanks*, organizata të Diasporës, profesionistë të kthyer etj. Rreth 100 ekspertë lokalë dhe profesionistë të Diasporës kontribuan në mënyrë aktive në panelet tematike dhe seksionet e konferencave shkencore të këtij takimi. Kontributet e tyre u materializuan në dy publikime: Libri me Referimet dhe Diskutimet në Panelet Tematike dhe Book of Proceedings (Përmbledhjet e punimeve shkencore).

~ Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës me mbështetjen e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Ministrit të Shtetit për Diasporën do të organizojë Samitin e Grave të Biznesit në 18 janar 2020.

~ Agjencia Kombëtare e Diasporës, me mbështetjen e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministrit të Shtetit për Diasporën, do të organizojë Takimin e Mjekësisë në Diasporë në 22 shkurt 2020.

~ Qendra e Botimeve për Diasporën, me mbështetjen e Ministrisë së Kulturës dhe Ministrit të Shtetit për Diasporën, do të organizojë Takimin Mbarëkombëtar të Shkrimtarëve nga Diaspora "LETRA NGA DIASPORA" në 22 shkurt 2020. Ky takim do të ndihmojë në njohjen dhe promovimin e shkrimtarëve të Diasporës me lexuesit dhe botuesit shqiptarë dhe synon prezantimin e letërsisë së Diasporës, duke e kthyer në një traditë vjetore të letërsisë së migracionit shqiptar.

~ Qendra e Botimeve për Diasporën, me mbështetjen e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Ministrit të Shtetit për Diasporën, do të organizojë Takimin e Mësuesve të Diasporës në 14 mars 2020. Në qendër të vëmendjes së tij do të jetë mësimdhënia e gjuhës dhe kulturës shqiptare brenda dhe jashtë vendit, krijimi i kontakteve, diskutimet mbi literaturën shtesë për procesin e mësimdhënies në Diasporë.

~ Agjencia Kombëtare e Diasporës, me mbështetjen e Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrit të Shtetit për Diasporën, do të organizojë Takimin e Juristëve në Diasporë në 4 prill 2020.

Tetor - Dhjetor 2019:

~ Në kuadër të aktiviteteve të projektit "Diaspora për Zhvillim", përfaqësues nga Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës morën pjesë në takimin e rrjetit të profesionistëve dhe grave shqiptare të Diasporës, organizuar nga Shoqata Internacionale "Women Alb World", në datat 1-3 nëntor 2019, në Gjenevë, Zvicër. Qëllimi i këtij aktiviteti ishte prezantimi i strategjisë së Shoqatës "Women Alb World", krijimi i rrjetit të grave shqiptare në Diasporë.

~ Në datë 11 nëntor 2019, Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (IOM) organizoi një takim me studentë shqiptarë të arkitekturës në Itali, të cilët janë pjesë e projektit "Diaspora si një burim për ruajtjen dhe përmirësimin e monumenteve kulturore më pak të njohura në Shqipëri". Gjatë prezantimeve të tyre mori pjesë edhe Ministri i Shtetit për Diasporën, z. Pandeli Majko, i cili vlerësoi kontributin e të rinjve për përfshirjen në projekte të tilla në dobi të vendit të origjinës.

~ Shkolla e Magjistraturës, me shkresën Nr. 904 Prot., datë 18.11.2019 informon mbi iniciativën për fushatat e sensibilizimit të studentëve të drejtësisë dhe juristëve në Itali me qëllim prezantimin e reformës në sistemin e drejtësisë dhe mundësinë që ofrohet nga Shkolla për ndjekjen e formimit fillestar profesional nga studentë të juridikut si dhe avokatë e juristë që studiojnë dhe punojnë në Itali. Në kuadër të kësaj nisme u lehtësua koordinimi i vizitës së delegacionit të Shkollës së Magjistraturës në Itali dhe u mundësua takimi i tij me juristë, avokatë dhe profesionistë në fushën e drejtësisë.

~ Për krijimin e rrjeteve të profesionistëve në komunitetet shqiptare në Diasporë, Agjencia Kombëtare e Diasporës, Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës dhe Qendra e Botimeve për Diasporën do të organizojnë disa takime gjatë vitit 2020:

- Në proces përgatitja e Samitit të Grave të Biznesit (16-18 janar 2020) i cili do të organizohet nga Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe Dhomën e Biznesit të Diasporës. Në këtë aktivitet do të marrin pjesë gra sipërmarrëse të Diasporës, profesioniste të reja,

studente, akademike dhe eksperte në fushën e biznesit, përfaqësuese të institucioneve shtetërore, si dhe të organizatave ndërkombëtare.

- Takimi i Mjekësisë në Diasporë (20 shkurt 2020) - Në kuadër të përgatitjeve për takimin, janë dërguar rreth 100 ftesa elektronike për pjesëmarrje tek anëtarët e Diasporës shqiptare dhe është në proces hartimi i programit për takimin.

- Takimi i Shkrimtarëve në Diasporë (22 shkurt 2020) në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës. Është krijuar dhe hapur formulari i aplikimit online, janë përzgjedhur autorët pjesëmarrës, si dhe është përgatitur agjenda e takimit.

- Takimi i Mësuesve në Diasporë (14 mars 2020) në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Është krijuar dhe hapur formulari i aplikimit online për regjistrimin e mësuesve pjesëmarrës dhe është përgatitur agjenda e takimit.

- Takimi i Juristëve në Diasporë (4 prill 2020) - Agjencia Kombëtare e Diasporës me mbështetjen e Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrin të Shtetit për Diasporën do të organizojë takimin e juristëve në diasporë. Në proces hartimi i programit.

Janar - Mars 2020:

- Me qëllim krijimin e rrjeteve të profesionistëve në komunitetet shqiptare në Diasporë, në datat 16 - 18 janar 2020 Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë organizoi Samitin e Grave në Biznes. Gjatë Samitit u ndanë përvojat e suksesit dhe projektet nga anëtarë të Diasporës shqiptare dhe përfaqësuese të biznesit vendas, si dhe u prezantuan platformat elektronike, “Rrjeti i Profesionistëve” dhe “Si të bësh biznes në Shqipëri” të cilat administrohen nga Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës.

- Në datë 20 shkurt 2020, Agjencia Kombëtare e Diasporës, në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Fondin Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës, organizoi Takimin e Mjekësisë në Diasporë, ku profesionistët e suksesshëm të diasporës në fushën e mjekësisë patën mundësi të diskutojnë dhe të shkëmbejnë eksperiencat e tyre. Ky aktivitet mundësoi rrjetëzimin e profesionistëve të diasporës me ata në Shqipëri si dhe krijimin e një database të profesionistëve shqiptarë në fushën e mjekësisë në diasporë.

- Në datë 22 shkurt 2020, Qendra e Botimeve për Diasporën, në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës organizoi Takimin e Shkrimtarëve në Diasporë. Ky takim, me synim krijimin e rrjeteve të profesionistëve në komunitetet shqiptare në Diasporë, mblodhi autorë, përkthyes, studiues dhe emra të njohur të letrave shqipe, brenda dhe jashtë vendit në një diskutim mbi letërsinë, gjuhën dhe vlerat atdhetare.

- Në datën 14 mars 2020, Qendra e Botimeve për Diasporën, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë do të organizonte Takimin e Mësuesve në Diasporë. Ky takim ka si qëllim shkëmbimin e përvojave dhe dijeve në fushën e arsimit dhe mësimdhënies në Diasporë. Për shkak të situatës së krijuar nga pandemia e COVID-19, takimi shtyhet për një kohë të papërcaktuar.

- Nënshkruar Memorandumi i Bashkëpunimit ndërmjet Agjencisë Kombëtare të Diasporës dhe Urdhrit të Mjekëve të Shqipërisë me qëllim rrjetëzimin e profesionistëve shqiptarë në fushën e mjekësisë në diasporë, organizimin e aktiviteteve dhe veprimtarive shkencore, si dhe shkëmbimin e eksperiencave dhe arritjeve në fushën e shëndetësisë.

~ Me qëllim krijimin e rrjeteve të profesionistëve shqiptarë në diasporë, Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës po punon për plotësimin e platformës “Rrjeti i Profesionistëve të Diasporës”. Çdo person i interesuar jashtë vendit mund të krijojë profilin personal në platformë dhe ka mundësinë të kërkojë profesionistë të tjerë në botë, të ndarë në kategori sipas fushës së veprimtarisë dhe vendndodhjes. “Rrjeti i Profesionistëve të Diasporës” do të ofrojë gjithashtu dhe informacion rreth procedurave të njohjes së titujve akademikë në Shqipëri, profesioneve të lira, si edhe aktiviteteve që angazhojnë profesionistë të fushave të ndryshme.

Prill - Qershor 2020:

~ Agjencia Kombëtare e Diasporës, në datë 4 prill 2020, do të organizonte Takimin e Juristëve në Diasporë, si një aktivitet me qëllim vendosjen e kontakteve ndërmjet rrjeteve të profesionistëve në diasporë dhe në Shqipëri. Ky takim u shty për shkak të të emergjencës virusale COVID - 19.

~ Qendra e Botimeve për Diasporën, për shkak të situatës së krijuar në shkollat shqipe në Diasporë si pasojë e pandemisë globale, ka zhvilluar disa takime online me përfaqësues të shkollave shqipe, me qëllim marrjen e informacioneve dhe gjetjen e zgjidhjeve për problematikat e ngritura. QBD-ja ka organizuar gjithsej 7 takime online me përfaqësues të mësimdhënies së gjuhës shqipe nga shtete, si: Italia, Greqia, Gjermania, Zvicra, Anglia, SHBA-ja, Kanadaja, Spanja dhe Turqia. Në këto mbledhje u diskutua për problematikat e ndryshme lidhur me mësimin e gjuhës shqipe në kushtet e situatës së re të krijuar prej Covid-19, rëndësinë dhe mënyrën e përdorimit të Platformës digjitale për mësimin e gjuhës shqipe dhe pajisjen me tekste mësimore për vitin shkollor 2020-2021.

NË PROCES

| Masa Nr.43 |

Mbështetja e organizatave të diasporës shqiptare për krijimin e strukturave lokale këshilluese për shtetasit e huaj në qytetet ku migrantët shqiptarë janë të përqendruar, mbi bazën e udhëzuesit të përgatitur nga Kongresi i Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Evropës dhe Këshillit të Evropës.

INDIKATORËT: Mbështetja e organizatave të diasporës shqiptare për krijimin e strukturave lokale këshilluese.

AFATI KOHOR: 6 mujsori i parë 2019

INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:

- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
- Ministri i Shtetit për Diasporën - Agjencia Kombëtare për Diasporën
- Ministria e Drejtësisë

Janar - Mars 2019:

~ Ndërmarrë iniciativa nga Ministri i Shtetit për Diasporën për ndryshimin e Ligjit nr.

139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”. Ky ndryshim është miratuar me Vendimin nr. 691/2018, të Këshillit të Ministrave dhe është në proces miratimi në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë. Kjo iniciativë është ndërmarrë për krijimin e strukturës së posaçme për diasporën dhe migracionin, për administrimin e shërbimeve në nivel vendor, si pjesë administrative e njësisë vendore, në çdo bashki të vendit.

Prill - Qershor 2019:

~ Në programin e Kuvendit është përfshirë projektligji për disa ndryshime në Ligjin Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”. Propozimet për ndryshimin e këtij ligji janë miratuar me Vendimin nr. 691/2018, të Këshillit të Ministrave. Këto ndryshime konsistojnë në krijimin e një strukture të posaçme për Diasporën dhe migracionin për administrimin e shërbimeve në nivel vendor, në çdo bashki.

~ Dërguar shkresa nr. 2238 Prot., datë 19.04.2019 Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, si dhe Ministrisë së Drejtësisë për identifikimin e strukturës administrative dhe personave përgjegjës për zbatimin e kësaj mase.

~ Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës është në proces diskutimi për një projekt të veçantë me donatorët për zbatimin e masës nr. 43, në funksion të mbështetjes së organizatave të Diasporës shqiptare për krijimin e strukturave lokale këshilluese.

Korrik - Shtator 2019:

~ Miratuar Ligji nr.38/2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”. Në bazë të këtij ligji në çdo bashki do të krijohet një strukturë e posaçme për diasporën dhe migracionin, për administrimin e shërbimeve në nivel vendor.

Tetor - Dhjetor 2019:

~ Me hyrjen në fuqi të ndryshimit në Ligjin Nr 139/2018 “Për vetëqeverisjen vendore” është në proces koordinimi i punës së përbashkët me Ministrinë e Brendshme dhe Shoqatat e Bashkive. Struktura administrative për diasporën dhe migracionin do të hapen në çdo bashki. Trajnimi i punonjësve të tyre do të kryhet në bashkëpunim me zyrën në Tiranë të Organizatës Ndërkombëtare të Migracionit (IOM).

Janar - Mars 2020:

~ Në proces miratimi i projektvendimit “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 910, datë 21.12.2016 të Këshillit të Ministrave “Për çështjet, objekt konsultimi dhe strukturën, procedurën, formën dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Këshillit Konsultativ të qeverisjes qendrore me vetëqeverisjen vendore”. Ky ndryshim ka për qëllim shtimin në Këshillin konsultativ të qeverisjes qendrore me vetëqeverisjen vendore të drejtorit ekzekutiv të Agjencisë Kombëtare të Diasporës, në përputhje me parashikimet e nenit 29/1 të Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, për monitorimin e funksioneve të bashkive në fushën e diasporës dhe përfaqësuesit të Ministrit të Shtetit për Sipërmarrjen me qëllim mbrojtjen e konsumatorit dhe zhvillimin ekonomik vendor.

~ Në proces nënshkrimi i memorandumit "Për bashkërendimin e punës për ngritjen e strukturës administrative për diasporën dhe migracionin në qeverisjen vendore" ndërmjet Ministrisë së Brendshme, Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministrin të Shtetit për Diasporën, Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë dhe Shoqatës për Autonomi Vendore. Qëllimi i këtij memorandum është angazhimi në krijimin e strukturës administrative pranë bashkive, për diasporën dhe migracionin, sipas parashikimeve të Ligjit Nr. 38/2019 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore".

Prill - Qershor 2020:

~ Nënshkruar Memorandum Bashkëpunimi ndërmjet Ministrin të Shtetit për Diasporën, Ministrinë së Brendshme, Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Shoqatës për Autonomi Vendore "Për bashkërendimin e punës me qëllim ngritjen e strukturës administrative pranë bashkive, për diasporën dhe migracionin në qeverisjen vendore".

~ Miratuar Vendimi Nr. 456, datë 10.06.2020 i Këshillit të Ministrave "Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin Nr. 910, datë 21.12.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për çështjet, objekt konsultimi, dhe strukturën, procedurën, formën, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Këshillit Konsultativ të qeverisjes qendrore me vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar. Sipas këtij vendimi, pjesë përbërëse e Këshillit Konsultativ të qeverisjes qendrore me vetëqeverisjen vendore do të jenë edhe përfaqësues nga institucionet përgjegjëse shtetërore për Diasporën.

~ Publikuar Revista Elektronike e Strukturës Administrative për Diasporën dhe Migracionin në Qeverisjen Vendore, pjesë e së cilës janë Memorandumi i bashkëpunimit për bashkërendimin e punës për ngritjen e strukturës administrative për Diasporën dhe migracionin në qeverisjen vendore dhe harta administrative territoriale e qarqeve të Shqipërisë.

| Masa Nr.44 |

NË PROCES

Kryerja e fushatave sensibilizuese lidhur me mundësitë e ndryshme për të apeluar ndaj shkeljeve të të drejtave të migrantëve, në strukturat e vendeve pritëse si dhe në ato ndërkombëtare, të cilat merren me mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të njeriut si dhe mbrojtjen e të drejtave të migrantëve, nëpërmjet aktiviteteve si:

- Publikim i këtyre informacioneve në faqen e internetit për migracionin kushtuar kësaj çështjeje,
- Botimi në gazetat shqiptare jashtë vendit,
- Botimi dhe shpërndarja e fletëpalosjeve lidhur me këto informacione,
- Publikimi i këtyre të drejtave nëpërmjet faqeve të internetit të krijuara nga komuniteti shqiptar që vepron jashtë vendit. Raportimi periodik nga ana e qeverisë shqiptare të rasteve të shkeljeve të të drejtave të migrantëve shqiptarë. (Disa nga strukturat ndërkombëtare që merren me këto të drejta janë si më poshtë:
- Special rapporteur for migrant's rights of the United Nations - Raportuesi Special për të Drejtat e Migrantëve.
- Commissioner for Human rights of the Council of Europe - Komisioneri për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut në Këshillin e Evropës.
- European Court in Human rights - Gjykata Evropiane për Mbrojtjen e të drejtave të Njeriut.
- European Commission against Racism and Intolerance (ECRI) of the Council of Europe -

Komisioni Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës për vendet anëtare në Këshillin e Evropës.

- Commission for Petition of European Parliament for the EU - Komisioni i Peticioneve të Parlamentit Evropian.
- Ombudsman of the EU - Avokati i Popullit i BE-së

INDIKATORËT: Kryerja e fushatave sensibilizuese ndaj shkeljeve të të drejtave të migrantëve. Raportimi periodik të rasteve për shkelje të të drejtave të migrantëve shqiptarë.

AFATI KOHOR: 6 mujori i dytë 2019 (periodike)

INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:

- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
- Ministri i Shtetit për Diasporën - Agjencia Kombëtare për Diasporën
- Ministria e Drejtësisë

Prill - Qershor 2019:

~ Miratuar Urdhri nr. 92, datë 17.05.2019 i Kryeministrit "Për ngritjen e grupit të punës dhe caktimin e personit përgjegjës për mbrojtjen e të drejtave të shqiptarëve që vuajnë heqjen e lirisë jashtë vendit, të drejtave të migrantëve nëpërmjet informimit mbi mundësitë e ndryshme për të apeluar ndaj shkeljeve të të drejtave të tyre, në strukturat e vendeve pritëse si dhe në ato ndërkombëtare".

Korrik - Shtator 2019:

~ Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, me shkresën nr. 9845 Prot., datë 04.07.2019, drejtuar Qendrës së Botimeve për Diasporën ka kërkuar pajisjen me libra artistikë në gjuhën shqipe të institucioneve penitenciare në Zvicër dhe Greqi me qëllim vënien në dispozicion të këtyre librave shtetasve shqiptarë që vuajnë dënimin me heqje lirie në këto vende. Qendra e Botimeve për Diasporën, me shkresën nr. 133/1 Prot., datë 11.07.2019 drejtuar Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, informon se në varësi të vendimit të Këshillit Koordinues të Botimeve për Diasporën, do të analizojë mundësitë e plotësimit të kërkesës së sipërcituar në bashkëpunim me institucione të tjera të artit dhe kulturës në vend.

~ Dërguar shkresa nr. 397 Prot., datë 26.08.2019 drejtuar Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Ministrit të Shtetit për Diasporën për caktimin e përfaqësuesve të grupit ndërshtetëror të punës sipas Urdhrit 92/2019 të Kryeministrit "Për ngritjen e grupit të punës dhe caktimin e personit përgjegjës për mbrojtjen e të drejtave të shqiptarëve që vuajnë heqjen e lirisë jashtë vendit, të drejtave të migrantëve nëpërmjet informimit mbi mundësitë e ndryshme për të apeluar ndaj shkeljeve të të drejtave të tyre, në strukturat e vendeve pritëse si dhe në ato ndërkombëtare". Ministria e Drejtësisë, me shkresën nr. 6081/1 Prot., datë 04.09.2019 ka caktuar znj. Lirika Kutrolli si përfaqësuese në grupin e punës të ngritur me Urdhrin nr. 92/2019.

~ Në proces realizimi i projektit për krijimin e gazetës elektronike "Diaspora Shqiptare".

Tetor - Dhjetor 2019:

- Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës, në bashkëpunim me Ambasadën Zvicerane në Tiranë, do të realizojnë projektin “Gazeta e Diasporës”. Institucionet janë në proces të hartimit të marrëveshjes financiare.

- Avokati i Popullit, me shkresën Nr. 442 Prot., datë 14.10.2019 drejtuar Ministrit të Shtetit për Diasporën, Ministrit të Brendshëm, Ministrit në detyrë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Ministres së Drejtësisë për organizimin e një takimi për të koordinuar mbi kontributin konkret të secilit prej këtyre institucioneve në drejtim të mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe të shtetasve shqiptarë të privuar nga liria jashtë vendit.

- Në datë 21 tetor 2019 u zhvillua takimi i grupit ndërinstytucional të punës për mbrojtjen e të drejtave të shqiptarëve që vuajnë heqjen e lirisë jashtë vendit, të drejtave të migrantëve nëpërmjet informimit mbi mundësitë e ndryshme për të apeluar ndaj shkeljeve të të drejtave të tyre, në strukturat e vendeve pritëse si dhe në ato ndërkombëtare. Në këtë takim grupi i punës u dakordësua për hartimin e broshurave informuese nga Ministria e Drejtësisë mbi të drejtat e migrantëve dhe për shtetasit shqiptarë që vuajnë dënimin me heqje lirie jashtë vendit.

- Ministria e Drejtësisë është në komunikim me Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme mbi angazhimin e ambasadorëve në mbledhjen e të dhënave të personave të burgosur jashtë Shqipërisë.

Janar - Mars 2020:

- Në zbatim të Urdhrit Nr. 92/2019 të Kryeministrit “Për ngritjen e grupit të punës dhe caktimin e personit përgjegjës për mbrojtjen e të drejtave të shqiptarëve që vuajnë heqjen e lirisë jashtë vendit, të drejtave të migrantëve nëpërmjet informimit mbi mundësitë e ndryshme për të apeluar ndaj shkeljeve të të drejtave të tyre, në strukturat e vendeve pritëse si dhe në ato ndërkombëtare”, Koordinatorja Shtetërore, znj. Fjoralba Caka, informon se:

- Ministria e Drejtësisë, në bashkëpunim me Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, ka krijuar databazën me të dhënat e shtetasve shqiptarë që vuajnë dënimin me heqje lirie jashtë vendit.
- Me qëllim ndjekjen e rasteve për të cilat kërkohet bashkëpunim me institucione të tjera, Ministria e Drejtësisë po rakordon me Kryqin e Kuq Shqiptar dhe Komitetin Shqiptar të Helsinkit në Greqi dhe vende të tjera fqinje.
- Ministria e Drejtësisë po përgatit një dokument-katalog përmbledhës me parimet e zbatueshme dhe të drejtat e personave të dënuar jashtë Shqipërisë, bazuar në standardet ndërkombëtare, i cili do të jetë i aksesueshëm në website-et e Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme. Drafti po rishikohet dhe do të marrë formën finale brenda muajit qershor.

- Avokati i Popullit në bashkëpunim me Organizatën Ndërkombëtare të Migracionit (IOM) ka publikuar një Manual me konventat dhe ligjet e ratifikuara për të drejtat e të burgosurve jashtë vendit. Ky manual gjendet i publikuar në faqen zyrtare të internetit të Ministrisë së Drejtësisë, në rubrikën “Diaspora”.

Prill - Qershor 2020:

~ Ministria e Drejtësisë, përmes komunikimit me email, informon se është në proces të përgatitjes së një dokumenti-katalog përmbledhës "Karta e të Drejtave", me parimet e zbatueshme dhe të drejtat e personave të dënuar jashtë Shqipërisë, bazuar në standardet ndërkombëtare, i cili do të jetë i aksesueshëm në faqet zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme.

NË PROCES

| Masa Nr.45 |

Koordinimi dhe organizimi i takimeve apo "Ditëve të Shqipërisë" në vendet pritëse të komuniteteve shqiptare në diasporë mbi bazën e një programi vjetor si dhe aktivitete të tjera periodike për turizmin shqiptar edhe lehtësirat lidhur me investimet në Shqipëri.

INDIKATORËT: Koordinimi dhe organizimi i takimeve të komuniteteve shqiptare në diasporë mbi bazën e një programi vjetor

AFATI KOHOR: 6 mujori i dytë 2018 (periodike)

INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:

- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
- Ministri i Shtetit për Diasporën
- Ministria e Kulturës
- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
- Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes

Buletini 2018:

~ Miratuar Urdhri nr.138/2018, i Kryeministrit "Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për zbatimin e Masave nr. 2 dhe 45, të Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare të Diasporës".

~ Në kuadër të "Ditëve të Shqipërisë", Agjencia Kombëtare e Diasporës në bashkëpunim me Institutin Kulinar "Neraxhi" në datat 26-27 nëntor 2018 zhvilluan aktivitetin "Ditët e Kulinarisë Shqiptare në Bruksel", Belgjikë.

Janar - Mars 2019:

~ Publikuar dokumenti i Programit Vjetor i Aktiviteteve për Diasporën. Në vijim përgatitja e informacioneve vlerësuese për Programin Vjetor për Komitetin Shtetëror të Diasporës dhe Nënkomisionin Parlamentar për Diasporën dhe Migracionin me qëllim fillimin e punës për organizimin e Programit Vjetor të aktiviteteve të vitit 2020.

~ Miratuar Urdhri nr.44/2019 i Kryeministrit "Për caktimin e Koordinatorit Shtetëror për organizimin e programit vjetor të aktiviteteve për diasporën". Koordinatorë Shtetërore është caktuar Zëvendësministrja e Turizmit dhe Mjedisit, znj. Ornela Çuçi.

~ Ministri i Shtetit për Diasporën, me shkresën nr. 1576 Prot., datë 19.03.2019 i ka përcjellë Kryeministrit konkluzionet për zbatimin e Urdhrit nr. 138/2018 të Kryeministrit “Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për zbatimin e masave 2 dhe 45, të Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare për Diasporën”.

~ Miratuar Urdhri nr. 55/2019 i Kryeministrit “Për shfuqizimin e Urdhrave të Kryeministrit nr.135/2018, nr. 136/2018 dhe nr. 138/2018”.

Prill - Qershor 2019:

~ Dërguar shkresa nr.164 Prot., datë 16.04.2019 Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme për koordinimin e aktiviteteve dedikuar Ditëve të Shqipërisë në Diasporë.

~ Koordinatori Shtetëror për organizimin e programit vjetor të aktiviteteve për Diasporën, caktuar me Urdhrin nr.44/2019, prezantoi në mbledhjen e Komitetit Shtetëror të Diasporës (3 maj 2019) kalendarin e festave lokale për vitin 2019. Kalendarit turistik përmban aktivitete të ndryshme si panaire të produkteve shqiptare, festa të agroturizmit, artizanatit, kulinarisë e kulturës shqiptare, pjesë e të cilave mund të bëhet edhe Diaspora shqiptare (Raportimi nga koordinatorët në Komitetin Shtetëror është periodik dhe kryhet çdo 3 muaj).

~ Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës dhe Qendra e Botimeve për Diasporën morën pjesë në Festivalin e Shumëgjuhësisë që u zhvillua në Selanik, Greqi në 17 - 20 maj 2019. Kjo pjesëmarrje pati edhe synim njohjen me rrjetin e grave, punën e bërë, si dhe çështje të tjera me qëllim mbështetjen e iniciativave të tyre në Greqi, forcimin e lidhjeve me vendin e origjinës dhe angazhimin e këtij rrjeti në projektet e ndryshme dedikuar Diasporës shqiptare.

~ Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, me shkresën nr. 7057 Prot., datë 13.05.2019 informon mbi zhvillimin e panairit "Brussels Holiday Fair 2020" në datat 6-9 shkurt 2020 dhe Shqipëria është ndër vendet e ftuara të aplikojnë për "Vendin e Nderit". Çdo vit, pas aplikimit, zgjidhet një "Vend Nderi" i cili shpalos pasurinë kulturore, gastronominë dhe aktivitete të tjera përpara vizitorëve belgë.

~ Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, me shkresën nr. 7049 Prot., datë 13.05.2019 informon mbi organizimin e aktivitetit "Dita e Kulturës Bektashiane" në Paris, në datë 27 maj 2019 ku u shpalosën tek publiku parisien jo vetëm traditat dhe folklori bektashian, por edhe vlerat reale të identitetit tonë fetar dhe kombëtar.

~ Agjencia Kombëtare e Diasporës mori pjesë në Audiencën e mbajtur në Vatikan nga Papa Françesku me rastin e 100 vjetorit të themelimit të Eparkisë së Ungros, një ngjarje e rëndësishme kjo për komunitetin arbëresh.

~ Agjencia Kombëtare e Diasporës mori pjesë në një aktivitet për inaugurimin e bustit të Skënderbeut, më datë 18 maj 2019 në Chieuti, me ftesë të komunitetit shqiptar në Itali.

~ Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, me shkresën nr. 7508 Prot., datë 21.05.2019 përcjell kalendarin e aktiviteteve kulturore të disa përfaqësive diplomatike të Republikës së Shqipërisë.

Korrik - Shtator 2019:

~ Agjencia Kombëtare e Diasporës në bashkëpunim me Teatrin Kombëtar të Operas dhe Baletit po realizojnë programin e mësimit të këngëve dhe valleve shqiptare për komunitetet shqiptare në Ukrainë. Aktivitetet e organizuara vijojnë si më poshtë:

- 1 - 15 korrik 2019 grupi i parë i valltarëve zhvilloi klasat e mësimit të valleve për komunitetin shqiptar në Karakurt.
- 10 - 13 shtator 2019 Agjencia Kombëtare e Diasporës zhvilloi vizitë pune në Zaporozhy, ku u informua për projektet e realizuara dhe mbështetjen e komunitetit shqiptar nëpër botë si edhe për programin për shqiptarët e Ukrainës që do t'iu ofrojë kurse për mësimin e gjuhës shqipe dhe folklorit shqiptar.
- 10 - 13 shtator 2019 në Ukrainë, Konsulli i nderit të Shqipërisë, z. Shahin Omanov firmosi memorandumin e bashkëpunimit me Institucionin edukativo-arsimor "Azimuth" në Priazov. Ky memorandum synon bashkëpunimin ndërinstytucional dhe edukimin e brezave të rinj për gjuhën, historinë dhe traditat shqiptare përmes organizimit të aktiviteteve të ndryshme në Ukrainë. Një ndër prioritetet është hapja e klasave për mësimin plotësues të gjuhës dhe kulturës shqipe për fëmijët e komunitetit shqiptar në këtë rajon. Gjithashtu memorandum i parashikon shkëmbimin arsimor të stafit pedagogjik me qëllim që mësuesit nga Ukraina të kryejnë studime të specializuara për gjuhën, literaturën dhe historinë shqiptare në Universitetin e Tiranës. Agjencia Kombëtare e Diasporës ka shprehur angazhimin e saj për të mbështetur këtë bashkëpunim.
- 31 tetor 2019 Agjencia Kombëtare e Diasporës, në bashkëpunim me Teatrin Kombëtar të Operas dhe Baletit, do të organizojë një koncert në Odessa me pjesëmarrjen e valltarëve dhe instrumentistëve të Ansambllit Popullor dhe komunitetin shqiptar.

~ Në datat 17 - 20 korrik 2019, Agjencia Kombëtare e Diasporës zhvilloi një vizitë në komunitetin shqiptar në Bullgari ku u bisedua për projektet e përbashkëta që mund të realizohen lidhur me promovimin e turizmit dhe të vlerave kulturore të shqiptarëve në fshatin Mandricë, ku jeton komuniteti shqiptar prej vitit 1636.

~ Agjencia Kombëtare e Diasporës, me mbështetjen e Ministrisë së Shtetit për Diasporën, do të organizojë në Otranto në datën 19 tetor 2019 një takim të përbashkët me arbëreshët në Itali ku do të diskutohen elementet kulturore, antropologjike, historike dhe folkloristike që bashkojnë veçoritë mes Italisë dhe Shqipërisë ndër shekuj. Ky aktivitet synon të sjellë në një dritë të veçantë kostumet tipike popullore e në veçanti "Fustanellën" dhe vallet e zonave ku banojnë arbëreshët. Në mbyllje të takimit të përbashkët, Agjencia Kombëtare e Diasporës, në bashkëpunim me Teatrin Kombëtar të Operas dhe Baletit dhe Ansambllin Popullor do të organizojë një koncert ku do të performojë trupa e Ansambllit Popullor.

~ Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, me shkresën nr. 11 049 prot., datë 29.07.2019 informon mbi takimin e zhvilluar ndërmjet ambasadorit të Republikës së Shqipërisë në Slloveni dhe ambasadorit të Republikës së Kosovës. Nga dy ambasadorët u vlerësua që në periudhën shtator - tetor 2019 të organizohet një takim i përbashkët i dy

ambasadave me drejtues e përfaqësues të shoqatave shqiptare në Slloveni. Në këtë takim janë prezantuar edhe dy projekte të tjera, si organizimi i një takimi sensibilizues për viktimat e dhunës gjatë luftës në Kosovë dhe organizimi i një veprimtarie me trupin diplomatik dhe Ministrinë e Punëve të Jashtme të Sllovenisë, ku të promovohet një biznesi shqiptar në fushën e hotelerisë dhe kulinarisë.

~ Në datat 28-31 gusht 2019 përfaqësues nga Agjencia Kombëtare e Diasporës zhvilluan një takim pune në Kroaci me përfaqësuesit e shtetit kroat për Diasporën. Qëllimi i këtij takimi ishte diskutimi për bashkëpunim institucional për çështjet e Diasporës dhe mbështetjen e komunitetit shqiptar në Kroaci, në veçanti Arbëreshëve të Zarës, të cilët përbëjnë një pjesë të rëndësishme të trashëgimisë kulturore. Me Vendimin Nr. 3, datë 26.08.2019, Këshilli Drejtues i Agjencisë Kombëtare të Diasporës ka miratuar aktivitetet dhe buxhetin lidhur me mësimin e gjuhës shqipe, valleve dhe këngëve popullore, si dhe organizimin e një koncerti përmbyllës në Kroaci.

~ Agjencia Kombëtare e Diasporës, me shkresën nr. 404, datë 02.09.2019 drejtuar Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme ka shprehur interesin për pjesëmarrje në takimin e përbashkët të dy ambasadave me përfaqësues të shoqatave shqiptare në Slloveni, si dhe për mundësinë e organizimit të “Ditëve të Kulinarisë” në Lubjanë, Slloveni. Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, me shkresën nr.12645/1, datë 19.09.2019 shprehet në parim dakord për pjesëmarrjen e Agjencisë Kombëtare të Diasporës.

~ Në datë 5 shtator 2019, Agjencia Kombëtare e Diasporës organizoi koncertin “Nëna Arbëri”, me rastin e tre vjetorit të shenjtërimit të Nënë Terezës, në sheshin “Vittorio Emanuele”, Piana degli Albanesi, Itali. Në këtë koncert performuan para publikut tre virtuozët e muzikës shqiptare, soprano Inva Mula, violonçelisti Olen Cezari, Genc Tukiçi dhe artistë të tjerë italianë.

~ Në mbledhjen e Komitetit Shtetëror për Diasporën në datën 17 shtator, koordinatori shtetëror për organizimin e programit vjetor të aktiviteteve për Diasporën shqiptare, znj. Orneta Çuçi informoi se gjatë periudhës janar - shtator 2019 janë realizuar në total 66 aktivitete të parashikuara në kalendarin e vitit 2019.

Tetor - Dhjetor 2019:

~ Në datën 19 tetor 2019, Agjencia Kombëtare e Diasporës organizoi një takim të përbashkët me arbëreshët në Itali ku u diskutuan elementet kulturore, antropologjike, historike dhe folkloristike që bashkojnë veçoritë mes Italisë dhe Shqipërisë ndër shekuj. Ky aktivitet paraqiti kostumet tipike popullore e në veçanti “Fustanellën” dhe vallet e zonave ku banojnë arbëreshët. Në mbyllje të takimit Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansambli Popullor organizoi një koncert me muzikë tradicionale dhe arbëreshe.

~ Në datë 31 tetor 2019 Agjencia Kombëtare e Diasporës, në bashkëpunim me Teatrin Kombëtar të Operas dhe Baletit të Republikës së Shqipërisë, organizoi një koncert në Odessa me pjesëmarrjen e valltarëve dhe instrumentistëve të Ansambli Popullor dhe komunitetin shqiptar në Ukrainë.

~ Nënshkruar Marrëveshja ndërmjet Agjencisë Kombëtare të Diasporës dhe Teatrit “Migjeni”, Shkodër “Për bashkëpunimin në ruajtjen dhe promovimin e identitetit kulturor kombëtar në diasporë”. Në bazë të kësaj marrëveshjeje, në datë 14 nëntor 2019 do të organizohet një shfaqje teatrale nga trupa e Teatrit “Migjeni” për

komunitetin shqiptar në Zadar, Kroaci.

~ Në datë 20 nëntor 2019 u zhvillua mbledhja e grupit të punës dhe Koordinatorës Shtetërore për Programin e Aktiviteteve për Diasporën Shqiptare znj. Ornela Çuçi. Secili nga institucionet ka përgatitur programin e aktiviteteve në interes të diasporës dhe grupi i punës do të koordinojë të gjitha aktivitetet për t'i përmbledhur në një program të përbashkët.

~ Në datë 1 dhjetor 2019, Agjencia Kombëtare e Diasporës organizoi në New York një aktivitet në bashkëpunim me Teatrin e Operas, Baletit dhe Ansamblit Kombëtar i Këngëve dhe Valleve dhe nën kujdesin e veçantë të Ministrit të Shtetit për Diasporën. Ky aktivitet filloi me një minutë heshtje nga artistët dhe pjesëmarrësit, të cilët në shenjë solidariteti ndaj situatës së vështirë që po kalonte Shqipëria pas tërmetit të datës 26 nëntor 2019 bënë thirrje për ndihmë ndaj familjeve të prekura nga tërmeti.

~ Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, me shkresën Nr. 17386 Prot, datë 04.12.2019 informon mbi organizimin e “Ditëve të Kulturës Shqiptare” në Balerup, Danimarkë, nën kujdesin e Ambasadës së Republikës së Shqipërisë atje dhe Konsullatës së Republikës së Kosovës.

Janar - Mars 2020:

~ Në datë 27 janar 2020, në kuadër të “Ditëve të Shqipërisë”, Agjencia Kombëtare e Diasporës organizoi një koncert në Selanik, Greqi, me pjesëmarrjen e artistëve të mirënjohur Inva Mula, Olen Cezari dhe Genc Tukiçi. Ky aktivitet u mirëprit nga komuniteti shqiptar atje, si dhe u përshëndet nga Konsulli i Përgjithshëm i Republikës së Shqipërisë në Selanik.

~ Agjencia Kombëtare e Diasporës, në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencinë Kombëtare të Turizmit dhe Agjencinë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve, po përgatisin programin e përbashkët të aktiviteteve për diasporën për vitin 2020 duke siguruar planifikimin e kujdesshëm dhe koordinimin institucional.

Prill - Qershor 2020:

~ Për shkak të emergjencës virusale Covid-19, programi shtetëror i aktiviteteve për Diasporën për 2020 po rishikohet nga institucionet përgjegjëse shtetërore.

NË PROCES

Masa Nr.46

Koordinimi me Institucionet Shëndetësore, publike dhe private, në përgatitjen e një fushate për promovimin e turizmit shëndetësor, lidhur kryesisht me disa shërbime për të cilat Shqipëria ka siguruar avantazhe (dentar, neurokirurgji, kardiokirurgji etj.).

INDIKATORËT: Koordinimi me Institucionet Shëndetësore, publike dhe private, për promovimin e turizmit shëndetësor.

AFATI KOHOR: 6 mujori i parë 2019 (periodike)

INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:

- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
- Ministri i Shtetit për Diasporën
- Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit

Janar - Mars 2019:

~ Në kuadër të promovimit të turizmit shëndetësor, Agjencia Kombëtare e Diasporës, për 6 mujorin e parë të 2019, ka parashikuar disa aktivitete në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

~ Në përputhje me masat nr. 2 dhe nr. 45 të Planit të Veprimit për zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Diasporës është realizuar publikimi i parë i programit vjetor të aktiviteteve për vitin 2019, ku është parashikuar zhvillimi i një aktiviteti për turizmin dental, kozmetik dhe shëndetësor nga Ambasada e Republikës së Shqipërisë në Mbretërinë e Bashkuar.

Prill - Qershor 2019:

~ Në proces koordinimi me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për një kalendar të përbashkët aktiviteteve në zbatim të masës nr. 46.

~ Në faqen zyrtare të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është krijuar një zë i veçantë në funksion të informimit për Diasporën. Aty do të përfshihet edhe informacioni për zbatimin e masës nr. 46.

Korrik - Shtator 2019:

~ Agjencia Kombëtare e Diasporës, me mbështetjen e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministrit të Shtetit për Diasporën, do të organizojë Takimin e Mjekësisë në Diasporë në 22 shkurt 2020.

Tetor - Dhjetor 2019:

- Në datë 20 shkurt 2020, Agjencia Kombëtare e Diasporës në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale do të organizojë Takimin e Mjekësisë në Diasporë. Në kuadër të përgatitjeve për takimin, janë dërguar ftesat për pjesëmarrje tek anëtarët e Diasporës shqiptare dhe është në proces hartimi i programit për takimin.

Janar - Mars 2020:

~ Për këtë masë nuk ka informacione të reja për këtë periudhë.

Prill - Qershor 2020:

~ Për këtë masë nuk ka informacione të reja për këtë periudhë.

| Masa Nr.47 |

Organizimi periodik i takimeve me rrjetet e biznesit në diasporë dhe i shkëmbimit të informacionit funksional për ta nga çdo institucion që mbulon fushën e interesit për të investuar në vendlindje.

INDIKATORËT: Takime me rrjetet e biznesit dhe i shkëmbimit të informacionit

AFATI KOHOR: 6 mujori i dytë 2018 (periodike çdo vit)

INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:

- Ministria e Financave dhe Ekonomisë/Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
- Ministri i Shtetit për Diasporën
- Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes
- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit

Buletini 2018:

~ Dërguar shkresa nr. 4013, datë 03.09.2018 Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për zbatimin e masës nr. 47, të Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare të Diasporës 2018 - 2024”.

~ Miratuar Vendimi nr. 611/2018 i Këshillit të Ministrave për projektin “Diaspora në Zhvillim”.

Janar - Mars 2019:

~ Agjencia Kombëtare e Diasporës dhe Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës në koordinim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe me Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme janë në vlerësim të krijimit të një liste të organizatave të biznesit në Diasporë me qëllim organizimin e takimeve periodike.

~ Në proces zbatimi i Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës “Për bashkëpunimin, nxitjen e biznesit dhe informimin e diasporës” që synon krijimin e Dhomës (Odës) së biznesit të Diasporës në Tiranë dhe Prishtinë mbi bazën e funksionimit të të njëjtit rrjet biznesi në Diasporë.

~ Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, përmes shkresës nr. 1697, datë 05.02.2019 na informon mbi takimin e zhvilluar me disa sipërmarrës shqiptarë që ushtrjnë aktivitetin e tyre në Atikë, Kretë dhe Santorini. Takimi u mbajt në Athinë. Pjesëmarrja e sipërmarrësve shqiptarë është një mundësi për të promovuar eksperiencën e tyre dhe për të realizuar në praktikë çfarë kërkohet dhe propozohet.

Prill - Qershor 2019:

~ Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës po punon për asistimin e krijimit të Dhomës së Biznesit të Diasporës duke koordinuar me agjencitë përgjegjëse në Shqipëri dhe Kosovë në zbatim të Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës “Për bashkëpunimin, nxitjen e biznesit

dhe informimin e Diasporës” që synon krijimin e Dhomës (Odës) së biznesit të Diasporës në Tiranë dhe Prishtinë mbi bazën e funksionimit të të njëjtit rrjet biznesi në Diasporë.

- Miratuar Vendimi nr. 321, datë 15.05.2019 i Këshillit të Ministrave “Për financimin e projektit “Diaspora shkencore si një faktor ndryshimi në procesin e integritimit evropian të Shqipërisë” dhe zbatimin e tij nga Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës”. Projekti ka si qëllim angazhimin e Diasporës shkencore shqiptare dhe profesionistëve të kualifikuar, në zbatim të Strategjisë Kombëtare, me qëllim gjenerimin e transformimeve ekonomike dhe sociale në Shqipëri.

- Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës është në proces organizimi për zhvillimin e aktivitetit vjetor të Institutit të Alb-Shkencës, me temë “Sfidat për zhvillim të qëndrueshëm të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor në hapësirën mbarëshqiptare”. Ky aktivitet do të zhvillohet në 27-29 shtator 2019 në Tiranë.

- Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës zhvilloi një takim me përfaqësues të Unionit të Bizneseve Shqiptaro-Gjermane, në 26 prill 2019 në Prishtinë. Në këtë takim u diskutua mbi krijimin e Dhomës së Biznesit të Diasporës në Kosovë dhe Shqipëri, si dhe mbi mundësitë e bashkëpunimit në këtë kuadër.

- Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës mori pjesë në Konferencën Ekonomike të Diasporës Shqiptare, organizuar në 24 dhe 25 maj 2019 në Prishtinë. Konferenca kishte për qëllim lidhjen e bizneseve të Diasporës nga Evropa me bizneset vendase dhe identifikimin e mundësive për investime dhe eksporte për produktet dhe shërbimet nga Kosova.

- Në kuadër të aktivitetit “Për krijimin e rrjetit të profesionistëve në diasporë”, Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës realizoi një vizitë pune me qëllim shkëmbimin e përvojës me institucionet për diasporën në Kosovë. Janë zhvilluar takime me Organizatën Germin, Ministrinë e Diasporës dhe Investimeve Strategjike, Unionin e Bizneseve Shqiptaro-Gjermane, Kosovo Ideas, Asociacionin e Komunave të Kosovës dhe Innovation Center Kosovo.

- Shkëmbim informacioni (me *email*) me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural një listë të bizneseve shqiptare që operojnë në Diasporë, e cila i shërben për hartimin e një programi të veçantë për promovimin e prodhimeve bujqësore dhe ushqimore shqiptare.

Korrik - Shtator 2019:

- Fondi Shqiptar për zhvillimin e Diasporës mori pjesë në Forumin “Invest in Prizren”, organizuar nga Komuna e Prizrenit në partneritet me Organizatën Germin, në datat 5-7 korrik 2019, i cili pati për qëllim prezantimin e mundësive për investime në Prizren dhe lidhjen e tregut mes bizneseve nga diaspora dhe atyre vendase. Rrjetëzimi me bizneset e Diasporës është një hap i rëndësishëm për ngritjen e Dhomës së Biznesit në Shqipëri.

- Në datat 27 - 28 shtator 2019 u zhvillua Takimi i XIV-të Ndërkombëtar “Kërkimi Shkencor në Hapësirën Mbarëshqiptare dhe Roli i Diasporës Shkencore”, organizuar nga Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës në bashkëpunim me Institutin Albshkenca dhe mbështetjen e GIZ në Shqipëri. Në këtë aktivitet, i cili kishte si synim angazhimin e diasporës shkencore shqiptare dhe profesionistëve të kualifikuar përmes shkëmbimit efektiv të njohurive, morën pjesë rreth 400 të ftuar ndër të cilët studiues të shquar të Diasporës shkencore shqiptare, anëtarë aktivë të Institutit Alb-Shkenca, studiues të rinj të angazhuar në studime pasuniversitare dhe teza doktorature; përfaqësues nga Akademia e Shkencave në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni, politikbërës, institute

kërkimore, think tanks, organizata të Diasporës, profesionistë të kthyer etj. Rreth 100 ekspertë lokalë dhe profesionistë të Diasporës kontribuan në mënyrë aktive në panelet tematike dhe seksionet e konferencave shkencore të këtij takimi. Kontributet e tyre u materializuan në dy publikime: Libri me Referimet dhe Diskutimet në Panelet Tematike dhe Book of Proceedings (Përmbledhjet e punimeve shkencore).

- Në muajin nëntor 2019 inagurohet hapja e Dhomës së Biznesit të Diasporës Shqiptare asistuar nga Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës.

Tetor - Dhjetor 2019:

- Inagurimi i fillimit të funksionimit të Dhomës së Biznesit të Diasporës në datë 27 nëntor 2019. Ajo u regjistrua me Vendimin Nr. 6378, datë 12.11.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Dhoma e Biznesit të Diasporës shqiptare e nisi punën e saj me organizimin e sipërmarrësve shqiptarë në diasporë për të kontribuar në ndihmë të familjeveve shqiptare të prekura nga tërmeti i datës 26 nëntor 2019.

- Në kuadër të aktiviteteve të projektit “Diaspora për Zhvillim”, përfaqësues nga Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës morën pjesë në takimin e rrjetit të profesionistëve dhe grave shqiptare të Diasporës, organizuar nga Shoqata Internacionale “Woman Alb World”, në datat 1-3 nëntor 2019, në Gjenevë, Zvicër. Qëllimi i këtij aktiviteti ishte prezantimi i strategjisë së Shoqatës “Women Alb World”, krijimi i rrjetit të grave shqiptare në Diasporë.

- Në datat 9 - 10 nëntor 2019, Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës mori pjesë në zhvillimin e punimeve të Kongresit të II-të Ekonomik të “Unionit të Bizneseve Shqiptaro-Gjermane” në Frankfurt, Gjermani. Në këtë aktivitet morën pjesë përfaqësues nga biznese të industrive të ndryshme, përfaqësues të fushave të ekonomisë dhe dhomave të bizneseve, përfaqësues politikë, institucione diplomatike dhe organizata joqeveritare ndërkombëtare nga Gjermania dhe trevat shqiptare. Diskutimet ishin të fokusuar kryesisht rreth mënyrave të bashkëpunimit midis bizneseve shqiptare në Diasporë dhe atyre në trevat shqiptare por edhe rreth bizneseve të huaja.

- Miratuar Vendimi Nr. 746, datë 20.11.2019 i Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime në Vendimin Nr. 294, datë 08.04.2015 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e Këshillit të Investimeve”, të ndryshuar. Sipas këtij vendimi, Dhoma e Biznesit të Diasporës dhe Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës bëhen anëtarë me status të përhershëm në Këshillin e Investimeve.

- Në datë 4 dhjetor 2019, Ministri i Shtetit për Diasporën, z. Pandeli Majko, mori pjesë në Forumin e Biznesit “Shqipëria, porta e Ballkanit” në Holandë. Në këtë takim, ministri Majko u përqendrua tek situata e biznesit në Shqipëri dhe e vendeve perëndimore, të cilat kanë shërbyer si model për vendin tonë. Gjithashtu, ministri prezantoi edhe Dhomën e Biznesit të Diasporës, institucionin e ri që do të ofrojë mbështetje për investime në vendin tonë. Pjesë e takimit ishte dhe z. Ardian Lekaj, anëtar i Këshillit Koordinues të Diasporës dhe kryetar i Dhomës së Biznesit të Diasporës.

Janar - Mars 2020:

- Në datë 27 janar 2020 Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës dhe Dhoma e Biznesit të Diasporës morën pjesë në mbledhjen e parë për këtë vit të Këshillit të Investimeve.

Gjatë kësaj mbledhje, u theksua rëndësia e ndërveprimit bashki- biznes për rritjen e transparencës dhe zhvillimin ekonomik të vendit.

~ Dhoma e Biznesit të Diasporës mori pjesë në konferencën Ballkanike për Dialogun në Biznes, zhvilluar në 5 mars 2020 në Hagë, ku Kryetari i Dhomës, z. Ardian Lekaj, prezantoi para kompanive holandeze të interesuara për investime në Shqipëri mundësitë dhe potencialet që ofron vendin ynë. Gjithashtu, ndër çështjet kryesore të diskutimit ishin zhvillimet më të fundit ekonomike në vendet e Ballkanit Perëndimor, si dhe modeli “Si të bësh biznes” në këto vende.

Prill - Qershor 2020:

~ Dhoma e Biznesit të Diasporës ka përgatitur një kalendar aktiviteteve me rrjetin e bizneseve dhe shkëmbimit funksional mes institucioneve dhe biznesit, në nivel kombëtar dhe në Diasporë për vitin 2021. Për shkak të emrgjencës virusale COVID-19, janë pezulluar aktivitetet e planifikuara në këtë periudhë.

NË PROCES

| Masa Nr.48 |

MEPJ-ja përmes strukturave të saj të diplomacisë ekonomike do t'i kushtojë një vëmendje të veçantë marrëdhënieve me diasporën shqiptare në botë, për shfrytëzimin e potencialit ekonomik që kjo diasporë mbart në vetvete, në shërbim të zhvillimit ekonomik dhe social të vendit. Bashkëpunim me sektorin e biznesit privat dhe institucionet e linjës për shpërndarjen e informacioneve të karakterit ekonomik dhe përpilimin e një programi aktiviteteve vjetore periodike, që nxit marrëdhëniet e biznesit ndërmjet komuniteteve shqiptare në diasporë me njëri-tjetrin dhe vendlindjen.

INDIKATORËT: Bashkëpunim me sektorin e biznesit privat dhe institucionet e linjës; Përpilim i një programi aktiviteteve vjetore periodike.

AFATI KOHOR: 6 maji i dytë 2018 (periodike çdo vit)

INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:

- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë
- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
- Ministri i Shtetit për Diasporën
- Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes

Buletini 2018:

~ Nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme në datë 20.11.2017 është realizuar takimi tre ditor me ambasadorët e Shqipërisë në botë “Për ridimensionimin e diplomacisë ekonomike shqiptare: “Sfida dhe mundësi”.

~ Nënshkruar Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës “Për bashkëpunimin, nxitjen e biznesit dhe informimin e Diasporës” nënshkruar në Pejë në 26 nëntor 2018. Kjo marrëveshje ka si qëllim bashkëpunimin, nxitjen e biznesit dhe informimin e Diasporës e cila do të arrihet

nëpërmjet ngritjes së disa strukturave të veçanta si: Këshilli i Bashkëpunimit të Diasporës Shqiptare, i cili do të kontribuojë në realizimin e organizimit më të mirë të komuniteteve shqiptare në vendet pritëse dhe Dhoma (Oda) e biznesit të Diasporës në Tiranë dhe Prishtinë.

Janar - Mars 2019:

~ Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës po ndjek procesin e krijimit të Dhomës së Biznesit të Diasporës në Tiranë dhe Prishtinë.

Prill - Qershor 2019:

~ Në proces realizimi i një dokumenti përmbledhës për Komitetin Shtetëror të Diasporës për planifikimin e aktiviteteve jashtë vendit në zbatim të masës nr. 48 për vitin 2020 në bashkëpunim me Ministrinë e Evropës dhe Punëve të Jashtme.

~ Në kuadër të aktivitetit “Për krijimin e rrjetit të profesionistëve në diasporë”, dhe aktivitetit “Si të fillosh biznes” Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës u bë pjesë e “Konferencës Ekonomike të Diasporës Shqiptare” ku morën pjesë rreth 400 sipërmarrës shqiptarë. Qëllimi i kësaj konference ishte njohja me bizneset shqiptare në Diasporë dhe krijimi i bashkëpunimeve me bizneset vendase për mundësi investimi në Shqipëri dhe Kosovë. Konferenca, ndër të tjera, përmbante takime B2B, panele ekonomike, vizita në komuna dhe në ndërmarrje të suksesshme në Kosovë.

~ Dërguar shkresa nr. 300 Prot., datë 17.06.2019 nga Agjencia Kombëtare e Diasporës, Ministrit të Shtetit për Sipërmarrjen dhe Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve ku kërkohet informacion mbi projekte të karakterit platformë elektronike, të ngjashëm me “Connect Albania”, (platformë e cila, pritet të krijohet nga IOM e financuar nga Zyra e Kooperacionit Italian, në bashkëpunim me institucionet e Diasporës), për shmangien e mbivendosjeve të mundshme.

~ Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve me shkresën me nr. 231/1 prot., datë 02.07.2019 informon lidhur me sistemin e informacionit E-Invest, e cila lidhet me zhvillimin e programit “Connect Albania” me synim nxitjen dhe angazhimin e Diasporës shqiptare në zhvillimin e investimeve të huaja. Në proces diskutimi që pranë saj të hapet një zë i posaçëm për Diasporën shqiptare.

Korrik - Shtator 2019:

~ Miratuar Vendimi nr. 514, datë 19.7.2019 i Këshillit të Ministrave “Për financimin e projektit “Për Dhomën e Biznesit të Diasporës - krijimi dhe nxitja e investimeve të diasporës në Shqipëri”, dhe zbatimin e tij nga Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës”. Në kuadër të këtij projekti Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës ka filluar procedurën e rekrutimit të punonjësve. Dhoma e Biznesit të Diasporës do të inaugurohet në nëntor 2019.

Tetor - Dhjetor 2019:

~ Në proces organizimi përgatitja e Newsletter për Dhomën e Biznesit të Diasporës, në të cilën do të publikohen informacione të ndryshme rreth të bërit biznes në Shqipëri, fushave prioritare, promovime të historive të suksesit lidhur me sipërmarrjen dhe investimet, etj.

~ Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës, në bashkëpunim me Ambasadën Zvicerane në Tiranë, do të realizojnë projektin “Gazeta e Diasporës”. Institucionet janë në proces të hartimit të marrëveshjes financiare.

~ Në datat 9 - 10 nëntor 2019, Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës mori pjesë në zhvillimin e punimeve të Kongresit të II-të Ekonomik të “Unionit të Bizneseve Shqiptaro-Gjermane” në Frankfurt, Gjermani. Në këtë aktivitet morën pjesë përfaqësues nga biznese të industrive të ndryshme, përfaqësues të fushave të ekonomisë dhe dhomave të bizneseve, përfaqësues politikë, institucione diplomatike dhe organizata joqeveritare ndërkombëtare nga Gjermania dhe trevat shqiptare. Diskutimet ishin të fokusuar kryesisht rreth mënyrave të bashkëpunimit midis bizneseve shqiptare në Diasporë dhe atyre në trevat shqiptare por edhe rreth bizneseve të huaja.

~ Dhoma e Biznesit të Diasporës, e regjistruar me Vendimin Nr. 6378, datë 12.11.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka filluar funksionimin e saj administrativ si dhe ka organizuar aktivitetet e para.

~ Dhoma e Biznesit të Diasporës në bashkëpunim me Unionin e Sipërmarrësve të Rinj të Shqipërisë organizuan në datë 18 dhjetor 2019 aktivitetin “MendjeArtët 2020”, i cili kishte si qëllim motivimin dhe nxitjen e sipërmarrësve të rinj që prodhojnë produkte ose shërbime në Shqipëri dhe Diasporë. Në këtë aktivitet u dhanë 14 çmime për bizneset e reja. Pjesë e aktivitetit ishin Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, z. Eduart Shalsi dhe kryetari i Dhomës së Biznesit të Diasporës dhe anëtari i Këshillit Koordinues të Diasporës, z. Ardian Lekaj.

~ Në datë 4 dhjetor 2019, Ministri i Shtetit për Diasporën, z. Pandeli Majko, mori pjesë në Forumin e Biznesit “Shqipëria, porta e Ballkanit” në Holandë. Në këtë takim, ministri Majko u përqendrua tek situata e biznesit në Shqipëri dhe e vendeve perëndimore, të cilat kanë shërbyer si model për vendin tonë. Gjithashtu, ministri prezantoi edhe Dhomën e Biznesit të Diasporës, institucionin e ri që do të ofrojë mbështetje për investime në vendin tonë. Pjesë e takimit ishte dhe z. Ardian Lekaj, anëtar i Këshillit Koordinues të Diasporës dhe kryetar i Dhomës së Biznesit të Diasporës.

Janar - Mars 2020:

~ Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, me shkresën Nr. 1578 Prot., datë 30.01.2020 informon mbi aktivitetin e organizuar nga kompania “IBX” në Kanada, e cila drejtohet nga një pjesëtar i diasporës shqiptare atje dhe luan një rol të rëndësishëm në forcimin e bashkëpunimit ekonomik ndërmjet dy vendeve duke promovuar potencialet e Shqipërisë në sektorë të rëndësishëm të ekonomisë.

~ Me qëllim shpërndarjen e informacionit me karakter ekonomik për sektorin e biznesit në diasporë, Dhoma e Biznesit të Diasporës publikon çdo javë “Newsletter e Dhomës së Biznesit të Diasporës”, në gjuhën shqipe dhe angleze. Informacioni i pasqyruar lidhet me ekonominë, financat, sipërmarrjen, mundësitë për investime, ndryshimet ligjore, paketat fiskale dhe incentivuese, si dhe aktivitete të ndryshme brenda dhe jashtë vendit me fokus biznesin dhe investimet. Newsletter i Dhomës së Biznesit shpërndahet elektronikisht në një databasë prej rreth 1000 kontakte, përbërë nga biznese, shoqata biznesi në Diasporë, Dhoma Tregtie në Shqipëri e Diasporë, zyra ekonomike të Ambasadave të huaja në Shqipëri, etj.

Prill - Qershor 2020:

~ Me qëllim shpërndarjen e informacionit me karakter ekonomik për sektorin e biznesit në diasporë, Dhoma e Biznesit të Diasporës publikon çdo javë “Newsletter e Dhomës së Biznesit të Diasporës”, në gjuhën shqipe dhe angleze. Informacioni i pasqyruar lidhet me ekonominë, financat, sipërmarrjen, mundësitë për investime, ndryshimet ligjore, paketat fiskale dhe incentivuese, si dhe aktivitete të ndryshme brenda dhe jashtë vendit me fokus biznesin dhe investimet.

NË PROCES

| Masa Nr.49 |

Krijimi dhe përditësimi i një banke të dhënash të gazetave, faqeve të internetit, radiove dhe televizioneve të diasporës, që funksionojnë në vendet që gjykohen si prioritare për politikën kombëtare mbi diasporën. Krijimi i rrjeteve të televizioneve dhe radiove shqiptare në diasporë dhe realizimi i një plan veprimi për trajnimin e gazetarëve në diasporë me projekteve stimuluese dhe aktiviteteve vjetore për këtë qëllim.

INDIKATORËT: Banka e të dhënave të gazetave, faqeve të internetit, radiove dhe televizioneve të diasporës; Krijimi i rrjeteve të televizioneve dhe radiove shqiptare, trajnimi i gazetarëve në diasporë.

AFATI KOHOR: 6 muji i parë 2019 (periodike)

INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:

- Ministri i Shtetit për Diasporën
- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
- Radio Televizioni Shqiptar (RTSH)

Janar - Mars 2019:

~ Dërguar shkresa me nr. 468 Prot., datë 23.01.2019, Radio Televizionit Shqiptar për përcaktimin e përfaqësuesve në Grupin e Koordinatorëve për zbatimin e Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare të Diasporës.

~ Është hartuar projekti “Gazeta e Diasporës” nga institucionet përgjegjëse për Diasporën. Kjo gazetë ka si qëllim komunikimin me Diasporën online për fusha të ndryshme, sociale ekonomike, kulturore dhe arsimore. Ky projekt është prezantuar tek disa donatorë për financimin dhe implementimin e tij.

~ Është publikuar “Neësletter e Diasporës”, informacion i përjavshëm i cili pasqyron aktivitetet e Ministrisë së Shtetit për Diasporën dhe institucioneve përgjegjëse për diasporën shqiptare.

Prill - Qershor 2019:

- Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës është në proces komunikimi me zyrën e Bankës Botërore dhe Zyrën e Bashkëpunimit Ekonomik Zvicerian në Tiranë për realizimin e projektit “Gazeta e Diasporës”. Në proces përgatitje profilizimi i një projekti tjetër në ndihmë të gazetarëve dhe mediave në Diasporë.

Korrik - Shtator 2019:

~ Në proces realizimi i projektit “Gazeta e Diasporës”, i cili ka për qëllim të sigurojë informacione për komunitetet shqiptare në diasporë. Ky projekt synon të jetë një mënyrë alternative në informacionin rreth ngjarjeve dhe çështjeve sociale në vendin e origjinës. Projekti parashikohet të fillojë në fund të vitit 2019.

Tetor - Dhjetor 2019:

~ Në kuadër të projektit “Diaspora për Zhvillim”, është në proces finalizimi zhvillimi i platformave “Rrjeti i Profesionistëve” dhe “Dhoma e Biznesit - Si të Bësh Biznes në Shqipëri”, platforma në të cilën është parashikuar regjistrimi dhe ndërveprimi i profesionistëve dhe bizneseve në Diasporë. Këto platforma do të shërbejnë për mbledhjen e të dhënave dhe krijimin e bazës së tyre si dhe hartëzimit. Platforma e profesionistëve, e cila parashikon ndarjen e të dhënave sipas kategorive, nënkategorive, si edhe pozicionit gjeografik do t’u japë mundësinë e regjistrimit në mënyrë autonome profesionistëve, duke krijuar kështu një bazë të dhënash dinamike e gjithmonë në rritje.

~ Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës, në bashkëpunim me Ambasadën Zvicerane në Tiranë, do të realizojnë projektin “Gazeta e Diasporës”. Institucionet janë në proces të hartimit të marrëveshjes financiare.

Janar - Mars 2020:

~ Ka përfunduar procesi i ndërtimit dhe strukturimit të medias së parë online të dedikuar plotësisht Diasporës Shqiptare. Çdo shqiptar kudo që jeton tashmë do të ketë mundësinë të informohet nëpërmjet webgazetës www.diasporashqiptare.al. Nëpërmjet rubrikave të konceptuara për të mbuluar një audiencë të gjerë si Diaspora shqiptare, çdo lexues do të ketë mundësinë të informohet mbi aktualitetin, ekonominë, kulturën, sportin dhe çdo temë tjetër që lidhet me Diasporën dhe shqiptarët.

~ Krijuar Portali “Dhoma e Biznesit të Diasporës-Si të fillosh një biznes në Shqipëri”, i cili do të shërbejë si mekanizëm kryesor në krijimin dhe forcimin e rrjetit të bizneseve të Diasporës me ato vendase përmes dhënies së informacionit mbi legjislacionin, institucionet, njoftime, grante, dokumenta të ndryshme që ndihmojnë në krijimin apo transferimin e biznesit në Shqipëri, si dhe ofrimit të asistencës për bizneset e Diasporës në identifikimin e sektorëve me interes brenda vendit dhe iniciativat sipërmarrëse.

~ Në proces plotësimi i platformës “Rrjeti i Profesionistëve të Diasporës”, www.adpn.al, si një mjet i cili i shërben rritjes së kapaciteteve dhe rrjetëzimit të kapitalit shoqëror në Diasporë, si një vlerë e shtuar për zhvillimin ekonomik të vendit. Çdo qytetar i interesuar jashtë vendit mund të krijojë profilin personal në platformë dhe ka mundësinë të kërkojë profesionistë të tjerë në botë, të ndarë në kategori sipas fushës së veprimtarisë dhe vendndodhjes. “Rrjeti i Profesionistëve të Diasporës” do të ofrojë gjithashtu dhe informacion rreth procedurave të njohjes së titujve akademikë në Shqipëri, profesioneve të lira, si edhe aktiviteteve që angazhojnë profesionistë të fushave të ndryshme.

Prill - Qershor 2020:

~ Publikohet gazeta “Diaspora Shqiptare”, një projekt i financuar nga qeveria e

Konfederatës së Zvicrës në bashkëpunim me Fondin Shqiptar të Zhvillimit të Diasporës. Gazeta “Diaspora Shqiptare” ka si mision informimin e komuniteteve shqiptare në diasporë dhe synon të jetë një hapësirë e lajmit për sfidat e migrimit, përvojën dhe realizimet e shqiptarëve larg vendlindjes.

NË PROCES

|| Masa Nr.50 ||

Organizimi i rrjetit të informimit për median shqiptare dhe të huaj për të apeluar dhe sensibilizuar ndaj shkeljeve të të drejtave të migrantëve shqiptarë në strukturat përkatëse të vendeve pritëse si dhe në ato të organizatave ndërkombëtare.

INDIKATORËT: Rrjeti i informimit për të apeluar dhe sensibilizuar ndaj shkeljeve të të drejtave të migrantëve.

AFATI KOHOR: 6 muhori i parë i 2019 (periodike)

INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:

- Ministri i Shtetit për Diasporën
- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme

Janar - Mars 2019:

~ Miratuar Urdhri nr. 45/2019 i Kryeministrit "Për caktimin e koordinatorit shtetëror për informimin e diasporës". Koordinator shtetëror është caktuar z. Fatjon Hallkaj, Drejtor i Drejtorisë së Programimit dhe Zhvillimit pranë AKSHI-t.

~ Është hartuar Projekti “Gazeta e Diasporës” nga institucionet përgjegjëse për Diasporën. Kjo gazetë ka si qëllim komunikimin me Diasporën online për fusha të ndryshme, sociale ekonomike, kulturore dhe arsimore. Ky projekt është prezantuar tek disa donatorë për financimin dhe implementimin e tij.

~ Është publikuar “Newsletter e Diasporës”, informacion i përjavshëm i cili pasqyron aktivitetet e Ministrit të Shtetit për Diasporën dhe institucioneve përgjegjëse për diasporën shqiptare.

~ Miratuar Urdhri nr. 55/2019 i Kryeministrit “Për shfuqizimin e Urdhrave të Kryeministrit nr.135/2018, nr. 136/2018 dhe nr. 138/2018”.

Prill - Qershor 2019:

~ Koordinator Shtetëror për informimin e Diasporës, caktuar me Urdhrin nr. 45/2019 të Kryeministrit, ka raportuar në mbledhjen e Komitetit Shtetëror për Diasporën (3 maj) për krijimin e seksionit informativ “Diaspora”. Koordinator informon se deri tani është punuar për ngritjen e infrastrukturës dhe për hedhjen e disa prej të dhënave të ofruara nga pjesëmarrësit e Samitit të Dytë të Diasporës. Pjesë e detyrave në vijim është dhe krijimi i një databaze shtetërore për Diasporën që përmban të dhëna të ndryshme mbi anëtarët e Diasporës shqiptare si sipërmarrësit, mjekët, juristët, mësuesit, etj.

~ Në proces lançimi i aplikacionit “Diaspora Shqiptare”, i cili ofron informacion të plotë për gjithçka që ndodh me Diasporën shqiptare, përfshirë aktivitetet e komunitetit shqiptar në vendet pritëse. Aplikacioni “Diaspora Shqiptare” mund të shkarkohet online dhe menaxhohet nga Agjencia Kombëtare e Diasporës.

~ Në proces krijimi i rrjetit të gazetarëve të mediave që funksionojnë në Diasporën shqiptare në zbatim të masës nr. 50.

Korrik - Shtator 2019:

~ Në datë 20 korrik 2019 u lançua aplikacioni “Diaspora Shqiptare”, i cili synon të ofrojë informacion për komunitetet shqiptare në diasporë. Aplikacioni “Diaspora Shqiptare” do të jetë një platformë aktive për të gjithë veprimtarinë e Këshillit Koordinues të Diasporës, i cili përbëhet nga 15 përfaqësues të komunitetit shqiptar në botë. Aplikacioni shkarkohet falas në Play Store dhe App Store.

~ Agjencia Kombëtare e Diasporës ka përgatitur dhe publikuar Revistën Elektronike të Komitetit Shtetëror për Diasporën. Ky dokument është një përmbledhje e bazës ligjore dhe jetëshkrimeve të koordinatorëve shtetërorë.

Tetor - Dhjetor 2019:

~ Në datë 21 tetor 2019 u zhvillua takimi i grupit ndërinstitucional të punës për mbrojtjen e të drejtave të shqiptarëve që vuajnë heqjen e lirisë jashtë vendit, të drejtave të migrantëve nëpërmjet informimit mbi mundësitë e ndryshme për të apeluar ndaj shkeljeve të të drejtave të tyre, në strukturat e vendeve pritëse si dhe në ato ndërkombëtare. Në këtë takim grupi i punës u dakordësua për hartimin e broshurave informuese nga Ministria e Drejtësisë mbi të drejtat e migrantëve dhe për shtetasit shqiptarë që vuajnë dënimin me heqje lirie jashtë vendit.

Janar - Mars 2020:

~ Avokati i Popullit në bashkëpunim me Organizatën Ndërkombëtare të Migracionit (IOM) ka publikuar një manual me konventat dhe ligjet e ratifikuara për të drejtat e të burgosurve jashtë vendit. Ky manual shërben për të informuar migrantët të cilët vuajnë heqjen e lirisë jashtë vendit dhe gjendet i publikuar në faqen zyrtare të internetit të Ministrisë së Drejtësisë, në rubrikën “Diaspora”.

Prill - Qershor 2020:

~ Publikohet gazeta “Diaspora Shqiptare”, një projekt i financuar nga qeveria e Konfederatës së Zvicrës në bashkëpunim me Fondin Shqiptar të Zhvillimit të Diasporës.

NE PROCES

|| Masa Nr.51 ||

Vlerësimi i cilësisë së faqeve të internetit të institucioneve shtetërore për informacion të detajuar për komunitetet shqiptare jashtë vendit duke hapur edhe një seksion që i kushtohet kësaj teme (aty ku është e nevojshme). Realizimi i takimeve periodike (çdo 6 muaj) për vlerësimin dhe koordinimin me “kujdestarët” e faqeve të informacionit të institucioneve për nivelin e informimit që këto faqe ofrojnë për diasporën shqiptare.

INDIKATORËT: Cilësia e faqeve të internetit të institucioneve. Takime periodike me “kujdestarët” e faqeve të informacionit.

AFATI KOHOR: 6 mujori i dytë i 2018 (periodike)

INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:

- Ministri i Shtetit për Diasporën
- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
- Agjencia kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI)

Buletini 2018:

~ Miratuar Urdhri nr.136/2018, i Kryeministrit “Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për zbatimin e masës 51, të Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare për Diasporën”.

Janar - Mars 2019:

~ Miratuar Urdhri nr. 45/2019 i Kryeministrit “Për caktimin e koordinatorit shtetëror për informimin e diasporës”. Koordinator Shtetëror është caktuar z. Fatjon Hallkaj, Drejtor i Drejtorisë së Programimit dhe Zhvillimit pranë AKSHI-t.

~ Dërguar shkresa nr. 1125 Prot., datë 20.02.2019 institucioneve përkatëse për paraqitjen e informacioneve në faqet web në rubrikën “Diaspora”.

- i. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka hapur rubrikën “Diaspora”, me nënkategori: “Informacion” dhe “Mjekë për Shqipërinë”.
- ii. Ministria e Brendshme ka hapur rubrikën “Diaspora”, me nënkategori: “Samiti i II”, “Ministri i Shtetit për Diasporën”.
- iii. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë ka hapur rubrikën “Diaspora”, me nënkategori: “Seminare të përbashkëta Shqipëri-Kosovë”, “Spoti i përbashkët për sensibilizimin e mësimit të gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në Diasporë i realizuar në zbatim të Marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit të Republikës së Shqipërisë, Ministrisë së Diasporës së Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës, datë 23 mars 2015, “Për organizimin e përbashkët të mësimit të gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në diasporë dhe në mërgatë”, “Programi i integruar i mësimit shqip në Diasporë”, etj.
- iv. Akademia e Shkencave ka hapur rubrikën “Diaspora Shqiptare”, me nënkategori: “Objektivat”, “Veprimtari”, “Projekte”, “Kërkues shkencor”.

~ Ministri i Shtetit për Diasporën, me shkresën nr. 1576 Prot., datë 19.03.2019 i ka përcjellë Kryeministrit konkluzionet për zbatimin e Urdhrit nr. 136/2018 të Kryeministrit “Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për zbatimin e masës 51, të Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare për Diasporën”.

~ Miratuar Urdhri nr. 55/2019 i Kryeministrit “Për shfuqizimin e Urdhrave të Kryeministrit nr. 135/2018, nr. 136/2018 dhe nr. 138/2018”.

Prill - Qershor 2019:

~ Koordinatori Shtetëror për informimin e Diasporës, caktuar me Urdhrin nr. 45/2019, ka raportuar në mbledhjen e Komitetit Shtetëror për Diasporën (3 maj) për krijimin e seksionit informativ "Diaspora" dhe si përmendur si detyra në vijim krijimin e një databaze shtetërore për Diasporën që përmban të dhëna të ndryshme mbi anëtarët e Diasporës shqiptare sipas profesionit që ushtrojnë. Aktualisht është punuar për ngritjen e infrastrukturës dhe për hedhjen e të dhënave të ofruara nga pjesëmarrësit e Samitit të Dytë të Diasporës.

~ Dërguar shkresa nr. 300 Prot., datë 17.06.2019 nga Agjencia Kombëtare e Diasporës, Ministrit të Shtetit për Sipërmarrjen dhe Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve ku kërkohet informacion mbi projekte të karakterit platformë elektronike, të ngjashëm me "Connect Albania", (platformë e cila, pritet të krijohet nga IOM e financuar nga Zyra e Kooperacionit Italian, në bashkëpunim me institucionet e Diasporës), për shmangien e mbivendosjeve të mundshme.

~ Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve me shkresën me nr. 231/1 prot., datë 02.07.2019 informon lidhur me sistemin e informacionit E-Invest, e cila lidhet me zhvillimin e programit "Connect Albania" me synim nxitjen dhe angazhimin e Diasporës shqiptare në zhvillimin e investimeve të huaja. Në proces diskutimi që pranë saj të hapet një zë i posaçëm për Diasporën shqiptare.

~ Në proces lançimi i aplikacionit "Diaspora Shqiptare", i cili ofron informacion të plotë për gjithçka që ndodh me Diasporën shqiptare, përfshirë aktivitetet e komunitetit shqiptar në vendet pritëse. Aplikacioni "Diaspora Shqiptare" do të mund të shkarkohet online dhe menaxhohet nga Agjencia Kombëtare e Diasporës.

Korrik - Shtator 2019:

~ Në datë 20 korrik 2019 u lançua aplikacioni "Diaspora Shqiptare", i cili synon të ofrojë informacion për komunitetet shqiptare në diasporë. Aplikacioni "Diaspora Shqiptare" do të jetë një platformë aktive për të gjithë veprimtarinë e Këshillit Koordinues të Diasporës, i cili përbëhet nga 15 përfaqësues të komunitetit shqiptar në botë. Aplikacioni shkarkohet falas në Play Store dhe App Store.

~ Qendra e Botimeve për Diasporën ka publikuar dokumentin "Udhëzues për mësimdhënien në Diasporë 2019". Ky material është një dokument informues i ndryshimeve ligjore, akteve dhe shkresave me rëndësi në mbështetje të mësuesve dhe mësimdhënies në Diasporën shqiptare. Ai synon të paraqesë ecurinë e deritanishme të politikave shtetërore që ndikojnë drejtpërdrejt në përmirësimin e statusit të shkollave shqipe dhe të mësuesve në Diasporë. Ky udhëzues është një tregues i bashkëpunimit midis Shqipërisë dhe Kosovës për miratimin e teksteve të përbashkëta për Diasporën nga Komisioni i Përbashkët ndërshtetëror, në zbatim të Marrëveshjes së Përbashkët mes institucioneve përgjegjëse të dy vendeve.

~ Agjencia Kombëtare e Diasporës ka përgatitur dhe publikuar Revistën Elektronike të Komitetit Shtetëror për Diasporën. Ky dokument është një përmbledhje e bazës ligjore dhe jetëshkrimeve të koordinatorëve shtetërorë.

~ Agjencia Kombëtare e Diasporës është në proces të përgatitjes së një botimi të posaçëm me legjislacionin dhe aktet nënligjore "Politika Shtetërore për Diasporën 2019". Ky botim do të realizohet në dhjetor 2019.

Tetor - Dhjetor 2019:

~ Dërguar shkresa Nr. 5454 Prot., datë 04.11.2019 Koordinatorit Shtetëror për informimin e diasporës z. Fatjon Hallkaj për zbatimin e masës Nr. 51 të Planit të Veprimit me qëllim plotësimin me informacion të rubrikës “Diaspora” në faqet e institucioneve të mëposhtme :

- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
- Ministria e Drejtësisë
- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë
- Ministria e Turizimit dhe Mjedisit
- Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes

~ Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), me shkresën Nr. 6878/1 Prot., datë 15.11.2019 informon se përgjegjësia për plotësimin me informacion të rubrikës “Diaspora” është e secilit prej institucioneve.

~ Këshilli Koordinues i Diasporës ka faqen zyrtare <http://keshilli.koordinues.diaspora.gov.al/>, ku reflektohet veprimtaria e anëtarëve të Këshillit Koordinues të Diasporës, baza ligjore me të cilën ata funksionojnë si dhe lajmet më të fundit rreth aktiviteteve në diasporës.

~ Në kuadër të projektit “Diaspora për Zhvillim”, është në proces finalizimi zhvillimi i platformave “Rrjeti i Profesionistëve” dhe “Dhoma e Biznesit - Si të Bësh Biznes në Shqipëri”, platforma në të cilën është parashikuar regjistrimi dhe ndërveprimi i profesionistëve dhe bizneseve në Diasporë.

Janar - Mars 2020:

~ Miratuar Urdhri Nr. 36, datë 10.02.2020 i Kryeministrit “Për një ndryshim në Urdhrin Nr. 45, datë 12.02.2019 të Kryeministrit, “Për caktimin e Koordinatorit Shtetëror për informimin e diasporës” dhe Koordinatore Shtetërore është caktuar znj. Jona Hoxha, Drejtore e Drejtorisë së Sistemeve e-Gov pranë Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI).

~ Në zbatim të masës Nr. 51 të Planit të Veprimit, në rubrikën “Diaspora” janë përditësuar informacionet në faqet e institucioneve të mëposhtme:

- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
- Ministria e Drejtësisë
- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
- Ministria e Turizimit dhe Mjedisit
- Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes
- Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

- Ministria e Brendshme
- Ministria e Kulturës

Prill - Qershor 2020:

~ Koordinatorja shtetërore për informimin e Diasporës, znj. Jona Hoxha, drejtore pranë institucionit të AKSHI, koordinon punën me "kujdestarët" e faqeve zyrtare të institucioneve shtetërore të cilët janë të përfshirë në Planin e Veprimit të Strategjisë Kombëtare për Diasporën.

NË PROCES

|| Masa Nr.52 ||

Planifikimi dhe realizimi i një fushate informuese mbi:

- Çështje që kanë të bëjnë me migracionin dhe diasporën
- Promovimin në shkallë të gjerë të regjistrimit të migrantëve dhe informimi për të drejtën e votës (pas miratimit);
- Identitetin e shqiptarëve, historinë dhe kulturën shqiptare në diasporë
- Ekzistencën e burimeve informative për çështje që interesojnë migracionin dhe diasporën dhe trajtimet rreth zhvillimeve më të fundit politike, sociale dhe ekonomike në vend; Reflektimi në këtë fushatë të procesit që diaspora dhe migracioni do të jenë pjesë integrale të zhvillimeve politike dhe ekonomike të Shqipërisë.

INDIKATORËT: Çështje për migracionin dhe diasporën; regjistrimi i migrantëve dhe informimi për të drejtën e votës; Ekzistencën e burimeve informative;

AFATI KOHOR: 6 maji i parë i 2020

INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:

- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
- Ministria e Brendshme
- Ministri i Shtetit për Diasporën
- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Janar - Mars 2020:

~ Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme ka informuar rregullisht përmes komunikimit shkresor dhe me email mbi aktivitetet e organizuara nga përfaqësitë diplomatike dhe konsullore jashtë vendit, me qëllim informimin dhe përfshirjen e diasporës në jetën politike, ekonomike dhe sociale të vendit të origjinës.

~ Institucionet përgjegjëse për diasporën, me qëllim informimin e diasporës mbi zhvillimet politike, sociale dhe ekonomike në vend, kanë disa burime informative si: Newsletter, aplikacionin "Diaspora shqiptare", Newsletter e Dhomës së Biznesit, Gazetën "Diaspora Shqiptare", website-et si dhe rrjetet sociale me qëllim adresimin e një target grupi sa më të gjerë në varësi të formimit të tyre profesional dhe grupmoshave, duke siguruar një rrjet të plotë burimesh informative.

Prill - Qershor 2020:

~ Eshtë në proces koordinimi i një projekti, i cili do të koordinojë informimin e Diasporës mbi zhvillimet politike, sociale dhe ekonomike në vend, me disa burime informative në varësi të formimit të tyre profesional dhe grupmohave, duke siguruar një rrjet të plotë burimesh informative.

NË PROCES

| Masa Nr.53 |

Rishikimi dhe vlerësimi i zonës së transmetimit nga televizionet dhe radiot shqiptare kombëtare në të gjitha vendet ku ka komunitete të diasporës dhe migrantësh shqiptarë. Krijimi dhe nxitja e programeve televizive në vend për temën e diasporës dhe protagonizmin e saj në shoqërinë shqiptare. Realizimi dhe strukturimi i një kanali televizionit publik (dhe radios) për temën e diasporës. Nxitja për marrëveshje me mediat në vendet pritëse, me qëllim transmetimin prej tyre të programeve për komunitetet shqiptare.

INDIKATORËT: Zonat e transmetimit nga televizionet dhe radiot shqiptare; Programet televizive për diasporën; Kanali televizionit publik (dhe radios) për diasporën; Marrëveshje me mediat në vendet pritëse.

AFATI KOHOR: 6 mujori i parë 2019

INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:

- Ministri i Shtetit për Diasporën
- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
- Radio Televizioni Shqiptar (RTSH)

Janar - Mars 2019:

~ Dërguar shkresa me nr.468 Prot., datë 23.01.2019, Radio Televizionit Shqiptar për përcaktimin e përfaqësuesve në Grupin e Koordinatorëve për zbatimin e Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare të Diasporës.

~ Miratuar Urdhri nr.180/2018, i Kryeministrit “Për përgatitjen e platformës së programeve të emisioneve të posaçme për mësimin e gjuhës shqipe, kulturën shqiptare dhe identitetin kombëtar, të dedikuara për Diasporën”. Në zbatim të këtij Urdhri, grupi i punës është duke përgatitur dy projekte “Fol Shqip” dhe “Krenohem me Ju”.

Prill - Qershor 2019:

~ Dërguar shkresa nr. 228 Prot., datë 20.05.2019 Radiotelevizionit Shqiptar, Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Ministrisë së Kulturës, ku kërkohet informacion mbi lidhjen e marrëveshjeve të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve në zbatim të Vendimit nr. 690/2018 të Këshillit të Ministrave “Për prodhimin, transmetimin dhe financimin e emisioneve të posaçme televizive, arsimore dhe kulturore, të dedikuara për diasporën.”

~ Ministria e Kulturës, me shkresën nr. 3292/1 Prot., kërkon miratimin e platformës së

programeve të posaçme televizive, arsimore dhe kulturore të dedikuara për Diasporën, për të vijuar bashkëpunimin me Radiotelevizionin Shqiptar dhe lidhjen e marrëveshjes mes institucioneve sipas Vendimit nr. 690/2018 të Këshillit të Ministrave “Për prodhimin, transmetimin dhe financimin e emisioneve të posaçme televizive, arsimore dhe kulturore, të dedikuara për diasporën.”

~ Agjencia Kombëtare e Diasporës, me shkresën nr.228/4 Prot., datë 05.06.2019 drejtuar Ministrisë së Kulturës thekson se platforma e emisioneve të posaçme televizive për Diasporën përgatitet nga grupi ndërinstytucional i punës, i ngritur me Urdhrin nr. 180/2018 të Kryeministrit.

~ Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, me shkresën nr. 5450/1 Prot., datë 31.05.2019, informon se nuk ka ende një marrëveshje mes këtij institucioni dhe Radiotelevizionit Shqiptar.

~ Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës është në proces diskutimi për një projekt të veçantë me donatorët për zbatimin e masës nr. 53, në funksion të ngritjes dhe zhvillimit të platformave mediatike të komunikimit dhe programeve televizive, në funksion dhe ndihmë të komuniteteve të Diasporës.

Korrik - Shtator 2019:

~ Në proces konkluzionet e grupit të punës të krijuar me Urdhrin nr.180/2018, i Kryeministrit “Për përgatitjen e platformës së programeve të emisioneve të posaçme për mësimin e gjuhës shqipe, kulturën shqiptare dhe identitetin kombëtar, të dedikuara për Diasporën”.

~ Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës është në proces finalizimi të marrëveshjes me donatorët për realizimin e projektit “Gazeta e Diasporës”. Kjo gazetë ka si qëllim komunikimin me Diasporën online për fusha të ndryshme, sociale ekonomike, kulturore dhe arsimore.

Tetor - Dhjetor 2019:

~ Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës, në bashkëpunim me Ambasadën Zvicerane në Tiranë, do të realizojnë projektin “Gazeta e Diasporës”. Institucionet janë në proces të hartimit të marrëveshjes financiare.

~ Radiotelevizioni Shqiptar, me shkresën Nr. 2987 Prot., datë 22.10.2019, ka konfirmuar miratimin e projekteve “Fol Shqip” dhe “Krenohem me Ju”, si dhe të kostove përkatëse të projekteve.

~ Radiotelevizioni Shqiptar me shkresën Nr. 2987 Prot., datë 22.10.2019 ka përcjellë projektet me titull “Fol Shqip” dhe “Krenohem me Ju” si edhe kostot financiare përkatëse.

Janar - Mars 2020:

~ Agjencia Kombëtare e Diasporës ka përcjellë pranë Grupit Ndërinstytucional të Punës, të ngritur me Urdhrin Nr. 180/2018 të Kryeministrit “Për ngritjen e Grupit Ndërinstytucional të Punës për përgatitjen e platformës së emisioneve të posaçme për mësimin e gjuhës shqipe, kulturën shqiptare dhe identitetin kombëtar, të dedikuara për

diasporën", projektet "Fol shqip" dhe "Krenohem me ju", me qëllim dakordësimin dhe miratimin e tyre nga grupi i punës dhe vijimin e realizimit të tyre.

Prill - Qershor 2020:

- Nuk ka informacion të ri për zbatimin e kësaj mase.

NË PROCES

| Masa Nr.54 |

Krijimi i projekteve mediatike që nxisin krijimin e rrjeteve informuese për studentët dhe koordinimin e institucioneve përgjegjëse për arsimin për promovimin e rritjes së programeve të shkëmbimit dhe internship-it, të universiteteve shqiptare me Universitetet në vendet pritëse me prani të lartë të studentëve shqiptarë.

INDIKATORËT: Krijimi i projekteve mediatike, promovimi i programeve të shkëmbimit dhe internship-it.

AFATI KOHOR: 6 mujori i parë 2019 (periodike)

INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:

- Ministri i Shtetit për Diasporën
- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
- Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
- Radio Televizioni Shqiptar (RTSH)
- Akademia e Shkencave

Janar - Mars 2019:

- Dërguar shkresa me nr. 468 datë 23.01.2019, Radio Televizionit Shqiptar për përcaktimin e përfaqësuesve në Grupin e Koordinatorëve për zbatimin e Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare të Diasporës.

- Miratuar Urdhri nr. 180/2018, i Kryeministrit "Për përgatitjen e platformës së programeve të emisioneve të posaçme për mësimin e gjuhës shqipe, kulturën shqiptare dhe identitetin kombëtar, të dedikuara për Diasporën". Në zbatim të këtij Urdhri, grupi i punës është duke përgatitur dy projekte "Fol Shqip" dhe "Krenohem me Ju".

- Është hartuar Projekti "Gazeta e Diasporës" nga institucionet përgjegjëse për Diasporën. Kjo gazetë ka si qëllim komunikimin me Diasporën online për fusha të ndryshme, sociale ekonomike, kulturore dhe arsimore. Ky projekt është prezantuar tek disa donatorë për financimin dhe implementimin e tij.

- Është publikuar "Neësletter e Diasporës", informacion i përjavshëm i cili pasqyron aktivitetet e Ministrit të Shtetit për Diasporën dhe institucioneve përgjegjëse për diasporën shqiptare.

Prill - Qershor 2019:

~ Në proces miratimi i marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës dhe Universitetit për Biznes dhe Teknologji (UBT) në Kosovë “Për bashkëpunim në fushën e kërkimit, mësimdhënies, zhvillimit teknologjik dhe inovacionit”.

~ Në proces lançimi i aplikacionit “Diaspora Shqiptare”, i cili ofron informacion të plotë për gjithçka që ndodh me Diasporën shqiptare, përfshirë aktivitetet e komunitetit shqiptar në vendet pritëse. Aplikacioni “Diaspora Shqiptare” mund të shkarkohet online dhe menaxhohet nga Agjencia Kombëtare e Diasporës.

~ Ministri i Shtetit për Diasporën, me shkresën nr. 3455 Prot., datë 28.06.2019 ka kërkuar Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë hapjen e një sektori të posaçëm për Diasporën në këtë institucion.

Korrik - Shtator 2019:

~ Në datë 20 korrik 2019 u lançua aplikacioni “Diaspora Shqiptare”, i cili synon të ofrojë informacion për komunitetet shqiptare në diasporë. Aplikacioni “Diaspora Shqiptare” do të jetë një platformë aktive për të gjithë veprimtarinë e Këshillit Koordinues të Diasporës, i cili përbëhet nga 15 përfaqësues të komunitetit shqiptar në botë. Aplikacioni shkarkohet falas në Play Store dhe App Store.

~ Nënshkruar marrëveshja ndërmjet Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës dhe Universitetit për Biznes dhe Teknologji në Kosovë “Për bashkëpunim në fushën e kërkimit, mësimdhënies, zhvillimit teknologjik dhe inovacionit” në datën 22 Korrik 2019 në Prishtinë. Sipas kësaj marrëveshje palët do të bashkëpunojnë për organizimin e aktiviteteve kërkimore, zhvillimore dhe inovative. Gjithashtu, bashkëpunimi do të shtrihet më tej edhe në fushat e arsimit, kulturës dhe trajnimeve të avancuara.

Tetor - Dhjetor 2019:

~ Aplikacioni “Diaspora Shqiptare” përditësohet në vazhdimësi duke ofruar një informacion të gjerë mbi aktivitetet e komunitetit shqiptar në çdo vend e mbi të gjitha shërben si pikë referimi për të gjithë shqiptarët kudo janë.

~ Në kuadër të projektit “Diaspora për Zhvillim”, është në proces finalizimi zhvillimi i platformave “Rrjeti i Profesionistëve” dhe “Dhoma e Biznesit - Si të Bësh Biznes në Shqipëri”, platforma në të cilën është parashikuar regjistrimi dhe ndërveprimi i profesionistëve dhe bizneseve në Diasporë. Këto platforma do të shërbejnë për mbledhjen e të dhënave dhe krijimin e bazës së tyre si dhe hartëzimit. Platforma e profesionistëve, e cila parashikon ndarjen e të dhënave sipas kategorive, nënkategorive, si edhe pozicionit gjeografik do t’u japë mundësinë e regjistrimit në mënyrë autonome profesionistëve, duke krijuar kështu një bazë të dhënash dinamike e gjithmonë në rritje.

~ Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës ka përgatitur projektin “Diaspora e-student”, i cili synon krijimin e një platforme të dedikuar për studentët shqiptarë në Diasporë. Kjo platformë synon të jetë një plotësim ndaj platformës së profesionistëve në projektin “Diaspora për Zhvillim”, e cila do të shërbejë si një mjet komunikimi, informimi dhe ndërlidhjeje me tregun e punës.

Janar - Mars 2020:

~ Për këtë masë nuk ka informacione të reja për këtë periudhë.

Prill - Qershor 2020:

~ Nuk ka informacion të ri për këtë masë.

NË PROCES

| Masa Nr.55 |

Organizimi i një plan veprimi mediatik për nxitjen, tërheqjen dhe motivimin e diasporës shqiptare për të siguruar eksplorimin e gjithë potencialit të saj dhe shfrytëzimin e të gjithë avantazheve në Shqipëri për qëllime turizmi dhe investimi. Përgatitja nga institucionet përgjegjëse të Turizmit e një fushate promovionale, për të tërhequr vëmendjen e atij segmenti të diasporës që është në kërkim të rrënjëve, kulturës dhe traditave të paraardhësve. Në bashkëpunim me sektorin privat të përgatitet një paketë që siguron pritshmëritë e mësipërme dhe në raste të veçanta siguron prezantimin e bazave të gjuhës shqipe. Si ikona të kësaj fushate mund të përfshihen figurat të njohura të diasporës në secilin treg.

INDIKATORËT: Plan veprimi mediatik; Përgatitja e një fushate promovionale; Përgatitja e një paketë që siguron pritshmëritë e mësipërme dhe në raste të veçanta siguron prezantimin e bazave të gjuhës shqipe.

AFATI KOHOR: 6 muhori i dytë 2019 (periodike)

INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:

- Ministri i Shtetit për Diasporën
- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
- Ministria e Kulturës
- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
- Radio-Televizioni Shqiptar (RTSH)

Prill - Qershor 2019:

~ Dërguar shkresa nr. 3049 prot., datë 6.06.2019 institucioneve përkatëse për zbatimin e masës.

~ Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, me shkresën nr. 9407 Prot., datë 25.06.2019 i kërkon Radiotelevizionit Shqiptar informacion rreth parashikimeve që ky institucion ka bërë për organizimin e plan veprimit mediatik për nxitjen, tërheqjen dhe motivimin e diasporës shqiptare.

Korrik - Shtator 2019:

~ Agjencia Kombëtare e Turizimit, me shkresën nr. 434/1 Prot., datë 31.07.2019 informon se në plan veprimin përfshihet realizimi i një fushate promovionale me qëllim nxitjen, tërheqjen dhe motivimin e komuniteteve shqiptare jashtë vendit për të eksploruar dhe shfrytëzuar maksimalisht të gjitha avantazhet që ofron Shqipëria. Gjithashtu, ka përcaktuar personin e kontaktit znj. Arjola Merpeza për zbatimin e kësaj

mase.

~ Në faqen zyrtare të Qendrës së Botimeve për Diasporën është krijuar nënndarja “Botime - Tekste shkollore”, në të cilën janë hedhur 19 fletore tematike të botuara falë projektit për mësimin plotësues të gjuhës së prejardhjes (MGJP), i realizuar nga Shkolla e Lartë Pedagogjike e Cyrihut (PH Zürich, IPE).

~ Në faqen zyrtare të Qendrës së Botimeve për Diasporën është krijuar nënndarja “Portali digjital - e-book”, në të cilën janë hedhur librash digjitalë, mundësuar nga Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë dhe Biblioteka Publike “Marin Barleti” Shkodër.

~ Në faqen zyrtare të Qendrës së Botimeve për Diasporën është krijuar nënndarja “Portali digjital - audiobook”, në të cilën janë hedhur libra audio, mundësuar nga kompania e sigurimeve “Sigal”.

~ Në faqen zyrtare të Qendrës së Botimeve për Diasporën është krijuar nënndarja “Portali digjital - e-learning”, ku prezantohet programi shkollor *online* “School Me”, qëllimi i të cilit është të mbështesë arsimimin e nxënësve shqipfolës të shkollave 9-vjeçare në trojet shqiptare dhe në Diasporë.

~ Institucionet përgjegjëse për zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Diasporës duhet të përditësojnë në mënyrë të vazhdueshme në faqet e tyre online (rubrika Diaspora) informacione lidhur me Diasporën shqiptare. Institucionet e mëposhtme duhet të përditësojnë informacionin:

- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
- Ministria e Drejtësisë
- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
- Ministria e Infrastrukturës
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë
- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
- Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes

Tetor - Dhjetor 2019:

~ Qendra e Botimeve për Diasporën, në bashkëpunim me Organizatën “CHWB - Shqipëri” (Trashëgimia kulturore pa kufij), po punon për hartimin e një pakete prezantuese për promovimin e trashëgimisë kulturore të qyteteve shqiptare me qëllim informimin e nxënësve të shkollave shqipe në Diasporë për kulturën dhe traditën e paraardhësve.

~ Në proces organizimi përgatitja e Newsletter për Dhomën e Biznesit të Diasporës, në të cilën do të publikohen informacione të ndryshme rreth të bërit biznes në Shqipëri, fushave prioritare, promovime të historive të suksesit lidhur me sipërmarrjen dhe investimet, etj.

Janar - Mars 2020:

~ Qendra e Botimeve për Diasporën ka hartuar një paketë prezantuese për ruajtjen dhe përhapjen e gjuhës shqipe nën drejtimin e anëtares së Këshillit Koordinues të Diasporës, studiueses dhe mësimdhënëses së gjuhës shqipe në Kanada, znj. Adriana Fishta - Bejko.

- Qendra e Botimeve për Diasporën ka hartuar një paketë prezantuese në formatin e intervistave me 30 shkrimtarë shqiptarë në diasporë, pjesëmarrës dhe në Takimin e Shkrimtarëve të Diasporës më datë 22 shkurt 2020.

- Krijuar Portali “Dhoma e Biznesit të Diasporës - Si të fillosh një biznes në Shqipëri”, i cili do të shërbejë si mekanizëm kryesor në krijimin dhe forcimin e rrjetit të bizneseve të Diasporës me ato vendase përmes dhënies së informacionit mbi legjislacionin, institucionet, njoftime, grante, dokumenta të ndryshme që ndihmojnë në krijimin apo transferimin e biznesit në Shqipëri, si dhe ofrimit të asistencës për bizneset e Diasporës në identifikimin e sektorëve me interes brenda vendit dhe iniciativat sipërmarrëse.

- Përgatitur itinerari dhe programi i Shkollës Verore 2020 në bashkëpunim me znj. Lorena Haxhiu, Koordinatore Shtetërore për realizimin e programit “Jam Shqiptar” të gjuhës dhe kulturës shqipe për të tërhequr vëmendjen e atij segmenti të diasporës që është në kërkim të rrënjëve, kulturës dhe traditave të paraardhësve.

Prill - Qershor 2020:

- Qendra e Botimeve për Diasporën, në zbatim të Vendimit Nr. 8, datë 07.11.2019 të Këshillit Koordinues të Diasporës, siguroi akses falas në platformën digjitale “Schoolme” për 300 mësues të gjuhës shqipe në Diasporë. Kjo platformë do të ndihmojë për promovimin dhe përhapjen e gjuhës shqipe në Diasporë.

- Qendra e Botimeve për Diasporën, për shkak të situatës së krijuar në shkollat shqipe në Diasporë si pasojë e pandemisë globale, ka zhvilluar disa takime online me përfaqësues të shkollave shqipe, me qëllim marrjen e informacioneve dhe gjetjen e zgjidhjeve për problematikat e ngritura. QBD-ja ka organizuar gjithsej 7 takime online me përfaqësues të mësimdhënies së gjuhës shqipe nga shtete, si: Italia, Greqia, Gjermania, Zvicra, Anglia, SHBA-ja, Kanadaja, Spanja dhe Turqia. Në këto mbledhje u diskutua për problematikat e ndryshme lidhur me mësimin e gjuhës shqipe në kushtet e situatës së re të krijuar prej Covid-19, rëndësinë dhe mënyrën e përdorimit të Platformës digjitale për mësimin e gjuhës shqipe dhe pajisjen me tekste mësimore për vitin shkollor 2020-2021.

NË PROCES

Masa Nr.56

Përfshirja e komunitetit të shqiptarëve të diasporës në jetën kulturore të vendit pritës dhe në Shqipëri me qëllim promovimin e tyre (nënshkrimi dhe/ose amendimi i marrëveshjeve dypalëshe me shtetet pritëse të diasporës duke përfshirë edhe interesat e këtyre të fundit në to) dhe nxitja e krijimit i aktiviteteve vjetore për këtë qëllim.

INDIKATORËT: Komunitetet shqiptare të diasporës në jetën kulturore të vendit pritës, me qëllim promovimin e tyre në Shqipëri.

AFATI KOHOR: 6 mujori i dytë 2018

INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:

- Ministria e Kulturës

- **Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme**
- **Ministri i Shtetit për Diasporën**

Buletini 2018:

~ Dërguar shkresa nr. 4014 Prot., datë 03.09.2018 Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Ministrisë së Kulturës “Për zbatimin e masës 56, të Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare për Diasporën 2018-2024”.

~ Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 4014/1 Prot., datë 3.10.2018, ku ka përcjellë aktivitetet e zhvilluara nga përfaqësitë diplomatike dhe konsullore me Diasporën shqiptare për vitin 2018, të cilat janë bërë pjesë të programit vjetor për vitin 2019.

~ Dërguar shkresa nr. 4362 Prot., datë 25.09.2018, ku është kërkuar konsultim me Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, për numrin e qendrave kulturore të cilat do të hapen në Diasporë si dhe masat që kanë ndërmarrë për financimin e tyre.

~ Ministria e Kulturës është në proces hartimi dhe nënshkrimi i marrëveshjeve në fushën e kulturës me Italinë dhe Greqinë, ku do të trajtohet mundësia e një klauzole të veçantë për zhvillimin e ditëve dhe javës së kulturës shqiptare.

Janar - Mars 2019:

~ Publikuar dokumenti i Programit Vjetor i Aktiviteteve për Diasporën. Në vijim përgatitja e informacioneve vlerësuese për Programin Vjetor për Komitetin Shtetëror të Diasporës dhe Nënkomisionin Parlamentar për Diasporën dhe Migracionin me qëllim fillimin e punës për organizimin e Programit Vjetor të aktiviteteve të vitit 2020.

~ Miratuar Urdhri nr.44/2019 i Kryeministrit "Për caktimin e koordinatorit shtetëror për organizimin e programit vjetor të aktiviteteve. Koordinatore Shtetërore është caktuar Znj. Ornela Çuçi, zëvendësministre e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit.

Prill - Qershor 2019:

~ Ministri i Shtetit për Diasporën, me shkresën nr. 3021 Prot., datë 05.06.2019, i ka përcjellë për mendim Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit Memorandumin e Bashkëpunimit "Për programin e shkollës verore". Memorandumi synon nxitjen e organizimit të veprimtarive kulturore, gjuhësore dhe turistike për formimin kulturor dhe gjuhësor të fëmijëve shqiptarë në Diasporë.

~ Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, me shkresën nr. 6363 Prot., datë 30.04.2019 informon lidhur me takimin e zhvilluar me përfaqësues të komunitetit shqiptar në Zarë, Kroaci. Në këtë takim u diskutua mbi hapjen e klasave të mësimi të gjuhës shqipe në dy shkolla publike të qytetit si dhe problematikat dhe nevojat e tyre. Gjithashtu, u theksua nevoja për bashkëpunim mes përfaqësuesve të komunitetit shqiptar të Zarës dhe Ambasadës së Republikës së Shqipërisë në Zagreb.

~ Dërguar shkresa nr. 228 Prot., datë 20.05.2019 Radiotelevizionit Shqiptar, Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Ministrisë së Kulturës, ku kërkohet informacion mbi

lidhjen e marrëveshjeve të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve në zbatim të Vendimit nr. 690/2018 të Këshillit të Ministrave “Për prodhimin, transmetimin dhe financimin e emisioneve të posaçme televizive, arsimore dhe kulturore, të dedikuara për diasporën.”

~ Ministria e Kulturës, me shkresën nr. 3292/1 Prot., kërkon miratimin e platformës së programeve të posaçme televizive, arsimore dhe kulturore të dedikuara për Diasporën, për të vijuar bashkëpunimin me Radiotelevizionin Shqiptar dhe lidhjen e marrëveshjes mes institucioneve sipas Vendimit nr. 690/2018 të Këshillit të Ministrave “Për prodhimin, transmetimin dhe financimin e emisioneve të posaçme televizive, arsimore dhe kulturore, të dedikuara për diasporën.”

Korrik - Shtator 2019:

~ Agjencia Kombëtare e Diasporës në bashkëpunim me Teatrin Kombëtar të Operas dhe Baletit po realizojnë programin e mësimit të këngëve dhe valleve shqiptare për komunitetet shqiptare në Ukrainë. Aktivitetet e organizuara vijojnë si më poshtë:

- 1 - 15 korrik 2019 grupi i parë i valltarëve zhvilloi klasat e mësimit të valleve për komunitetin shqiptar në Karakurt.
- 10 - 13 shtator 2019 Agjencia Kombëtare e Diasporës zhvilloi vizitë pune në Zhaporozhy, ku u informuan për projektet e realizuara dhe mbështetjen e komunitetit shqiptar nëpër botë si edhe për programin për shqiptarët e Ukrainës që do t’iu ofrojë kurse për mësimin e gjuhës shqipe dhe folklorit shqiptar.
- 10 - 13 shtator 2019 në Ukrainë, Konsulli i nderit të Shqipërisë, z. Shahin Omanov firmosi memorandumin e bashkëpunimit me Institucionin edukativo-arsimor “Azimuth” në Priazov. Ky memorandum synon bashkëpunimin ndërinstitutional dhe edukimin e brezave të rinj për gjuhën, historinë dhe traditat shqiptare përmes organizimit të aktiviteteve të ndryshme në Ukrainë. Një ndër prioritetet është hapja e klasave për mësimin plotësues të gjuhës dhe kulturës shqipe për fëmijët e komunitetit shqiptar në këtë rajon. Gjithashtu memorandumit parashikon shkëmbimin arsimor të stafit pedagogjik me qëllim që mësuesit nga Ukraina të kryejnë studime të specializuara për gjuhën, literaturën dhe historinë shqiptare në Universitetin e Tiranës. Agjencia Kombëtare e Diasporës ka shprehur angazhimin e saj për të mbështetur këtë bashkëpunim.
- 31 tetor 2019 Agjencia Kombëtare e Diasporës, në bashkëpunim me Teatrin Kombëtar të Operas dhe Baletit, do të organizojë një koncert në Odessa me pjesëmarrjen e valltarëve dhe instrumentistëve të Ansambllit Popullor dhe komunitetin shqiptar.

~ Në datat 17 - 20 korrik 2019, Agjencia Kombëtare e Diasporës zhvilloi një vizitë në komunitetin shqiptar në Bullgari ku u bisedua për projektet e përbashkëta që mund të realizohen lidhur me promovimin e turizmit dhe të vlerave kulturore të shqiptarëve në fshatin Mandricë, ku jeton komuniteti shqiptar prej vitit 1636.

~ Në datat 28-31 gusht 2019 përfaqësues nga Agjencia Kombëtare e Diasporës zhvilluan një takim pune në Kroaci me përfaqësuesit e shtetit kroat për Diasporën. Qëllimi i këtij takimi ishte diskutimi për bashkëpunim institucional për çështjet e Diasporës dhe mbështetjen e komunitetit shqiptar në Kroaci, në veçanti Arbëreshëve të Zarës, të cilët

përbëjnë një pjesë të rëndësishme të trashëgimisë kulturore. Me Vendimin Nr. 3, datë 26.08.2019, Këshilli Drejtues i Agjencisë Kombëtare të Diasporës ka miratuar aktivitetet dhe buxhetin lidhur me mësimin e gjuhës shqipe, valleve dhe këngëve popullore, si dhe organizimin e një koncerti përmbyllës në Kroaci.

- Miratuar Urdhri nr.112, datë 30.08.2019 i Kryeministrit “Për caktimin e koordinatorit shtetëror për realizimin e programit “Jam shqiptar” të gjuhës dhe kulturës shqipe”. Koordinatorë është caktuar znj. Lorena Haxhiu, zëvendësministre në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

- Në datë 5 shtator 2019 Agjencia Kombëtare e Diasporës, me mbështetjen e Ministrit të Shtetit për Diasporën, organizoi koncertin “Nëna Arbëri”, me rastin e tre vjetorit të shenjtërimit të Nënë Terezës, në sheshin “Vittorio Emanuele”, Piana degli Albanesi, Itali. Në këtë koncert performuan para publikut tre virtuozët e muzikës shqiptare, soprano Inva Mula, violonçelisti Olen Cezari, Genc Tukiçi dhe artistë të tjerë italianë.

- Nënshkruar Memorandum Bashkëpunimi “Për programin “Jam shqiptar” të gjuhës dhe kulturës shqipe ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, Ministrisë së Kulturës dhe Ministrit të Shtetit për Diasporën. Ky program ka si qëllim organizimin e veprimtarive kulturore, gjuhësore e turistike, njohjen e historisë së Shqipërisë dhe të vendeve të saj turistike për formimin kulturor e gjuhësor të brezave të rinj në Diasporën shqiptare.

- Ministria e Kulturës, nëpërmjet komunikimit elektronik ka përcjellë listën e marrëveshjeve të nënshkuara dhe atyre në proces me vendet e tjera në fushën e kulturës.

- Agjencia Kombëtare e Diasporës do të organizojë në Otranto në datën 19 tetor 2019 një takim të përbashkët me arbëreshët në Itali ku do të diskutohen elementet kulturore, antropologjike, historike dhe folkloristike që bashkojnë veçoritë mes Italisë dhe Shqipërisë ndër shekuj. Ky aktivitet synon të sjellë në një dritë të veçantë kostumet tipike popullore e në veçanti “Fustanellën” dhe vallet e zonave ku banojnë arbëreshët. Në mbyllje të takimit të përbashkët, Agjencia Kombëtare e Diasporës, në bashkëpunim me Teatrin Kombëtar të Operas dhe Baletit dhe Ansamblin Popullor do të organizojë një koncert ku do të performojë trupa e Ansamblit Popullor.

Tetor - Dhjetor 2019:

- Në datën 19 tetor 2019, Agjencia Kombëtare e Diasporës organizoi një takim të përbashkët me arbëreshët në Itali ku u diskutuan elementet kulturore, antropologjike, historike dhe folkloristike që bashkojnë veçoritë mes Italisë dhe Shqipërisë ndër shekuj. Ky aktivitet paraqiti kostumet tipike popullore e në veçanti “Fustanellën” dhe vallet e zonave ku banojnë arbëreshët. Në mbyllje të takimit të përbashkët, Teatri Kombëtar i Operas dhe Baletit dhe Ansamblin Popullor Kombëtar i Këngëve dhe Valleve organizoi një koncert me muzikë tradicionale dhe arbëreshe.

- Në datë 9 nëntor 2019 Ministri i Shtetit për Diasporën, z. Pandeli Majko, zhvilloi një vizitë pune në Belgjikë, ku u takua me kryetarin e Bashkisë së qytetit Namur, z. Maxime Prevot, me të cilin bashkëbisedoi për komunitetin shqiptar në Belgjikë, integrimin e tyre në shoqërinë belge dhe mundësinë e bashkëpunimeve në projekte të ndryshme për ruajtjen dhe vazhdimësinë e kulturës shqiptare në këtë komunitet.

Gjithashtu, gjatë vizitës në Belgjikë, Ministri i Shtetit për Diasporën mori pjesë në konferencën “Nënë Tereza mes nesh”, e organizuar në qytetin Namur nga shoqata shqiptare “Nënë Tereza” në bashkëpunim me organizatën studentore “Vlera” dhe me mbështetjen e Ambasadës së Republikës së Shqipërisë dhe Ambasadës së Kosovës në Bruksel.

~ Nënshkruar Marrëveshja ndërmjet Agjencisë Kombëtare të Diasporës dhe Teatrit “Migjeni”, Shkodër “Për bashkëpunimin në ruajtjen dhe promovimin e identitetit kulturor kombëtar në diasporë”. Në bazë të kësaj marrëveshjeje, në datë 14 nëntor 2019 u organizua një shfaqje teatrale nga trupa e Teatrit “Migjeni” për komunitetin shqiptar në Zadar, Kroaci.

~ Me rastin e festave të nëntorit, nxënësit e gjimnazit “Petro Nini Luarasi”, me mbështetjen dhe organizimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës, vizituan fshatrat Mandricë dhe Arbanas në Bullgari. Gjatë kësaj vizite nxënësit u njohën me përpjekjet për ruajtjen e gjuhës shqipe, traditave, vlerave dhe identitetit kombëtar nga diaspora shqiptare në Bullgari.

~ Në datë 1 dhjetor 2019, Agjencia Kombëtare e Diasporës organizoi në Neë York një aktivitet në bashkëpunim me Teatrin e Operas, Baletit dhe Ansamblit Kombëtar dhe nën kujdesin e veçantë të Ministrit të Shtetit për Diasporën. Ky aktivitet filloi me një minutë heshtje nga artistët dhe pjesëmarrësit, të cilët në shenjë solidariteti ndaj situatës së vështirë që po kalonte Shqipëria pas tërmetit të datës 26 nëntor 2019 bënë thirrje për ndihmë ndaj familjeve të prekura nga tërmeti.

Janar - Mars 2020:

~ Në datë 27 janar 2020, në kuadër të “Ditëve të Shqipërisë”, Agjencia Kombëtare e Diasporës organizoi një koncert në Selanik, Greqi, me pjesëmarrjen e artistëve të mirënjohur Inva Mula, Olen Cezari dhe Genc Tukiçi. Ky aktivitet u përshëndet dhe nga Konsulli i Përgjithshëm i Republikës së Shqipërisë në Selanik.

~ Agjencia Kombëtare e Diasporës, me shkresën Nr. 111 Prot., datë 03.03.2020 ka kërkuar bashkëpunimin e Teatrit Kombëtar të Operas, Baletit dhe Ansamblit Popullor me qëllim vijimin e programit të mësimin të këngëve dhe valleve popullore për komunitetet shqiptare të Ukrainës dhe Kroacisë.

~ Në proces nënshkrimi i marrëveshjes midis Agjencisë Kombëtare të Diasporës dhe Universiteti Humanitar Shtetëror në Izmail, Ukrainë ku parashikohet hapja e një qendre informacioni të gjuhës dhe kulturës shqipe pranë këtij universiteti. Kjo marrëveshje parashikon bashkërendimin midis dy institucioneve me qëllim përfshirjen e komuniteteve shqiptare të diasporës në jetën kulturore të Ukrainës dhe promovimin e tyre në Shqipëri, duke pasur parasysh që komuniteti i shqiptarëve në Ukrainë është një ndër më të vjetrit.

Prill - Qershor 2020:

~ Për shkak të emergjencës virusale Covid-19, periudha e zbatimit të programit të mësimin të këngëve dhe valleve popullore për komunitetet shqiptare të Ukrainës dhe Kroacisë, është në proces rivlerësimi.

Krijimi i mekanizmave administrativ në nivel qendror dhe lokal për ndihmën dhe transparencën, për të mbështetur investimet dhe kërkesat e të interesuarve në diasporë. Informimi i diasporës për mundësitë e investimeve në Shqipëri me anë të medias, bankave (internet, broshura), etj. dhe motivimi i migrantëve shqiptarë për të investuar të ardhurat e tyre në sektorë të veçante të ekonomisë.

INDIKATORËT: Mekanizma administrativ në nivel qendror dhe lokal; Informimi i diasporës për investimet me anë të medias, bankave (internet, broshura), etj. dhe motivimi për të investuar.

AFATI KOHOR: 6 mujori i dytë 2019 (periodike çdo vit)

INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:

- Ministria e Financave dhe Ekonomisë
- Ministri i Shtetit për Diasporën
- Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes
- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit

Korrik - Shtator 2019:

~ Miratuar Ligji nr.38/2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”. Në bazë të këtij ligji në çdo bashki do të krijohet një strukturë e posaçme për diasporën dhe migracionin, për administrimin e shërbimeve në nivel vendor.

~ Ministri i Shtetit për Diasporën, me shkresën nr. 2504/1 Prot., datë 10.05.2019 ka përcjellë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë propozimet për projektligjin “Për investimet ku ka kërkuar parashimin e kategorisë së investitorëve të diasporës si kategori e veçantë si dhe parashikimin e Dhomës së Biznesit të Diasporës si instrument që do të mbështesë promovimin dhe rritjen e investimeve nga diaspora në vend”.

~ Miratuar Vendimi nr. 514, datë 19.7.2019 i Këshillit të Ministrave “Për financimin e projektit “Për Dhomën e Biznesit të Diasporës - krijimi dhe nxitja e investimeve të diasporës në Shqipëri”, dhe zbatimin e tij nga Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës”. Në kuadër të këtij projekti Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës ka filluar procedurën e rekrutimit të punonjësve. Dhoma e Biznesit të Diasporës do të inaugurohet në nëntor 2019.

Tetor - Dhjetor 2019:

~ Miratuar Vendimi Nr. 746, datë 20.11.2019 i Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime në Vendimin Nr. 294, datë 08.04.2015 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e Këshillit të Investimeve”, të ndryshuar. Sipas këtij vendimi, Dhoma e Biznesit të Diasporës dhe Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës bëhen anëtarë me status të përhershëm në Këshillin e Investimeve.

~ Inagurimi i fillimit të funksionimit të Dhomës së Biznesit të Diasporës në datë 27 nëntor 2019. Ajo u regjistrua me Vendimin Nr. 6378, datë 12.11.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Dhoma e Biznesit të Diasporës shqiptare e nisi punën e saj me organizimin e sipërmarrësve shqiptarë në diasporë për të kontribuar në ndihmë të familjeve shqiptare të prekura nga tërmeti i datës 26 nëntor 2019.

~ Me hyrjen në fuqi të ndryshimit në Ligjin Nr. 139/2018 “Për vetëqeverisjen vendore” është në proces koordinimi i punës së përbashkët me Ministrinë e Brendshme dhe Shoqatat e Bashkive. Struktura administrative për diasporën dhe migracionin do të hapen në çdo bashki. Trajnimi i punonjësve të tyre do të kryhet në bashkëpunim me zyrën në Tiranë të Organizatës Ndërkombëtare të Migracionit (IOM).

Janar - Mars 2020:

~ Në proces nënshkrimi i memorandumit “Për bashkërendimin e punës për ngritjen e strukturës administrative për diasporën dhe migracionin në qeverisjen vendore” ndërmjet Ministrisë së Brendshme, Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministrinë të Shtetit për Diasporën, Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë dhe Shoqatës për Autonomi Vendore. Qëllimi i këtij memorandumi është angazhimi në krijimin e strukturës administrative pranë bashkive, për diasporën dhe migracionin, sipas parashikimeve të Ligjit Nr. 38/2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

- Dhoma e Biznesit publikon çdo javë “Newsletter e Dhomës së Biznesit të Diasporës”, në gjuhën shqipe dhe angleze, përmes së cilës, komuniteti i Biznesit në Diasporë dhe Shqipëri informohet rreth lajmeve dhe informacioneve të ndryshme për ekonominë, financat, sipërmarrjen, mundësitë për investime, ndryshimet ligjore, paketat fiskale dhe incentivuese, si dhe aktivitete të ndryshme brenda dhe jashtë vendit me fokus biznesin dhe investimet. Newsletter e Dhomës së Biznesit shpërndahet elektronikisht në një databasë prej rreth 1000 kontakte, përbërë nga biznese, shoqata biznesi në Diasporë, Dhoma Tregtie në Shqipëri, zyra ekonomike të Ambasadave të huaja në Shqipëri, etj.

~ Në datë 3 shkurt 2020 nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Dhomës së Biznesit të Diasporës me Agjencinë Shqiptare për Zhvillimin e Investimeve (AIDA) dhe Agjencinë e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA) me qëllim përmirësimin e klimës së biznesit në Shqipëri dhe të shërbimeve ndaj sipërmarrësve të Diasporës shqiptare, si dhe nxitjen e kapitalit investues të Diasporës në vendin e origjinës. Dy agjencitë ofrojnë mbështetje dhe konsulencë për shërbimet e reja pranë Dhomës së Biznesit të Diasporës.

Prill - Qershor 2020:

~ Dhoma e Biznesit të Diasporës Shqiptare ka aktivizuar web-faqen si platformë komunikimi me Diasporën dhe po punon mbi përditësimin e të dhënave të sektorëve potencial, duke renditur sektorin potencial, legjislacionin në vend dhe proceset që duhet të ndjekë një biznes i ri, aktorët e tregut, si dhe do të ofrojë një analizë tregu aktuale për secilin sektor.

- Në proces koordinimi i marrëveshjeve mes Dhomës së Biznesit dhe institucioneve AIDA, ADISA dhe aplikimit të projektit “Connect Albania”. Përmes projektit synohet nxitja e investitorëve të huaj me agjentë që do të promovojnë Shqipërinë dhe sektorët potencial

tek investitorët me interes reciprok. Janë krijuar faqet e rrjeteve sociale për të promovuar më tej prezencën dhe mundësitë që ofron Dhoma e Biznesit të Diasporës, si dhe janë koordinuar me Gazetën e Diasporës për informimin ekonomik.

- Dhoma e Biznesit publikon çdo javë "Newsletter e Dhomës së Biznesit të Diasporës", në gjuhën shqipe dhe angleze, përmes së cilës, komuniteti i Biznesit në Diasporë dhe Shqipëri informohet rreth lajmeve dhe informacioneve të ndryshme për ekonominë, financat, sipërmarrjen, mundësitë për investime, ndryshimet ligjore, paketat fiskale dhe incentivuese, si dhe aktivitete të ndryshme brenda dhe jashtë vendit me fokus biznesin dhe investimet.

NË PROCES

Masa Nr.58

Rishikimi i praktikave dhe kushteve për arsimimin e brezave të rinj të diasporës në gjuhën amtare. Identifikimi i nevojave për kurse të gjuhës shqipe në vendet pritëse. Rivlerësimi i hartimit të kurikulave standarde për mësimdhënien në gjuhën shqipe. Identifikimi i vazhdueshëm i nevojave për mësim në gjuhën shqipe dhe njohjen e trashëgimisë kulturore shqiptare për fëmijët në diasporë.

INDIKATORËT: Rishikimi i praktikave dhe kushteve për arsimimin; Identifikimi i nevojave për kurse; Rivlerësimi i hartimit të kurikulave për mësimdhënien; Identifikimi i nevojave për fëmijët.

AFATI KOHOR: 6 mujori i dytë 2019 (periodike)

INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:

- Ministri i Shtetit për Diasporën
- Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
- Akademia e Shkencave

Prill - Qershor 2019:

~ Ministri i Shtetit për Diasporën, me shkresën nr. 3021 Prot., datë 05.06.2019, ka përcjellë për mendim Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit Memorandumin e Bashkëpunimit "Për programin e shkollës verore". Përmes këtij Memorandumi synon nxitjen e organizimit të veprimtarive kulturore, gjuhësore dhe turistike për formimin kulturor dhe gjuhësor të fëmijëve shqiptarë në diasporë.

Korrik - Shtator 2019:

~ Në datat 31 korrik- 3 gusht 2019 Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e Republikës së Kosovës dhe Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë e Republikës së Shqipërisë organizuan Seminarin XV të mësimit plotësues të gjuhës shqipe. Në këtë aktivitet Qendra e Botimeve për Diasporën prezantoi para mësuesve misionin dhe vizionin e saj, hapat e ndërmarrë për hartimin e teksteve të reja të përbashkëta për mësimdhënien në Diasporë, si dhe projektet e tjera për ruajtjen dhe përhapjen e gjuhës dhe kulturës shqiptare jashtë vendit. Qendra e Botimeve për Diasporën shpërndau për

mësuesit “Udhëzuesin për mësimdhënien në Diasporë” botuar nga QBD-ja, si dhe materiale të tjera informuese.

~ Në 10 - 13 shtator 2019 në Ukrainë u firmos memorandum i bashkëpunimit me Institucionin edukativo-arsimor “Azimuth” në Priazov. Ky memorandum synon bashkëpunimin ndër-institucional dhe edukimin e brezave të rinj për gjuhën, historinë dhe traditat shqiptare përmes organizimit të aktiviteteve të ndryshme në Ukrainë. Një ndër prioritetet është hapja e klasave për mësimin plotësues të gjuhës dhe kulturës shqipe për fëmijët e komunitetit shqiptar në këtë rajon. Gjithashtu memorandum i parashikon shkëmbimin arsimor të stafit pedagogjik me qëllim që mësuesit nga Ukraina të kryejnë studime të specializuara për gjuhën, literaturën dhe historinë shqiptare në Universitetin e Tiranës. Agjencia Kombëtare e Diasporës ka shprehur angazhimin e saj për të mbështetur këtë bashkëpunim.

~ Drejtoresha e Qendrës së Botimeve për Diasporën, znj. Mimoza Hysa zhvilloi një takim me kryetaren e Lidhjes së Mësuesve Shqiptarë në Greqi, znj. Anila Velaj Kila, për të diskutuar rreth problematikave dhe nevojave të mësuesve dhe nxënësve në Diasporë. Ndër të tjera u diskutua për hapat e ndërmarrë për hartimin e teksteve të reja dhe për literaturën shtesë në ndihmesë të mësimdhënies dhe për organizimin e Takimit Mbarëkombëtar të Mësuesve të Diasporës në 14 mars 2020.

~ Nënshkruar Memorandum Bashkëpunimi “Për programin “Jam shqiptar” të gjuhës dhe kulturës shqipe ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, Ministrisë së Kulturës dhe Ministrit të Shtetit për Diasporën. Ky program ka si qëllim organizimin e veprimtarive kulturore, gjuhësore e turistike, njohjen e historisë së Shqipërisë dhe të vendeve të saj turistike për formimin kulturor e gjuhësor të brezave të rinj në Diasporën shqiptare.

Tetor - Dhjetor 2019:

~ Vijon komunikimi për vazhdimësinë e punës së Komisionit të Përbashkët Shqipëri - Kosovë për hartimin e teksteve shkollore të përbashkëta, pezulluar prej situatës zgjedhore në Kosovë.

~ Qendra e Botimeve për Diasporën, me shkresën Nr. 205 Prot., datë 09.10.2019, drejtuar Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme bën me dije se në adresë të QBD-së kanë ardhur kërkesa shtesë për tekste shkollore nga shoqatat e mësuesve shqiptarë në Diasporë (Austri, SHBA, Norvegji, Mbretëri e Bashkuar, Itali, Greqi, Finlandë dhe Gjermani) dhe kërkon bashkëpunim në sigurimin e teksteve në bazë të gjendjes aktuale të teksteve në magazinën e MEPJ-së.

~ Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, me shkresën Nr. 14896, datë 18.10.2019, dërgon listën me gjendjen aktuale të teksteve në magazinën e MEPJ-së.

~ Sipas programit të Agjencisë Kombëtare të Diasporës për mësimin e gjuhës shqipe, mësues nga Shqipëria kanë zhvilluar një kurs të mësimin të gjuhës shqipe për fëmijët e komunitetit shqiptar në vendet pritëse:

- Dy mësues të gjuhës shqipe kanë zhvilluar kurs të mësimin të gjuhës shqipe në datat 2 - 10 nëntor 2019 në Zarë, Kroaci.
- Dy mësues të gjuhës shqipe kanë zhvilluar një kurs të mësimin të gjuhës shqipe

në datat 4-11 nëntor 2019 në Karakurt, Ukrainë.

~ Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, me shkresën Nr. 16240 Prot., datë 13.11.2019 informon mbi hapjen e shkollës shqipe “Scanderbeg”, në Parma, Itali për vitin 2019 - 2020.

~ Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, me shkresën Nr. 16242 Prot., datë 13.11.2019 informon mbi vizitën që ka zhvilluar ambasadori i Republikës së Shqipërisë në Kanada në klasën e gjuhës shqipe në Windsor. Kjo klasë ndiqet nga 30 nxënës shqiptarë dhe për herë të parë u janë shpërndarë abetaret e botuara nga Qendra e Botimeve për Diasporën, si dëshmi konkrete e angazhimit në mbështetje të diasporës shqiptare.

~ Qendra e Botimeve për Diasporën, me shkresën Nr. 233 Prot., datë 04.11.2019 informon Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme për dërgimin e teksteve mësimore shtesë për komunitetin shqiptar në Zaporozhye dhe Karakurt, Ukrainë.

~ Me shkresën Nr. 15869 Prot., datë 06.11.2019, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme drejtuar Qendrës së Botimeve për Diasporën kërkon mundësimin e një kontigjenti librash për mësimin e kulturës dhe gjuhës shqipe në shkollën e re të mësimin të gjuhës shqipe në Madrid nga shoqata “Los albaneses en Espana”.

~ Me shkresën Nr. 243/1 Prot., datë 13.11.2019, drejtuar Ministrisë së Evropës dhe Punëve të Jashtme, QBD-ja vlerësoi pajisjen nga MEPJ-ja me kargo diplomatike të 25 librave “Të mësojmë gjuhën amtare 1” dhe 25 sete abetaresh për shkollën e re të mësimin të gjuhës shqipe në Madrid.

~ Qendra e Botimeve për Diasporën me shkresën Nr. 248 Prot., datë 15.11.2019, drejtuar Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme informon për kërkesat e tjera shtesë për tekste të ardhura nga shkollat e mësimin të gjuhës shqipe në adresë të QBD-së dhe kërkon bashkëpunimin e MEPJ-së për sigurimin e teksteve shkollore në bazë të gjendjes aktuale të tyre në magazinën e MEPJ-së.

~ Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, me shkresën Nr. 16983, datë 25.11.2019 konfirmon bashkëpunimin në sigurimin e teksteve shkollore në Diasporë dhe sugjeron që këto tekste të dërgohen në adresë të përfaqësive diplomatike me qëllim bashkëpunimin e komunitetit me ambasadën.

~ Në datë 07.11.2019, Këshilli Koordinues i Botimeve për Diasporën, vendosi miratimin e botimit të “Fjalor dygjuhësh për fëmijë” në gjuhët: shqip-italisht, shqip-anglisht, shqip-greqisht, shqip-gjermanisht, shqip-frëngjisht, shqip-kroatisht, shqip-turqisht, shqip-ukrainisht, shqip-spanjisht; miratimin e serisë (kolanës) “Klasikët dygjuhësorë” e shtëpisë botuese spanjolle “Libsa” me 7 libra me nga 2 rrëfenja për secilin libër dhe blerjen e të drejtës për akses në platformën on-line të mësimin të gjuhës shqipe për rreth 300 mësues në Diasporë.

~ Akademia e Shkencave në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Diasporës dhuroi 152 tituj për Agjencinë për Zbatimin e Gjuhës që e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut, një institucion i ri shtetëror në Maqedoninë e Veriut.

~ Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, me shkresën Nr. 18239 Prot., datë 20.12.2019, informon mbi nisjen e kurseve të mësimin të gjuhës shqipe në Manitoba të Kanadasë.

Janar - Mars 2020:

~ Agjencia Kombëtare e Diasporës, me shkresën Nr. 79 Prot., datë 12.02.2020 ka kërkuar nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë caktimin e mësuesve për mësimdhënien e gjuhës shqipe për fëmijët e komuniteteve shqiptare në Ukrainë dhe Kroaci, si vazhdim i programit të iniciuar në vitin 2019. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë me shkresën Nr. 79/1., datë 27.02.2020 informon se është në proces të përzgjedhjes së mësuesve në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar.

~ Qendra e Botimeve për Diasporën vijon komunikimin për rinisjen e punës së Komisionit të Përbashkët Shqipëri - Kosovë, për përmbushjen e objektivave të përcaktuara nga marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Diasporës së Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës “Për organizimin e përbashkët të mësimit të gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në diasporë dhe në mërgatë” firmosur më 25 mars 2015.

Prill - Qershor 2020:

~ Për shkak të emergjencës virusale Covid-19, periudha e zbatimit të programit të mësimit të gjuhës shqipe për fëmijët e komuniteteve shqiptare të Ukrainës dhe Kroacisë është në proces rivlerësimi.

~ Miratuar Vendimi Nr.408, datë 20.05.2020 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e çmimeve dhe kategorive që përfitojnë falas tekstet/librat e botuar nga Qendra e Botimeve për Diasporën “Klasikët dygjuhësh” dhe “Fjalor dygjuhësh për fëmijë”.

~ Qendra e Botimeve për Diasporën zhvilloi në muajin prill mbledhjen me Komisionin e Përbashkët Shqipëri-Kosovë për Miratimin e Teksteve Mësimore për Diasporën, i cili është ngritur në zbatim të marrëveshjes së miratuar midis dy shteteve “Për organizimin e përbashkët të mësimit të gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në Diasporë dhe mërgatë”. Në këtë mbledhje u diskutua për problematikat e hasura deri tani në punën e këtij komisioni dhe për mënyrën e procedimit në të ardhmen. Për shkak të situatës së krijuar, takimi u zhvillua online.

NË PROCES

| Masa Nr.59 |

Vlerësimi vjetor i nevojave për mësimin në gjuhën shqipe dhe njohjen e trashëgimisë kulturore shqiptare për fëmijët në diasporë. Përmirësim periodik i kurrikulave të përbashkëta me Kosovën, për mësimdhënien në gjuhën shqipe. Mbështetje në zbatimin e kurrikulave të përbashkëta.

INDIKATORËT: Vlerësimi vjetor i nevojave; Përmirësim dhe zbatim i kurrikulave me Kosovën.

AFATI KOHOR: 6 mujori i dytë 2018 (periodike çdo vit)

INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:

- **Ministri i Shtetit për Diasporën**
- **Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë**
- **Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme**

Buletini 2018:

~ Dërguar shkresa nr.3662 Prot., datë 31.7.2018, Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, si dhe Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, “Për zbatimin e masës nr.59, të Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare për Diasporën 2018 - 2024”.

~ Në zbatim të Urdhrit të Përbashkët nr. 682/2018 “Për ngritjen e Grupit të Punës për hartimin e projektakteve nënligjore për regjistrin shtetëror të mësuesve të diasporës dhe të certifikatës së nxënësve në diasporë”, janë realizuar takimet midis Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Ministrit të Shtetit për Diasporën.

~ Miratuar Vendimi nr. 690/2018 i Këshillit të Ministrave “Për prodhimin, transmetimin dhe financimin e emisioneve të posaçme televizive, arsimore dhe kulturore, të dedikuara për diasporën”.

~ Në funksion të "Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Rinisë dhe Sportit dhe Ministrisë së Diasporës së Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës për organizimin e përbashkët të mësimin të gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare” datë 23.03.2015 janë ngritur 4 grupe pune të përbashkëta, si më poshtë:

1. Grupi i kurrikulës pas disa takimesh ka finalizuar kurrikulën e përbashkët të nënshkruar edhe nga ministrat përgjegjës të arsimit të Shqipërisë dhe Kosovës në maj 2018. Mbi bazën e kësaj kurrikule po punohet për realizimin e teksteve të përbashkëta për mësimin në Diasporë.
2. Grupi i Standardeve ka hartuar draft-standardet për mësuesit e Diasporës, të cilat do të shërbejnë si model referimi për regjistrin e mësuesve të Diasporës
3. Grupi i Legjislacionit është në përfundim të marrëveshjes së përbashkët për financimin e mësimin të gjuhës shqipe në Diasporë. Kjo marrëveshje është miratuar në parim nga të dyja qeveritë e Shqipërisë dhe Kosovës.
4. Grupi i Promovimit ka përgatitur spotin “Mëso Shqip” për nxitjen e arsimimit në gjuhën shqipe në radhët e Diasporës dhe po marrin pjesë bashkërisht në emisionet televizive për këtë qëllim.

Janar - Mars 2019:

~ Qendra e Botimeve për Diasporën ka nisur funksionimin në janar 2019.

~ Në përputhje me Vendimin nr. 469/2018 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve për Diasporën”, janë emëruar, me Urdhrin Nr. 3/2018, të Ministrit të Shtetit për Diasporën, kryetari dhe anëtarët e Këshillit Koordinues të Botimeve për Diasporën.

~ Është emëruar Drejtori i Qendrës së Botimeve për Diasporën. Në proces miratimi i strukturës dhe emërimi i personelit.

~ Miratuar Urdhri nr. 180/2018, i Kryeministrit “Për përgatitjen e platformës së programeve të emisioneve të posaçme për mësimin e gjuhës shqipe, kulturën shqiptare

dhe identitetin kombëtar, të dedikuara për Diasporën”. Në zbatim të këtij Urdhri, grupi i punës është duke përgatitur dy projekte “Fol Shqip” dhe “Krenohem me Ju”.

~ Miratuar Vendimi nr. 104/2019 i Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve për krijimin e regjistrit shtetëror të mësuesve të gjuhës shqipe e të kulturës shqiptare dhe dhënien e certifikatës për nxënësit në diasporë”.

~ Miratuar Urdhri nr.47/2019 i Kryeministrit "Për caktimin e koordinatorit shtetëror për programet/donorët të cilët ofrojnë bursa studimi për jashtë vendit". Koordinator Shtetëror është caktuar z. Redi Shtino, zëvendësministër i Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

~ Në kuadër të përmbushjes së masës 15 për vitin 2019, INSTAT ka filluar punën përgatitore për realizimin e Raportit Vjetor për vitin 2019. Në kuadër të zbatimit të kësaj mase, INSTAT do të përfshijë në raportin vjetor për vitin 2019 edhe masa të tjera të Planit të Veprimit si: 30, 32, 33, 40, 41, 59, 60 dhe 64, me qëllim evidentimin dhe llogaritjen e disa indikatorëve. Për këtë çështje INSTAT ka filluar komunikimin zyrtar me institucionet përgjegjëse.

Prill - Qershor 2019:

~ Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë me shkresën nr. 4410/1 Prot., datë 24.04.2019, propozon 3 anëtarë për komisionin e përbashkët për hartimin e teksteve të përbashkëta për Diasporën.

~ Më datë 22 maj 2019 u mbledh për herë të parë Komisioni i Përbashkët i Shqipërisë dhe Kosovës. Anëtarët e Komisionit zgjodhën kryetarin e Komisionit, z. Nuhi Gashi, përfaqësues i Kosovës. Komisioni i Përbashkët i Shqipërisë dhe Kosovës për miratimin e teksteve të përbashkëta mësimore për Diasporën, vendosi hartimin e rregullores së funksionimit të Komisionit nga përfaqësuesit e Kosovës brenda dy javëve nga data e takimit.

~ Në datat 26 dhe 27 qershor 2019, Komisioni i Përbashkët i Shqipërisë dhe Kosovës për Miratimin e Teksteve Mësimore për Diasporën zhvilloi mbledhjen e dytë në Prishtinë me qëllim planifikimin e punës për shpalljen e konkursit për hartimin dhe miratimin e teksteve mësimore për Diasporën. Në përfundim të këtij takimi komisioni vendosi që brenda vitit 2019 të shpallë konkursin për nivelin e parë për tekstet mësimore të përbashkëta për Diasporën. Ndërkohë, Komisioni do të përgatisë dokumentacionin për shpalljen e konkursit duke filluar nga plotësimi i standarteve për tekstet për Diasporën. Komisioni hartoi dhe miratoi gjithashtu kalendarin e punës deri në miratimin përfundimtar të teksteve mësimore për Diasporën.

~ Koordinator Shtetëror për Programet/donorët të cilët ofrojnë bursa studimi për jashtë vendit, caktuar me Urdhri nr. 47/2019 të Kryeministrit, ka raportuar për herë të parë në mbledhjen e Komitetit Shtetëror për Diasporën (3 maj 2019). Raportimet e koordinatoreve do të jenë periodike, çdo tre muaj.

~ Qendra e Botimeve për Diasporën është në proces të përgatitjes së një dokumenti me informacione të plota për mësimdhënien në Diasporë, në ndihmesë të mësuesve, të cilët e ushtrjnë këtë profesion në shërbim të komuniteteve shqiptare jashtë vendit.

~ Ministri i Shtetit për Diasporën, me shkresën nr. 3021 Prot., datë 05.06.2019, ka përcjellë për mendim Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Ministrisë së Turizmit

dhe Mjedisit Memorandumit e Bashkëpunimit "Për programin e shkollës verore". Përmes këtij Memorandumi synon nxitjen e organizimit të veprimtarive kulturore, gjuhësore dhe turistike për formimin kulturor dhe gjuhësor të fëmijëve shqiptarë në Diasporë.

Korrik - Shtator 2019:

~ Miratuar Vendimi nr. 443, datë 26.06.2019 i Këshillit të Ministrave "Për organizimin e procesit mësimor dhe përzgjedhjen e arsimtarëve në diasporë".

~ Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, me shkresat me nr. 9045/1, datë 01.07.2019 dhe datë 02.07.2019 ka dërguar listat me tekstet shkollore për mësimin plotësues të kulturës dhe gjuhës shqipe për diasporën për vitin shkollor 2019-2020.

~ Miratuar Vendimi nr. 492, datë 10.07.2019 i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e çmimeve dhe kategorive që përfitojnë falas tekstet e botuara nga Qendra e Botimeve për Diasporën për vitin shkollor 2019 - 2020".

~ Më 22-23 korrik u zhvillua në Vlorë mbledhja e tretë e Komisionit të Përbashkët të Shqipërisë dhe Kosovës për miratimin e teksteve të përbashkëta. Në këtë mbledhje u diskutuan dhe u hartuan standardet për tekstet e përbashkëta për Diasporën.

~ Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, me shkresën nr. 11 041 Prot., datë 29.07.2019 informon mbi njohjen e ambasadës së Republikës së Shqipërisë në Bernë si sponsor zyrtar i mësimin të gjuhës shqipe në kantonin e Zyrihut, Zvicër.

~ Qendra e Botimeve për Diasporën, me shkresën nr. 169 Prot., datë 26.08.2019 drejtuar Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme informon për sasinë e dërguar të teksteve për diasporën për vitin shkollor 2019 - 2020 pranë këtij institucioni.

~ Miratuar Urdhri nr.112, datë 30.08.2019 i Kryeministrit "Për caktimin e koordinatorit shtetëror për realizimin e programit "Jam shqiptar" të gjuhës dhe kulturës shqipe". Koordinatore është caktuar znj. Lorena Haxhiu, zëvendësministre në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

~ Në datë 3 shtator, Qendra e Botimeve për Diasporën mori pjesë në mbledhjen e radhës të Këshillit Koordinues të Botimeve për Diasporën. Qëllimi i kësaj mbledhjeje ishte miratimi i literaturës plotësuese të gjuhës shqipe, të cilat do t'u vijnë në ndihmë fëmijëve të grupmohave të ndryshme në Diasporë.

~ Qendra e Botimeve për Diasporën ka publikuar dokumentin "Udhëzues për mësimdhënien në Diasporë 2019". Ky material është një dokument informues i ndryshimeve ligjore, akteve dhe shkresave me rëndësi në mbështetje të mësuesve dhe mësimdhënies në Diasporën shqiptare. Ai synon të paraqesë ecurinë e deritanishme të politikave shtetërore që ndikojnë drejtpërdrejt në përmirësimin e statusit të shkollave shqipe dhe të mësuesve në Diasporë. Ky udhëzues është një tregues i bashkëpunimit midis Shqipërisë dhe Kosovës për miratimin e teksteve të përbashkëta për Diasporën nga Komisioni i Përbashkët ndërshtetëror, në zbatim të Marrëveshjes së Përbashkët mes institucioneve përgjegjëse të dy vendeve.

~ Nënshkruar Memorandum Bashkëpunimi "Për programin "Jam shqiptar" të gjuhës dhe kulturës shqipe ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, Ministrisë së Kulturës dhe Ministrit të Shtetit për Diasporën. Ky program ka si qëllim organizimin e veprimtarive kulturore, gjuhësore e turistike, njohjen e historisë

së Shqipërisë dhe të vendeve të saj turistike për formimin kulturor e gjuhësor të brezave të rinj në Diasporën shqiptare.

~ Koordinatori Shtetëror për Programet/donatorët të cilët ofrojnë bursa studimi për jashtë vendit, caktuar me Urdhrin nr. 47/2019 të Kryeministrit, z. Redi Shtino ka raportuar në mbledhjen e Komitetit Shtetëror për Diasporën në 17.09.2019.

~ Në datë 23 shtator, Qendra e Botimeve për Diasporën mori pjesë në mbledhjen e radhës të Këshillit Koordinues të Botimeve për Diasporën, i cili miratoi listën e plotë prej 11 librash plotësues të gjuhës shqipe, që do t'u vijë në ndihmë fëmijëve të grupmoshave të ndryshme në Diasporë.

~ Drejtoresha e Qendrës së Botimeve për Diasporën, znj. Mimoza Hysa zhvilloi një takim me kryetaren e Lidhjes së Mësuesve Shqiptarë në Greqi, znj. Anila Velaj Kila, për të diskutuar rreth problematikave dhe nevojave të mësuesve dhe nxënësve në Diasporë. Ndër të tjera u diskutua për hapat e ndërmarrë për hartimin e teksteve të reja dhe për literaturën shtesë në ndihmesë të mësimdhënies dhe për organizimin e Takimit Mbarëkombëtar të Mësuesve të Diasporës në 14 mars 2020.

~ Qendra e Botimeve për Diasporën në bashkëpunim me Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Postën Shqiptare ka përfunduar të gjitha dërgesat e teksteve shkollore falas për mësimdhënien në Diasporë, sipas kërkesave të përfaqësive diplomatike dhe konsullore jashtë vendit.

Tetor - Dhjetor 2019:

~ Nënshkruar Memorandum Mirëkuptimi ndërmjet Ministrit të Shtetit për Diasporën dhe Fondacionit për Politikën Diplomatike dhe Kërkim Shkencor (DRPF) në kuadër të UNESCO. Firmosja e këtij memorandumi ka një rëndësi të veçantë për forcimin e marrëdhënieve mes palëve në lidhje me ofrimin e një arsimit cilësor, promovimin dhe zhvillimin e kërkimit shkencor si dhe krijimin e një programi për arsimin në gjuhën shqipe që do t'u vijë në ndihmë komuniteteve shqiptare në Diasporë për të promovuar gjuhën dhe kulturën shqiptare.

~ Qendra e Botimeve për Diasporën, me shkresën Nr.205 Prot., datë 09.10.2019, drejtuar Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme bën me dije se në adresë të QBD-së kanë ardhur kërkesa shtesë për tekste shkollore nga shoqatat e mësuesve shqiptarë në Diasporë (Austri, SHBA, Norvegji, Mbretëri e Bashkuar, Itali, Greqi, Finlandë dhe Gjermani) dhe kërkon bashkëpunim në sigurimin e teksteve në bazë të gjendjes aktuale të teksteve në magazinën e MEPJ-së.

~ Miratuar Vendimi Nr. 723, datë 11.11.2019 i Këshillit të Ministrave "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin Nr. 492, datë 10.07.2019 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e çmimeve dhe të kategorive që përfitojnë falas tekstet e botuara nga Qendra e Botimeve për Diasporën për vitin shkollor 2019 - 2020".

~ Qendra e Botimeve për Diasporën, në zbatim të Vendimit Nr. 8, datë 07.11.2019, të Këshillit Koordinues për Diasporën, siguroi akses falas në platformën digjitale "Schoolme" për 300 mësues të gjuhës shqipe në Diasporë. Kjo platformë do të ndihmojë për promovimin dhe përhapjen e gjuhës shqipe në Diasporë.

~ Krijuar harta digjitale me 250 shkolla shqipe në Diasporë, si dhe rregjistri elektronik

me 320 mësues të gjuhës shqipe në diasporë, i cili përditësohet në përgjegjësinë e QBD-së.

~ Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, me shkresën Nr. 14896, datë 18.10.2019, dërgon listën me gjendjen aktuale të teksteve në magazinën e MEPJ-së.

~ Sipas programit të Agjencisë Kombëtare të Diasporës për mësimin e gjuhës shqipe, mësues të gjuhës shqipe nga Shqipëria kanë zhvilluar një kurs të mësimin të gjuhës shqipe për fëmijët e komunitetit shqiptar në vendet pritëse:

- Dy mësues të gjuhës shqipe kanë zhvilluar kurs të mësimin të gjuhës shqipe në datat 2 - 10 nëntor 2019 në Zarë, Kroaci.
- Dy mësues të gjuhës shqipe kanë zhvilluar një kurs të mësimin të gjuhës shqipe në datat 4-11 nëntor 2019 në Karakurt, Ukrainë.

~ Qendra e Botimeve për Diasporën, me shkresën Nr. 233 Prot., datë 04.11.2019 informon Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme për dërgimin e teksteve mësimore shtesë për komunitetin shqiptar në Zaporozhye dhe Karakurt, Ukrainë.

~ Me shkresën Nr. 15869 Prot., datë 06.11.2019, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme drejtuar Qendrës së Botimeve për Diasporën kërkon mundësimin e një kontigjenti librash për mësimin e kulturës dhe gjuhës shqipe në shkollën e re të mësimin të gjuhës shqipe në Madrid nga shoqata “Los albaneses en Espana”.

-Në datë 07.11.2019, Këshilli Koordinues i Botimeve për Diasporën, vendosi miratimin e botimit të “Fjalor dygjuhësh për fëmijë” në gjuhët: shqip-italisht, shqip-anglisht, shqip-greqisht, shqip-gjermanisht, shqip-frëngjisht, shqip-kroatisht, shqip-turqisht, shqip-ukrainisht, shqip-spanjisht; miratimin e serisë (kolanës) “Klasikët dygjuhësorë” e shtëpisë botuese spanjolle “Libsa” me 7 libra me nga 2 rrëfenja për secilin libër dhe blerjen e të drejtës për akses në platformën on-line të mësimin të gjuhës shqipe për rreth 300 mësues në Diasporë.

~ Miratuar Vendimi Nr. 723, datë 11.11.2019 i Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin Nr. 492, datë 10.07.2019 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e çmimeve dhe të kategorive që përfitojnë falas tekstet e botuara nga Qendra e Botimeve për Diasporën për vitin shkollor 2019 - 2020”.

~ Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, me shkresën Nr.16240 Prot., datë 13.11.2019 informon mbi hapjen e shkollës shqipe “Scanderbeg”, në Parma, Itali për vitin 2019 - 2020.

~ Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, me shkresën Nr. 16242 Prot., datë 13.11.2019 informon mbi vizitën që ka zhvilluar ambasadori i Republikës së Shqipërisë në Kanada në klasën e gjuhës shqipe në Windsor. Kjo klasë ndiqet nga 30 nxënës shqiptarë dhe për herë të parë u janë shpërndarë abetaret e botuara nga Qendra e Botimeve për Diasporën, si dëshmi konkrete e angazhimit në mbështetje të diasporës shqiptare.

~ Me shkresën Nr. 243/1 Prot., datë 13.11.2019, drejtuar Ministrisë së Evropës dhe Punëve të Jashtme, QBD-ja vlerësoi pajisjen nga MEPJ-ja me kargo diplomatike të 25 librave “Të mësojmë gjuhën amtare 1” dhe 25 sete abetaresh për shkollën e re të mësimin të gjuhës shqipe në Madrid.

~ Qendra e Botimeve për Diasporën me shkresën Nr. 248 Prot., datë 15.11.2019, drejtuar Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme informon për kërkesat e tjera shtesë për tekste të ardhura nga shkollat e mësimit të gjuhës shqipe në adresë të QBD-së dhe kërkon bashkëpunimin e MEPJ-së për sigurimin e teksteve shkollore në bazë të gjendjes aktuale të tyre në magazinën e MEPJ-së.

~ Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, me shkresën Nr. 16983, datë 25.11.2019 konfirmon bashkëpunimin në sigurimin e teksteve shkollore në Diasporë dhe sugjeron që këto tekste të dërgohen në adresë të përfaqësive diplomatike me qëllim bashkëpunimin e komunitetit me ambasadën dhe anasjellas.

~ Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, me shkresën Nr. 18239 Prot., datë 20.12.2019, informon mbi nisjen e kurseve të mësimit të gjuhës shqipe në Manitoba të Kanadasë.

Janar - Mars 2020:

~ Qendra e Botimeve për Diasporën organizoi takimin me mësues shqiptarë në Itali më datë 8 shkurt 2020 në Reggio Emilia për prezantimin e literaturës plotësuese me 11 tituj librash të miratuar nga Këshilli Koordinues i Botimeve për Diasporën, si dhe pajisjen e 100 mësuesve të Italisë me paketën e literaturës plotësuese.

~ Agjencia Kombëtare e Diasporës, me shkresën Nr. 79 Prot., datë 12.02.2020 ka kërkuar nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë caktimin e mësuesve për mësimin e gjuhës shqipe për fëmijët e komuniteteve shqiptare në Ukrainë dhe Kroaci, si vazhdim i programit të iniciuar në vitin 2019. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë me shkresën Nr. 79/1., datë 27.02.2020 informon se është në proces të përzgjedhjes së mësuesve në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar.

~ Qendra e Botimeve për Diasporën vijon komunikimin për rinisjen e punës së Komisionit të Përbashkët Shqipëri - Kosovë, për përmbushjen e objektivave të përcaktuara nga marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Diasporës së Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës “Për organizimin e përbashkët të mësimit të gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në diasporë dhe në mërgatë” firmosur më 25 mars 2015.

~ Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, me shkresën Nr. 3798 Prot., datë 05.03.2020, drejtuar Qendrës së Botimeve për Diasporën ka kërkuar pajisjen me tekste shkollore në gjuhën shqipe të një klase për mësimin plotësues të kulturës dhe gjuhës shqipe në Barcelonë.

~ Qendra e Botimeve për Diasporën, me shkresën Nr. 146/1 Prot., datë 12.03.2020, informon Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme mbi plotësimin e kërkesës për pajisjen me tekste shkollore në gjuhën shqipe të një klase për mësimin plotësues të kulturës dhe gjuhës shqipe në Barcelonë.

Prill - Qershor 2020:

~ Miratuar Vendimi Nr.408, datë 20.05.2020 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e çmimeve dhe kategorive që përfitojnë falas tekstet/librat e botuar nga Qendra e Botimeve për Diasporën “Klasikët dygjuhësh” dhe “Fjalor dygjuhësh për fëmijë”.

- Qendra e Botimeve për Diasporën zhvilloi në muajin prill mbledhjen me Komisionin e Përbashkët Shqipëri-Kosovë për Miratimin e Teksteve Mësimore për Diasporën, i cili është ngritur në zbatim të marrëveshjes së miratuar midis dy shteteve “Për organizimin e përbashkët të mësimin të gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në Diasporë dhe mërgatë”. Në këtë mbledhje u diskutua për problematikat e hasura deri tani në punën e këtij komisioni dhe për mënyrën e procedimit në të ardhmen. Për shkak të situatës së krijuar, takimi u zhvillua online.

- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, me shkresën Nr. 5191 Prot., datë 07.05.2020, ka përcjellë pranë Qendrës së Botimeve për Diasporën listën e kërkesave për tekste mësimore dhe materiale plotësuese të Shkollës Shqipe në Zvicër, e cila sponsorizohet nga Ambasada e Republikës së Shqipërisë në Bernë. Kërkesa do të plotësohet duke iu shtuar listës së plotë dhe përfundimtare të kërkesave për tekste shkollore dhe literaturë shtesë për vitin 2020-2021.

- Qendra e Botimeve për Diasporën, për shkak të situatës së krijuar në shkollat shqipe në Diasporë si pasojë e pandemisë globale, ka zhvilluar disa takime online me përfaqësues të shkollave shqipe, me qëllim marrjen e informacioneve dhe gjetjen e zgjidhjeve për problematikat e ngritura. QBD-ja ka organizuar gjithsej 7 takime online me përfaqësues të mësimdhënies së gjuhës shqipe nga shtete, si: Italia, Greqia, Gjermania, Zvicra, Anglia, SHBA-ja, Kanadaja, Spanja dhe Turqia. Në këto mbledhje u diskutua për problematikat e ndryshme lidhur me mësimin e gjuhës shqipe në kushtet e situatës së re të krijuar prej Covid-19, rëndësinë dhe mënyrën e përdorimit të Platformës digjitale për mësimin e gjuhës shqipe dhe pajisjen me tekste mësimore për vitin shkollor 2020-2021.

- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme me shkresë Nr. 6390 Prot., datë 09.06.2020 ka përcjellë pranë Qendrës së Botimeve për Diasporën listën e kërkesave për tekste mësimore dhe literaturë shtesë për vitin shkollor 2020-2021. Lista përfshin rreth 17.000 tekste, me një shtesë të kërkesave prej 1/3 nga viti 2019-2020.

- Nënshkruar Marrëveshja e Bashkëpunimit midis Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët (QSPA) dhe Bibliotekës Kombëtare të Kosovës “Pjetër Bogdani”. Në bazë të kësaj marrëveshjeje, pritet që të dyja institucionet të bashkëpunojnë për shkëmbimin e literaturës shkencore në funksion të hulumtimit të autorëve dhe të të dhënave mbi Arbëreshët. Gjithashtu, në qendër të marrëveshjes është edhe koordinimi në aspektin shkencor e profesional, në fushën e digjitalizimit të veprave mbi Arbëreshët, si dhe të veprimtarive të përbashkëta kulturoro-shkencore, mes të cilave shihet me përparësi promovimi i veprimtarive me karakter bibliografik, ekspozitave e botimeve.

- Nënshkruhet memorandumi i bashkëpunimit mes Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët (QSPA) dhe Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës (ASHAK). Dokumenti i nënshkruar përfshin organizimin e veprimtarive në fushën kërkimore-shkencore, si dhe kryerjen e studimeve të përbashkëta mbi historinë dhe kulturën e komunitetit arbëresh. Memorandumi cilësohet të jetë një marrëveshje e zgjerimit dhe thellimit të marrëdhënieve në mes dy vendeve në fushën e kërkimit shkencor dhe sheh me përparësi koordinimin e punës dhe bashkëpunimin mes studiuesve të rinj të Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët me studiuesit me përvojë të Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës.

~ Nënshkruar memorandum i bashkëpunimit midis Akademisë së Studimeve Albanologjike (ASA), Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët (QSPA) dhe Ministrisë të Shtetit për Diasporën. Ky memorandum bashkëpunimi vjen në vazhdim të një sërë marrëveshjeve institucionale të ndërmarra nga QSPA-ja, me qëllim krijimin e infrastrukturës së nevojshme për kërkimin shkencor, si dhe rrjetëzimin e kontakteve dhe literaturës së nevojshme për studimin e thelluar të historisë, kulturës dhe letërsisë arbëreshe. Memorandumi mes tri institucioneve, synon koordinimin e studimeve për kulturën e komunitetit arbëresh, bashkëpunimin ndërinstitucional që parashikon realizimin e studimeve të përbashkëta, organizimin e aktiviteteve studimore, si dhe krijimin e grupeve të punës për aplikimin në projekte të përbashkëta.

~ Nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi midis Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët (QSPA) dhe Institutit Arkeologjik të Kosovës, i cili njihet si një ndër institucionet më të rëndësishme të Trashëgimisë Kulturore të Kosovës, dhe institucioni kryesor për shkencën e arkeologjisë në këtë vend.

~ Drejtoresha ekzekutive e Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët (QSPA), prof. Diana Kastrati, në kuadër të vizitës zyrtare në Prishtinë, ka zhvilluar një takim në mjediset e Institutit Albanologjik të Prishtinës (IAP), ku prof. Kastrati së bashku me studiuesen Vilma Proko janë takuar me Sekretarin Shkencor të IAP-së, prof. Lulëzim Lajçi dhe përgjegjës të sektorit të gjuhësisë pranë këtij institucioni, prof. Qemal Murati. Palët përfaqësuese të të dyja institucioneve kanë diskutuar në parim pikat dhe hapësirat e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe konkretizimin e tyre edhe zyrtarisht në takimin e radhës. Po ashtu, në kuadër të bashkëpunimit të mëtejshëm me institucionet kërkimore-shkencore u zhvillua takim zyrtar edhe në Institutin e Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve. Studiuesit Qazim Namani, Emin Sallahu dhe përgjegjësja e bibliotekës, znj. Arbërie Demaçi bënë një prezantim të gjerë të botimeve të këtij Instituti, ku theksuan edhe fokusin kryesor të punës së tyre në rivlerësimin dhe mbrojtjen e monumenteve të kulturës kombëtare shqiptare.

~ Nënshkruar marrëveshja e bashkëpunimit mes Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët (QSPA) dhe Institutit të Historisë “Ali Hadri”, Kosovë. Në qendër të kësaj marrëveshjeje është shkëmbimi i literaturës shkencore, si dhe hartimi i projekteve të përbashkëta akademike në realizimin e hulumtimeve shkencore dhe në organizimin e veprimtarive të ndryshme mbi Arbëreshët. Drejtori Sylja ka bërë një ekspozitë të punëve kryesore të institucionit që drejton dhe së bashku me prof. Kastratin kanë diskutuar hapësirat e mundshme të bashkëveprimit ndërinstitucional për vënien në jetë të shumë projekteve.

NË PROCES

| Masa Nr.60 |

Krijimi i Regjistrisë të mësuesve në diasporë dhe krijimi i programeve për mbështetje në zbatimin e standardeve për mësuesit në diasporë. Identifikimi i vazhdueshëm i mësuesve dhe hartimi i skemës së pensioneve për mësuesit në diasporë. Promovimi i aktiviteteve arsimore me mësues e nxënës shqiptarë në diasporë.

INDIKATORËT: Regjistri i mësuesve dhe krijimi i programeve mbështetëse; Identifikimi i mësuesve dhe hartimi i skemës së pensioneve; Promovimi i aktiviteteve arsimore.

AFATI KOHOR: 6 mujori i parë 2019 (periodike çdo vit)

INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:

- Ministri i Shtetit për Diasporën
- Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
- Akademia e Shkencave

Janar - Mars 2019:

~ Miratuar Ligji nr. 48/2018 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Në kuadër të ndryshimeve të parashikuara në këtë ligj Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë po bashkëpunon me Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme për ndërtimin e një regjistri të mësuesve në Diasporë.

~ Në Samitin e Dytë të Diasporës, u mbajt edhe Paneli III: “Identiteti Shqiptar e ardhmja fillon nga Diaspora!”, dedikuar Arsimit, Kulturës, Artit dhe filantropisë si cilësi komunitare.

~ Në zbatim të Urdhrit të Përbashkët nr. 682/2018 “Për ngritjen e Grupit të Punës për hartimin e projektakteve nëligjore për regjistrin shtetëror të mësuesve të diasporës dhe të certifikatës së nxënësve në diasporë”, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, me mbështetjen e Ministrit të Shtetit për Diasporën propozoi për miratim pranë Këshillit të Ministrave projekt vendimin “Për përcaktimin e kriterëve për krijimin e regjistrit shtetëror të mësuesve të gjuhës shqipe e të kulturës shqiptare dhe dhënien e certifikatës për nxënësit në diasporë”.

~ Miratuar Vendimi nr. 104/2019 i Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve për krijimin e regjistrit shtetëror të mësuesve të gjuhës shqipe e të kulturës shqiptare dhe dhënien e certifikatës për nxënësit në diasporë”.

~ Në kuadër të përmbushjes së masës 15 për vitin 2019, INSTAT ka filluar punën përgatitore për realizimin e Raportit Vjetor për vitin 2019. Në kuadër të zbatimit të kësaj mase, INSTAT do të përfshijë në raportin vjetor për vitin 2019 edhe masa të tjera të Planit të Veprimit si: 30, 32, 33, 40, 41, 59, 60 dhe 64, me qëllim evidentimin dhe llogaritjen e disa indikatorëve. Për këtë çështje INSTAT ka filluar komunikimin zyrtar me institucionet përgjegjëse.

~ Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë i është drejtuar Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, me shkresën nr.463 Prot., datë 17.01.2019, ku i kërkon informacion për:

- Shoqatat që mbështesin mësimin plotësues të gjuhës shqipe në diasporë;
- Kurset e mësimit plotësues të gjuhës shqipe (numrin e nxënësve, tekstet me të cilat punojnë, grupmoshat, vlerësimin, përfshirjen e mësimit të gjuhës shqipe në kurrikulën e shtetit përkatës, kush është përfshirë në mësimin e gjuhës shqipe, si edhe institucioni ku zhvillohet kursi i mësimit të gjuhës shqipe;
- Mësuesit në Diasporë.

~ Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, me shkresën nr. 4455 Prot., datë 29.03.2019, i ka përcjellë Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë informacionin e

kërkuar.

Prill - Qershor 2019:

~ Dërguar shkresa nr. 1957 Prot., datë 05.04.2019 Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Akademisë së Shkencave, ku i kërkohet dërgimi i informacionit mbi zbatimin e Vendimit nr. 104/2019 "Për përcaktimin e kriterëve për krijimin e regjistrit shtetëror të mësuesve të gjuhës shqipe e të kulturës shqiptare dhe dhënien e çertifikatës për nxënësit në diasporë".

~ Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, me shkresën nr.3854/1 Prot., datë 17.04.2019 informon se kanë filluar punën për hartimin e aktit nënligjor që do të përcaktojë rregullat për aplikimin, procedurat, afatet dhe dokumentacionin që duhet të paraqesin mësuesit e gjuhës shqipe e kulturës shqiptare në Diasporë, për të qenë pjesë e regjistrit shtetëror të mësuesve të Diasporës.

~ Qendra e Botimeve për Diasporën është në proces të përgatitjes së një dokumenti me informacione të plota për mësimdhënien në Diasporë, në ndihmesë të mësuesve, të cilët e ushtrojnë këtë profesion në shërbim të komuniteteve shqiptare jashtë vendit.

~ Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, me shkresën nr. 8485 Prot., datë 10.06.2019 informon mbi takimin e zhvilluar me Sekretaren e Përgjithshme të Konferencës së Drejtorëve të Arsimit të kantoneve të Konfederatës për identifikimin e problematikave të mësimit të kulturës dhe gjuhës shqipe në Zvicër.

~Dërguar shkresa nr. 301 Prot., datë 18.06.2019 Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë ku kërkohet informacion mbi hapat që do të ndërmerren lidhur me krijimin e regjistrit të mësuesve dhe çertifikatat e nxënësve në Diasporë.

~ Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë ka përcjellë informacionin e kërkuar me shkresën nr. 301/1 Prot., datë 03.07.2019 në lidhje me hapat e ndërmarra për regjistrin e mësuesve shqiptarë dhe çertifikatat e nxënësve në Diasporë.

~ Ministri i Shtetit për Diasporën, me shkresën nr. 3455 Prot., datë 28.06.2019 ka kërkuar Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë hapjen e një sektori të posaçëm për Diasporën në këtë institucion.

~ Në proces diskutimi është gjetja e në modeli të pranueshëm për skemën e pensioneve për mësuesit që ushtrojnë këtë profesion në Diasporë, në shërbim të arsimit dhe kulturës shqiptare.

Korrik - Shtator 2019:

~ Miratuar Vendimi nr. 443, datë 26.06.2019 i Këshillit të Ministrave "Për organizimin e procesit mësimor dhe përzgjedhjen e arsimtarëve në diasporë".

~ Miratuar Vendimi nr. 492, datë 10.07.2019 i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e çmimeve dhe kategorive që përfitojnë falas tekstet e botuara nga Qendra e Botimeve për Diasporën për vitin shkollor 2019 - 2020".

~ Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë me shkresën nr.2278/1 Prot., datë 24.07.2019 informon se krijimi i një sektori të posaçëm për diasporën pranë këtij institucioni nuk është i mundur pasi procedurat për bursat studimore jashtë Shqipërisë për studentë

shqiptarë, sipas marrëveshjeve dypalëshe, ndiqen nga Drejtoria e Integritit, Koordinimit, Marrëveshjeve dhe Asistencës (DIKMA).

~ Qendra e Botimeve për Diasporën ka publikuar dokumentin "Udhëzues për mësimdhënien në Diasporë 2019". Ky material është një dokument informues i ndryshimeve ligjore, akteve dhe shkresave me rëndësi në mbështetje të mësuesve dhe mësimdhënies në Diasporën shqiptare. Ai synon të paraqesë ecurinë e deritanishme të politikave shtetërore që ndikojnë drejtpërdrejt në përmirësimin e statusit të shkollave shqipe dhe të mësuesve në Diasporë. Ky udhëzues është një tregues i bashkëpunimit midis Shqipërisë dhe Kosovës për miratimin e teksteve të përbashkëta për Diasporën nga Komisioni i Përbashkët ndërshtetëror, në zbatim të Marrëveshjes së Përbashkët mes institucioneve përgjegjëse të dy vendeve.

Tetor - Dhjetor 2019:

~ Miratuar Vendimi Nr. 723, datë 11.11.2019 i Këshillit të Ministrave "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 492, datë 10.07.2019 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e çmimeve dhe të kategorive që përfitojnë falas tekstet e botuara nga Qendra e Botimeve për Diasporën për vitin shkollor 2019 - 2020".

~ Qendra e Botimeve për Diasporën përditëson në vazhdimësi hartën digjitale të shkollave shqipe në diasporë, si dhe të dhënat për mësuesit e gjuhës shqipe në diasporë.

~ Akademia e Shkencave në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Diasporës dhuroi 152 tituj për Agjencinë për Zbatimin e Gjuhës që e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut, një institucion i ri shtetëror në Maqedoninë e Veriut.

~ Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, në varësi të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë shpalli më datë 1 tetor thirrjen për aplikim për regjistrim në regjistrin shtetëror të mësuesve të gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në diasporë. Thirrja qëndroi e hapur deri më datë 30 tetor. Pas vlerësimit të dokumentacionit ASCAP do të bëjë publike listën e mësuesve të regjistruar në këtë fazë të parë.

Janar - Mars 2020:

~ Me shkresën Nr. 795/1, datë 10.02.2020 Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë ka përcjellë listën e mësuesve të gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në Diasporë.

~ Qendra e Botimeve për Diasporën ka siguruar aksesin e 300 mësuesve në Diasporë në Platformën digjitale të mësimdhënies së gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare për vitin shkollor 2020-2021.

~ Me propozim të Ministrit të Shtetit për Diasporën është hartuar projektvendimi "Për regjistrin shtetëror të mësuesve të gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë" dhe i është dërguar për mendim Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Ministrisë së Drejtësisë përmes platformës e-akte.

Prill - Qershor 2020:

~ Qendra e Botimeve për Diasporën, në zbatim të Vendimit Nr. 8, datë 07.11.2019 të Këshillit Koordinues të Diasporës, siguroi akses falas në platformën digjitale "Schoolme" për 300 mësues të gjuhës shqipe në Diasporë. Kjo platformë do të ndihmojë për

promovimin dhe përhapjen e gjuhës shqipe në Diasporë. Platforma ka qenë ndihmesa kryesore për zhvillimin e mësimin në situatën e pandemisë globale.

Realizuar (periodike)

Masa Nr.61

Krijimi i një strukture permanente, që do të ndjekë vlerësimin dhe sigurimin e teksteve shkollore të nevojshme. Ajo do të ndjekë trajnimin e mësuesve që do të japin mësim në kurset, që do të krijohen për këtë qëllim. Sigurimi i vazhdueshëm i teksteve shkollore për diasporë dhe trajnimi i mësimeve mbi kurikulat e përbashkëta me Kosovën.

INDIKATORËT: Krijimi i një strukture permanente, për tekstet shkollore dhe trajnimin e mësuesve; Sigurimi i teksteve shkollore dhe trajnimi i mësimeve.

AFATI KOHOR: 6 muhori i parë 2019 (periodike çdo vit)

INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:

- **Ministri i Shtetit për Diasporën**
- **Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë**
- **Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme**

Janar - Mars 2019:

- ~ Qendra e Botimeve për Diasporën ka nisur funksionimin që prej janarit 2019.
- ~ Në përputhje me Vendimin nr. 469/2018 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve për Diasporën”, janë emëruar, me Urdhrin Nr. 3/2018, të Ministrit të Shtetit për Diasporën, kryetari dhe anëtarët e Këshillit Koordinues të Botimeve për Diasporën.
- ~ Është emëruar Drejtori i Qendrës së Botimeve për Diasporën. Në proces miratimi i strukturës dhe emërimi i personelit.
- ~ Në funksion të "Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Rinisë dhe Sporteve dhe Ministrisë së Diasporës së Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës për organizimin e përbashkët të mësimin të gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare" datë 23.03.2015 është ngritur grupi i kurikulës i cili pas disa takimesh ka finalizuar “Kurrikulën e mësimin plotësues të gjuhës shqipe dhe të kulturës Shqiptare në Diasporë dhe Mërgatë” nënshkruar nga ministrat përgjegjës të arsimit të Shqipërisë dhe Kosovës në maj 2018. Mbi bazën e kësaj kurrikule po punohet për çështjet e vlerësimit të teksteve shkollore dhe është në proces ngritja e komisionit të përbashkët për tekstet mësimore të arsimit në Diasporë.
- ~ Miratuar Vendimi nr. 697/2017, i Këshillit të Ministrave “Për miratimin në parim, të Marrëveshjes së bashkëpunimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës, për financimin dhe organizimin e përbashkët të mësimin të gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në Diasporë”.
- ~ Në proces ngritja e komisionit të përbashkët për tekstet mësimore të arsimit në

Diasporë.

~ Kanë filluar përgatitjet e përbashkëta ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë në Shqipëri dhe Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës për organizimin e seminarit vjetor të mësuesve të Diasporës, në datat 31 korrik - 3 gusht 2019, në Kosovë.

~ Për dërgimin e teksteve të mësimit bazë të gjuhës shqipe është në proces planifikimi i sasisë së teksteve sipas kërkesave që do të paraqiten nga përfaqësitë diplomatike nëpërmjet Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme.

Prill - Qershor 2019:

~ Miratuar Urdhri nr. 76, datë 15.04.2019 i Kryeministrit "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Qendrës së Botimeve për Diasporën". U ngrit komisioni përgjegjës për rekrutimin e personelit të Qendrës së Botimeve për Diasporën, i cili e përfundoi procesin e rekrutimit duke e bërë funksional institucionin përgjegjës për botimin dhe sigurimin e teksteve mësimore për Diasporën.

~ Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë me shkresën nr. 4410/1 Prot., datë 24.04.2019, propozon 3 anëtarë për komisionin e përbashkët për hartimin e teksteve të përbashkëta për Diasporën.

~ Në datë 22 maj 2019 u mbledh për herë të parë Komisioni i Përbashkët i Shqipërisë dhe Kosovës për Miratimin e Teksteve Mësimore për Diasporën, në koordinimin e Qendrës së Botimeve për Diasporën. Anëtarët e Komisionit zgjodhën kryetarin e Komisionit, z. Nuhi Gashi, përfaqësues i Kosovës. Komisioni i Përbashkët i Shqipërisë dhe Kosovës për miratimin e teksteve mësimore për Diasporën vendosi gjithashtu hartimin e rregullores së funksionimit të Komisionit nga përfaqësuesit e Kosovës brenda dy javëve nga data e takimit.

~ Në datat 26 dhe 27 qershor 2019, Komisioni i Përbashkët i Shqipërisë dhe Kosovës për Miratimin e Teksteve Mësimore për Diasporën zhvilloi mbledhjen e dytë në Prishtinë me qëllim planifikimin e punës për shpalljen e konkursit për hartimin dhe miratimin e teksteve mësimore për Diasporën. Në përfundim të këtij takimi komisioni vendosi që brenda vitit 2019 të shpallë konkursin për nivelin e parë për tekstet mësimore të përbashkëta për Diasporën. Ndërkohë, Komisioni do të përgatisë dokumentacionin për shpalljen e konkursit, duke filluar nga plotësimi i standarteve për tekstet për Diasporën. Komisioni hartoi dhe miratoi gjithashtu kalendarin e punës deri në miratimin përfundimtar të teksteve mësimore për Diasporën.

~ Miratuar Vendimi nr. 443, i Këshillit të Ministrave, datë 26.06.2019 "Për organizimin e procesit mësimor dhe përzgjedhjen e arsimtarëve në diasporë" përmes së cilit përcaktohet përgjegjëse Qendra e Botimeve për Diasporën për sigurimin e sasisë së teksteve mësimore dhe materialeve plotësuese për Diasporën brenda muajit gusht të çdo viti.

~ Hartuar Projekt Vendimi i Këshillit të Ministrave "Për shpërndarjen dhe kategoritë që përfitojnë falas tekstet e botuara nga Qendra e Botimeve për Diasporën për vitin shkollor 2019 - 2020", përmes së cilit përcaktohet sasia e teksteve mësimore që do të shpërndahen falas në Diasporë përmes Qendrës së Botimeve për Diasporën në bashkëpunim me Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme në përputhje me listën zyrtare të dërguar prej saj.

- Qendra e Botimeve për Diasporën është në proces të plotësimit të kërkesave dhe sigurimit të teksteve shkollore për mësimin plotësues të gjuhës dhe kulturës shqipe në shkollat shqipe në Diasporë për vitin shkollor 2019-2020, në përputhje me listën zyrtare të dërguar nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme.

- Qendra e Botimeve për Diasporën është në proces të përgatitjes së një dokumenti me informacione të plota për mësimdhënien në Diasporë, në ndihmesë të mësuesve, të cilët e ushtrjnë këtë profesion në shërbim të komuniteteve shqiptare jashtë vendit.

- Nga data 31 korrik deri më 3 gusht 2019 Qendra e Botimeve për Diasporën do të marrë pjesë në seminarin XV për mësimin plotësues të gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në Diasporë të organizuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe e Teknologjisë (MASHT) e Republikës së Kosovës dhe Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR) e Republikës së Shqipërisë.

Korrik - Shtator 2019:

- Miratuar Vendimi nr. 443, datë 26.06.2019 i Këshillit të Ministrave "Për organizimin e procesit mësimor dhe përzgjedhjen e arsimtarëve në diasporë".

- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, me shkresat me nr. 9045/1, datë 01.07.2019 dhe nr. 9045/1, datë 02.07.2019 ka dërguar listat me tekstet shkollore për mësimin plotësues të kulturës dhe gjuhës shqipe për diasporën për vitin shkollor 2019-2020.

- Miratuar Vendimi nr. 492, datë 10.07.2019 i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e çmimeve dhe kategorive që përfitojnë falas tekstet e botuara nga Qendra e Botimeve për Diasporën për vitin shkollor 2019 - 2020".

- Në 22-23 korrik u zhvillua në Vlorë mbledhja e tretë e Komisionit të Përbashkët të Shqipërisë dhe Kosovës për miratimin e teksteve të përbashkëta. Në këtë mbledhje u diskutuan dhe u hartuan standardet për tekstet e përbashkëta për Diasporën.

- Në datat 31 korrik- 3 gusht 2019 Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e Republikës së Kosovës dhe Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë e Republikës së Shqipërisë organizuan Seminarin e XV të mësimin plotësues të gjuhës shqipe. Në këtë aktivitet mori pjesë edhe drejtoresha ekzekutive e Qendrës së Botimeve për Diasporën znj. Mimoza Hysa, e cila prezantoi para mësuesve misionin dhe vizionin e Qendrës së Botimeve për Diasporën, hapat e ndërmarrë për hartimin e teksteve të reja të përbashkëta për mësimdhënien në Diasporë, si dhe projektet e tjera për ruajtjen dhe përhapjen e gjuhës dhe kulturës shqiptare jashtë vendit. Qendra e Botimeve për Diasporën shpërndau për mësuesit "Udhëzuesin për mësimdhënien në Diasporë" botuar nga QBD-ja, si dhe materiale të tjera informuese.

- Qendra e Botimeve për Diasporën, me shkresën nr. 169 Prot., datë 26.08.2019 drejtuar Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme informon për sasinë e dërguar të teksteve për diasporën për vitin shkollor 2019 - 2020 pranë këtij institucioni.

- Qendra e Botimeve për Diasporën ka publikuar dokumentin "Udhëzues për mësimdhënien në Diasporë 2019". Ky material është një dokument informues i ndryshimeve ligjore, akteve dhe shkresave me rëndësi në mbështetje të mësuesve dhe

mësimdhënies në Diasporën shqiptare. Ai synon të paraqesë ecurinë e deritanishme të politikave shtetërore që ndikojnë drejtpërdrejt në përmirësimin e statusit të shkollave shqipe dhe të mësuesve në Diasporë. Ky udhëzues është një tregues i bashkëpunimit midis Shqipërisë dhe Kosovës për miratimin e teksteve të përbashkëta për Diasporën nga Komisioni i Përbashkët ndërshtetëror, në zbatim të Marrëveshjes së Përbashkët mes institucioneve përgjegjëse të dy vendeve.

~ Qendra e Botimeve për Diasporën në bashkëpunim me Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Postën Shqiptare ka përfunduar të gjitha dërgesat e teksteve shkollore falas për mësimdhënien në Diasporë, sipas kërkesave të përfaqësive diplomatike dhe konsullore jashtë vendit.

Tetor - Dhjetor 2019:

~ Vijon komunikimi për vazhdimësinë e punës së Komisionit të Përbashkët Shqipëri - Kosovë për hartimin e teksteve shkollore të përbashkëta, pezulluar prej situatës zgjedhore në Kosovë.

~ Qendra e Botimeve për Diasporën, me shkresën Nr. 205 Prot., datë 09.10.2019, drejtuar Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme bën me dije se në adresë të QBD-së kanë ardhur kërkesa shtesë për tekste shkollore nga shoqatat e mësuesve shqiptarë në Diasporë (Austri, SHBA, Norvegji, Mbretëri e Bashkuar, Itali, Greqi, Finlandë dhe Gjermani) dhe kërkon bashkëpunim në sigurimin e teksteve në bazë të gjendjes aktuale të teksteve në magazinën e MEPJ-së.

~ Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, me shkresën Nr. 14896, datë 18.10.2019, dërgon listën me gjendjen aktuale të teksteve në magazinën e MEPJ-së.

~ Me shkresën Nr. 15869 Prot., datë 06.11.2019, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme drejtuar Qendrës së Botimeve për Diasporën kërkon mundësimin e një kontigjenti librash për mësimin e kulturës dhe gjuhës shqipe në shkollën e re të mësimin të gjuhës shqipe në Madrid nga shoqata “Los albaneses en Espana”.

~ Miratuar Vendimi Nr. 723, datë 11.11.2019 i Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin Nr. 492, datë 10.07.2019 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e çmimeve dhe të kategorive që përfitojnë falas tekstet e botuara nga Qendra e Botimeve për Diasporën për vitin shkollor 2019 - 2020”.

~ Me shkresën Nr. 243/1 Prot., datë 13.11.2019, drejtuar Ministrisë së Evropës dhe Punëve të Jashtme, QBD-ja vlerësoi pajisjen nga MEPJ-ja me kargo diplomatike të 25 librave “Të mësojmë gjuhën amtare 1” dhe 25 sete abetaresh për shkollën e re të mësimin të gjuhës shqipe në Madrid.

~ Qendra e Botimeve për Diasporën me shkresën Nr. 248 Prot., datë 15.11.2019, drejtuar Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme informon për kërkesat e tjera shtesë për tekste të ardhura nga shkollat e mësimin të gjuhës shqipe në adresë të QBD-së dhe kërkon bashkëpunimin e MEPJ-së për sigurimin e teksteve shkollore në bazë të gjendjes aktuale të tyre në magazinën e MEPJ-së.

~ Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, me shkresën Nr. 16983, datë 25.11.2019 konfirmon bashkëpunimin në sigurimin e teksteve shkollore në Diasporë dhe sugjeron që këto tekste të dërgohen në adresë të përfaqësive diplomatike me qëllim bashkëpunimin e komunitetit me ambasadën.

- Në datë 07.11.2019, Këshilli Koordinues i Botimeve për Diasporën, vendosi miratimin e botimit të “Fjalor dygjuhësh për fëmijë” në gjuhët: shqip-italisht, shqip-anglisht, shqip-greqisht, shqip-gjermanisht, shqip-frëngjisht, shqip-kroatisht, shqip-turqisht, shqip-ukrainisht, shqip-spanjisht; miratimin e serisë (kolanës) “Klasikët dygjuhësorë” e shtëpisë botuese spanjolle “Libsa” me 7 libra me nga 2 rrëfenja për secilin libër dhe blerjen e të drejtës për akses në platformën on-line të mësimin të gjuhës shqipe për rreth 300 mësues në Diasporë.

- Takimi i Mësuesve në Diasporë (14 mars 2020) do të organizohet nga Qendra e Botimeve për Diasporën në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Është hapur formulari i aplikimit online për regjistrimin e mësuesve pjesëmarrës dhe është përgatitur agjenda e takimit.

- Qendra e Botimeve për Diasporën në bashkëpunim me Lidhjen e Mësuesve të Greqisë dhe Lidhjen e Mësuesve të Italisë, po përgatit zhvillimin e dy aktiviteteve me mësuesit e shkollave shqipe në këto vende, me qëllim shpërndarjen e literaturës shtesë në ndihmesë të procesit mësimor, si dhe njohjen e problematikave shqetësuese të mësuesve, prindërve dhe nxënësve në këto dy vende.

Janar - Mars 2020:

- Qendra e Botimeve për Diasporën vijon komunikimin për rinisjen e punës së Komisionit të Përbashkët Shqipëri - Kosovë, për përmbushjen e objektivave të përcaktuara nga marrëveshja e bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Diasporës së Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës “Për organizimin e përbashkët të mësimin të gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në diasporë dhe në mërgatë” firmosur më 25 mars 2015.

- Qendra e Botimeve për Diasporën organizoi takimin me mësues shqiptarë në Itali më datë 8 shkurt 2020 në Reggio Emilia për prezantimin e literaturës plotësuese me 11 tituj librash të miratuar nga Këshilli Koordinues i Botimeve për Diasporën, si dhe pajisjen e 100 mësuesve të Italisë me paketën e literaturës plotësuese.

Prill - Qershor 2020:

- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, me shkresën Nr. 5191 Prot., datë 07.05.2020, ka përcjellë pranë Qendrës së Botimeve për Diasporën listën e kërkesave për tekste mësimore dhe materiale plotësuese të Shkollës Shqipe në Zvicër, e cila sponsorizohet nga Ambasada e Republikës së Shqipërisë në Bernë.

- Miratuar Vendimi Nr.408, datë 20.05.2020 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e çmimeve dhe kategorive që përfitojnë falas tekstet/librat e botuar nga Qendra e Botimeve për Diasporën “Klasikët dygjuhësh” dhe “Fjalor dygjuhësh për fëmijë”.

- Qendra e Botimeve për Diasporën zhvilloi në muajin prill mbledhjen me Komisionin e Përbashkët Shqipëri-Kosovë për Miratimin e Teksteve Mësimore për Diasporën, i cili është ngritur në zbatim të marrëveshjes së miratuar midis dy shteteve “Për organizimin e përbashkët të mësimin të gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në Diasporë dhe mërgatë”. Në këtë mbledhje u diskutua për problematikat e hasura deri tani në punën e këtij komisioni dhe për mënyrën e procedimit në të ardhmen. Për shkak të situatës së krijuar, takimi u zhvillua online.

~ Qendra e Botimeve për Diasporën, për shkak të situatës së krijuar në shkollat shqipe në Diasporë si pasojë e emergjencës virusale, ka zhvilluar disa takime online me përfaqësues të shkollave shqipe, me qëllim marrjen e informacioneve dhe gjetjen e zgjidhjeve për problematikat e ngritura. QBD-ja ka organizuar gjithsej 7 takime online me përfaqësues të mësimdhënies së gjuhës shqipe nga shtete, si: Italia, Greqia, Gjermania, Zvicra, Anglia, SHBA-ja, Kanadaja, Spanja dhe Turqia. Në këto mbledhje u diskutua për problematikat e ndryshme lidhur me mësimin e gjuhës shqipe në kushtet e situatës së re të krijuar prej Covid-19, rëndësinë dhe mënyrën e përdorimit të Platformës digjitale për mësimin e gjuhës shqipe dhe pajisjen me tekste mësimore për vitin shkollor 2020-2021.

NË PROCES

| Masa Nr.62 |

Zhvillimi i projektit "e-book" (shkarkimi on-line i teksteve shkollore të vendosura në programin arsimor për diasporën) me qëllim shpërndarjen e librave në të gjithë botën dhe krijimin e lehtësirave për të furnizuar të gjithë me materialet e nevojshme për mësimin e gjuhës dhe kulturës shqipe.

INDIKATORËT: Projekti "e-book" për shpërndarjen e librave.

AFATI KOHOR: 6 maji i dytë 2018

INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:

- Ministri i Shtetit për Diasporën
- Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
- Akademia e Shkencave

Buletini 2018:

~ Miratuar Vendimi nr. 469/2018, i Këshillit të Ministrave, "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve për Diasporën".

~ Dërguar shkresa nr. 4323 Prot., datë 21.09.2018 Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë në përputhje me Vendimin nr. 469/2018 të Këshillit të Ministrave "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve për Diasporën".

~ Përgatitur relacion informues paraprak mbi kostimin e zhvillimit dhe realizimit të projektit e-book. Bashkëpunimi zyrtar me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) është një ndër pikat kryesore që duhet realizuar. AKSHI, bazuar në Vendimin Nr. 248/2007 të Këshillit të Ministrave, parashikon përcaktimin e standardeve të TIK për administratën publike, i cili merret me menaxhimin e serverave online të institucioneve shtetërore.

Janar - Mars 2019:

~ Në kuadër të projektit “Diaspora për Zhvillim” të Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës, një ndër aktivitetet e parashikuara është dixhitalizimi i 100 veprave të shkruara në gjuhën shqipe. Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës është duke vlerësuar mundësinë e realizimit të një projekti të përbashkët për këtë qëllim me Fondin Shqiptaro - Amerikan të Zhvillimit.

Prill - Qershor 2019:

~ Në faqen zyrtare të Qendrës së Botimeve për Diasporën është krijuar nënndarja “Botime - Tekste shkollore”, në të cilën janë hedhur 19 fletore tematike të botuara falë projektit për mësimin plotësues të gjuhës së prejdardhjes (MGJP), i realizuar nga Shkolla e Lartë Pedagogjike e Cyrihut (PH Zürich, IPE).

- Është krijuar gjithashtu nënndarja “Portali digjital - e-book”, në të cilën janë hedhur libra të mundësuar nga Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë dhe Biblioteka Publike “Marin Barleti” Shkodër.

~ Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës, në kuadër të projektit “Diaspora për Zhvillim”, do të realizojë dixhitalizimin e 100 veprave të shkruara në gjuhën shqipe. Platforma e dixhitalizimit do të ofrojë mundësinë për shqiptarët në Diasporë të njihen me letërsinë e gjuhës shqipe, duke lexuar vepra të autorëve shqiptarë dhe duke dëgjuar audio-libra. Digjitalizimi i disa veprave shqiptare shfrytëzon teknologjinë për t’i ndihmuar ata të ruajnë identitetin e tyre duke u njohur me autorë dhe libra shqiptarë. Këta libra do të prezantohen nëpërmjet një platforme të ndarë sipas zhanrit, autorit dhe vitit e cila do të mund të shfletohen nga përdoruesit.

~ Ministri i Shtetit për Diasporën, me shkresën nr. 3455 Prot., datë 28.06.2019 ka kërkuar Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë hapjen e një sektori të posaçëm për Diasporën në këtë institucion.

Korrik - Shtator 2019:

~ Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë me shkresën nr.2278/1 Prot., datë 24.07.2019 informon se krijimi i një sektori të posaçëm për diasporën pranë këtij institucioni nuk është i mundur pasi procedurat për bursat studimore jashtë Shqipërisë për studentë shqiptarë, sipas marrëveshjeve dypalëshe, ndiqen nga Drejtoria e Integritit, Koordinimit, Marrëveshjeve dhe Asistencës (DIKMA).

~ Nënshkruar Marrëveshja e Bashkëpunimit ndërmjet Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës dhe Institutit “Alb-shkenca” “Për bashkëpunimin në fushën e kërkim-zhvillimit dhe të bashkëveprimit me diasporën shkencore shqiptare”. Kjo marrëveshje përfshin bashkëpunimin në fushën e kërkimit shkencor, organizimin e konferencave shkencore, botimeve dhe studimeve në funksion të interesit dhe përfitimit të përbashkët. Aktivitetet bashkëpunuese në kuadër të kryerjes së kërkimit shkencor përfshijnë bashkëpunimin për zhvillimin dhe promovimin e aktiviteteve me interes të përbashkët nëpërmjet rrjeteve ndërkombëtare, botimin dhe publikimin e studimeve mbi historinë e Diasporës shqiptare dhe trashëgiminë kulturore, si dhe promovimin e publikimin e studimeve apo botimeve në formatin e-book.

~ Në faqen zyrtare të Qendrës së Botimeve për Diasporën është krijuar nënndarja “Botime - Tekste shkollore”, në të cilën janë hedhur 19 fletore tematike të botuara falë projektit për mësimin plotësues të gjuhës së prejdardhjes (MGJP), i realizuar nga Shkolla e Lartë Pedagogjike e Cyrihut (PH Zürich, IPE).

~ Në faqen zyrtare të Qendrës së Botimeve për Diasporën është krijuar nënndarja “Portali digjital - e-book”, në të cilën janë hedhur një sasi e konsiderueshme librash digjitalë, mundësuar nga Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë dhe Biblioteka Publike “Marin Barleti” Shkodër.

~ Në faqen zyrtare të Qendrës së Botimeve për Diasporën është krijuar nënndarja “Portali digjital - audiobook”, në të cilën është hedhur një sasi e konsiderueshme librash audio, mundësuar nga kompania e sigurimeve “Sigal”.

~ Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës ka realizuar procesin e rekrutimit të dy ekspertëve për përzgjedhjen e veprave shqiptare që do të hidhen në platformën digjitale. Platforma dixhitale e veprave shqiptare do të shërbejë si mekanizëm për konsultimin online jo vetëm të veprave të përzgjedhura të letërsisë shqipe ndër vite por edhe për botimet e autorëve të diasporës si dhe pasqyrimin e studimeve më të rëndësishme të diasporës shkencore shqiptare, duke kontribuar në zhvillimin e mendimit kritik, progresit kulturor dhe shkencor.

Tetor - Dhjetor 2019:

~ Në faqen zyrtare të Qendrës së Botimeve për Diasporën (www.qbd.al) është krijuar nënndarja “Botime - Tekste shkollore”, në të cilën janë hedhur 19 fletore tematike të botuara falë projektit për mësimin plotësues të gjuhës së prejardhjes (MGJP), si dhe për mësuesit në Diasporë të pajisur me tekste shkollore nga Qendra e Botimeve për Diasporën janë mundësuar tekstet digjitale, duke iu referuar kodit në kopertinë.

~ Është krijuar gjithashtu nënndarja “Portali digjital - e-book”, në të cilën janë hedhur libra të mundësuar nga Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë dhe Biblioteka Publike “Marin Barleti” Shkodër.

~ Në datë 07.11.2019, Këshilli Koordinues i Botimeve për Diasporën vendosi blerjen e të drejtës për akses në platformën on-line të mësimin të gjuhës shqipe për rreth 300 mësues në Diasporë.

-Qendra e Botimeve për Diasporën, në zbatim të Vendimit Nr. 8, datë 07.11.2019 të Këshillit Koordinues për Diasporën, siguroi akses falas në platformën digjitale “Schoolme” për 300 mësues të gjuhës shqipe në Diasporë.

~ Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës ka zhvilluar aktivitetin e radhës lidhur me projektin “Diaspora për Zhvillim”, i cili synon digjitalizimin e veprave letrare shqiptare në formatin elektronik në funksion të lexuesit në Diasporë. Gjatë kësaj periudhe, nëpërmjet një grupi pune në nivel ekspertësh, janë përzgjedhur autorët dhe veprat.

Janar - Mars 2020:

~ Qendra e Botimeve për Diasporën ka siguruar aksesin e 300 mësuesve në Diasporë në Platformën digjitale të mësimdhënies së gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare për vitin shkollor 2020-2021.

~ Në kuadër të projektit “Diaspora për Zhvillim”, Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës po përditëson platformën e digjitalizimit të 100 veprave nga autorë të letërsisë së gjuhës shqipe. Qendra e Botimeve për Diasporën po mbështet dhe monitoron procesin e digjitalizimit të veprave shqiptare të përzgjedhura nga Fondi

Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës.

Prill - Qershor 2020:

~ Qendra e Botimeve për Diasporën, botoi për fëmijët shqiptarë që jetojnë jashtë trojeve shqiptare serinë “Klasikët Dytëgjyesh”. Seria përfshin përrallat më të bukura, botuar në një vëllim dygjuhësh: shqip dhe anglisht, shqip dhe greqisht, shqip dhe italisht. Projekti i botimeve dygjuhëshe u vjen në ndihmë fëmijëve shqiptarë të rritur në mërgatë që gjuhën shqipe e mësojnë paralelisht me gjuhën e vendit, apo si gjuhë të dytë. QBD-ja e solli serinë “Klasikët Dytëgjyesh” edhe në formatin e-book, të shkarkueshëm falas për të gjithë.

~ Qendra e Botimeve për Diasporën, botoi fjalorët dygjuhësh për fëmijë: shqip-anglisht; shqip-italisht; shqip-greqisht dhe shqip-ukrainisht. Fjalori dygjuhësh për fëmijë është konceptuar për fëmijë të moshës deri në 6 vjeç dhe shoqërohet me ilustrime të përzgjedhura me kujdes për t’i qartësuar dhe për t’i konkretizuar edhe më shumë fjalët duke i bërë ato edhe më të kuptueshme për fëmijët. Këta fjalorë janë të shkarkueshëm falas në formatin e-book.

~ Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës, në kuadër të projektit “Diaspora për Zhvillim”, është në proces të zhvillimit të platformës “Digjitalizimi i Veprave Shqiptare”.

~ Nënshkruar Marrëveshja e Bashkëpunimit midis Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët (QSPA) dhe Bibliotekës Kombëtare të Kosovës “Pjetër Bogdani”. Në bazë të kësaj marrëveshjeje, pritet që të dyja institucionet të bashkëpunojnë për shkëmbimin e literaturës shkencore në funksion të hulumtimit të autorëve dhe të të dhënave mbi Arbëreshët. Gjithashtu, në qendër të marrëveshjes është edhe koordinimi në aspektin shkencor e profesional, në fushën e digjitalizimit të veprave mbi Arbëreshët, si dhe të veprimtarive të përbashkëta kulturoro-shkencore, mes të cilave shihet me përparësi promovimi i veprimtarive me karakter bibliografik, ekspozitave e botimeve.

NË PROCES

| Masa Nr.63 |

Rishikimi dhe nënshkrimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucionet arsimore në vendet pritëse, për hapjen e kurseve në gjuhën shqipe në shkollat e ambientet edukative ekzistuese në këto vende. (Krijimi dhe nxitja e programeve për mësimdhënien e gjuhës shqipe për fëmijët e emigrantëve shqiptarë në bashkëpunim me strukturat përkatëse të vendeve pritëse). Nënshkrimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucionet arsimore në vendet pritëse, për hapjen e kurseve në gjuhën shqipe në shkollat e ambientet edukative ekzistuese në këto vende.

INDIKATORËT: Marrëveshje bashkëpunimi për hapjen e kurseve në gjuhën shqipe.

AFATI KOHOR: 6 mujori i dytë 2018 (periodike çdo vit)

INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:

- **Ministri i Shtetit për Diasporën**
- **Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme**
- **Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë**

Buletini 2018:

~ Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë është në proces të realizimit të një plan-veprimi për të nënshkruar marrëveshje për hapjen e kurseve në gjuhën shqipe në institucionet arsimore të vendeve pritëse.

~ Dërguar shkresa nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 4323/1 Prot., datë 29.10.2018 “Mbi kurrikulën e mësimit plotësues të gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë dhe mërgatë”.

~ Në zbatim të Urdhrit të Përbashkët nr. 682/2018 “Për ngritjen e Grupit të Punës për hartimin e projektakteve nënligjore për regjistrin shtetëror të mësuesve të diasporës dhe të certifikatës së nxënësve në diasporë”, janë realizuar takimet midis Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Ministrit të Shtetit për Diasporën.

~ Miratuar Vendimi nr. 690/2018 i Këshillit të Ministrave “Për prodhimin, transmetimin dhe financimin e emisioneve të posaçme televizive, arsimore dhe kulturore, të dedikuara për diasporën”.

Janar - Mars 2019:

~ Miratuar Urdhri nr.47/2019 i Kryeministrit "Për caktimin e koordinatorit shtetëror për programet/donatorët të cilët ofrojnë bursa studimi për jashtë vendit". Koordinator Shtetëror është caktuar z. Redi Shtino, zëvendësministër i Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

~ Miratuar Vendimi nr. 104/2019 i Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve për krijimin e regjistrin shtetëror të mësuesve të gjuhës shqipe e të kulturës shqiptare dhe dhënien e certifikatës për nxënësit në diasporë”.

~ Miratuar Urdhri nr. 180/2018, i Kryeministrit “Për përgatitjen e platformës së programeve të emisioneve të posaçme për mësimin e gjuhës shqipe, kulturën shqiptare dhe identitetin kombëtar, të dedikuara për Diasporën”. Në zbatim të këtij Urdhri, grupi i punës është duke përgatitur dy projekte “Fol Shqip” dhe “Krenohem me Ju”.

~ Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, me shkresën nr. 3683 Prot., datë 13.03.2019, ka përcjellë projekt-marrëveshjen e bashkëpunimit ndërmjet Universitetit Pedagogjik dhe Konsullatës së Nderit të Republikës së Shqipërisë në Kharkiv, Ukrainë për hapjen e katedrës së gjuhës shqipe në Kharkiv.

Prill - Qershor 2019:

~ Koordinator Shtetëror për Programet/donatorët, të cilët ofrojnë bursa studimi për jashtë vendit, caktuar me Urdhrin nr. 47/2019 të Kryeministrit, ka raportuar në mbledhjen e Komitetit Shtetëror për Diasporën (3 maj 2019). Ky raportim zhvillohet çdo 3 muaj.

- Nënshkruar marrëveshja ndërmjet Agjencisë Kombëtare të Diasporës dhe Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë, Universiteti i Tiranës, "Për bashkëpunimin në ruajtjen e gjuhës dhe identitetit kombëtar në Diasporë".

- Dërguar shkresa nr. 228 Prot., datë 20.05.2019 Radiotelevizionit Shqiptar, Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Ministrisë së Kulturës, ku kërkohet informacion mbi lidhjen e marrëveshjeve të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve, në zbatim të Vendimit Nr. 690/2018 të Këshillit të Ministrave "Për prodhimin, transmetimin dhe financimin e emisioneve të posaçme televizive, arsimore dhe kulturore, të dedikuara për diasporën".

- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, me shkresën nr. 8485 Prot., datë 10.06.2019 informon mbi takimin e zhvilluar me Sekretaren e Përgjithshme të Konferencës së Drejtorëve të Arsimit të Kantoneve të Konfederatës për identifikimin e problematikave të mësimin të kulturës dhe gjuhës shqipe në Zvicër.

- Qendra e Botimeve për Diasporën, ka dorëzuar aplikimin në 13 qershor në Thirrjen e hapur të UNESCO-s "Internation Fund for Cultural Diversity", me projektin me titull: "Fuqizimi i bashkëpunimit të katedrave të gjuhës shqipe në botë". Projekti synon fuqizimin e bashkëpunimit të katedrave të gjuhës shqipe në botë nëpërmjet krijimit të rrjetit dhe shkëmbimit të eksperiencave. Rrjeti do të përfshijë një grup të gjerë institucionesh në mënyrë direkte dhe indirekte, si dhe profesorë, shkrimtarë, përkthyes për të krijuar mundësi bashkëpunimi jo vetëm me njëri-tjetrin, por edhe me institucionet shtetërore.

- Ministri i Shtetit për Diasporën, me shkresën nr. 3455 Prot., datë 28.06.2019, i ka kërkuar Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë hapjen e një sektori të posaçëm për Diasporën në këtë institucion.

- Qendra e Botimeve për Diasporën është në proces diskutimi me donatorët për realizimin e një projekti të veçantë për këtë masë ku parashikohet krijimi i një qendre të specializuar për këtë qëllim.

- Qendra e Botimeve për Diasporën është në proces diskutimi me donatorët për realizimin e një projekti të veçantë për këtë masë ku parashikohet krijimi i një qendre të specializuar për këtë qëllim.

Korrik - Shtator 2019:

- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, me shkresën nr. 9011 Prot., datë 18.06.2019 informon lidhur me takimin e zhvilluar me zv. Kryetarin e Këshillit të lartë të Arsimit të Turqisë në kuadër të bashkëpunimit të dy vendeve, krijuar me "Memorandumin e Mirëkuptimit në fushën e Arsimit të Lartë" midis Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Arsimit të Lartë të Turqisë. Ky memorandum synon forcimin e marrëdhënieve mes dy vendeve në fushën e arsimit të lartë, duke nxitur dhe mbështetur ofrimin e bursave për studentë, për njohjen e diplomave dhe mbështetjen për hapjen e departamenteve në gjuhën shqipe në institucionet e arsimit të Turqisë. Gjithashtu u dakordësua që të fillojnë procedurat e binjakëzimit midis universiteteve shtetërore të Shqipërisë dhe Turqisë bazuar në programin e projekteve të përbashkëta "Mevlana".

- Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë me shkresën nr.2278/1 Prot., datë 24.07.2019 informon se krijimi i një sektori të posaçëm për diasporën pranë këtij institucioni nuk është i mundur pasi procedurat për bursat studimore jashtë Shqipërisë për studentë

shqiptarë, sipas marrëveshjeve dypalëshe, ndiqen nga Drejtoria e Integritit, Koordinimit, Marrëveshjeve dhe Asistencës (DIKMA).

~ Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, me shkresën nr.11 041 Prot., datë 29.07.2019 informon mbi njohjen e ambasadës së Republikës së Shqipërisë në Bernë si sponsor zyrtar i mësimin të gjuhës shqipe në kantonin e Zyrihut, Zvicër.

~ Në 10 - 13 shtator 2019 në Ukrainë u firmos memorandum i bashkëpunimit me Institucionin edukativo-arsimor "Azimuth" në Priazov. Ky memorandum synon bashkëpunimin ndërinstitucional dhe edukimin e brezave të rinj për gjuhën, historinë dhe traditat shqiptare përmes organizimit të aktiviteteve të ndryshme në Ukrainë. Një ndër prioritetet është hapja e klasave për mësimin plotësues të gjuhës dhe kulturës shqipe për fëmijët e komunitetit shqiptar në këtë rajon. Gjithashtu memorandum i parashikon shkëmbimin arsimor të stafit pedagogjik me qëllim që mësuesit nga Ukraina të kryejnë studime të specializuara për gjuhën, literaturën dhe historinë shqiptare në Universitetin e Tiranës. Agjencia Kombëtare e Diasporës ka shprehur angazhimin e saj për të mbështetur këtë bashkëpunim.

~ Koordinatori Shtetëror për Programet/donorët të cilët ofrojnë bursa studimi për jashtë vendit, caktuar me Urdhrin nr. 47/2019 të Kryeministrit, z. Redi Shtino ka raportuar në mbledhjen e Komitetit Shtetëror për Diasporën në 17.09.2019.

Tetor - Dhjetor 2019:

~ Qendra e Botimeve për Diasporën ka aplikuar në projektin e financuar nga UNESCO "Internation Fund for Cultural Diversity" për projektin "Mbështetja dhe përhapja e mësimin të gjuhës shqipe në diasporën shqiptare". Aktualisht, projekti e ka kaluar fazën e parë të kualifikimit në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe priten rezultatet e vlerësimit nga UNESCO, në janar 2020.

Janar - Mars 2020:

~ Në proces nënshkrimi i marrëveshjes midis Agjencisë Kombëtare të Diasporës dhe Universiteti Humanitar Shtetëror në Izmail, Ukrainë ku parashikohet hapja e një qendre informacioni të gjuhës dhe kulturës shqipe pranë këtij universiteti. Kjo marrëveshje parashikon bashkërendimin midis dy institucioneve me qëllim përfshirjen e komuniteteve shqiptare të diasporës në jetën kulturore të Ukrainës dhe promovimin e tyre në Shqipëri, duke pasur parasysh që komuniteti i shqiptarëve në Ukrainë është një ndër më të vjetrit.

Prill - Qershor 2020:

~ Në proces nënshkrimi i marrëveshjes midis Agjencisë Kombëtare të Diasporës dhe Universiteti Humanitar Shtetëror në Izmail, Ukrainë ku parashikohet hapja e një qendre informacioni të gjuhës dhe kulturës shqipe pranë këtij universiteti. Kjo marrëveshje parashikon bashkërendimin midis dy institucioneve me qëllim përfshirjen e komuniteteve shqiptare të diasporës në jetën kulturore të Ukrainës dhe promovimin e tyre në Shqipëri, duke pasur parasysh që komuniteti i shqiptarëve në Ukrainë është një ndër më të vjetrit.

Rishikimi dhe orientimi i programeve/donatorëve, të cilët ofrojnë bursa studimore për jashtë vendit, drejt fushave të ekspertizës për të cilat ka nevojë Shqipëria. Vlerësimi i kryerjes së një studimi të thelluar mbi numrin e studentëve shqiptarë në universitetet jashtë vendit dhe mbi fushat ku ata specializohen. Rivlerësimi për përfshirjen e kushtit të kthimit në Shqipëri (për një periudhë jo më pak se një vit) për të gjithë studentët që marrin bursa studimi për jashtë vendit, në kuadër të programeve studimore të donatorëve të ndryshëm për Shqipërinë.

INDIKATORËT: Orientimi i programeve/donatorëve për të cilat ka nevojë Shqipëria; Studim mbi numrin e studentëve shqiptarë dhe fushat ku specializohen; Rivlerësimi për kushtin e kthimit në Shqipëri.

AFATI KOHOR: 6 mujori i dytë 2018 (periodike çdo vit)

INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:

- Ministri i Shtetit për Diasporën
- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
- Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë

Buletini 2018:

~ Miratuar Urdhri nr.135/2018, i Kryeministrit, “Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për zbatimin e masës 64, të Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare për Diasporën”.

~ Dërguar kërkesa për bashkëpunim me zyrën e IOM në Tiranë për kryerjen e një studimi mbi numrin e studentëve shqiptarë jashtë vendit dhe vështirësitë e tyre në vendet pritëse, në zbatim të masave nr. 64 dhe nr. 67.

~ Nënshkruar Marrëveshja ndërmjet Agjencisë Kombëtare të Diasporës në Shqipëri dhe Universitë Degli Studi E-Campus në Itali, datë 05.12.2018, me qëllim bashkëpunimin në fushën e kërkimit, mësimdhënies, zhvillimit teknologjik dhe inovacionit.

~ Në kuadër të Programit të Fondit të Ekselencës, duke filluar nga viti 2013 Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë ka financuar 50 studentë. Në fund të çdo viti kalendarik, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë publikon në faqen zyrtare listën e përfituesve të përditësuar. Këta studentë kanë kontratë me Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, e cila parashikon detyrimin për të punuar së paku 3 vjet në Shqipëri pas diplomimit në ciklin e studimeve për të cilin përfiton bursë.

Janar - Mars 2019:

~ Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, me shkresën nr. 695, datë 18.01.2019, informon për mundësinë e dy bursave të studimit për programin e shkollës verore nga Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve e Republikës Çeke.

- Miratuar Urdhri nr.47/2019 i Kryeministrit "Për caktimin e koordinatorit shtetëror për programet/donatorët, të cilët ofrojnë bursa studimi për jashtë vendit". Koordinator Shtetëror është caktuar z. Redi Shtino, zëvendësministër i Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

- Dërguar shkresa nr. 1152 Prot., datë 22.02.2019 Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, përmes së cilës i kërkohet hapja e një sektori të posaçëm për bursa.

- Ministri i Shtetit për Diasporën, me shkresën nr. 1576 Prot., datë 19.03.2019, i ka përcjellë Kryeministrit konkluzionet për zbatimin e Urdhrit nr. 135/2018 të Kryeministrit "Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për zbatimin e masës 64, të Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare për Diasporën".

- Miratuar Urdhri nr. 55/2019 i Kryeministrit "Për shfuqizimin e Urdhrave të Kryeministrit nr.135/2018, nr. 136/2018 dhe nr. 138/2018".

- Në kuadër të përmbushjes së masës 15 për vitin 2019, INSTAT ka filluar punën përgatitore për realizimin e Raportit Vjetor për vitin 2019. Në kuadër të zbatimit të kësaj mase, INSTAT do të përfshijë në raportin vjetor për vitin 2019 edhe masa të tjera të Planit të Veprimit si masat 30, 32, 33, 40, 41, 59, 60 dhe 64, me qëllim evidentimin dhe llogaritjen e disa indikatorëve. Për këtë çështje INSTAT ka filluar komunikimin zyrtar me institucionet përgjegjëse.

Prill - Qershor 2019:

- Koordinator Shtetëror për Programet/donatorët, të cilët ofrojnë bursa studimi për jashtë vendit, caktuar me Urdhrin nr. 47/2019, ka raportuar në mbledhjen e Komitetit Shtetëror për Diasporën se në zbatim të masës nr. 64 është ndërmarrë:

- a) analiza e çdo programi të veçantë financimi, bazuar mbi marrëveshjet e bashkëpunimit dypalësh, në funksion të vlerësimit për orientimin dhe rishikimin e tyre drejt fushave të ekspertizës për të cilat ka nevojë Shqipëria;
- b) përgatitja e metodologjisë për studimin e thelluar mbi numrin e studentëve shqiptarë jashtë vendit dhe të profilit të tyre të studimeve; dhe
- c) vlerësimi i negocimit me partnerët e huaj, për çdo program financimi, të përfshirjes së kushtit të kthimit në Shqipëri, ndër kushtet e akordimit të bursës.

- Projekti "Angazhimi i Diasporës Shqiptare në Zhvillimin Ekonomik dhe Social të Vendit" që financohet nga Kooperacioni Italian, përmes zyrës së IOM-it në Tiranë, filloi zbatimin e nismës së parë të bashkëveprimit të një grupi të studentëve shqiptarë nga Universiteti Italian i Firenze-s, Departamenti i Arkitekturës për të kontribuar në krijimin e një modeli zhvillimor në fshatrat Zvërnec, Nartë (Vlorë) si dhe Banjat e Bënjës (Përmet).

- Ministri i Shtetit për Diasporën, me shkresën nr. 3455 Prot., datë 28.06.2019 i ka kërkuar Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë hapjen e një sektori të posaçëm për Diasporën në këtë institucion.

Korrik - Shtator 2019:

- Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë me shkresën nr.2278/1 Prot., datë 24.07.2019

informon se krijimi i një sektori të posaçëm për diasporën pranë këtij institucioni nuk është i mundur pasi procedurat për bursat studimore jashtë Shqipërisë për studentë shqiptarë, sipas marrëveshjeve dypalëshe, ndiqen nga Drejtoria e Integritit, Koordinimit, Marrëveshjeve dhe Asistencës (DIKMA).

~ Koordinatori Shtetëror për Programet/donatorët të cilët ofrojnë bursa studimi për jashtë vendit, caktuar me Urdhrin nr. 47/2019 të Kryeministrit, z. Redi Shtino ka raportuar në mbledhjen e Komitetit Shtetëror për Diasporën, datë 17.09.2019 si më poshtë:

- a) Është në proces përditësimi lista e donatorëve që ofrojnë bursa studimi për jashtë vendit;
- b) Është ngritur Grupi i Punës për hartimin e strategjisë në arsim, ku do të identifikohen fushat prioritare dhe të ekspertizës për të cilat ka nevojë vendi.

~ Në datë 27 shtator 2019 Ministri i Shtetit për Diasporën, z. Pandeli Majko zhvilloi një takim me Ministrin për të Drejtat e Njeriut dhe të Pakicave në Qeverinë e Malit të Zi, z. Mehmet Zenka, ku u diskutua mbi çështjen e ofrimit të bursave dhe regjistrimin e nxënësve të Malit të Zi në universitetet në Shqipëri.

Tetor - Dhjetor 2019:

~ Shkolla e Magjistraturës, me shkresën Nr. 904 Prot., datë 18.11.2019 informon mbi iniciativën për fushatat e sensibilizimit të studentëve të drejtësisë dhe juristëve në Itali me qëllim prezantimin e reformës në sistemin e drejtësisë dhe mundësinë që ofrohet nga Shkolla për ndjekjen e formimit fillestar profesional nga studentë të juridikut si dhe avokatë e juristë që studiojnë dhe punojnë në Itali. Në kuadër të kësaj nisme u lehtësua koordinimi i vizitës së delegacionit të Shkollës së Magjistraturës në Itali dhe u mundësua takimi i tij me juristë, avokatë dhe profesionistë në fushën e drejtësisë.

Janar - Mars 2020:

~ Miratuar Urdhri Nr. 32, datë 10.02.2020 i Kryeministrit “Për një ndryshim në Urdhrin Nr. 47, datë 18.02.2019 të Kryeministrit, “Për caktimin e Koordinatorit Shtetëror për programet/donatorët të cilët ofrojnë bursa studimi për jashtë vendit” dhe Koordinator Shtetëror është caktuar z. Oltion Rrumbullaku, zëvendësministër në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

~ Me propozim të Ministrit të Shtetit për Diasporën dhe Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë është hartuar projektvendimi “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të studentëve të cilët studiojnë jashtë vendit dhe shtetasve të huaj me origjinë shqiptare të cilët përfitojnë bursa nga Shqipëria” në mënyrë që të identifikohen edhe programet që ofrojnë bursa studimi jashtë vendit. Qëllimi i këtij projektvendimi është krijimi për herë të parë i një baze të dhënash shtetërore të studentëve të cilët kryejnë studimet e larta jashtë vendit, studentëve shqiptarë të cilët kanë përfituar bursat e studimit të cilat i ofrohen Shqipërisë nga shtete, organizata ndërkombëtare dhe jofitimprurëse në bazë të marrëveshjeve të nënshkruara apo dokumente të tjera ku Qeveria e Republikës së Shqipërisë është palë, si dhe të studentëve të huaj me origjinë shqiptare të cilët janë përfitues të programeve të financuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.

Prill - Qershor 2020:

~ Me propozim të Ministrit të Shtetit për Diasporën është hartuar projektvendimi “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të studentëve të cilët studiojnë jashtë vendit dhe shtetasve të huaj me origjinë shqiptare të cilët përfitojnë bursa nga Shqipëria” në mënyrë që të identifikohen edhe programet që ofrojnë bursa studimi jashtë vendit. Qëllimi i këtij projektvendimi është krijimi për herë të parë i një baze të dhënash shtetërore të studentëve të cilët kryejnë studimet e larta jashtë vendit, si dhe adresimi i problematikave me të cilat ata përballen.

| Masa Nr.65 |

NË PROCES

Hartimi dhe miratimi i marrëveshjeve të nevojshme të përbashkëta me Kosovën dhe të veçanta për mbështetjen e mësimit të gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë. Rivlerësim për kuadrin ligjor lidhur me përgjegjësinë e shtetit shqiptar për të mundësuar mësimin e gjuhës shqipe për brezin e ri të komuniteteve shqiptare në diasporë.

INDIKATORËT: Marrëveshjet me Kosovën; Rivlerësim i kuadrin ligjor.

AFATI KOHOR: 6 mujori i parë 2019 (periodike)

INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:

- Ministri i Shtetit për Diasporën
- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
- Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë

Janar - Mars 2019:

~ Në funksion të "Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Rinisë dhe Sporteve dhe Ministrisë së Diasporës së Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës për organizimin e përbashkët të mësimit të gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare" datë 23.03.2015 është ngritur grupi i kurrikulës i cili pas disa takimesh ka finalizuar "Kurrikulën e mësimit plotësues të gjuhës shqipe dhe të kulturës Shqiptare në Diasporë dhe Mërgatë" nënshkruar nga ministrat përgjegjës të arsimit të Shqipërisë dhe Kosovës në maj 2018. Mbi bazën e kësaj kurrikule po punohet për çështjet e vlerësimit të teksteve shkollore dhe është në proces ngritja e komisionit të përbashkët për tekstet mësimore të arsimit në Diasporë.

~ Miratuar Vendimi nr. 697/2017, i Këshillit të Ministrave "Për miratimin në parim, të Marrëveshjes së bashkëpunimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës, për financimin dhe organizimin e përbashkët të mësimit të gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në Diasporë".

~ Në proces ngritja e komisionit të përbashkët për certifikimin e teksteve mësimore të arsimit në Diasporë.

Prill - Qershor 2019:

~ Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë me shkresën nr. 4410/1 Prot., datë 24.04.2019, propozon 3 anëtarë për komisionin e përbashkët për hartimin e teksteve të përbashkëta

për Diasporën.

~ Në datë 22 maj 2019 u mbledh për herë të parë Komisioni i Përbashkët i Shqipërisë dhe Kosovës. Anëtarët e Komisionit zgjodhën kryetarin e Komisionit, z. Nuhi Gashi, përfaqësues i Kosovës. Komisioni i Përbashkët i Shqipërisë dhe Kosovës për miratimin e teksteve mësimore për Diasporën vendosi hartimin e rregullores së funksionimit të Komisionit, nga përfaqësuesit e Kosovës brenda dy javëve nga data e takimit.

~ Në datat 26 dhe 27 qershor 2019, Komisioni i Përbashkët i Shqipërisë dhe Kosovës për Miratimin e Teksteve Mësimore për Diasporën zhvilloi mbledhjen e dytë në Prishtinë me qëllim planifikimin e punës për shpalljen e konkursit për hartimin dhe miratimin e teksteve mësimore për Diasporën. Në përfundim të këtij takimi komisioni vendosi që brenda vitit 2019 të shpallë konkursin për nivelin e parë për tekstet mësimore të përbashkëta për Diasporën. Ndërkohë, Komisioni do të përgatisë dokumentacionin për shpalljen e konkursit, duke filluar nga plotësimi i standarteve për tekstet për Diasporën. Komisioni hartoi dhe miratoi gjithashtu kalendarin e punës deri në miratimin përfundimtar të teksteve mësimore për Diasporën.

~ Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës organizuan programin e shkëmbimit “Si në Shtëpinë tënde” për 120 nxënës nga Shqipëria dhe Kosova. Ky program ka si qëllim integrimin e tyre në sistemin arsimor, qytetarisë dhe kulturës së vendit pritës, socializimit me komunitetin dhe forcimit të bashkëpunimit mes dy vendeve në fushën e arsimit dhe rinisë.

~ Dërguar shkresa nr. 2180 Prot., datë 17.04.2019 Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë për mbledhjen e Grupit të Përbashkët të punës për çertifikimin e teksteve të kurrikulës së përbashkët Shqipëri-Kosovë.

~ Zhvilluar takim ndërmjet Drejtores Ekzekutive të Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës dhe Drejtorit Ekzekutiv të “Innovation Centre Kosovo” mbi shkëmbimin e eksperiencave dypalëshe dhe identifikimin e praktikave më të mira për arritjen e objektivave të projektit dhe nxitjen e angazhimit të Diasporës.

~ Ministria e Kulturës, me shkresën nr. 6314 Prot., datë 26.04.2019, ka përcjellë kalendarin e përbashkët kulturor Shqipëri-Kosovë për vitin 2019.

Korrik - Shtator 2019:

~ Në 22-23 korrik u zhvillua në Vlorë mbledhja e tretë e Komisionit të Përbashkët të Shqipërisë dhe Kosovës për miratimin e teksteve të përbashkëta. Në këtë mbledhje u diskutuan dhe u hartuan standardet për tekstet e përbashkëta për Diasporën.

~ Në datat 31 korrik- 3 gusht 2019 Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e Republikës së Kosovës dhe Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë e Republikës së Shqipërisë organizuan Seminarin e XV të mësimit plotësues të gjuhës shqipe. Në këtë aktivitet mori pjesë edhe drejtoresha ekzekutive e Qendrës së Botimeve për Diasporën znj. Mimoza Hysa, e cila prezantoi para mësuesve misionin dhe vizionin e Qendrës së Botimeve për Diasporën, hapat e ndërmarrë për hartimin e teksteve të reja të përbashkëta për mësimdhënien në Diasporë, si dhe projektet e tjera për ruajtjen dhe përhapjen e gjuhës dhe kulturës shqiptare jashtë vendit. Qendra e Botimeve për Diasporën shpërndau për mësuesit “Udhëzuesin për mësimdhënien në Diasporë” botuar nga QBD-ja, si dhe materiale të tjera informuese.

Tetor - Dhjetor 2019:

~ Vijon komunikimi për vazhdimësinë e punës së Komisionit të Përbashkët Shqipëri - Kosovë për hartimin e teksteve shkollore të përbashkëta, pezulluar prej situatës zgjedhore në Kosovë.

Janar - Mars 2020:

~ Qendra e Botimeve për Diasporën vijon komunikimin për rinisjen e punës së Komisionit të Përbashkët Shqipëri - Kosovë, për përmbushjen e objektivave të përcaktuara nga marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Diasporës së Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës “Për organizimin e përbashkët të mësimit të gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në diasporë dhe në mërgatë” firmosur më 25 mars 2015.

Prill - Qershor 2020:

~ Qendra e Botimeve për Diasporën zhvilloi në muajin prill mbledhjen me Komisionin e Përbashkët Shqipëri-Kosovë për Miratimin e Teksteve Mësimore për Diasporën, i cili është ngritur në zbatim të marrëveshjes së miratuar midis dy shteteve “Për organizimin e përbashkët të mësimit të gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në Diasporë dhe mërgatë”. Në këtë mbledhje u diskutua për problematikat e hasura deri tani në punën e këtij komisioni dhe për mënyrën e procedimit në të ardhmen. Për shkak të situatës së krijuar, takimi u zhvillua online.

~ Nënshkruar Marrëveshja e Bashkëpunimit midis Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët (QSPA) dhe Bibliotekës Kombëtare të Kosovës “Pjetër Bogdani”. Në bazë të kësaj marrëveshjeje, pritet që të dyja institucionet të bashkëpunojnë për shkëmbimin e literaturës shkencore në funksion të hulumtimit të autorëve dhe të të dhënave mbi Arbëreshët. Gjithashtu, në qendër të marrëveshjes është edhe koordinimi në aspektin shkencor e profesional, në fushën e digjitalizimit të veprave mbi Arbëreshët, si dhe të veprimtarive të përbashkëta kulturoro-shkencore, mes të cilave shihet me përparësi promovimi i veprimtarive me karakter bibliografik, ekspozitave e botimeve.

~ Nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi midis Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët (QSPA) dhe Institutit Arkeologjik të Kosovës, i cili njihet si një ndër institucionet më të rëndësishme të Trashëgimisë Kulturore të Kosovës, dhe institucioni kryesor për shkencën e arkeologjisë në këtë vend.

~ Drejtoresha ekzekutive e Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët (QSPA), prof. Diana Kastrati, në kuadër të vizitës zyrtare në Prishtinë, ka zhvilluar një takim në mjediset e Institutit Albanologjik të Prishtinës (IAP), ku prof. Kastrati së bashku me studiuesen Vilma Proko janë takuar me Sekretarin Shkencor të IAP-së, prof. Lulëzim Lajçi dhe përgjegjës të sektorit të gjuhësisë pranë këtij institucioni, prof. Qemal Murati. Palët përfaqësuese të të dyja institucioneve kanë diskutuar në parim pikat dhe hapësirat e bashkëpunimit ndër-institucional dhe konkretizimin e tyre edhe zyrtarisht në takimin e radhës. Po ashtu, në kuadër të bashkëpunimit të mëtejshëm me institucionet kërkimore-shkencore u zhvillua takim zyrtar edhe në Institutin e Kosovës

për Mbrojtjen e Monumenteve. Studiuesit Qazim Namani, Emin Sallahu dhe përgjegjësja e bibliotekës, znj. Arbërie Demaçi bënë një prezantim të gjerë të botimeve të këtij Instituti, ku theksuan edhe fokusin kryesor të punës së tyre në rivlerësimin dhe mbrojtjen e monumenteve të kulturës kombëtare shqiptare.

~ Nënshkruar marrëveshja e bashkëpunimit mes Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët (QSPA) dhe Institutit të Historisë “Ali Hadri”, Kosovë. Në qendër të kësaj marrëveshjeje është shkëmbimi i literaturës shkencore, si dhe hartimi i projekteve të përbashkëta akademike në realizimin e hulumtimeve shkencore dhe në organizimin e veprimtarive të ndryshme mbi Arbëreshët. Drejtori Syla ka bërë një ekspozitë të punëve kryesore të institucionit që drejton dhe së bashku me prof. Kastratin kanë diskutuar hapësirat e mundshme të bashkëveprimit ndërinstitucional për vënien në jetë të shumë projekteve.

NË PROCES

Masa Nr. 66

Promovimi i programeve apo donatorëve të cilët ofrojnë bursa për studime jashtë vendit, për Shqipërinë. Organizimi i aktiviteteve për informimin në shkollat e mesme dhe të larta me qëllim njohjen e këtyre programeve dhe procedurave të aplikimit si nga pedagogët, studentët apo nxënësit.

INDIKATORËT: Programe me bursa studimi; Organizimi i aktiviteteve për informim.

AFATI KOHOR: 6 maji i dytë 2018 (periodike çdo vit)

INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:

- Ministri i Shtetit për Diasporën
- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
- Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë

Buletini 2018:

~ Në diskutime me zyrën e IOM në Tiranë për të realizuar termat e referencës për programe bursash për studentët në Diasporë apo sapo të diplomuar të zhvillojnë projekte të ndryshme në vendlindje. Në Ambasadën e Republikës së Shqipërisë në Romë dhe në Konsullatat në Bari dhe Milano janë shpallur termat e referencës për felloëships.

~ Programet që ofrojnë bursa studimi jashtë vendit publikohen në faqen zyrtare të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

~ Në datë 05.12.2018 është nënshkruar marrëveshje ndërmjet Agjencisë Kombëtare të Diasporës në Shqipëri dhe Universitë Degli Studi E-Campus në Itali, me qëllim bashkëpunimin në fushën e kërkimit, mësimdhënies, zhvillimit teknologjik dhe inovacionit.

~ Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë është në proces vlerësimi për organizimin në shkollat e mesme të ditëve të veçanta informuese apo panairë në muajt e fundit të mbylljes së Maturës Shtetërore për të dhënë informacion mbi mundësitë e nxënësve për të studiuar jashtë vendit.

Janar - Mars 2019:

~ Miratuar Urdhri nr.47/2019 i Kryeministrit "Për caktimin e koordinatorit shtetëror për programet/donatorët të cilët ofrojnë bursa studimi për jashtë vendit". Koordinator Shtetëror është caktuar z. Redi Shtino, zëvendësministër i Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

~ Ministri i Shtetit për Diasporën, me shkresën nr.1152, datë 22.02.2019, i propozon Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë krijimin e një sektori të posaçëm për bursat.

Prill - Qershor 2019:

~ Koordinator Shtetëror për Programet/donatorët të cilët ofrojnë bursa studimi për jashtë vendit, caktuar me Urdhrin nr. 47/2019 të Kryeministrit, z. Redi Shtino ka raportuar në mbledhjen e Komitetit Shtetëror për Diasporën se është ndërmarrë:

- a) analiza e çdo programi të veçantë financimi, bazuar mbi marrëveshjet e bashkëpunimit dypalësh, në funksion të vlerësimit për orientimin dhe rishikimin e tyre drejt fushave të ekspertizës për të cilat ka nevojë Shqipëria;
- b) përgatitja e metodologjisë për studimin e thelluar mbi numrin e studentëve shqiptarë jashtë vendit dhe të profilit të tyre të studimeve; dhe
- c) vlerësimi i negocimit me partnerët e huaj, për çdo program financimi, të përfshirjes së kushtit të kthimit në Shqipëri, ndër kushtet e akordimit të bursës.

~ Ministri i Shtetit për Diasporën, me shkresën nr. 3455 Prot., datë 28.06.2019, i ka kërkuar Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë hapjen e një sektori të posaçëm për Diasporën në këtë institucion.

Korrik - Shtator 2019:

~ Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, me shkresën nr. 9011 Prot., datë 18.06.2019 informon lidhur me takimin e zhvilluar me zv. Kryetarin e Këshillit të lartë të Arsimit të Turqisë, në kuadër të bashkëpunimit të dy vendeve, krijuar me " Memorandumin e Mirëkuptimit në fushën e Arsimit të Lartë" midis Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë të R. Sh. dhe Këshillit të Arsimit të Lartë të Turqisë. Ky memorandum synon forcimin e marrëdhënieve mes dy vendeve në fushën e arsimit të lartë, duke nxitur dhe mbështetur ofrimin e bursave për studentë, për njohjen e diplomave dhe mbështetjen për hapjen e departamenteve në gjuhën shqipe në institucionet e arsimit të Turqisë. Gjithashtu u dakordësua që të fillojnë procedurat e binjakëzimit midis universiteteve shtetërore të Shqipërisë dhe Turqisë bazuar në programin e projekteve të përbashkëta "Mevlana".

~ Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë me shkresën nr.2278/1 Prot., datë 24.07.2019 informon se krijimi i një sektori të posaçëm për diasporën pranë këtij institucioni nuk është i mundur pasi procedurat për bursat studimore jashtë Shqipërisë për studentë shqiptarë, sipas marrëveshjeve dypalëshe, ndiqen nga Drejtoria e Integritit, Koordinimit, Marrëveshjeve dhe Asistencës (DIKMA).

~ Koordinator Shtetëror për Programet/donatorët të cilët ofrojnë bursa studimi për jashtë vendit, caktuar me Urdhrin nr. 47/2019 të Kryeministrit, z. Redi Shtino ka raportuar në mbledhjen e Komitetit Shtetëror për Diasporën, datë 17.09.2019 se është

drejt përfudnimit lista e donatorëve që ofrojnë bursa studimi për jashtë vendit për studentët shqiptarë si dhe është ngritur grupi i punës për hartimin e strategjisë në arsim, ku do të identifikohen fushat prioritare dhe të ekspertizës për të cilat ka nevojë vendi.

Tetor - Dhjetor 2019:

~ Shkolla e Magjistraturës, me shkresën Nr. 904 Prot., datë 18.11.2019 informon mbi iniciativën për fushatat e sensibilizimit të studentëve të drejtësisë dhe juristëve në Itali me qëllim prezantimin e reformës në sistemin e drejtësisë dhe mundësinë që ofrohet nga Shkolla për ndjekjen e formimit fillestar profesional nga studentë të juridikut si dhe avokatë e juristë që studiojnë dhe punojnë në Itali. Në kuadër të kësaj nisme u lehtësua koordinimi i vizitës së delegacionit të Shkollës së Magjistraturës në Itali dhe u mundësua takimi i tij me juristë, avokatë dhe profesionistë në fushën e drejtësisë.

Janar - Mars 2020:

~ Miratuar Urdhri Nr. 32, datë 10.02.2020 i Kryeministrit “Për një ndryshim në Urdhrin Nr. 47, datë 18.02.2019 të Kryeministrit, “Për caktimin e Koordinatorit Shtetëror për programet/donatorët të cilët ofrojnë bursa studimi për jashtë vendit” dhe Koordinator Shtetëror është caktuar z. Oltion Rrumbullaku, zëvendësministër në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

~ Miratuar Vendimi Nr. 160, datë 19.02.2020 i Këshillit të Ministrave “Për mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer dhe të nëpunësve civilë (Fondi i Ekselencës). Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë në zbatim të këtij vendimi ka hapur shpalljen për aplikime në programin e Fondit të Ekselencës.

Prill - Qershor 2020:

~ Me propozim të Ministrit të Shtetit për Diasporën është hartuar projektvendimi “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të studentëve të cilët studiojnë jashtë vendit dhe shtetasve të huaj me origjinë shqiptare të cilët përfitojnë bursa nga Shqipëria” në mënyrë që të identifikohen edhe programet që ofrojnë bursa studimi jashtë vendit.

NË PROCES

| Masa Nr.67 |

Kryerja e një raporti vlerësues mbi vështirësitë e studentëve shqiptarë që studiojnë jashtë vendit dhe mbi faktorët që ndikojnë në këtë situatë. Organizimi në vendet pritëse për marrjen e masave për të mundësuar komunikimin dhe rrjetet funksionale në ndihmë të studentëve shqiptarë.

INDIKATORËT: Raporti vlerësues mbi vështirësitë e studentëve dhe faktorët ndikues; Organizimi në vendet pritëse për marrjen e masave.

AFATI KOHOR: 6 mujori i parë 2019 (periodike çdo vit)

INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:

- **Ministri i Shtetit për Diasporën**

- **Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme**
- **Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë**

Janar - Mars 2019:

~ Dërguar kërkesa për bashkëpunim zyres së IOM në Tiranë për kryerjen e një studimi mbi numrin e studentëve shqiptarë jashtë vendit dhe vështirësitë e tyre në vendet pritëse, në zbatim të masave 64 dhe 67.

~ Miratuar Urdhri nr.47/2019 i Kryeministrit "Për caktimin e koordinatorit shtetëror për programet/donatorët të cilët ofrojnë bursa studimi për jashtë vendit". Koordinator Shtetëror është caktuar z. Redi Shtino, zëvendësministër i Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

~ Ministri i Shtetit për Diasporën, me shkresën nr.1152, datë 22.02.2019, i propozon Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë krijimin e një sektori të posaçëm për bursat.

Prill - Qershor 2019:

~ Koordinator Shtetëror për Programet/donatorët të cilët ofrojnë bursa studimi për jashtë vendit, caktuar me Urdhrin nr. 47/2019 të Kryeministrit, z. Redi Shtino ka raportuar në mbledhjen e Komitetit Shtetëror për Diasporën se është ndërmarrë:

- a) analiza e çdo programi të veçantë financimi, bazuar mbi marrëveshjet e bashkëpunimit dypalësh, në funksion të vlerësimit për orientimin dhe rishikimin e tyre drejt fushave të ekspertizës për të cilat ka nevojë Shqipëria;
- b) përgatitja e metodologjisë për studimin e thelluar mbi numrin e studentëve shqiptarë jashtë vendit dhe të profilit të tyre të studimeve; dhe
- c) vlerësimi i negociimit me partnerët e huaj, për çdo program financimi, të përfshirjes së kushtit të kthimit në Shqipëri, ndër kushtet e akordimit të bursës.

~ Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës është në proces diskutimi për një projekt të veçantë me donatorët për zbatimin e masës nr. 67, me fokus shqiptarët që studiojnë jashtë vendit, komunikimin dhe rrjetet funksionale në ndihmë të tyre.

Korrik - Shtator 2019:

~ Koordinator Shtetëror për Programet/donatorët të cilët ofrojnë bursa studimi për jashtë vendit, caktuar me Urdhrin nr. 47/2019 të Kryeministrit, z. Redi Shtino ka raportuar në mbledhjen e Komitetit Shtetëror për Diasporën, datë 17.09.2019 lidhur me përditësimin e listave të donatorëve që ofrojnë bursa studimi për studentët shqiptarë jashtë vendit dhe ngritjen e Grupit të Punës për hartimin e strategjisë në arsim, ku do të identifikohen fushat prioritare dhe të ekspertizës për të cilat ka nevojë vendi.

Tetor - Dhjetor 2019:

~ Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës ka përgatitur projektin "Diaspora e-student", i cili synon krijimin e një platforme të dedikuar për studentët shqiptarë në Diasporë. Kjo platformë synon të jetë një plotësim ndaj platformës së profesionistëve në projektin "Diaspora për Zhvillim", e cila do të shërbejë si një mjet komunikimi, informimi dhe ndërlidhjeje me tregun e punës.

Janar - Mars 2020:

~ Në funksion të zhvillimit të platformës së Profesionistëve, Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës ka përgatitur projekt propozimin “Diaspora E-student”, i cili synon krijimin e një platforme të dedikuar për studentët shqiptarë në Diasporë. Kjo platformë do të shërbejë për studentët në diasporë si një mjet komunikimi, informimi dhe ndërlidhjeje me tregun e punës në vendin amë.

~ Me propozim të Ministrit të Shtetit për Diasporën dhe Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë është hartuar projektvendimi “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të studentëve të cilët studiojnë jashtë vendit dhe shtetasve të huaj me origjinë shqiptare të cilët përfitojnë bursa nga Shqipëria” në mënyrë që të identifikohen edhe programet që ofrojnë bursa studimi jashtë vendit. Qëllimi i këtij projektvendimi është krijimi për herë të parë i një baze të dhënash shtetërore të studentëve të cilët kryejnë studimet e larta jashtë vendit, si dhe adresimi i problematikave me të cilat ata përballen duke ju ardhur në ndihmë në shtetet ku studjojnë.

Prill - Qershor 2020:

~ Me propozim të Ministrit të Shtetit për Diasporën është hartuar projektvendimi “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të studentëve të cilët studiojnë jashtë vendit dhe shtetasve të huaj me origjinë shqiptare të cilët përfitojnë bursa nga Shqipëria” në mënyrë që të identifikohen edhe programet që ofrojnë bursa studimi jashtë vendit. Qëllimi i këtij projektvendimi është krijimi për herë të parë i një baze të dhënash shtetërore të studentëve të cilët kryejnë studimet e larta jashtë vendit, si dhe adresimi i problematikave me të cilat ata përballen nëpërmjet një Raporti Vjetor.

| Masa Nr.68 |

NË PROCES

Rivlerësimi i politikave me qëllim nxitjen e kthimit të migrantëve të kualifikuar. Vlerësimi i ofertës dhe i kërkesës për personel të kualifikuar, në tregun e punës shqiptar dhe krijimi i kontakteve ndërmjet migrantëve dhe ndërmarrjeve të mesme e të mëdha në Shqipëri, duke krijuar një bankë të dhënash elektronike me CV-në e migrantëve të kualifikuar.

INDIKATORËT: Nxitjen e kthimit të migrantëve të kualifikuar; Krijimi i një banke të dhënash elektronike me CV.

AFATI KOHOR: 6 mujori i dytë 2018 (periodike çdo vit)

INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:

- Ministri i Shtetit për Diasporën
- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
- Ministria e Brendshme
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë
- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
- Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë

Buletini 2018:

~ Dërguar shkresa nr. 4015 Prot., datë 3.9.2018 Ministrisë për Evropën dhe Punët e

Jashtme, Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, “Për zbatimin e masës Nr.68, të Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare për Diasporën 2018 - 2024”.

~ Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, me shkresën nr. 9062/1 Prot., datë 26.09.2018 ka dërguar listën e mësuesve të cilët kanë marrë pjesë në seminarin e 14-të, zhvilluar në Tiranë, në muajin gusht 2018. Kjo listë përfshin vetëm mësuesit që kanë aplikuar online dhe kanë pasur mundësi të marrin pjesë në këtë seminar.

~ Ministria e Financave dhe Ekonomisë në proces vlerësimi për Sistemin Informatik të Shërbimeve të Punësimit (SISHP) për të qenë lehtësisht i aksesueshëm dhe për të mundësuar krijimin e kontakteve ndërmjet migrantëve dhe ndërmarrjeve të mesme e të mëdha në Shqipëri.

~ Ministria e Brendshme ka përcjellë informacion mbi shtetasit e kthyer gjatë periudhës janar-gusht 2018, por Policia e Shtetit nuk ka informacion mbi kualifikimin e tyre. I nevojshëm rregullimi i kësaj çështjeje, e cila është në proces.

Janar - Mars 2019:

~ Miratuar Vendimi nr. 611/2018 i Këshillit të Ministrave “Për financimin e projektit “Diaspora për Zhvillim” dhe zbatimin e tij nga Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës”. Më datë 14 dhjetor 2018 u prezantua tek grupet e interesit, projekti “Diaspora për Zhvillim” i Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës.

~ Organizata “Jeta” me seli në Athinë, Greqi, organizoi me datë 16 mars 2019 Konferencën e III-të të Gruas me temë: “Roli i Gruas në Diasporë, kthimi në Atdhe, sfidat dhe perspektivat”. Pjesë e kësaj konference ishin dhe përfaqësues nga Agjencia Kombëtare e Diasporës dhe Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës.

Prill - Qershor 2019:

~ Miratuar Vendimi nr. 321, datë 15.05.2019 i Këshillit të Ministrave “Për financimin e projektit “Diaspora shkencore si një faktor ndryshimi në procesin e integritit evropian të Shqipërisë” dhe zbatimin e tij nga Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës”. Ky projekt u sugjerua gjatë punimeve të Samitit të Dytë të Diasporës dhe ka si qëllim angazhimin e Diasporës shkencore shqiptare dhe profesionistëve të kualifikuar, përmes zbatimit të strategjive kombëtare, me qëllim gjenerimin e transformimeve ekonomike dhe sociale në Shqipëri.

~ Në proces diskutimi me donatorët projeksioni i ndërtimit të modelit të rrjetit të profesionistëve në Diasporë, të koordinuar me agjenci shtetërore përgjegjëse.

~ Në diskutim konceptimi dhe fillimi i punës për krijimin e platformës elektronike “Connect Albania” për aktivizimin dhe ndërmjetësimin nga Diaspora të investimeve nga kompani të njohura të biznesit ndërkombëtar dhe lidhjen e tyre me bizneset vendase si dhe për identifikimin e mundësive për investime. Projekti do të financohet nga Zyra e Kooperacionit Italian në Shqipëri përmes IOM-it.

Korrik - Shtator 2019:

~ Në datat 27 - 28 shtator 2019 u zhvillua Takimi i XIV-të Ndërkombëtar “Kërkimi

Shkencor në Hapësirën Mbarëshqiptare dhe Roli i Diasporës Shkencore”, organizuar nga Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës në bashkëpunim me Institutin Albshkenca dhe mbështetjen e GIZ në Shqipëri. Në këtë aktivitet, i cili kishte si synim angazhimin e diasporës shkencore shqiptare dhe profesionistëve të kualifikuar përmes shkëmbimit efektiv të njohurive, morën pjesë rreth 400 të ftuar ndër të cilët studiues të shquar të Diasporës shkencore shqiptare, anëtarë aktivë të Institutit Alb-Shkenca, studiues të rinj të angazhuar në studime pasuniversitare dhe teza doktorature; përfaqësues nga Akademia e Shkencave në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni, politikbërës, institute kërkimore, think tanks, organizata të Diasporës, profesionistë të kthyer etj. Rreth 100 ekspertë lokalë dhe profesionistë të Diasporës kontribuan në mënyrë aktive në panelet tematike dhe seksionet e konferencave shkencore të këtij takimi. Kontributet e tyre u materializuan në dy publikime: Libri me Referimet dhe Diskutimet në Panelet Tematike dhe Book of Proceedings (Përmbledhjet e punimeve shkencore).

~ Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës me mbështetjen e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Ministrit të Shtetit për Diasporën do të organizojë Samitin e Grave të Biznesit në muajin në 18 janar 2020.

~ Agjencia Kombëtare e Diasporës, me mbështetjen e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministrit të Shtetit për Diasporën, do të organizojë Takimin e Mjekësisë në Diasporë në 22 shkurt 2020.

~ Qendra e Botimeve për Diasporën, me mbështetjen e Ministrisë së Kulturës dhe Ministrit të Shtetit për Diasporën, do të organizojë Takimin Mbarëkombëtar të Shkrimtarëve nga Diaspora “LETRA NGA DIASPORA” në 22 shkurt 2020. Ky takim do të ndihmojë në njohjen dhe promovimin e shkrimtarëve të Diasporës me lexuesit dhe botuesit shqiptarë dhe synon prezantimin e letërsisë së Diasporës, duke e kthyer në një traditë vjetore të letërsisë së migracionit shqiptar.

~ Qendra e Botimeve për Diasporën, me mbështetjen e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Ministrit të Shtetit për Diasporën, do të organizojë Takimin e Mësuesve të Diasporës në 14 mars 2020. Në qendër të vëmendjes së tij do të jetë mësimdhënia e gjuhës dhe kulturës shqiptare brenda dhe jashtë vendit, krijimi i kontakteve, diskutimet mbi literaturën shtesë për procesin e mësimdhënies në Diasporë.

~ Agjencia Kombëtare e Diasporës do të organizojë Takimin e Juristëve në Diasporë në 4 prill 2020. Agjencia Kombëtare e Diasporës po bashkëpunon me institucionet për identifikimin e aktorëve në fushën e drejtësisë, sigurimin e pjesëmarrjes dhe angazhimit të tyre aktiv.

Tetor - Dhjetor 2019:

~ Në kuadër të projektit “Diaspora për Zhvillim”, është në proces finalizimi zhvillimi i platformave “Rrjeti i Profesionistëve” dhe “Dhoma e Biznesit - Si të Bësh Biznes në Shqipëri”, platforma në të cilën është parashikuar regjistrimi dhe ndërveprimi i profesionistëve dhe bizneseve në Diasporë. Këto platforma do të shërbejnë për mbledhjen e të dhënave dhe krijimin e bazës së tyre si dhe hartëzimit. Platforma e profesionistëve, e cila parashikon ndarjen e të dhënave sipas kategorive, nënkategorive, si edhe pozicionit gjeografik do t’u japë mundësinë e regjistrimit në mënyrë autonome profesionistëve, duke krijuar kështu një bazë të dhënash dinamike e gjithmonë në rritje.

~ Në datën 14 dhjetor 2019, kryetarja e Këshillit Drejtues të Fondit Shqiptar për

Zhvillimin e Diasporës si dhe përfaqësues të Drejtorisë së Projekteve dhe Mbështetjes së Sipërmarrjes të FSHZHD-së kryen një takim pune me përfaqësues të Fondacionit Italian Magnia Grecia. Të dy institucionet kanë nënshkruar në prill 2019, një marrëveshje bashkëpunimi në fushën e kërkimit, studimeve dhe projekteve. Gjatë takimit u zhvillua prezantimi i platformës MyOurJob, si një sistem inovativ për orientimin e studentëve të rinj në zgjedhjen e profesioneve. Kjo platformë është implementuar dhe ka rezultuar një model i suksesshëm në disa prej vendeve të Europës. Në rastin specifik të Diasporës Shqiptare Myourjob mund të përbëjë lidhjen e domosdoshme midis nevojave të kompanive shqiptare, por edhe atyre që do të investojnë në Shqipëri, për sa i përket aftësive profesionale, dhe specializimeve të marra me kalimin e kohës nga studentët e rinj të Diasporës, duke sjellë kështu në vendin e tyre të origjinës “know how” dhe “kapitalin njerëzor” të kualifikuar dhe të duhur.

~ Për krijimin e rrjeteve të profesionistëve në komunitetet shqiptare në Diasporë, Agjencia Kombëtare e Diasporës, Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës dhe Qendra e Botimeve për Diasporën do të organizojnë disa takime gjatë vitit 2020:

- Në proces përgatitja e Samitit të Grave të Biznesit (16-18 janar 2020) i cili do të organizohet nga Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe Dhomën e Biznesit të Diasporës. Në këtë aktivitet do të marrin pjesë gra sipërmarrëse të Diasporës, profesioniste të reja, studente, akademike dhe eksperte në fushën e biznesit, përfaqësuese të institucioneve shtetërore, si dhe të organizatave ndërkombëtare.

- Takimi i Mjekësisë në Diasporë (20 shkurt 2020) - Në kuadër të përgatitjeve për takimin, janë dërguar rreth 100 ftesa elektronike për pjesëmarrje tek anëtarët e Diasporës shqiptare dhe është në proces hartimi i programit për takimin.

- Takimi i Shkrimtarëve në Diasporë (22 shkurt 2020) në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës. Është hapur formulari i aplikimit online, janë përzgjedhur autorët pjesëmarrës, si dhe është përgatitur agjenda e takimit.

- Takimi i Mësuesve në Diasporë (14 mars 2020) në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Është hapur formulari i aplikimit online për regjistrimin e mësuesve pjesëmarrës dhe është përgatitur agjenda e takimit.

- Takimi i Juristëve në Diasporë (4 prill 2020) - Agjencia Kombëtare e Diasporës me mbështetjen e Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrit të Shtetit për Diasporën do të organizojë takimin e juristëve në diasporë. Në proces hartimi i programit.

Janar - Mars 2020:

~ Krijuar Portali “Dhoma e Biznesit të Diasporës - Si të fillosh një biznes në Shqipëri”, i cili do të shërbejë si mekanizëm kryesor në krijimin dhe forcimin e rrjetit të bizneseve të Diasporës me ato vendase përmes dhënies së informacionit mbi legjislacionin, institucionet, njoftime, grante, dokumenta të ndryshme që ndihmojnë në krijimin apo transferimin e biznesit në Shqipëri, si dhe ofrimit të asistencës për bizneset e Diasporës në identifikimin e sektorëve me interes brenda vendit dhe iniciativat sipërmarrëse.

~ Me qëllim krijimin e rrjeteve të profesionistëve shqiptarë në diasporë, Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës po punon për plotësimin e platformës “Rrjeti i Profesionistëve të Diasporës”. Çdo qyetetar i interesuar jashtë vendit mund të krijojë profilin personal në platformë dhe ka mundësinë të kërkojë profesionistë të tjerë në botë, të ndarë në

kategori sipas fushës së veprimtarisë dhe vendndodhjes. “Rrjeti i Profesionistëve të Diasporës” do të ofrojë gjithashtu dhe informacion rreth procedurave të njohjes së titujve akademikë në Shqipëri, profesioneve të lira, si edhe aktiviteteve që angazhojnë profesionistë të fushave të ndryshme.

- Me qëllim krijimin e rrjeteve të profesionistëve në komunitetet shqiptare në Diasporë, në datat 16 - 18 janar 2020 Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, nën kujdesin e veçantë të Ministrit të Shtetit për Diasporën, organizoi Samitin e Grave në Biznes. Gjatë Samitit u ndanë përvojat e suksesit dhe projektet nga anëtarë të Diasporës shqiptare dhe përfaqësuese të biznesit vendas, si dhe u prezantuan platformat elektronike, “Rrjeti i Profesionistëve” dhe “Si të bësh biznes në Shqipëri” të Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës.

- Në datë 20 shkurt 2020, Agjencia Kombëtare e Diasporës, nën kujdesin e Ministrit të Shtetit për Diasporën dhe në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Fondin Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës, organizoi Takimin e Mjekësisë në Diasporë, ku profesionistët e suksesshëm të diasporës në fushën e mjekësisë patën mundësi të diskutojnë dhe të shkëmbejnë eksperiencat e tyre. Në këtë aktivitet Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale prezantoi platformat “Infermierë për Shqipërinë” dhe “Mjekë për Shqipërinë” që kanë për qëllim evidentimin e kërkesës për personel të kualifikuar mjekësor, në sistemin shëndetësor shqiptar dhe krijimin e kontakteve ndërmjet mjekëve në diasporë dhe institucioneve shqiptare në fushën e mjekësisë.

- Në datë 22 shkurt 2020, Qendra e Botimeve për Diasporën, në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës dhe nën kujdesin e Ministrit të Shtetit për Diasporën, organizoi Takimin e Shkrimtarëve në Diasporë. Ky takim, me synim krijimin e rrjeteve të profesionistëve në komunitetet shqiptare në Diasporë, mbledhi autorë, përkthyes, studiues dhe emra të njohur të letrave shqipe, brenda dhe jashtë vendit në një diskutim mbi letërsinë, gjuhën dhe vlerat atdhetare.

Prill - Qershor 2020:

- Në proces krijimi i Rrjetit të Profesionistëve në Diasporë si projekt i Fondit Shqiptar të Zhvillimit të Diasporës si një platformë që synon të mbështesë e të nxisë zhvillimin e Shqipërisë, duke ofruar një urë lidhëse për Diasporën, për të mbledhur dhe shkëmbyer informacione, në drejtim të përfshirjes së ekspertizës së anëtarëve të komuniteteve shqiptare në Diasporë në zhvillimin ekonomik të vendit si dhe në drejtim të gjenerimit të ideve dhe nismave me përfitim të përbashkët.

NË PROCES

| Masa Nr.69 |

Monitorimi i Planit Kombëtar të Veprimit mbi vlerësime 6 mujore dhe kryerja e raportimit në Komitetin Shtetëror për Diasporën. Raportimi në Nënkomisionin për Migracionin dhe Diasporën në Kuvendin e Shqipërisë për ecurinë e Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit. Nënkomisioni do të propozojë që për çështjen e trajtimit të migracionit dhe diasporës, Kuvendi çdo vit të miratojë një rezolutë për këtë çështje.

AFATI KOHOR: 6-mujori i Parë 2019 (periodike çdo vit)

INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:

- **Ministri i Shtetit për Diasporën**
- **Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme**

Janar - Mars 2019:

~ Dërguar shkresa me nr. 1827 Prot., datë 29.03.2019, “Raporti vjetor i punës për vitin 2018 të Agjencisë Kombëtare të Diasporës”, Komisionit për Politikën e Jashtme dhe Nënkomisionit për Diasporën dhe Migracionin, në Kuvendin e Shqipërisë.

~ Dërguar shkresa me nr. 1813 Prot., datë 29.03.2019, “Raporti vjetor i punës për vitin 2018 të Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës”, Komisionit për Politikën e Jashtme dhe Nënkomisionit për Diasporën dhe Migracionin, në Kuvendin e Shqipërisë.

Prill - Qershor 2019:

~ Ministri i Shtetit për Diasporën, me shkresën nr. 2137 Prot., datë 15.04.2019, ka përcjellë Buletinin nr. 1, mars 2019, tek Komisioni për Politikën e Jashtme dhe Nënkomisionin për Diasporën dhe Migracionin.

~ Në 3 maj 2019 u zhvillua mbledhja e Komitetit Shtetëror për Diasporën, ku koordinatorët shtetërorë bënë një prezantim të shkurtër të politikave të institucioneve të tyre lidhur me fushën e përgjegjësisë të secilit koordinator në raport me zbatimin e masave të Strategjisë Kombëtare të Diasporës. Koordinatorët shtetërorë të cilët raportuan në mbledhje janë si më poshtë:

- Koordinatori Shtetëror për marrëveshjet shtetërore në fushën e sigurimeve për shtetasit shqiptarë jashtë vendit - zëvendësministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, z. Etjen Xhafaj;
- Koordinatori Shtetëror për organizimin e programit vjetor të aktiviteteve për diasporën shqiptare - zëvendësministre e Turizmit dhe Mjedisit, znj. Ornela Çuçi;
- Koordinatori Shtetëror për marrëveshjet shtetërore në fushën e njohjes së lejeve të drejtimit të automjeteve për shtetasit shqiptarë jashtë vendit - zëvendësministri i Infrastrukturës dhe Energjisë, z. Artan Shkreli;
- Koordinatori Shtetëror për programet/donorët të cilët ofrojnë bursa studimi për jashtë vendit - zëvendësministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë, z. Redi Shtino; dhe
- Koordinatori Shtetëror për informimin e diasporës, drejtori i programimit dhe zhvillimit në Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), z. Fatjon Hallkaj.

~ Miratuar dhe dorëzuar raportimet vjetore të Agjencisë Kombëtare të Diasporës dhe Fondit Shqiptar të Zhvillimit të Diasporës në Nënkomisionin e Diasporës dhe Migracionit. Në pritje të miratimit të raportimeve të sipërpërmendura në këto struktura.

Korrik - Shtator 2019:

~ Në 17 shtator 2019 u zhvillua mbledhja e Komitetit Shtetëror për Diasporën, ku Ministri i Shtetit për Diasporën, z. Pandeli Majko raportoi mbi veprimtarinë e strukturave shtetërore për Diasporën dhe koordinatorët shtetërorë raportuan mbi

detyrat dhe zhvillimet e fundit sipas fushës së përgjegjesisë.

~ Janë emëruar znj. Lorena Haxhiu, me Urdhrin nr.112, datë 30.8.2019 të Kryeministrit “Për caktimin e koordinatorit shtetëror për realizimin e programit “Jam shqiptar” të gjuhës dhe kulturës shqipe” dhe znj. Fjoralba Cakaj, me Urdhrin nr. 92, datë 17. 05. 2019 të Kryeministrit “Për ngritjen e grupit të punës dhe caktimin e personit përgjegjës për mbrojtjen e të drejtave të shqiptarëve që vuajnë heqjen e lirisë jashtë vendit, të drejtave të migrantëve nëpërmjet informimit mbi mundësitë e ndryshme për të apeluar ndaj shkeljeve të të drejtave të tyre, në strukturat e vendeve pritëse si dhe në ato ndërkombëtare”.

Tetor - Dhjetor 2019:

Nuk ka informacion të ri për zbatimin e masës Nr. 69.

Janar - Mars 2020:

~ Agjencia Kombëtare e Diasporës ka publikuar Raportin Vjetor të veprimtarisë për vitin 2019⁸.

~ Ministri i Shtetit për Diasporën, me shkresën Nr. 945 Prot., datë 20.02.2020, i ka përcjellë Kuvendit Raportin Vjetor për vitin 2019 të Agjencisë Kombëtare për Diasporën, të Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës dhe Qendrës së Botimeve për Diasporën, si dhe Buletinin Nr. 4, dhjetor 2019 mbi zbatimin e masave të Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare të Diasporës.

~ Në datë 18 shkurt 2020, Agjencia Kombëtare e Diasporës, Qendra e Botimeve për Diasporën dhe Fondi Shqiptar për zhvillimin e Diasporës raportuan në Nënkomisionin për Diasporën dhe Migracionin në Kuvend mbi veprimtarinë e institucioneve përkatëse të realizuar gjatë vitit 2019.

Prill - Qershor 2020:

~ Nuk ka informacion të ri për zbatimin e kësaj mase.

NË PROCES

| Masa 70 |

Vlerësimi nga Nënkomisioni për Migracionin dhe Diasporën dhe Komiteti Shtetëror për Diasporën në mbledhje të veçanta i dokumenteve të:

- Raportimit me shkrim i Agjencisë kombëtare të Diasporës;
- Bankës së Shqipërisë për remitancat në Republikën e Shqipërisë;
- INSTAT-it për të dhënat vjetore për migracionin dhe diasporën;
- Institutit Shtetëror të Sigurimeve për informacionin vjetor për gjendjen e pensioneve dhe statusin e shtetasve jashtë vendit;
- Nga Ministria e Brendshme për gjendjen e regjistrimit të shtetasve shqiptarë jashtë vendit.

AFATI KOHOR: 6 mujori i dytë 2019 (periodike çdo vit)

⁸ <http://akd.gov.al/wp-content/uploads/2020/01/RAPORTI-VJETOR.pdf>

INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:

- Zëvendës-kryeministri
- Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme
- Ministri i Shtetit për Diasporën
- Ministria e Brendshme
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë
- Banka e Shqipërisë

Korrik - Shtator 2019:

~ Agjencia Kombëtare e Diasporës ka dërguar Raportin Vjetor 2018 në Nënkomisionin për Diasporën dhe Migracionin në Kuvendin e Shqipërisë.

Tetor - Dhjetor 2019:

~ Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës ka botuar Periodikun e Dytë, si një përmbledhje studimore për Diasporën shqiptare. Ky botim përmban studime kryesore të vitit 2019 për Diasporën dhe Migrimin si dhe analiza dhe raporte të institucioneve kombëtare dhe ndërkombëtare.

~ Agjencia Kombëtare e Diasporës ka botuar librin “Politika Shtetërore për Diasporën 2019”. Ky botim i posaçëm përmban të gjitha aktet e miratuara gjatë vitit 2019 për diasporën.

~ Në datën 24 dhjetor, Këshilli Koordinues i Botimeve për Diasporën mbajti mbledhjen e radhës, gjatë së cilës miratoi raportin vjetor të punës së Qendrës së Botimeve për Diasporën.

~ Në datën 30 dhjetor, Këshilli Drejtues i Agjencisë Kombëtare të Diasporës zhvilloi mbledhjen e radhës për miratimin e raportit vjetor të Agjencisë për vitin 2019.

~ Banka e Shqipërisë ka publikuar raportin vjetor “Diaspora dhe pagesat” për vitin 2019. Në këtë raport analizohet tregu i pagesave në Shqipëri dhe nevoja për reformim, kostot dhe kursimet e pagesave me vlerë të vogël në Shqipëri, si dhe statistika mbi remitancat.

~ Instituti i Statistikave (INSTAT) ka publikuar raportin vjetor “Diaspora e Shqipërisë në shifra” për vitin 2019. Ky publikim ofron një vlerësim të Diasporës shqiptare dhe profilit të saj mbi karakteristikat bazë demografike dhe sociale.

Janar - Mars 2020:

~ Ministri i Shtetit për Diasporën, me shkresën Nr. 945 Prot., datë 20.02.2020, i ka përcjellë Kuvendit Raportin Vjetor për vitin 2019 të Agjencisë Kombëtare të Diasporës, të Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës dhe Qendrës së Botimeve për Diasporën, si dhe Buletinin Nr. 4, dhjetor 2019 mbi zbatimin e masave të Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare të Diasporës.

~ Në datë 18 shkurt 2020, Agjencia Kombëtare e Diasporës, Qendra e Botimeve për Diasporën dhe Fondi Shqiptar për zhvillimin e Diasporës raportuan në Nënkomisionin për Diasporën dhe Migracionin në Kuvend mbi veprimtarinë e institucioneve përkatëse të realizuar gjatë vitit 2019.

Prill - Qershor 2020:

~ Ministri i Shtetit për Diasporën, me shkresën Nr. 2278/1 Prot., datë 30.04.2020, i ka përcjellë Nënkomisionit për Diasporën dhe Migracionin në Kuvend librin “Politika Shtetërore për Diasporën 2019”, i cili përmban të gjitha aktet dhe dokumentet kryesore të miratuara gjatë vitit 2019 për Diasporën.

NË PROCES

| Masa 71 |

Vlerësimi, diskutimi dhe propozime për ndryshime për dokumentin e Strategjisë Kombëtare dhe planin e veprimit në Samitin e Diasporës Shqiptare. Këto propozime do shikohen si nismëtare për të kryer ndryshimet e mundshme.

AFATI KOHOR: 6-mujori i dytë 2018 (periodik)

INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:

- Ministri i Shtetit për Diasporën
- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme

Buletini 2018:

~ Në kuadër të projektit “Për Angazhimin e Diasporës Shqiptare për Zhvillimin Social dhe Ekonomik të Shqipërisë” në bashkëpunim me zyrën e IOM në Tiranë, financuar nga Kooperacioni Italian, ka filluar puna për rivlerësimin e Strategjisë Kombëtare të Diasporës 2018 - 2024 dhe Planit të Veprimit. Rivlerësimi i Strategjisë po realizohet edhe me mbështetje të ekspertizës ndërkombëtare në funksion të buxhetimit të detajuar të masave sipas institucioneve përgjegjëse.

Janar - Mars 2019:

~ Gjatë organizimit të Samitit të Dytë të Diasporës në datat 28 shkurt deri më 2 mars, u zhvillua sesion i veçantë dedikuar dokumentit “Post Samit”, me qëllim vlerësimin e propozimeve për rishikimin e dokumentit të Strategjisë Kombëtare për Diasporën dhe për realizimin e dokumentit përfundimtar të Samitit të Dytë të Diasporës.

~ Zyra e IOM në Tiranë ka organizuar dy takime të veçanta në datat 15 janar dhe 19 shkurt me koordinatoret e Agjencisë Kombëtare për Diasporën si edhe me grupin e koordinatorëve për zbatimin e Strategjisë Kombëtare ngritur me Urdhrin nr. 98/2018, të Kryeministrit “Për përcaktimin e grupit të koordinatorëve për zbatimin e Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare për Diasporën 2018-2024”.⁹

Prill - Qershor 2019:

~ Në kuadër të projektit “Për Angazhimin e Diasporës Shqiptare për Zhvillimin Social dhe Ekonomik të Shqipërisë” në bashkëpunim me zyrën e IOM në Tiranë, financuar nga

⁹ <https://diaspora.gov.al/diskutimi-mbi-angazhimin-e-diaspores-ne-zhvillimin-social-dhe-ekonomik-te-shqiperise/>

zyra e Kooperacionit Italian, është përgatitur dokumenti me propozime për ndryshimin e Strategjisë Kombëtare të Diasporës dhe Planit të Veprimit 2018 - 2024. Në këtë dokument është realizuar edhe kostimi i masave të Planit të Veprimit. Ky dokument do të jetë i hapur për konsultime dhe sugjerime përmirësuese në proces.

Korrik - Shtator 2019:

~ Në kuadër të diskutimeve të zhvilluara gjatë Samitit të Dytë të Diasporës lidhur me rishikimin e Strategjisë Kombëtare të Diasporës, ekspertët e Organizatës Ndërkombëtare për Migracion (IOM) kanë propozuar disa ndryshime në Strategjinë Kombëtare të Diasporës. Rishikimi i Strategjisë do të realizohet në tri faza. Aktualisht, dokumenti i ndryshuar i Strategjisë Kombëtare të Diasporës 2021 - 2025 është i hapur për konsultim në faqen zyrtare të Ministrit të Shtetit për Diasporën www.diaspora.gov.al.

Tetor - Dhjetor 2019:

~ Vazhdon procesi i rishikimit të Strategjisë Kombëtare të Diasporës dhe Planit të Veprimit 2021 -2025. Agjencia Kombëtare e Diasporës ndjek dhe mbledh opinionet e konsultimit publik në platformën elektronike www.konsultimipublik.gov.al edhe nëpërmjet emailit zyrtar info@akd.gov.al.

Janar - Mars 2020:

~ Vijon procesi i konsultimit publikit për projekt Strategjinë Kombëtare të Diasporës 2021- 2025, të rishikuar me ndihmën e ekspertëve të zyrës në Tiranë të Organizatës Ndërkombëtare të Migracionit (IOM).

Prill - Qershor 2020:

~ Në datë 26.05.2020 u zhvillua mbledhja e parë e grupit ndërinstitucional të punës për rishikimin e Strategjisë Kombëtare të Diasporës. Qëllimi i mbledhjes ishin detyrat e grupit të punës, mbi bazën e propozimeve e diskutimeve nga anëtarët e tij, për rishikimin e masave të Planit të Veprimit, të cilat do të paraqiten për miratim brenda muajit korrik 2020.

~ Në datë 19.06.2020 u zhvillua mbledhja e dytë e grupit ndërinstitucional të punës për rishikimin e Strategjisë së Re Kombëtare të Diasporës. Gjatë takimit virtual, ministri Majko prezantoi draftin e Strategjisë dhe kërkoi sugjerimet e anëtarëve të grupit lidhur me rishikimin e masave të Planit të Veprimit. Strategjia e rishikuar do të paraqitet për miratim në muajin korrik 2020.

NË PROCES

| Masa Nr.72 |

Përcaktimi i indikatorëve të cilët do të evidentojnë nivelin e zbatimit të masave të vendosura nga kjo strategji. Detyrimi i institucioneve përgjegjëse për zbatimin e strategjisë për hartimin e raporteve vjetore të masave të marra duke përfshirë të dhëna sasiore edhe cilësore të monitorimit, bazuar në indikatorët e përcaktuar.

AFATI KOHOR: 6-mujori i Parë 2019 (periodik çdo vit)

INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:

- **Ministri i Shtetit për Diasporën**
- **Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme**

Janar - mars 2019:

- ~ Samiti i Dytë i Diasporës u organizua në datat 28 shkurt deri 2 mars 2019.
- ~ Sesioni kryesor i diskutimit të Samitit u organizua në 4 panele me tematikat e mëposhtme:
 - Paneli I: “Vota si e Drejtë! Politika e Re Shtetërore Për Diasporën”;
 - Paneli II: “Zhvillimi Ekonomik i Qëndrueshëm” Vendlindja dhe Diaspora;
 - Paneli III: “Identiteti Shqiptar e ardhmja fillon nga Diaspora!”;
 - Paneli IV: Tema e diskutimit ishte “Ftesë nga Shtëpia Juaj”.
- ~ Në Sesionin përfundimtar u paraqitën konkluzionet nga institucionet të cilat ishin pjesë e paneleve në Samitin e Dytë të Diasporës në funksion të përgatitjes së dokumentit “Post-Samit” i cili do të diskutohet në vazhdim me palët e interesuara. Hartimi i këtij dokumenti do të realizohet nën kujdesin e zyrës së IOM në Tiranë.
- ~ Në kuadër të rishikimit të Strategjisë Kombëtare të Diasporës, Ministri i Shtetit për Diasporën dhe Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (IOM) mundësuan zhvillimin e dy takimeve me Grupin e Koordinatorëve.¹⁰ Pjesë e takimeve ishin edhe ekspertë të cilët rishikuan Planin e Veprimit, përfshirë indikatorët e masave.

Prill - Qershor 2019:

- ~ Në kuadër të projektit “Për Angazhimin e Diasporës Shqiptare për Zhvillimin Social dhe Ekonomik të Shqipërisë” në bashkëpunim me zyrën e IOM në Tiranë, financuar nga zyra e Kooperacionit Italian, është përgatitur dokumenti me propozime për ndryshimin Strategjisë Kombëtare të Diasporës dhe Planit të Veprimit 2018 - 2024. Në këtë dokument është realizuar edhe kostimi i masave të Planit të Veprimit. Ky dokument do të jetë i hapur për konsultime dhe sugjerime përmirësuese në proces.
- ~ Miratimi i raportimeve vjetore të Agjencisë Kombëtare të Diasporës dhe Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës në Komitetin Shtetëror të Diasporës (3 maj 2019). Raportimet vjetore u dërguan në Nënkomisionin për Diasporën dhe Migracionin në Kuvendin e Shqipërisë.

Korrik - Shtator 2019:

- ~ Në kuadër të diskutimeve të zhvilluara gjatë Samitit të Dytë të Diasporës lidhur me rishikimin e Strategjisë Kombëtare të Diasporës ekspertiza e Organizatës Ndërkombëtare për Migracion (IOM) ka propozuar disa ndryshime në Strategjinë Kombëtare të Diasporës.
- ~ Rishikimi i Strategjisë Kombëtare do të kalojë në disa faza:
 - Faza e Parë do të jetë periudha për mbledhjen e opinionëve me shkrim nga

¹⁰ <https://diaspora.gov.al/diskutimi-mbi-angazhimin-e-diaspores-ne-zhvillimin-social-dhe-ekonomik-te-shqiperise/>

- individë dhe ekspertë të ndryshëm (nëntor 2019)
- Faza e Dytë do të jetë diskutimi në publik i projekt-dokumentit të Strategjisë Kombëtare të Diasporës (mars 2020)
 - Faza e Tretë do të jetë përmbledhja dhe miratimi i Strategjisë Kombëtare (qershor 2020)

Projekti i dokumentit të ndryshuar të Strategjisë Kombëtare të Diasporës 2021 - 2025 është i hapur për konsultimin publik në faqen zyrtare të Ministrisë të Shtetit për Diasporën www.diaspora.gov.al.

Tetor - Dhjetor 2019:

~ Vazhdon procesi i rishikimit të Strategjisë Kombëtare të Diasporës dhe Planit të Veprimit 2021 -2025. Agjencia Kombëtare e Diasporës ndjek dhe mbledh opinionet e konsultimit publik në platformën elektronike www.konsultimipublik.gov.al edhe nëpërmjet emailit zyrtar info@akd.gov.al.

Janar - mars 2020:

~ Vijon procesi i konsultimit publikit për projekt Strategjinë Kombëtare të Diasporës 2021- 2025, të rishikuar me ndihmën e ekspertëve të zyrës në Tiranë të Organizatës Ndërkombëtare të Migracionit (IOM).

Prill - Qershor 2020:

Në datë 26.05.2020 dhe 19.06.2020 janë zhvilluar mbledhjet e grupit ndërinstitucional të punës për rishikimin e Strategjisë Kombëtare të Diasporës. Janë ndarë detyrat e grupit të punës dhe janë në proces sugjerimet e anëtarëve të grupit lidhur me rishikimin e masave të Planit të Veprimit. Strategjia Kombëtare e Diasporës dhe Plani i Veprimit 2021 - 2025 do të paraqiten për miratim në muajin korrik 2020.

